



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 7

Tiranë – E premte, 15 janar 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe	
Ligj nr. 160/2020, datë 17.12.2020	Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Integritimit Evropian, dhe Komisionit Evropian për Programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA II, Shqipëri–Kosovë, 2014–2020, alokimet për vitin 2019.....	1315
Dekret i Presidentit nr. 11898, datë 5.1.2021	Për shpallje ligji.....	1377
Ligj nr. 166/2020, datë 23.12.2020	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar.....	1377
Dekret i Presidentit nr. 11913, datë 12.1.2021	Për shpallje ligji.....	1379
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1117, datë 16.12.2020	Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021–2027 dhe të planit të veprimit 2021–2023.....	1379
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1144, datë 24.12.2020	Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të objektit “ <i>Atrium Center Thumana</i> ”, Njësia Administrative Thumanë, Bashkia Krujë, dhe caktimin e Bashkisë Krujë si njësi zbatuese.....	1448
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1145, datë 24.12.2020	Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të objektit arsimor shkolla 9-vjeçare “Hajdar Zogu”, fshati Tapizë, Njësia Administrative Nikël, Bashkia Krujë, dhe caktimin e Bashkisë Krujë si njësi zbatuese.....	1449
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1150, datë 24.12.2020	Për miratimin e marrëveshjes së grantit dhe projektit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për programin e rindërtimit të ndërtesave publike (faza I).....	1449
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 238, datë 21.12.2020	Mbi kërkesën e shoqërisë “Wenerg” sh.a., për marrjen e autorizimit të ERE-s, për barrësimin e 100% të aksioneve të shoqërisë në favor të bankës OTP Albania sh.a. (ish-Societe Generale Albania sh.a.).....	1457

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 239, datë 21.12.2020	Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Wenerg” sh.a. për barrësim të aseteve (makineri dhe pajisje) në favor të “O’TP Albania” sh.a., për efekt të ristrukturimit të kredisë, për fondet e përdorura, me qëllim financimin e ndërtimit të HEC “Dardha 1”.....	1458
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 242, datë 21.12.2020	Mbi licencimin e shoqërisë “HEC Zall Xhuxhë” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	1460
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 243, datë 21.12.2020	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “ES 2019” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	1461
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 245, datë 21.12.2020	Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Greentech Energy Systems” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	1462
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 246, datë 21.12.2020	Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Greentech Energy Systems” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.....	1463
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 247, datë 21.12.2020	Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Energy Supply - AL” sh.p.k., për rinovimin e licencës nr. 310, seria F11/FK15, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	1464
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 248, datë 21.12.2020	Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Energy Supply - AL” sh.p.k., për rinovimin e licencës nr. 309, seria T11/T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	1465
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 250, datë 21.12.2020	Mbi kërkesën e shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 89, datë 6.8.2008, të ndryshuar.....	1467
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 251, datë 21.12.2020	Mbi kërkesën e shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 90, datë 6.8.2008, të ndryshuar.....	1468
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 253, datë 21.12.2020	Mbi kërkesën e shoqërisë “E-Vento SRL Albania” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 84, datë 17.7.2008, të ndryshuar.....	1470
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 254, datë 21.12.2020	Mbi kërkesën e shoqërisë “Hera” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 61, datë 2.11.2007, të ndryshuar.....	1471
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 255, datë 21.12.2020	Mbi propozimin e OST sh.a. për treguesit e kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike, për vitin 2021.....	1473

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 256, datë 21.12.2020	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullores për integritetin dhe transparencën e tregut me shumicë të energjisë (REMIT)”.....	1475
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 257, datë 21.12.2020	Mbi miratimin e Programit të Pajtueshmërisë së OSSH sh.a.....	1476
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 258, datë 21.12.2020	Mbi korrigjimin e pagesave rregullatore, për vitin 2020, për disa nga të licencuarit e sektorit të energjisë.....	1482
	Korrigjim gabimi material në vendimin nr. 1084, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike dhe planit të veprimit, 2020–2025”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 233, datë 30.12.2020.....	1485



LIGJ
Nr. 160/2020

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
SË FINANCIMIT NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
PËRFAQËSUAR NGA KËSHILLI I
MINISTRAVE, REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E INTEGRIMIT EVROPIAN,
DHE KOMISIONIT EVROPIAN PËR
PROGRAMIN E BASHKËPUNIMIT
NDËRKUFITAR IPA II, SHQIPËRI-
KOSOVË, 2014–2020, ALOKIMET PËR
VITIN 2019**

Në mbështetje të neneve, 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Integrimit Evropian, dhe Komisionit Evropian për programin e bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Shqipëri–Kosovë, 2014–2020, alokimet për vitin 2019, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 17.12.2020.

**Shpallur me dekretin nr. 11898, datë 5.1.2021
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Ilir Meta**

**MARRËVESHJA E FINANCIMIT
KUSHTET E VEÇANTA**

Komisioni Evropian, në vijim i referuar si “Komisioni” ose “pala”, i cili vepron në emër të Bashkimit Evropian, në vijim i referuar si “Bashkimi”, nga njëra anë, dhe Republika e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave dhe Kosova*¹, e përfaqësuar nga Ministria e Integrimit Evropian, që në vijim referohen bashkërisht si “përfituesit e IPA II” ose veçmas si “përfituesja e IPA II” ose “pala”, nga ana tjetër, dhe bashkërisht të referuara si “palët”, kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Programi i veprimit

1. Bashkimi bie dakord të financojë dhe përfituesit e IPA II bien dakord të pranojnë financimin për alokimet e vitit 2019 të Programit të Veprimit në vijim, siç përshkruhet në shtojcën I:

Programi i Veprimit të Bashkëpunimi Ndërkufitar Shqipëri–Kosovë, për vitet 2018–2020 (numri i angazhimit (CRIS): 2019/041-457).

Ky Program Veprimi financohet nga Buxheti i Bashkimit në bazë të aktit themelor në vijim: Instrumenti për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II)².

Kostoja e totale e llogaritur për fondet e vitit 2019 të këtij Programi Veprimi është 1,411,764 euro dhe kontributi maksimal i Bashkimit për këtë Program Veprimi është vendosur 1.200.000 euro.

Nuk kërkohet kontribut financiar nga përfituesit e vendeve IPA II.

Neni 2

**Periudha e ekzekutimit dhe periudha e
zbatimit operacional**

1. Siç përcaktohet në nenin 1(1) të shtojcës II, periudha e ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje

¹ Ky përcaktim nuk cenon qëndrimet mbi statusin dhe, në përputhje me rezolutën 1244/1999 të UNSCR-së dhe opinionin e GJND-së për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

² Rregullorja nr. 231/2014 (BE) e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 11 mars 2014, që krijon një Instrument për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II), OJ L 77, 15.3.2014, f. 11.



Financimi është caktuar 12 vjet nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje Financimi.

Marrëveshje e Financimit BNK për programet vjetore IPA II, Kushtet e veçanta, versioni 1.2

2. Siç përcaktohet në nenin 1(2) të shtojcës II, periudha e zbatimit operacional të kësaj Marrëveshjeje Financimi është caktuar 6 vjet nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje Financimi.

Neni 3

Adresat dhe komunikimi

I gjithë komunikimi në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi duhet të jenë në formë të shkruar, duke iu referuar shprehimisht Programit të Veprimit, siç identifikohet në nenin 1(1) dhe do të dërgohet në adresat e mëposhtme:

a) Për Komisionin:

Drejtoria e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat për Zgjerimin (DG NEAR) Directorate D

Rue de la Loi 15

B-1049 Brussels

Belgjikë

Adresa e *email*-it: NEAR-D4@ec.europa.eu

b) Për përfituesit e IPA II:

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

Bulevardi “Gjergj Fishta”, nr. 6

Tiranë, Shqipëri

Adresa e *email*-it: info@mfa.gov.al

Ministria e Integritimit Evropian

Godina e Qeverisë, kati 9, zyra 905.910

Rruga “Nënë Tereza”, 10000, Prishtinë, Kosovë

Adresa e *email*-it: mei@rks-gov.net

Neni 4

Pikat e kontaktit të OLAF-it

Pikat e kontaktit e përfituesit IPA II, që kanë kompetencat e duhura për të bashkëpunuar drejtpërdrejt me Zyrën Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF), me qëllim lehtësimin e aktiviteteve të OLAF-it, do të jenë:

Z. Bejko Late

Drejtor i Sektorit të Inspektimit Financiar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të Shqipërisë

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, Tiranë, Shqipëri

Bejko.late@financa.gov.al

Dhe

Ministria e Integritimit Evropian

Nënë Tereza, 14, Ndërtesa e re qeveritare, zyra 910

10000, Prishtinë, Kosovë

E-mail: mei@rks-gov.net

Neni 5

Marrëveshjet Kuadër

Programi i Veprimit do të zbatohet në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Komisionit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë mbi marrëveshjet për zbatimin e asistencës financiare të Unionit për Shqipërinë nën Instrumentin e Asistencës së Paraaderimit (IPA II), i cili ka hyrë në fuqi më 16 prill 2015 dhe në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Komisionit Evropian dhe Kosovës mbi masat për zbatimin e asistencës financiare të Unionit për Kosovën nën Instrumentin e Asistencës së Paraaderimit (IPA II), i cili ka hyrë në fuqi më datë 16 prill 2015, përkatësisht (më poshtë e/të referuar/a si “Marrëveshje/t Kuadër”).

Kjo Marrëveshje Financimi plotëson dispozitat e Marrëveshjeve Kuadër të lartpërmendura. Në rast konflikti midis dispozitave të Marrëveshjes së Financimit, nga njëra anë, dhe dispozitave të Marrëveshjes Kuadër përkatëse nga ana tjetër, do të kenë përparësi këto të fundit.

Neni 6

Shtojcat

1. Kjo Marrëveshje Financimi përbëhet nga:

a) Këto kushte specifike;

b) Shtojca I: Programi i Veprimit të Bashkëpunimit Ndërkufitar Shqipëri–Kosovë për vitet 2018–2020;

c) Shtojca IA: Programi IPA BNK Shqipëri - Kosovë;

d) Shtojca II: Kushtet e përgjithshme;

e) Shtojca III: Modeli i Raportit Vjetor BNK mbi zbatimin e asistencës IPA II (neni 80 i Marrëveshjes Kuadër;



f) Shtojca IIIA: Modeli i raportit vjetor mbi zbatimin e asistencës IPA II, në përputhje me nenin 58 të Marrëveshjes Kuadër;

2. Në rast të një konflikti midis dispozitave të shtojcave, nga njëra anë, dhe dispozitave të Kushteve speciale, nga ana tjetër, do të kenë përparësi këto të fundit. Në rast konflikti midis dispozitave të shtojcës I dhe shtojcës IA, nga njëra anë, dhe dispozitave të shtojcës II, nga ana tjetër, do të zbatohen këto të fundit. Në rast konflikti midis dispozitave të shtojcës I dhe shtojcës IA do të zbatohen dispozitat e para.

Neni 7 Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje e Financimit do të hyjë në fuqi në datën kur Komisioni merr njoftim nga vendi i fundit përfitues i IPA II, i cili konfirmon përfundimin e procedurave të brendshme të përfituesit të IPA II, të nevojshme për hyrjen e tij në fuqi. Komisioni duhet të informojë përfituesit IPA II për datën e marrjes së këtij njoftimi. Nëse

Komisioni nuk merr njoftim deri më 31 dhjetor 2020, kjo Marrëveshje Financimi nuk hyn në fuqi.

Kjo Marrëveshje është hartuar në tri kopje origjinale në gjuhën angleze, nga të cilat një do t'i dorëzohet Komisionit dhe dy të tjerat përfituesve IPA II.

Për përfituesin IPA II:

Për Republikën e Shqipërisë:
Z. Zef Mazi
Koordinatori Kombëtar i IPA-së
Kryenegociator

Tiranë, datë 21 tetor 2020

Për Kosovën:

Avdullah Hoti
Kryeministër

Prishtinë, datë 26 nëntor 2020

Për Komisionin:

Znj. Genoveva Ruiz Calavera
Drejtoresh D, Ballkani
Perëndimor
Drejtorja e Përgjithshme për
Negociatat e Zgjerimit dhe
Fqinjësinë
Komisioni Evropian

Bruksel, datë 10 qershor 2020

SHTOJCA 1

KY DOKUMENT PËRBËN PROGRAMIN SHUMËVJEÇAR TË PUNËS BAZUAR NË NENIN 110(2) TË RREGULLORES (BE, EURATOM) 2018/1046

1. Identifikimi

Përfituesit	Shqipëria dhe Kosova*
Referenca e angazhimit financiar CRIS/ABAC Kontributi i Unionit Linja buxhetore	2018/041-401 - euro 1,200,000.00 - 22.020401 2019/041-457 - euro 1,200,000.00 - 22.020401 2020/041-459 - euro 1,080,000.00 - 22.020401
Mënyra e menaxhimit Strukturat përgjegjëse	Menaxhim i drejtpërdrejtë nga Komisioni Evropian (Delegacioni i BE-së në Shqipëri) Për Shqipërinë: Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme Për Kosovën: Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Afati për nënshkrimin e Marrëveshjes/ve të Financimit me vendet përfituese të IPA II (trepalëshe)	Për alokimin buxhetor të vitit 2018: deri më 31 dhjetor 2019 Për alokimin buxhetor të vitit 2019: deri më 31 dhjetor 2020 Për alokimin buxhetor të vitit 2020: deri më 31 dhjetor 2021
Afati për përfundimin e prokurimeve dhe kontratat e grantit	3 vjet pas datës së nënshkrimit të Marrëveshjes së Financimit (nënshkruar nga pala e fundit), me përjashtim të rasteve të renditura në nenin 189(2) të Rregullores Financiare

* Ky përcaktim është pa paragjykuar statusin dhe është në përputhje me rezolutën 1244/1999 të UNSCR-së dhe opinionin e GJND-së për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.



Afati për zbatimin operacional	6 vjet pas datës së nënshkrimit të Marrëveshjes së Financimit
Afati për zbatimin e Marrëveshjes së Financimit (datë në të cilën ky program duhet të jetë mbyllur dhe të jetë përfunduar angazhimi i fondeve), pas pranimin të llogarive)	12 vjet pas datës së nënshkrimit të Marrëveshjes së Financimit

2. PËRSHKRIMI I PROGRAMIT TË VEPRIMIT

2.1 PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME I PROGRAMIT TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR 2014–2020 DHE PROGRAMI VEPRIMIT BNK 2018–2020

Programi BNK Shqipëri–Kosovë 2014–2020 u miratua nga Komisioni me vendimin zbatues C(2014) 9574 në dhjetor 2014*. Programi i miratuar përbën strategjinë e bashkëpunimit BNK për rajonin kufitar, duke përcaktuar midis të tjerash, listën e zonave gjeografike të lejuara, kontekstin e zonës, prioritetet tematike të programit dhe alokimet treguese buxhetore për periudhën 7-vjeçare.

Programi BNK Shqipëri–Kosovë, 2014–2020, shërben gjithashtu si referencë për miratimin e programeve të veprimit BNK. Programi i veprimit BNK 2018–2020 synon të sigurojë ndihmë për bashkëpunimin ndërkufitar në zonat tematike të përcaktuara në vitet 2014–2020 të këtij programi (siç tregohet në seksionin 2.2).

Më 6 shkurt 2018, Komisioni Evropian miratoi komunikatën me temë “Një perspektivë e besueshme e zgjerimit për angazhim të zgjeruar të BE-së me Ballkanin Perëndimor”⁸. Kjo komunikatë synon të avancojë më tej reformën në Ballkanin Perëndimor dhe të sigurojë një angazhim të dukshëm për zgjerimin e BE-së, për të mbështetur më mirë përgatitjet e tyre në rrugën evropiane. Komunikata përcakton orientimet e reja strategjike, veçanërisht në lidhje me zbatimin e gjashtë iniciativave kryesore.

Në veçanti, bashkëpunimi ndërkufitar është një mjet kyç për nxitjen e pajtimit dhe trajtimin e trashëgimisë së të kaluarës në Ballkanin Perëndimor, në përputhje me iniciativën kyçe 6 (mbështetje për pajtimin dhe marrëdhëniet e

fqinjësisë së mirë) dhe për zhvillimin e qëndrueshëm lokal, në përputhje me iniciativën kyçe 3 (mbështetje e zhvillimit socio-ekonomik).

Lista e zonave gjeografike të lejuara

Zona e programit ndërkufitar mbulon një territor prej 8,335 km² me një popullsi që arrin në rreth 936.761 banorë, nga të cilët 76% jetojnë në territorin e Kosovës dhe 24% në anën shqiptare të zonës së programit. Gjatësia e vijës kufitare është 114 km. Në Shqipëri zonat përfituese përfshijnë rajonet e Kukësit dhe të Lezhës (8 bashki me një total prej 362 vendbanime), duke mbuluar 48% të zonës së programit. Në Kosovë, zonat përfituese përfshijnë Rajonin Ekonomik Perëndimor dhe Rajonin Ekonomik Jugor (12 bashki), duke mbuluar 52% të zonës së programit.

Konteksti i zonës së lejuar të bashkëpunimit ndërkufitar

Rajoni kufitar ka një ekonomi kryesisht agrare, me industrinë më të zhvilluar në anën e Kosovës, ndërsa rajonet shqiptare bazohen më shumë në bujqësi dhe shërbime. Sektori i bujqësisë ka një rëndësi shumë të madhe për zhvillimin ekonomik dhe punësimin, duke qenë se një pjesë e madhe e popullsisë ende jeton në zonat rurale, pavarësisht lëvizjeve të fundit të konsiderueshme drejt zonave urbane. Aktiviteti i bujqësisë është kryesisht një aktivitet ekonomik familjar dhe i orientuar drejt mbijetesës edhe për shkak se fragmentimi i tokës është mjaft i lartë dhe madhësia e fermave bujqësore është mesatarisht 1.5 hektarë. Përmirësimi i infrastrukturës rurale dhe menaxhimi më i mirë i burimeve ujore janë prioritet të rëndësishme për të rritur produktivitetin e sektorit.

Konkurrenca dhe shkëmbimi i përvojës janë mjaft të ulëta në të gjithë zonën e programit dhe kërkon investime të mëtejshme si kombëtare dhe ndërkombëtare për t'u zgjeruar. Aftësitë e punës nuk i përgjigjen kërkesës së tregut për shërbime dhe produkte me cilësi të lartë. Industria e lehtë, veçanërisht për përpunimin e ushqimit, ka potencial të konsiderueshëm për të përsheptuar rritjen ekonomike. NMV-të dominojnë hartën e bizneseve, ndërsa rrjeti i biznesit dhe bashkëpunimi

* Vendimi Zbatues i Komisionit C (2014) 9574 i 11 dhjetorit 2014.

⁸ https://ec.europa.eu/commission/sites/beta-political/files/communication-credible-enlargement-perspective-western-balkans_en.pdf



i biznesit përtej kufirit është ende i pashfrytëzuar. Prodhimet vendore kanë pak ose aspak qasje në tregjet rajonale dhe ndërkombëtare. Mekanizmat për mbështetjen e biznesit janë të dobëta dhe të pamjaftueshme, duke qenë pak më aktive në Kosovë.

Papunësia mbetet në një shkallë shqetësuese për popullatën e zonës së programit, sidomos në anën kosovare, ku ka një papunësi shumë më të lartë, veçanërisht në mesin e të rinjve, popullsinë rurale dhe grave (në disa zona ajo e tejkalon 50%). Shërbimet sociale janë pak të zhvilluara dhe në mënyrë të pabarabartë. Përmirësimi i sistemit arsimor në të gjitha nivelet është një përparësi e madhe për zonën e programit, veçanërisht në zonat rurale. Projektet e përbashkëta mund të ndërmerren për të krijuar një rrjet të qendrave të formimit profesional dhe të nxisë bashkëpunimin në të gjitha institucionet e arsimit të lartë, agjencitë kërkimore dhe organizatat. Avantazhet që vijnë nga gjuha e përbashkët duhet të shfrytëzohen edhe më tej në zhvillimin e kurrikulave arsimore.

Trashëgimia e pasur historike-kulturore-artistike e zonës është një vlerë e shtuar për zhvillimin ekonomik, por turizmi është ende një mundësi e humbur. Llojet e ndryshme të turizmit (malor, kulinar dhe agroturizmi) mund të zhvillohen; vendndodhjet historike dhe kulturore meritojnë një transparencë më të madhe dhe veçoritë tradicionale mund të promovohen më mirë.

Mbrojtja e mjedisit ka nevojë për konsideratë serioze. Shtimi i vlerave të burimeve natyrore është një çështje e rëndësishme për të rritur atraktivitetin e rajonit kufitar dhe për të përmirësuar cilësinë e jetës për qytetarët. Sfidat kryesore me të cilat përballen autoritetet lokale janë ulja e ndotjes, menaxhimi i mbetjeve urbane, cilësia e ujit të pijshëm, mbrojtja e tokës nga shkatërrimi natyror dhe artificial, procesi i planifikimit strategjik urban dhe përdorimi efikas i burimeve të energjisë.

Duke marrë parasysh aspektet problematike që ndikojnë në ekonominë e zonës dhe zhvillimin e saj të qëndrueshëm, programi do të fokusohet në prioritetet e mëposhtme tematike, ku nismat e bashkëpunimit ndërkufitar mund të ketë një vlerë të shtuar reale:

1. Mbrojtja e mjedisit, përshtatja dhe zbutja e ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i riskut;

2. Turizmi dhe trashëgimia natyrore dhe kulturore;

3. Rinia dhe arsimiti, me fokus nxitjen e punësimit.

Përmbledhja e përvojës BNK të kaluar dhe në vazhdim, duke përfshirë mësimet e nxjerra

Në përgatitjen e këtij programi janë marrë në konsideratë rekomandimet kryesore nga vlerësimet e përkohshme dhe auditimet mbi programet BNK 2007–2013. Kështu, programet BNK 2014–2020 janë më të përqendruara në lidhje me numrin e prioritetëve tematike të adresuara dhe zonave të lejuara gjeografike, të cilat do të ndihmojnë në arritjen e një rezultati më të mirë dhe rritjes së ndikimit. Përveç kësaj, zbatimi i programeve BNK është thjeshtuar kryesisht duke pasur një autoritet të vetëm kontraktues dhe një paketë të vetme financiare për çdo program.

Mësimet kryesore të nxjerra u identifikuan edhe nga vlerësimi përfundimtar i Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA), programet BNK 2007–2013, që u realizua midis viteve 2016 dhe 2017. Mësimet e nxjerra dhe rekomandimet u diskutuan me palët e interesuara të BNK-së në Ballkanin Perëndimor dhe masat për ndjekje u identifikuan për një afat të shkurtër dhe të mesëm, si për programet BNK 2014–2020 në vijim, ashtu edhe për programet e ardhshme BNK 2021–2027. Rekomandimet kryesore në lidhje me të gjitha programet BNK në nivelin e Ballkanit Perëndimor përfshijnë:

- objektivi kryesor për të promovuar marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë duhet të reflektohet qartë në projektet e BNK-së;

- thirrjet për propozime duhet të përqendrohen më shumë në pak çështje prioritare që kanë interes të lartë ndërkufitar;

- logjika e ndërhyrjes së programeve dhe sistemet e raportimit dhe monitorimit duhet të përmirësohen, pasi nuk janë të strukturuar për të vendosur një bazë të qartë për matjen e rezultateve në nivelin rajonal;

- ekziston nevoja për vazhdimin e aktiviteteve për rritjen e kapaciteteve për strukturat operuese dhe sekretariatet e përbashkëta teknike/antenat;

- ekziston nevoja për përmirësimin e sinergjive me politikat dhe donatorët e tjerë, kapitalizimin dhe shkëmbimin e përvojave me instrumentet e tjera të BNK-së (si, p.sh., INTERREG (Programi i



Bashkëpunimit Ndërrajonal) dhe Instrumenti Evropian për fqinjësinë (ENI) Programet BNK.

2.2 PËRSHKRIMI DHE ZBATIMI I PROJEKTEVE 2018–2020

Aktiviteti 1	Projektet e Bashkëpunimit Ndërkufitar	3,480,000 euro
--------------	---------------------------------------	----------------

Ndihma e parashikuar për Shqipërinë dhe Kosovën konsiderohet se ndjek kushtet dhe procedurat e përcaktuara nga masat kufizuese të miratuara në bazë të nenit 215 TFEU*.

1. Përshkrimi i programit, objektivi dhe rezultatet e pritshme

Përshkrimi i programit

Operacionet e bashkëpunimit ndërkufitar në rajonin kufitar në fushat e mjedisit, përshtatjes dhe zbutjes së ndryshimeve klimatike, parandalimit dhe menaxhimit të rreziqeve; turizmi dhe trashëgimia kulturore dhe natyrore dhe rinia dhe arsimit me fokus në krijimin e punësimit.

Objektivi

Zhvillimi socioekonomik dhe forcimi i marrëdhënieve të fqinjësisë në zonën ndërkufitare përmes zbatimit të projekteve të bashkëpunimit ndërkufitar që synojnë:

a) mbrojtjen e mjedisit dhe promovimin e adaptimit dhe zbutjes së ndryshimeve klimatike, parandalimin dhe menaxhimin e rreziqeve, ndër të tjera: veprime të përbashkëta për mbrojtjen e mjedisit; promovimin e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, efikasitetin e burimeve, burimet e rinovueshme të energjisë dhe zhvendosjen drejt një ekonomie të ulët dhe të qëndrueshme të karbonit; nxitjen e investimeve për të trajtuar rreziqet specifike, sigurimi i zbutjes së fatkeqësive dhe zhvillimi i sistemeve të menaxhimit të fatkeqësive dhe gatishmërive në raste emergjence;

b) inkurajimin e turizmit dhe i trashëgimisë kulturore dhe natyrore;

c) investimi në të rinj, arsim dhe aftësi përmes, ndër të tjera, zhvillimin dhe implementimin e arsimit të përbashkët, formimin profesional, skemat e trajnimit dhe infrastrukturën që mbështesin aktivitetet e përbashkëta rinore.

Rezultatet e pritshme

a) burimet mjedisore dhe biodiversiteti janë menaxhuar më mirë dhe promovuar;

b) cilësia e shërbimeve dhe e produkteve të turizmit është përmirësuar dhe është më konkurruese; trashëgimia kulturore, historike dhe natyrore është mbrojtur më mirë dhe është promovuar;

c) qasja në arsim për të rinjtë është përmirësuar; aftësitë janë forcuar për të përmbushur kërkesat e tregut të punës; shkëmbimet dhe bashkëpunimi i të rinjve është rritur.

Objektivat dhe rezultatet e pritshëm do të arrihen gjatë periudhës së zbatimit të këtij programi, nga viti 2014 deri në vitin 2020. Programi i Veprimit BNK 2018–2020 do të kontribuojë në arritjen e objektivave të përgjithshëm dhe rezultatet e pritshme të përcaktuara në programin BNK 2014–2020. Për detaje të mëtejshme shihni seksionin 3.2 të programit BNK 2014–2020 (aneksi 2 i Komisionit Zbatues - vendimi C (2014) 9574 të 11 dhjetor 2014).

2. Supozimet dhe kushtet

Si kusht i nevojshëm për menaxhimin efektiv të programit, vendet pjesëmarrëse do të ngrenë një Komitet të Përbashkët Monitorues dhe do të sigurojnë zyrat dhe stafin e duhur për Sekretariatit e Përbashkët Teknik (që do të ngrihet me një vendim të veçantë financimi) dhe Zyrën e Antenës.

Mosrespektimi i kërkesave të lartpërmendura mund të çojë në kthimin mbrapsht të fondeve në kuadër të këtij programi dhe/ose rialokimin e fondeve të ardhshme.

Deri më tani, përfituesit janë pajtuar me këto kushte, duke siguruar krijimin e Sekretariatit të Përbashkët Teknik në Kukës dhe Zyrës së Antenave në Prizren. Këto struktura janë financuar plotësisht nga masat mbështetëse për asistencë teknike për programet e bashkëpunimit ndërkufitar ndërmjet përfituesve të IPA II, nën instrumentin e ndihmës parapruese (IPA II) për vitin 2014 C (2014) 37629. Ndihma e mëtejshme financiare është programuar nga Komisioni Evropian, e cila do të vazhdojë të sigurojë mbështetje për Sekretariatit e Përbashkët Teknik dhe Zyrën e Antenave nga viti 2019 e në vazhdim. Për këtë arsye do të vendosen marrëveshje të reja me përfituesit të cilët duhet të sigurojnë që kushtet e këtij paragrafi të respektohen në vazhdim.

* https://ec.europa.eu/headquarters/headquarters-homepage/8442/consolidated-list-sanctions_en



3. Modalitetet e zbatimit

3.a) Menaxhimi direkt nga Komisioni

Granti – Thirrja për propozime: 3,480,000 euro

Janë parashikuar dy lloje thirrjesh:

i. Thirrje për projektpropozime për ndërhyrje strategjike me një ndikim të rëndësishëm (ose strategjik) ndërkufitar.

Siç u përmend në programin CBC 2014–2020, Shqipëri–Kosovë, përfituesve u jepet mundësia që të konsiderojnë përdorimin e një pjese të alokimit financiar të programit (p.sh., një ose dy nga alokimet vjetore) për të financuar një ose më shumë projekte strategjike, në lidhje me prioritetet tematike:

1. “Mbroytja e mjedisit, përshtatja dhe zbutja e ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rreziqeve”; dhe

2. “Turizmi dhe trashëgimia kulturore dhe natyrore”.

Projektet strategjike përcaktohen si ndërhyrje që kanë një ndikim domethënës ndërkufitar në të gjithë zonën e programit, të cilat, në mënyrë të pavarur ose në kombinim me projekte të tjera strategjike, kontribuojnë në mënyrë thelbësore në arritjen e objektivave kryesorë në nivelin prioritar.

Disa kriteret të përgjithshme për zgjedhjen e projekteve strategjike do të ishin: ndikimi në të dyja anët e zonës së programit; lidhje me strategji rajonale ose të tjera për zhvillimin e zonave kufitare; niveli i kontributit dhe bashkëfinancimi nga autoritetet rajonale; numri i popullsisë që përfiton nga ndërhyrja; efektiviteti i kostos së ndërhyrjes; në mënyrë plotësuese me veprime paralele dhe qëndrueshmëri të ndërhyrjes. Për më tepër, këto projekte duhet të kenë një dokumentacion të plotë të tenderit dhe, në rast të investimeve në infrastrukturë, përveç vlerësimeve të nevojshme të ndikimit në mjedis, të gjitha lejet e nevojshme për vendndodhjen dhe ndërtimin.

Përmes konsultimeve ndërmjet përfituesve (d.m.th. Shqipërisë dhe Kosovës) të lehtësuar nga Delegacioni i BE-së në Shqipëri, llojet e aktiviteteve që do të financohen do të identifikohen në përputhje me seksionin 3.2, “Përshkrimi i përparësive të programit” të programit CBC 2014–2020 (shtojca 2 e vendimit zbatues të Komisionit C (2014) 9574 të 11 dhjetorit 2014) dhe, më pas, Autoriteti Kontraktues i Programit do të publikojë një thirrje të hapur për propozime.

ii. Thirrje për propozim

Aktivitetet e pranueshme janë të përcaktuara në seksionin 3.2 të programit ndërkufitar 2014–2020 (shtojca 2 e vendimit zbatues të Komisionit C (2014) 9574 të 11 dhjetorit 2014). Lista e mëposhtme është një përmbledhje që tregon veprimet/projektet kryesore të lejuara:

- Fushatat e ndërgjegjësimit mjedisor; ndërhyrje infrastrukture mjedisore në shkallë të vogël dhe prokurimi i pajisjeve; sisteme monitorimi të integruara mjedisore; përgatitja e strategjive rajonale dhe planeve të veprimit për menaxhimin e mbetjeve të ngurta, erozionin e tokës dhe parandalimin dhe zvogëlimin e rreziqeve artificiale dhe fatkeqësive natyrore (p.sh., ripyllëzimin dhe shërbimet e emergjencave civile); studime të përbashkëta në fushën e energjisë efektive; projekte në shkallë të vogël të energjisë së rinovueshme.

- Ndërhyrje në shkallë të vogël rikonstruksioni, modernizimi dhe restaurimi për të lehtësuar tërheqjen turistike (p.sh., përmirësimin e vendeve potenciale turistike) dhe prokurimin e pajisjeve; zhvillimin e itinerareve tematike turistike të përbashkëta; promovimi i nismave të përbashkëta të turizmit; integrimi i trashëgimisë historike brenda ofertave turistike; hartat turistike (p.sh., historike dhe gastronomi); zhvillimin dhe promovimin e markave rajonale ekzistuese/të reja të produkteve tipike lokale (p.sh., produktet agrorushqimore dhe punës me dorë); promovimi i teknikave të reja të marketingut të turizmit (p.sh., përdorimi i TIK-ut dhe multimedia); organizimi i festivale lokale, panairë dhe konkurse.

- Nismat e vetëpunësimit dhe fuqizimit të rinisë; mbështetje ndaj fillimit të bizneseve të reja; nisma të përbashkëta për të parandaluar braktisjen e shkollës; kurrikula të përbashkëta dhe programe trajnimi profesionale dhe arsimore për brezat e rinj; shkëmbime njohurish dhe trajnime për kualifikime të reja për mësuesit; aktivitetet e përbashkëta të agjencive të punësimit; aktivitetet e krijimit të rrjeteve (p.sh., turne sportive, festivale dhe veprimtari kulturore e muzikore).

3.b) Elemente të veçanta të veprimit

- Kriteret thelbësore të pranueshmërisë

Përfituesit duhet të jenë persona juridikë dhe të vendosur në një nga vendet përfituese të IPA II që merr pjesë në programin BNK.

Përfituesit potencialë mund të jenë: autoritetet lokale, qeveritë lokale dhe institucionet e tyre,



shoqatat e bashkive, agjencitë e zhvillimit, organizatat mbështetëse të biznesit lokal, faktorët ekonomikë, si NVM-të, organizatat turistike dhe kulturore, OJQ-të, sindikatat e punës, institucionet e trajnimit teknik dhe profesional, organet dhe organizatat për mbrojtjen e natyrës, institucionet publike përgjegjëse për menaxhimin e ujit, shërbimet e zjarrit/emergjencave, shkollat, kolegjet, universitetet dhe qendrat kërkimore, duke përfshirë institucionet e trajnimit teknik dhe profesional.

b) Kriteret thelbësore të përzgjedhjes janë kapaciteti financiar dhe operacional i aplikantit.

c) Kriteret kryesore për financimin: janë relevanca, efektiviteti, qëndrueshmëria dhe fizibiliteti, dhe kosto-efektiviteti i veprimit.

d) Shkalla maksimale e bashkëfinancimit të BE-së për grante në bazë të thirrjeve është 85% e vlerës së lejueshme të projektit.

e) Shuma indikative e thirrjes (s) (pjesë e BE): 3,480,000 EUR, nga të cilat 2.040,000 EUR do të ndahen për thirrjen për ndërhyrje strategjike dhe 1,440,000 për thirrjen e dytë.

Strukturat përgjegjëse mund të vendosin për të publikuar më shumë thirrje për projektpropozime. Çdo thirrje për propozime do të ketë të njëjtët objektiva, rezultate dhe kriteret thelbësorë lejueshmërie, përzgjedhje dhe kontraktimi, siç përkruhet më sipër. Strukturat përgjegjëse mund të vendosin të bashkojnë alokimet e vitit 2019 me alokimet e mëvonshme të buxhetit.

f) Datë treguese për fillimin e thirrjes (s) për propozime:

Semestri i parë 2020 për angazhimin buxhetor për vitin 2018: fillimin e një thirrje për propozim për veprime standarde në prioritetet 1, 2 ose 3 (të konfirmohet në konsultim me përfituesit dhe Komitetin e Përbashkët të Monitorimit dhe duke marrë parasysh nevojën për t'u përqendruar më shumë, bën thirrje për propozime, siç theksohet në paragrafin 2.1). Numri tregues i granteve që do të akordohen: 3 deri 4.

Semestri i parë 2022: për angazhimet buxhetore 2019 dhe 2020: lëshimi i thirrjes për propozim për veprime strategjike. Vlera totale 2,040,000 EUR, për ndarjen nga 1 deri në 2 grante.

3. BUXHETI

	2018			2019			2020			Vendimi i financimit total		
	Financimi i Unionit*	Bashkëfinancimi i përfituesit/ve†	Totali i Shpenzimeve	Financimi i Unionit	Bashkëfinancimi i përfituesit/ve	Totali i Shpenzimeve	Financimi i Unionit	Bashkëfinancimi i përfituesit/ve	Totali i Shpenzimeve			
Projektet BNK	1,200,000	211,765	1,411,765	Projektet BNK	1,200,000	211,765	1,411,765	Projektet BNK	1,080,000	190,588.00	1,270,588.00	3,480,000
në %	85	15	100	85	15	100	85	15	100			
TOTALI 2018	1,200,000	211,765	1,411,765	TOTALI 2016	1,200,000	211,765	1,411,765	TOTALI 2017	1,080,000	190,588.00	1,270,588.00	4,094,116.00

* Kontributi i Unionit është llogaritur në lidhje me shpenzimet e pranueshme, i cili bazohet në shpenzimet totale të pranueshme, përfshirë shpenzimet publike dhe private. Shkalla e bashkimit të financimit të Bashkimit në nivelin e secilit tematikë të pavarësisë nuk duhet të jetë më e vogël se 20% dhe jo më e lartë se 85% e shpenzimeve të pranueshme.

† * Bashkëfinancimi i këtyre temave do të sigurojë ai nga përfituesit e grantit. Përfituesit e grantit duhet të kontribuojnë me një minimum prej 5% të koston totale të pranueshme të projektit



5. MARRËVESHJET E MONITORIMIT TË PERFORMANCËS

Si pjesë e kuadrit të saj, matjes së performancës, Komisioni do të monitorojë dhe vlerësojë progresin drejt arritjes së objektivave specifike të përcaktuara në Rregulloren e IPA-së II mbi bazën e treguesve të matshëm, të paracaktuar, të qartë, transparentë. Raportet e progresit të përmendura në nenin 4 të Rregullores së IPA II do të merren si pikë referimi në vlerësimin e rezultateve të asistencës IPA II.

Komisioni do të mbledhë të dhëna të performancës (ecuria, rezultatet dhe treguesit e rezultateve) nga të gjitha burimet, të cilat do të mblidhen dhe të analizohen në aspektin e përcjelljes së progresit kundrejt objektivave dhe pikave kyçe të përcaktuar për secilin nga veprimet e këtij programi, si dhe në Dokumentin Strategjik Kombëtar.

Koordinatorët Kombëtarë IPA (NIPAC) do të mbledhin informacion mbi performancën e projekteve dhe programeve (ecuria, rezultatet dhe treguesit e rezultateve) dhe do të koordinojnë mbledhjen dhe paraqitjen e treguesve që rrjedhin nga burimet kombëtare.

Progresi i përgjithshëm do të monitorohet nëpërmjet mënyrave të mëposhtme: a) Sistemi i monitorimit i orientuar drejt rezultateve (ROM); b) monitorimi i vetë përfituesit IPA II; c) vetëmonitorimi i kryer nga delegacionet e BE-së; d) monitorimi i përbashkët nga Drejtoria e Përgjithshme për Zgjerim dhe Përfituesit IPA II, ku pajtueshmëria, koherenca, efektiviteti, efikasiteti dhe koordinimi në zbatimin e asistencës financiare do të monitorohen rregullisht nga një komision monitorues IPA II, mbështetur nga KPM-ja, i cili do të sigurojë një proces monitorimi në nivel programi.

Progresi i përgjithshëm do t'i nënshtrohet vlerësimit i cili do të bëhet pas zbatimit të aktiviteteve.

SHTOJCA I A INSTRUMENTI PËR ASISTENCËN E PARAANËTARËSIMIT (IPA) 2014–2020

Programi IPA CBC SHQIPËRI–KOSOVË* MIRATUAR MË 11.12.2014

Pasqyra e lëndës

Përmbledhje

Seksioni 1: Përmbledhje

1.1 Përmbledhje e programit

1.2 Përgatitje e programit dhe përfshirja e partnerëve

Seksioni 2: Zona e programit

2.1 Analiza e situatës

2.2 Konstatimet kryesore

Seksioni 3: Strategjia e programit

3.1 Argumentimi - Arsytimi për strategjinë e përzgjedhur për fushat e ndërhyrjes

3.2 Përshkrimi i prioriteteve të programit

3.3 Çështjet horizontale dhe ndërsektoriale

Seksioni 4: Plani financiar

Seksioni 5: Dispozitat zbatuese

* Ky emërtim nuk cenon qëndrimet në lidhje me statusin dhe është në pajtim me rezolutën 1244/1999 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe me opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND) për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.



LISTA E SHTOJCAVE

SHTOJCA 1: Situata dhe analiza SWOT - Hyrje

Përmbledhje

Titulli i programit	Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar Shqipëri–Kosovë, 2014–2020
Zona e programit	<u>Shqipëri:</u> -Rajoni i Lezhës -Rajoni i Kukësit <u>Kosovë:</u> -Rajoni Ekonomik Perëndimor dhe Rajoni Ekonomik Jugor
Objektivi përgjithshëm i programit	Forcimi i marrëdhënieve të mira të fqinjësisë dhe zhvillimi social-ekonomik i rajoneve kufitare, përmes vlerësimit të potencialeve turistike, zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, social, mjedisor dhe gjithëpërfshirës, në lidhje me trashëgiminë e përbashkët kulturore dhe natyrore.
Prioritetet tematike të programit	PT1: Mbrojtja e mjedisit, promovimi i politikave të zbatueshme dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimit dhe menaxhimit të rreziqeve; PT2: Inkurajimi i turizmit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore; PT3: Investimi në rini, arsim dhe aftësi; PT4: Asistenca teknike.
Objektivat specifikë të programit	PT1: Mbrojtja dhe ruajtja e burimeve mjedisore; PT2: Promovimi i turizmit dhe vlefësimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore si një mënyrë për të nxitur zhvillimin ekonomik; PT3: Integrimi social-ekonomik i të rinjve; PT4: Garantimi për zbatimin e efektshëm, efikas, transparent dhe në kohë të programit dhe rritja e ndërgjegjësimit.
Alokimi financiar 2014–2020	8,400,000.00 euro
Mënyra e zbatimit	Menaxhim i drejtpërdrejtë
Autoriteti kontraktues	Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri, ABA Business Center, rruga “Papa Gjon Pali II”, kati 17, Tiranë, Shqipëri Tel.: (+355) 4 222 8320 ose 223 0871-222 8479-223 4284
Autoritetet përkatëse në pjesëmarrjen e përfituesve IPA II [strukturat operuese]	Shqipëri: Ministria e Integrimi Evropian, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, sheshi “Nënë Tereza” 1010, Tiranë, Shqipëri Tel: +355 4 22 286 45 Faks: + 355 4 22 562 67 Kosovë: Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal për Kosovën Ndërtesa e ish -“Rilindja”, 10000, Prishtinë, Kosovë Tel.: (+381) 38 213 380
SPT/Antena	Sekretariati i Përbashkët Teknik do të vendoset në Kukës, Shqipëri “Hotel Amerika”, kati 2, Kukës, Shqipëri Antena do të vendoset në Prizren, Kosovë “Remzi Ademaj” nr. 23, 2000, Prizren, Kosovë



Seksioni 1: Përmbledhje

Programi për bashkëpunimin ndërkuftar ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës do të zbatohet në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimin (IPA II). IPA II mbështet bashkëpunimin ndërkuftar me synim nxitjen e marrëdhënies të mira fqinjësore, inkurajimin e integritit në BE dhe nxitjen e zhvillimit social-ekonomik. Dispozitat ligjore për zbatimin e tij janë përcaktuar në pjesët e mëposhtme të legjislacionit:

- Rregullorja (BE) nr. 231/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 11 marsit 2014, për themelimin e Instrumentit të Asistencës për Paraanëtarësimin (IPA II),

- Rregullorja (BE) nr. 236/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 11 marsit 2014, që përcakton rregulla dhe procedura të përbashkëta për zbatimin e instrumenteve të unionit për financimin e veprimit të jashtëm,

- Rregullorja e Komisionit për Zbatimin (BE) nr. 447/2014, e 2 majit 2014, mbi rregullat specifike për zbatimin e rregullores IPA II.

1.1 Përmbledhje e programit

Programi ndërkuftar IPA ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës mbulon një territor prej 8,335 km², me një popullsi të përgjithshme prej rreth 936,761 banorësh.

Gjatësia e vijës kufitare është 114 km³. Në Shqipëri zonat përfituese mbulojnë 48% të sipërfaqes së programit që mbulon 2 rajone të përbëra nga 8 bashki, me një total prej 362 vendbanimesh. Të dyja rajonet nga Shqipëria përfshijnë qarkun e Kukësit dhe qarkun e Lezhës. Në Kosovë⁴, zona përfituese mbulon 52% të zonës së programit dhe përfshin rajonin ekonomik jugor të përbërë nga 6 komuna dhe rajonin ekonomik perëndimor të përbërë nga 6 komuna.

Zona e programit ka një popullsi të përgjithshme prej 936.761 banorë, nga e cila 76% jetojnë në territorin e Kosovës dhe 24% jetojnë në anën e Shqipërisë. Në të gjithë zonën e programit popullsia është kryesisht rurale. Në rajonet e Kosovës 65.9% e popullsisë është rurale, ndërsa në Shqipëri popullsia rurale arrin 53.8%

Konkluzionet kryesore

Konkluzionet kryesore të analizës që pasqyrojnë përgatitjen e dokumentit janë përmbledhur si më poshtë:

Dallimet rajonale në aspektin e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror janë të dukshme jo vetëm në të gjithë zonën e programit, por edhe brenda rajoneve. Zona e programit ka një ekonomi kryesisht industriale-agrare, me industri më të zhvilluar në anën e Kosovës, ndërsa rajonet shqiptare janë të dominuara nga bujqësia dhe shërbimet. Të dyja palët kanë, pak a shumë, të njëjtën strukturë ekonomike që mbështetet në bujqësi, shërbime, tregjet me shumicë dhe pakicë, ndërsa industria tradicionale është më e pranishme në rajonet e Kosovës. Bujqësia dhe turizmi janë përgjithësisht të rëndësishme për të dyja vendet, por edhe të pashfrytëzuara dhe të pazhvilluara. Tregtia ndërmjet të dyja anëve po vuan nga barrierat administrative. Disa faktorë të rëndësishëm që përfaqësojnë kufizimet për zhvillimin ekonomik të rajonit janë, ndër të tjera, mungesa e njohurive teknologjike dhe aftësive të punës të nevojshme për t'u përgjigjur kërkesave të tregut për shërbime dhe produkte të kualitetit të lartë. Prodhimet lokale nga të dyja anët e kufirit kanë pak ose aspak akses në tregjet rajonale dhe ndërkombëtare. Mekanizmat për mbështetjen e biznesit janë të dobët dhe të pamjaftueshëm, duke qenë pak më aktivë në Kosovë.

Konkurrenshmëria, produktiviteti dhe ekspertiza janë mjaft të ulëta në të gjithë zonën e programit. Investimi i mëtejshëm për rritjen e nivelit të prodhimit dhe teknologjisë është parakusht për t'u bërë më konkurrues si brenda dhe jashtë vendit. Industria e lehtë dhe industritë e përpunimit të ushqimit konsiderohen edhe si potencial për rritjen e përsheptuar ekonomike të zonës së programit. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të), me më pak se 4 punonjës, dominojnë hartën e bizneseve, ndërsa rjetet ekzistuese të biznesit në zonat kufitare janë të pashfrytëzuara. Niveli i bashkëpunimit të biznesit përtej kufirit është minimal. Sinergjitë midis komuniteteve të biznesit duhet të zhvillohen brenda zonës së programit dhe të përkrahen nga iniciativat (CBC) BNK.

Sektori i bujqësisë është i një rëndësie të madhe për zhvillimin ekonomik dhe punësimin në zonën e programimit në Shqipëri, meqë një pjesë e madhe e

³ Agjencia e Statistikave të Kosovës: Kosova, shifra të 2012-ës.

⁴ Agjencia Kadastrale e Kosovës, 2013.



popullsisë ende jeton në zonat rurale, pavarësisht lëvizjeve mjaft të mëdha drejt zonave urbane. Veprimtaria bujqësore është më shumë një aktivitet ekonomik i orientuar nga prodhimi familjar i mbijetesës dhe fragmentimi i tokës është mjaft i lartë, gjithashtu. Madhësia e fermave bujqësore është mesatarisht 1.5 hektarë. Përmirësimi i infrastrukturës rurale dhe menaxhimit më të mirë të burimeve ujore mund të jenë prioritetet e ardhshme në zonën e programimit. Potenciali turistik është një mundësi e pashfrytëzuar në të dyja anët. Trashëgimia e pasur historiko-kulturore-artistike e zonës është një pasuri për zhvillimin ekonomik të zonës së programit.

Investimet e fundit të mëdha në infrastrukturën rrugore kanë qenë efektive për nxitjen e rritjes ekonomike të zonës së programit, e cila megjithatë kërkon një rrjet më të gjerë të infrastrukturave për zhvillimin e qëndrueshëm afatgjatë. Zona e programimit është gjeneratori më i madh i energjisë për të dy përfituesit IPA II. Të dyja rezervat e mundshme hidrike dhe të linjtit janë burime të rëndësishme në zonën e programit për gjenerimin e energjisë dhe zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të përfituesve IPA II.

Mbrojtja e mjedisit duhet të merret seriozisht në konsideratë në planet e ardhshme të zhvillimit të zonës së programit. Vlerësimi i mëtejshëm i burimeve natyrore në funksion të zhvillimit ekonomik është një çështje kyçe për zhvillimin e zonës. Reduktimi i ndotjes ekzistuese, menaxhimi i mbetjeve urbane dhe sigurimi i cilësisë së ujit të pijshëm për qëllime të mbrojtjes së shëndetit publik dhe garantimi i një mjedisi të pastër, shoqëruar me masat për mbrojtjen e tokës nga shkatërrimi natyror dhe artificial, si edhe zbatimi i një procesi strategjik të planifikimit urban janë sfidat kryesore për t'u përballuar në zonën e programimit. Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve, kontrolli i ndotjes, përdorimi efikas i burimeve të energjisë dhe përmirësimi i menaxhimit të tokës janë ndër prioritetet kyçe që duhet të trajtohen nga planet qeveritare dhe lokale të zhvillimit.

Pabarazitë rajonale në të dyja anët e kufirit janë të dukshme. Varfëria është bërë një shqetësim urban, duke treguar një ecuri të ngadaltë të ekonomisë gjatë viteve të fundit, ndërsa rimëkëmbja e potencialit urban tashmë të ezauruar drejt rritjes ekonomike është bërë e domosdoshme. Papunësia mbetet në një shkallë shqetësuese për

popullatën e zonës së programit, veçanërisht në anën e Kosovës, ku ka papunësi shumë më të lartë, veçanërisht ndërmjet të rinjve, popullsisë rurale dhe grave (në disa zona ajo e tejkalon 50%). Shërbimet sociale janë pak të zhvilluara dhe në mënyrë të pabarabartë; veçanërisht shërbimet shëndetësore kanë nevojë për përmirësime të mëdha, si në mbulim edhe cilësi.

Prioritet madhor për zonën e programit është edhe përmirësimi i sistemit arsimor në të gjitha nivelet, veçanërisht në zonat rurale. Mund të ndërmerren veprime të mëtejshme të përbashkëta për të krijuar rrjetet e qendrave të formimit profesional, si edhe institucionet e arsimit të lartë dhe agjencitë e organizatat kërkimore. Avantazhet që vijnë nga gjuha e përbashkët duhet të shfrytëzohen më tej në zhvillimin e kurrikulave arsimore.

Përfundimisht, analiza PESTLE (analizë politike, ekonomike, social-kulturore, teknologjike, ligjore dhe mjedisore) dhe analiza SWOT (pikat e forta, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet) tregojnë se në zonën e programimit mund të identifikohen potencialet e pashfrytëzuara për zhvillimin ekonomik në sektorë të ndryshëm, të tillë si: ekonomia, mjedisi, turizmi, burimet kulturore dhe natyrore, rinia dhe arsimit.

Fushat kryesore të ndërhyrjeve

Objektivi i përgjithshëm i këtij programi BNK është të forcojë marrëdhëniet e mira të fqinjësisë dhe të nxisë zhvillimin ekologjikisht miqësor dhe gjithëpërfshirës shoqëror ekonomik të rajoneve kufitare, përmes promovimit të potencialit të tyre turistik dhe respektimin e trashëgimisë së përbashkët kulturore dhe natyrore.

Bazuar në analizat PESTLE dhe SWOT, prioritetet e mëposhtme tematike dhe objektivat specifike konsiderohen të dobishëm për nismat efektive BNK:

1. Mbrojtja e mjedisit, përshtatja dhe zbutja ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i reziqeve:

Mbrojtja dhe ruajtja e burimeve mjedisore.

2. Promovimi i turizmit dhe i trashëgimisë kulturore dhe natyrore:

Promovimi i turizmit dhe valorizimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore si një mënyrë për të nxitur zhvillimin ekonomik.

3. Investimi në rini, arsim dhe aftësi:

Integrimi social-ekonomik i rinisë.



Përveç tri prioriteteve tematike të përmendura më lart, programet do të përfshijnë edhe një prioritet të veçantë të asistencës teknike, që synon, midis qëllimeve të tjera, sigurimin e menaxhimit dhe administrimit efikas të programit ndërkufitar.

1.2 Përgatitja e programit dhe përfshirja e partnerëve

Dy strukturat operuese (SO), veçanërisht Ministria e Integritimit Evropian të Shqipërisë dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal të Kosovës, kanë punuar së bashku në mënyrë koherente për përgatitjen e programit.

Objektivi i përgjithshëm i këtij programi ndërkufitar është promovimi/forcimi i marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe zhvillimi social-ekonomik i rajonit kufitar të rajonit.

Programi IPA CBC 2014–2020 midis Shqipërisë dhe Kosovës është rezultat i punës së përbashkët për ushtrimin e programimit të kryer nga përfituesit pjesëmarrës IPA II, duke përfshirë palët e interesuara nga institucionet qendrore, institucionet vendore të zonave përfituese të programit, dhomat e tregtisë dhe industrisë, bizneset dhe organizatat lokale. Përveç kësaj, Task-Forcat e Përbashkëta janë themeluar në të dy përfituesit IPA II për të përgatitur dhe zbatuar dokumentin e programimit së bashku me strukturat operative dhe SPT.

Ushtrimi i programimit filloi në mes të shtatorit të vitit 2013, duke vazhduar deri në maj 2014. Ky program u hartua nëpërmjet një procesi konsultimi të gjerë që përfshin aktorët vendorë dhe përfituesit potencialë nga të dyja anët e kufijve. Gjatë procesit, si SO-të dhe SPT u ndihmuan nga projekti “Ndërtimi i institucioneve ndërkufitare” (CBIB +) dhe nga asistenca teknike për BNK-në Kosovë.

Pyetësorët janë hartuar nga CBIB +, diskutuar me SO-të dhe shpërndarë nga SO-të me mbështetjen e SPT-së në institucionet e nivelit qendror dhe vendor, OSHC-të, për të mbështetur analizat PESTLE dhe SWOT për programin dhe për të siguruar një nga treguesit për identifikimin e

prioriteteve të përbashkëta për zonën ndërkufitare. Një numër total prej 69 pyetësorësh, që përbëjnë mbi 65% e të anketuarve për të dy përfituesit IPA II kanë siguruar kontribut të mëtejshëm për përgatitjen e analizave PESTLE dhe SWOT dhe intervenimin logjik. Në këtë proces janë mbajtur edhe intervista sqaruese, duke përfshirë diskutimet me aktorët përkatës në nivel qendror dhe vendor, si edhe përfaqësues të shoqërisë civile në bazë qendrore dhe vendore, duke synuar rajonet përfituese, për ta bërë procesin të arrijë një objektiv më të gjerë.

Draftdokumenti i parë i programit iu dorëzua Komisionit më 15 nëntor 2013, drafti i dytë i rishikuar u paraqit në 7 shkurt 2014 dhe versioni i tretë i rishikuar më 5 maj 2014.

Gjatë muajit dhjetor 2013, dy SO-të në koordinim edhe me CBIB + zhvilluan raundin e parë të takimeve konsultative, në formën e prezantimit të programit, me aktorët kryesorë lokalë në zonat e përzgjedhura, me qëllimin për të kërkuar të dhëna dhe rekomandimet të tyre.

Gjatë periudhës mars–maj 2014 u organizua nga SO-të, në koordinim me CBIB +, vala e dytë e konsultimeve, duke marrë në konsideratë një proces të gjerë konsultimi publik, për t’i paraqitur organizatave të shoqërisë civile, universiteteve, aktivistëve të shoqërisë civile në rajonet e përzgjedhura draftdokumentin e dytë të programit CBC. Aktorët e shoqërisë civile dhe përfaqësuesit e pushtetit vendor mbështetën fuqimisht prioritetet tematike të përzgjedhura për këtë program dhe siguruan, gjithashtu, detaje për sa u përket nevojave që lidhen me rajonet e tyre përkatëse, të cilat janë pasqyruar në mënyrë të rregullt në dokumentin e programit.

Përveç kësaj, për të koordinuar procesin në nivel kombëtar, një takim konsultativ u organizua edhe në Shqipëri me përfaqësues nga ministrinë e linjës që mbulojnë prioritetet tematike të propozuara në programin.



Tabela - Takime dhe konsultime

Koha dhe Vendi	Aktivitetet dhe Qëllimi
20–21 qershor 2013	Takimi i Projektit CBIB + në Budva të Malit të Zi me të gjithë Përfituesit IPA II të Ballkanit Perëndimor, EUD-të përkatëse dhe DP e zgjerimit që prezantuan procesin e programimit IPA për periudhën 2014–2020 në rajon.
26 korrik 2013 Prizren, Kosovë	Takimi i përbashkët përgatitor (OS AL, OS KSV, stafi SPT/antena, CBC AT në Kosovë) - Diskutimi i prioriteteve tematike të sugjeruara për bashkëpunimin ndërkuftar në kuadër të IPA II, themelimi i Task-Forcave
6 gusht 2013 Prishtinë, Kosovë	Takimi konsultativ me SPT/A dhe RDAs (OS KSV, EUO, RDA, CBC AT në Kosovë). Për të kërkuar mbështetjen e RDAs në mbledhjen e të dhënave të sondazhit.
shtator 2013	Ngritja e Task-Forcave të Përbashkëta, përkatësisht në Shqipëri dhe Kosovë, që synojnë Ushtrimin e Programimit për Shqipërinë - Kosovën.
shtator 2013 16, 17 Tiranë, Shq., dhe 18 shtator, Prishtinë, KOS	Hapja e takimeve në Tiranë dhe në Prishtinë me ekipin CBIB + dhe koordinimi për ushtrimin e programimit IPA CBC 2014–2020
27 shtator 2013 në Tiranë	Trajnimi CBIB + mbi zhvillimin dhe formulimin e strategjisë
Shtator–tetor (2 misione CBIB+)	Takimi me strukturat operative të Kosovës për të diskutuar mbi dokumentet strategjike, zhvillimi i analizave PESTLE dhe SWOT
28 tetor 2013 Tiranë, Shqipëri	Takimi i parë i përbashkët i Task-Forcës për programin Shqipëri–Kosovë në Tiranë, për të diskutuar mbi dokumentin e programit analizat PESTLE dhe SWOT dhe prioritetet
14 nëntor 2013 Prishtinë, Kosovë	Takimi i dytë i përbashkët i Task-Forcës për Programin Shqipëri–Kosovë në Prishtinë, për të diskutuar mbi logjikën e intervenimit të programit, diskutuar dhe rënë dakord
15 nëntor 2013	Dorëzimi i draftit të parë të Dokumentit të Programimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Zgjerimit
21–22 nëntor 2013 Beograd, Serbia	Forumi Rajonal Konsultativ CBC në Beograd
12 dhjetor 2013 Tiranë, Shqipëri	Takim teknik i procesit të programimit: OS, DG ELARG, Delegacionit të BE dhe CBIB + - Diskutimi mbi strategjitë e programit
18 dhjetor 2013, Rajoni Kukës, Shq. Konsultim publik paraprak Takim prezantimi	U prezantua dokumenti i programit, si edhe procesi i programimit dhe arsyetimi për përzgjedhjen e strategjisë së ndërhyrjes. Strategjia e ndërhyrjes dhe prioritetet tematike të zgjedhura janë konfirmuar nga palët e interesuara
19 dhjetor 2013, rajoni i Lezhës, Shq. Konsultim publik paraprak Takim prezantimi	U prezantua dokumenti i programit, si edhe procesi i programimit dhe arsyetimi për përzgjedhjen e strategjisë së ndërhyrjes. Strategjia e ndërhyrjes dhe prioritetet tematike të zgjedhura janë konfirmuar nga palët e interesuara
Mesjanari–7 shkurt 2014	Reflektimi mbi komentet e marra
7 shkurt 2014	Dorëzimi i draftit të dytë të dokumentit të programimit në DG e zgjerimit
27 mars 2014, rajoni i Lezhës, Shq. Takim i gjerë konsultimi publik me shoqërinë civile dhe aktorët vendorë	Procesi i programimit së bashku me prioritetet e programit iu prezantuan organizatave të shoqërisë civile dhe përfaqësuesve të pushtetit vendor të rajonit të Lezhës, ndjekur nga diskutime aktive mbi rekomandimin dhe sugjerimet nga pjesëmarrësit. Prioritetet u konfirmuan plotësisht nga palët e interesuara
15 prill 2014, rajoni Kukës, Shq. Takim i gjerë konsultimi publik me shoqërinë civile dhe aktorët vendorë	Procesi i programimit së bashku me prioritetet e programit iu prezantuan organizatave të shoqërisë civile dhe përfaqësuesve të pushtetit vendor të rajonit të Kukësit, ndjekur nga diskutime aktive mbi rekomandimin dhe sugjerimet nga pjesëmarrësit. Prioritetet u konfirmuan plotësisht nga palët

	e interesuara.
16 prill 2014, Tiranë, Shq. Takim konsultimi me ministrinë e linjës	Procesi i programimi dhe prioritetet e programit për të 3 kufijtë, AL-KSV, MNE-AL, MK-AL iu prezantuan ministrive të linjës që mbulojnë prioritetet në dokumentet, në mënyrë që të konsultohet në lidhje me programet aktuale kombëtare në fushat përkatëse të veprimit në mënyrë që të mos mbivendosen dhe të shikohen sinergjitë e mundshme. Draftdokumentet ishin në përputhje edhe me strategjitë kombëtare dhe u konceptuan si shumë të rëndësishme për zhvillimin e rajoneve nga pjesëmarrësit.
17 prill–1 maj 2014	Reflektimi mbi komentet e marra nga KE-ja dhe takimet e konsultimeve me publikun.
5 maj 2014	Dorëzimi i draftit të tretë paraprak të dokumentit të programimit në DG e zgjerimit
12 maj 2014 Takim konsultimi në Prizren	Procesi i programimit së bashku me prioritetet e programit iu prezantuan organizatave të shoqërisë civile dhe përfaqësuesve të qeverisjes vendore të rajoneve ekonomike jugore dhe perëndime ndjekur nga diskutime aktive për rekomandimin dhe sugjerimet nga pjesëmarrësit. Prioritetet u konfirmuan plotësisht nga aktorët.
Maj 2014	Dorëzimi i draftit përfundimtar në Komisionin Evropian.

Seksioni 2: Zona e programit

2.1 Analiza e situatës

Zona⁵ e programit për programin ndërkuftar ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës mbulon një territor prej 8,335 km², me një popullsi prej rreth 936 761 banorësh. Gjatësia e përgjithshme e vijës kufitare është 114 km⁶.

Figura 1: Harta e zonës së programit



Në Shqipëri⁷ zonat përfituese mbulojnë 3,994 km² që përfshijnë 2 rajone dhe 8 komuna, me një total prej 362 vendbanimesh:

⁵ Zona ndërkuftare përfituese është përcaktuar në përputhje me nenin 88 të rregullores zbatuese IPA.

⁶ Agjencia e Statistikave të Kosovës: Kosova në shifra 2012.

⁷ Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011, INSTAT, Shqipëri.

□ Rajoni i Kukësit përfshin rrethet Kukës, Has dhe

Tropojë, 3 komuna, 24 komuna dhe 206 vendbanime.

□ Rajoni i Lezhës përfshin rrethet Lezhë, Mirditë dhe

Kurbin, 5 bashki, 16 komuna dhe 170 vendbanime.

Në Kosovë⁸ zona përfituese mbulon 4,341 km² dhe

përfshin rajonet ekonomike të mëposhtme:

□ **Rajoni Ekonomik Jugor** përbëhet nga 6 bashki: Prizren, Dragash/Dragaš, Rahovec/Orahovac, Suharekë/Suva Reka, Malishevë/Mališevo dhe Mamusha/Mamuša.

□ **Rajoni Ekonomik Perëndimor** përbëhet nga 6 bashki: Pejë/Peć, Deçan/Dečani, Gjakovë/Đakovica, Istog/Istok, Klinë/Klina dhe Junik.

As Shqipëria dhe as Kosova nuk kanë futur ende zyrtarisht klasifikimet⁹ e Nomenklaturës së Njësive Territoriale për Statistikat (NUTS). Si rrjedhojë, zonat përfituese bazohen për Shqipërinë në rajonet administrative dhe për Kosovën në përcaktimin “rajon ekonomik”.

Zona e programit ka një profil të ndryshëm gjeografik. Ajo është e pasur me vargmale, fusha, lugina, lumenj dhe liqene. Është e pasur në pyje, kafshë të egra dhe kullota (pyjet dhe livadhet

⁸ Agjencia Kadastrale e Kosovës 2013.

⁹ Nomenklatura e Njësive Territoriale për Statistikat.



mbulojnë 50% të sipërfaqes së përgjithshme). Terreni, gjithashtu, është mjaft i vështirë me vendndodhje të pashfrytëzuara duke e bërë atë një atraksion për turizmin në të dyja anët e kufirit. Zona ka kontraste të terreneve malore dhe fushore, burime ujore, liqene, peshkim, lumenj, që rrjedhin nga të dyja anët e kufirit dhe dalin në det përmes Lezhës. Autostrada e re e ndërnuar të kalojë përmes Durrësit për në Kukës dhe pastaj përmes kufirit në Prishtinë ka kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në rritjen e lëvizshmërisë së njerëzve dhe të mallrave, për qëllime të ndryshme, si: tregtisë, turizmit, arsimit dhe shkëmbimeve, që nga viti 2009.

Kjo është një zonë tradicionale për mbarëshkrimin e deleve dhe konsiderohet të jetë një zonë e madhe kullote në Evropë. Zona është e pasur në minerale, si: krom, qymyr, hekur-nikel, bakër, gëlqere, rërë kuarci dhe mermer dhe përmban monumente të shumta natyrore.

E gjithë zona e programit banohet kryesisht nga popullsi fshatare. Në rajonet përfituese të Kosovës 65.9% e popullsisë është rurale, ndërsa në Shqipëri ajo përfshin 53.8%. E tërë zona e programimit ka një **popullsi relativisht të re** (rreth 51% e grupmoshës nga 0–27). Tendenca e **rritjes së popullsisë** është duke rënë në të dyja anët e kufirit. Ka pasur një rënie të vazhdueshme të numrit të lindjeve. Për më tepër, në të dyja anët ka pasur një tendencë të lëvizjeve masive migratore të brendshme dhe të jashtme, të cilat kanë ndikuar negativisht në rritjen e popullsisë dhe strukturën e zonës së programit.

Reformat e politikave

Shqipëria dhe Kosova aspirojnë të bëhen anëtare të Bashkimit Evropian. Sondazhet e përsëritura të perceptimit publik tregojnë se ato mbeten ndër përfituesit IPA II me qëndrimin më pozitiv (më shumë se 95%) për t'u bërë anëtar i familjes së Bashkimit Evropian. BE nënvizon¹⁰ një sërë sfidash kyçe përpara me të cilat Shqipëria dhe Kosova përballen, të tilla si: shteti i së drejtës; funksionimi i institucioneve që garantojnë demokracinë; të drejtat themelore; dhe tejkalimi i trashëgimisë të së kaluarës në rastin e Kosovës.

Ekonomia

Shqipëria ka ecur relativisht mirë gjatë dekadës

së fundit. Vendi ka qëndruar larg recesionit, duke ruajtur ritmet pozitive të rritjes, pavarësisht ekspozimit të saj ndaj krizës ekonomike që e goditi fort Greqinë dhe Italinë, edhe duke qenë e rrethuar nga ekonomitë rajonale kontraktuese. Rritja e PBB-së është ngadalësuar nga norma e rritjes 7.5% në 2008, në një normë më të ulët të rritjes 1.6% në vitin 2012. **Kosova** ka bërë progres në drejtim të krijimit të një ekonomie funksionale të tregut. Nevojiten reforma dhe investime të konsiderueshme për të mundësuar që ajo të përballojë në afat të gjatë presionin konkurrues dhe forcat e tregut. Situata e vështirë ekonomike në rajon dhe BE-ja kanë ndikuar ekonominë e Kosovës, megjithëse më pak se përfituesit e tjerë të IPA II në rajon. PBB-ja e Kosovës u rrit me 2.5% në 2012¹¹.

Dallimet rajonale në aspektin e zhvillimit social-ekonomik janë të dukshme jo vetëm në të gjithë zonën e programit, por edhe brenda rajoneve.

Zona e programit ka një ekonomi kryesisht industriale-agrare, me industrinë më të zhvilluar në anën e Kosovës, ndërsa rajonet shqiptare janë të dominuara nga bujqësia dhe shërbimet. Për momentin, rritja ekonomike është modeste. Megjithatë, ka shenja të rimëkëmbjes ekonomike pas një periudhe të ngecjes ekonomike (stanjacionit).

Sektori privat

Operatorët ekonomikë në zonën e programit janë shumë të fragmentuar dhe të vegjël në madhësi, që pasqyrojnë strukturën e ndërmarrjeve në nivel kombëtar, që tregon se biznesi është më së shumti familjar dhe se mbizotëron vetëpunësimi. Struktura e ndërmarrjeve dominohet nga ndërmarrjet shumë të vogla, që punësojnë 1–4 persona, të cilat përbëjnë pothuajse 90% të totalit të ndërmarrjeve në zonat përfituese.

Infrastruktura

Rrugët: Kosova dhe Shqipëria janë pjesë e rrjetit¹² SEETO me Autostradën 7 (314 km), që kalon te të dyja ato¹³. **Hekurudhat:** Nuk ka lidhje hekurudhore mes Shqipërisë dhe Kosovës. Për shkak të mungesës së investimeve, infrastruktura hekurudhore është shumë e varfër, mungojnë

¹¹ Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Kosovën, tetor 2013.

¹² Observatori i Transportit i Evropës Juglindore.

¹³ Route 7, drejtimet përfshijnë: Lezhë (Shqipëri)–Prishtinë/Priština (Kosovë)–Doljevac (Serbi).

¹⁰ KE - Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2013–2014, tetor 2013.



terminalet e mirë-zhvilluar, shinat dhe linjat.

Energjia: Zona e programimit është gjeneratori më i madh i energjisë në të dy përfituesit IPA II.

Mjedisi

Zona e programimit është jashtëzakonisht e pasur me biodiversitet dhe burime natyrore. Mbrojtja dhe valorizimi i këtyre aseteve është padyshim një nga pikat kyçe për zhvillimin e qëndrueshëm dhe mund të ofrojë mundësi të shumta për bashkëpunimin ndërkuftar. Zona e programimit ofron klimë dhe biodiversitet të pasur, duke përfshirë një peizazh të mrekullueshëm që nga malet më të larta në zonë, kodra, fusha, liqen, lumenj dhe bregdet.

Mbetjet dhe kanalizimet

Furnizimi me ujë, sistemet e kanalizimit dhe të ujitjes mbeten problematike në zonën e programimit. Reduktimi i ndotjes ekzistuese, menaxhimi i mbetjeve urbane dhe sigurimi i cilësisë së ujit të pijshëm për qëllime të mbrojtjes së shëndetit publik dhe garantimi i një mjedisi të pastër, shoqëruar me masat për të mbrojtur tokën nga shkatërrimi natyror dhe shkatërrimi nga njeriu, si edhe zbatimi i një procesi strategjik të planifikimit urban janë sfidat kryesore për t'u përballuar në zonën e programimit.

Bujqësia dhe zhvillimi rural

Edhe pse ka burime të bollshme ujore dhe një kërkesë të madhe për produktet bujqësore, zona e programimit ka potencial të kufizuar për zhvillimin e bujqësisë. Modernizimi i bujqësisë, përmirësimi i proceseve të prodhimit dhe zbatimi i rregullave dhe standardeve të BE-së për sigurinë ushqimore, rritja e prodhimit bujqësor tradicional dhe mbështetja e bashkëpunimit midis prodhuesve janë sfida për t'u përballuar në zonën e programimit dhe që mund të mbështeten nga iniciativat ndërkuftare. Për sa u përket eksporteve/importeve bujqësore mes Shqipërisë dhe Kosovës, është parë një rritje pozitive vjetore prej 4–6% gjatë tri viteve të fundit. Bujqësia është një nga sektorët që përmban një potencial të madh për tregtinë dhe shkëmbimet ndërmjet komuniteteve që jetojnë në zonat kufitare dhe më gjerë.

Turizmi

Turizmi ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në rritjen e zonës; madhësia e madhe e tregut të turizmit rajonal tregon një potencial të pashfrytëzuar në masë të madhe. Zhbllokimi i këtij potenciali do të japë një stimul të konsiderueshëm në rritjen ekonomike në të dyja anët e kufirit. Zona

e programit ofron një larmi të karakteristikave lokale që janë të përshtatshme për aktivitete turistike, si: natyrën e bukur dhe peizazhet spektakolare, folklorin tradicional dhe disa vende (site) kulturore dhe historike me famë botërore. Malet, parqet kombëtare, zonat e mbrojtura dhe pyjet janë të njohura për bukurinë dhe egërsinë e tyre dhe mund të jenë me interes të madh për turistët dhe ofrojnë mundësinë për të organizuar sporte dimërore dhe në natyrë. Vija bregdetare, liqenet dhe lumenjtë e shumtë ofrojnë një mundësi të shkëlqyer për turizmin turistik dhe të aventurës.

Tregu i punës

Situata në tregun e punës paraqet një pasqyrë të qartë të pabarazive të rajonit. Shkalla e papunësisë në Kosovë është e lartë 30.9%¹⁴. Në Kosovë, pjesa relative e popullsisë në moshë pune është 64%, ndërsa shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore është 36%; është shumë e ulët në krahasim me Shqipërinë (68.2%).

Numri i personave të papunë në zonën e programimit të Kosovës është 87.181, që përfaqëson 38% të numrit të përgjithshëm të të papunëve të regjistruar në Kosovë. Papunësia është veçanërisht e lartë në mesin e të rinjve (55.3%). Rritja e potencialit për popullatën joaktive në Kosovë është shumë shqetësuese, meqë numri i të rinjve që hyjnë në popullsinë në moshë pune është tri herë më i lartë se numri i personave që arrijnë moshën e pensionit. Në anën e zonës së programimit të Kosovës, numri i madh i të rinjve që hyjnë në tregun e punës çdo vit së bashku me vetëm një pjesë të vogël të të diplomuarve që gjejnë punë rezulton në shkallën më të lartë të papunësisë në rajon. Shqetësimi rritet për shkak të faktit se sistemi arsimor në Kosovë nuk prodhon të diplomuar me aftësitë e nevojshme për t'u përshtatur kërkesave të tregut të punës, dhe aftësitë e të diplomuarve bëhen të vjetruara kur nuk përdoren¹⁵. Në tërësi, niveli i aktivitetit ekonomik në këtë zonë është i pamjaftueshëm për të absorbuar personat që hyjnë në tregun e punës.

Punësimi në raport popullsie në zonën e programimit në anën e Kosovës është më i ulët se mesatarja e brendshme (e vendit), me 22% (45,050) në Rajonin Ekonomik Perëndimor, dhe 23%

¹⁴ Agjencia Kosovare për Statistikat dhe Banka Botërore: Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore në Kosovë, 2012.

¹⁵ Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim.(OECD), 2013.



(56,599) në Rajonin Ekonomik Jugor. Sektorët e industrisë përpunuese, tregtisë, arsimit dhe ndërtimit punësuan pothuajse gjysmën e të punësuarve në Kosovë në vitin 2012

Sektorët kryesorë të punësimit në Rajonin Ekonomik Perëndimor janë tregtia dhe industria përpunuese me 17%, e ndjekur nga administrata publike me 14.8%. Në Rajonin Ekonomik Jugor, bujqësia është sektori që ka punësuar 16.4% të forcës aktive të punës, pasuar nga tregtia dhe industria e përpunimit me 16%.

Megjithëse është vërejtur një ndryshim i vogël pozitiv, përqindja e punëkërkesve e konsideruar si të pakualifikuar është 57% (duke përfshirë edhe grupin pa ndonjë arsim formal dhe atë vetëm me arsim fillor), ndërsa ata me arsim të lartë dhe universitar janë vetëm në 3%, kurse ata me arsim të mesëm 28%.¹⁶

Në Rajonin Ekonomik Jugor, bujqësia është sektori që punëson 16.4% të forcës aktive të punës, ndjekur nga tregtia dhe shërbimet artizanale me 16%. Veç kësaj, 38,388 banorë ose 12.38% e sigurojnë jetesën e tyre nga pensionet, asistenca sociale dhe programet e tjera të mirëqenies dhe kujdesit shëndetësor, ndërsa 12.19% të tjerë varen nga remitancat e huaja dhe burime të tjera. Gjithashtu, 160,556 banorë ose rreth 51% e popullsisë mbështeten nga të tjerët për jetesën e tyre, shifër që mbulon edhe pjesën e popullsisë “ekonomikisht joaktive”.

Punësimi i përgjithshëm në Shqipëri arriti në 56.4% në vitin 2012, ndërsa norma mesatare e papunësisë në vitin 2013 arriti në 13.9%, e mbetur në të njëjtat nivele të vitit 2011. Fuqia punëtore totale në Shqipëri arriti në 2.229,652 njerëz në fund të dhjetorit 2012¹⁷. Shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore në Shqipëri është 68.2%. Shkalla e punësimit tregon një trend në rënie. Nga 58.8% në fillim të vitit 2012, ajo ra në 48.5% në fund të vitit 2013. Përqindja e të rinjve të punësuar (15–29) në të njëjtën periudhë ka rënë nga 39.4% në 28%¹⁸. Sektori i bujqësisë punëson mbi 40%, ndjekur nga punësimi në tregun e orientuar të shërbimeve (20%), sektori i shërbimeve jo të tregut (17%), si dhe të ndërtimit dhe industrisë së përpunimit, secili me rreth 7%.

Papunësia në rajonin e Kukësit pasqyron të njëjtën normë mesatare të papunësisë si ajo në nivel kombëtar, si edhe të njëjtën strukturë të punësimit. Rajoni i Kukësit ka një popullsi relativisht të re. Grup moshë 15–64 vjeç, që përfaqëson popullsinë e moshës së punës përbën 46% të totalit. Numri i të papunëve në Lezhë ishte 15.021 deri në fund të vitit 2012. Personat e papunë në Lezhë përbëjnë 10.6% të totalit të fuqisë punëtore aktive, ndërsa në Kukës 10.322 të papunë përbëjnë rreth 7% të totalit¹⁹.

Gjithashtu, në anën shqiptare të zonës së programimit numri i madh i të rinjve që hyjnë në tregun e punës çdo vit është i lartë, ndërsa pjesa e vogël e të diplomuarve që gjejnë punë rezulton në normën më të lartë të papunësisë, veçanërisht në rajonin e Kukësit. Kjo është e lidhur edhe me faktin se sistemi arsimor në zonën e programeve nuk ofron aftësitë e nevojshme për përballimin e kërkesave të tregut të punës. Nga ana tjetër, niveli i aktivitetit ekonomik në këtë zonë është i pamjaftueshëm për të thithur personat e rinj që hyjnë në tregun e punës.

Sistemi i mbrojtjes sociale siguron mbështetje për një pjesë të konsiderueshme të popullatës në të dy anët e zonës së programit.

Varfëria

Kufiri absolut i varfërisë në **Shqipëri** në vitin 2012 ishte 35.2 euro për person të rritur²⁰. Varfëria është rritur në Shqipëri, ndërsa shkalla e varfërisë në vitin 2012 u rrit në 14.3% krahasuar me 12.4% të regjistruar në vitin 2008. Cenueshmëria e popullsisë shqiptare u rrit në vitin 2012; numri i personave të regjistruar në nivelin e varfërisë u rrit me 8.4%. Varfëria ekstreme arriti në 2.2% në vitin 2012, krahasuar me 1.2% të regjistruar në vitin 2008.

Gjatë vitit 2012, rritja e shkallës së varfërisë në zonat urbane u përshpejtua në krahasim me shkallën e varfërisë në zonat rurale. Numri i personave të varfër në zonat rurale ka rënë me 11.8%, ndërsa numri i të varfërve në zonat urbane është rritur ndjeshëm nga 36.8% në vitin 2012 krahasuar me vitin 2008. Kjo tregon se popullsia e zonave rurale dhe rajoneve veriore të Shqipërisë ka lëvizur drejt zonave urbane, kryesisht në Tiranë, në

¹⁶ Puna dhe Punësimi - Raporti i Performancës 2012 - MPMS prill 2013.

¹⁷ INSTAT, Tregu i Punës 2011–2012.

¹⁸ INSTAT, Anketa e Fuqisë Punëtore, T1.2012-T4.2013.

¹⁹ INSTAT, Buletini Statistikor Tremujor nr. 2, 2013.

²⁰ Shqipëria, Tendencat e Varfërisë, shtator 2013, INSTAT- Banka Botërore.



kryeqytet, dhe në zonat bregdetare - këta të fundit regjistrojnë normën më të lartë të varfërisë në vitin 2012 në një mesatare prej 17.6%. Pabarazitë rajonale në Shqipëri janë evidente, edhe pse duket sikur varfëria ka migruar nga zona veriore drejt zonës bregdetare. Të gjitha rajonet në zonën e programimit janë mbi normën mesatare të varfërisë kombëtare, me Kukësin si rajoni më i varfër i vendit mesatarisht një normë prej 21.8% e varfërisë, e ndjekur nga rajoni i Lezhës me 17.5%. Varfëria është bërë një shqetësim urban, që tregon një ecuri të ngadaltë të ekonomisë gjatë viteve të fundit, dhe se rimëkëmbja e potencialit të ezauruar urban për të udhëhequr rritjen ekonomike është bërë e domosdoshme.

Të dhënat e nivelit të varfërisë në **Kosovë** nuk janë premtuese. Treguesit e varfërisë në Kosovë janë përkeqësuar në vend të përmirësimit gjatë viteve. Bazuar në të dhënat zyrtare statistikore në vitin 2012, është llogaritur se rreth 34.5% e popullsisë së Kosovës jeton në varfëri të përgjithshme dhe rreth 12.1% jetojnë në varfëri²¹ ekstreme. Niveli i varfërisë në zonat rurale është më i lartë se në zonat urbane, ndërsa në mes të meshkujve dhe femrave niveli i varfërisë në vitin 2011 ishte pothuajse i njëjtë²². Nuk ka të dhëna në lidhje me shkallën e varfërisë nga rajonet ekonomike të Kosovës.

Arsimi

Arsimi mbetet një nga prioritetet kryesore në zonën e programimit. Arsimi jepet në të gjitha nivelet: fillor, i mesëm dhe terciar (universitar). Gjenden 589 shkolla për 137.557 nxënës që ndjekin nivelin e **arsimit fillor** në tërë zonën²³ e programimit. Ka 89 shkolla për **arsimin e mesëm** në zonën e programimit, nga të cilat 34 në zonat shqiptare dhe 55 në zonën e Kosovës. Ka një përqindje të lartë të të rinjve që ndjekin arsimin e

mesëm në zonën urbane, krahasuar me 37.02% në zonën rurale. Gjenden 3 **shkolla profesionale** në Lezhë dhe 1 në Kukës.

Qendrat e formimit profesional në Pejë dhe në Gjakovë ofrojnë programe të ndryshme profesionale për të rriturit. Gjenden institucione të **arsimit të lartë** në zonë. Universiteti i Tiranës ka hapur degën e tij në Kukës me 3 fakultete. Gjatë vitit akademik 2011–2012 kanë qenë 671 studentë të regjistruar. Gjenden 3 universitete në qendrat më të mëdha urbane në zonën e Kosovës, si në Pejë/Peç, Gjakovë/Đakovica dhe Prizren.

Në lidhje me **Kërkimin dhe zhvillimin**, zonës së programimit i mungon totalisht infrastruktura dhe kapacitetet.

Shëndetësia

Në **Shqipëri**, sistemi shëndetësor publik menaxhohet nga qeveria²⁴ qendrore. Kujdesi parësor shëndetësor në Shqipëri jepet në nivel komune dhe bashkie, ndërsa kujdesi shëndetësor dytësor është i vendosur kryesisht në qendrat më të mëdha urbane të zonës së programimit, si pjesë e rajonalizimit të shërbimeve shëndetësore spitalore.

Sistemi i kujdesit shëndetësor në **Kosovë** siguron mbrojtje shëndetësore në tri nivele:

Parësor²⁵, sekondar dhe terciar. Në të gjithë zonën e programit sistemi shëndetësor ballafaqohet me nevojën për t'u përgjigjur në mënyrën më efektive dhe efektive, të krahasueshme me vendet e tjera evropiane dhe standardet e BE-së.

Kultura

Trashëgimia historike dhe kulturore është një nga pasuritë më të rëndësishme të zonës së programit. Ka lidhje shumë të fortë midis popullatave të dyja anëve të zonës së programit, të cilat rrjedhin nga gjuha dhe historia e përbashkët, nga rrënjët e thella të përbashkëta dhe marrëdhëniet intensive të njerëzve, marrëdhëniet kulturore dhe komerciale dhe shkëmbimet që kanë lidhur këto territore dhe banorët e tyre për shekuj. Rajoni është i pasur me vende dhe monumente të

²¹ Anketa e Banesave e vitit 2011 vlerësoi se 29.7% e popullsisë së Kosovës jeton nën kufirin e varfërisë, me 10.2% të popullsisë që jeton nën kufirin e varfërisë së skajshme (Agjencia e Statistikave të Kosovës).

²² Në vitin 2011, 30.3% e femrave në Kosovë jetojnë në varfëri në krahasim me 29.2% të meshkujve, me një pikë përqindjeje diferencë. Nga viti 2009 deri në vitin 2010 shkalla e varfërisë ka rënë pak më shumë për meshkujt se te femrat.

²³ Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Vjetari Statistikor 2010–2011:

<http://www.mash.gov.al/File/statistika/vjetari-statistikor-per-arsimin-2010-2011-dhe-seri-kohore.pdf>.

²⁴ Brenda rajonit, drejtoritë e ndryshme të Rrethit për Shëndetësinë, pjesë e Ministrisë së Shëndetësisë në Tiranë, kanë përgjegjësi të caktuara operative dhe administrative.

²⁵ Mjekësia familjare/kujdesi parësor shëndetësor është pjesë e sistemit qeveritar të kujdesit shëndetësor dhe është rregulluar në të gjitha bashkitë dhe komunat e Kosovës. Koncepti i mjekësisë familjare nënkupton aplikimin e masave parandaluese dhe të kujdesit shëndetësor publik.



shumta historike dhe feje, si edhe në traditat dhe folklor. Evente të shumta kulturore dhe festivale janë organizuar, dhe ka tradita të shumëllojshme të kulinarisë dhe të zejtarisë që mund të luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin e turizmit, por, deri tani, këto janë pamjaftueshmërisht të njohura, të nënvlerësuara dhe nuk shfrytëzohen. Shkëmbimet kulturore paraqesin një shtytje të madhe për zbatimin e bashkëpunimit ndërkuftar. Si Shqipëria dhe Kosova marrin pjesë në Programin e Lisbonës për Mbrojtjen dhe Promovimin e Trashëgimisë Kulturore.

Shoqëria civile

Sektori OSHC-së i **Shqipërisë** është i vogël dhe i zhvilluar në mënyrë të pabarabartë. Shumica e OSHC-ve janë të përqendruara në kryeqytet dhe qytetet më të mëdha. OSHC-të janë shumë pak të pranishme në zonat rurale dhe të largëta. Aktivitetet kryesore të OSHC-ve janë mbrojtja dhe kërkime/hulumtimet në fushën e promovimit të të drejtave të njeriut, mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijëve, demokracisë dhe qeverisjes së mirë, si dhe mendimin e politikave dhe zhvillimin ekonomik. Shoqëria civile në **Kosovë** përfshin shumë organizata joqeveritare (OJQ) të regjistruara. Vetëm disa shembuj të iniciativave jo të regjistruara mund të gjenden dhe shumica e tyre lindin në baza të posaçme dhe nuk vazhdojnë të jenë aktive, pasi çështja konkrete/problemi është zgjidhur.

2.2 Konstatimet kryesore

Zona e programit është e ndryshme, por ende disa tipare të përbashkëta në lidhje me natyrën, pozitën gjeografike, tendencat demografike, ekonomia, kapitali njerëzor etj., mund të gjenerojnë sinergji dhe të jenë një mundësi e mirë për zhvillimin dhe zbatimin e nismave të BNK-së.

Struktura e ekonomisë së zonës në kufi është më shumë, në përputhje se sa komplementare. Të dyja palët kanë, pak a shumë, të njëjtën strukturë të prodhimit. Të dyja palët mbështeten në bujqësi, shërbime, tregtinë me shumicë dhe pakicë, ndërsa industria tradicionale është më e pranishme në rajonet e Kosovës. Bujqësia dhe turizmi janë përgjithësisht të rëndësishme për të dyja palët, por të dyja kërkojnë të pashfrytëzuara. 4–6% e rritjes vjetore në eksporte/importe të viteve të fundit, veçanërisht e produkteve bujqësore është një tregues se potencialet janë atje. Sfidat kryesore përfshijnë:

Trajtimin e pabarazive ekonomike rajonale:

niveli i ulët i produktivitetit si pasojë e mungesës së teknologjive të ekspertizës dhe aftësive të punës dhe mospërputhjes së kërkesës së tregut për shërbime të cilësisë së lartë dhe të produkteve dhe aftësive të pamjaftueshme të punës. Tregtia në mes të dyja anëve po pëson barrierat e rënda administrative, të cilat janë të vështira për t'u shpjeguar.

Konkurrueshmëria, produktiviteti dhe ekspertiza janë mjaft të ulëta në të dyja anët e kufirit.

Investimi më tej në rritjen e nivelit të produktivitetit dhe të teknologjisë është një parakusht për t'u bërë më konkurrues, si brenda dhe jashtë vendit. Sfidat kryesore në të dyja anët e programit përfshijnë nevojën për përmirësimin e kushteve dhe, veçanërisht, infrastrukturën për të bërë biznes dhe tërheqjen e IHD-ve. Industria e lehtë dhe industritë e përpunimit të ushqimit konsiderohen edhe si një potencial për rritjen e përshtetshme ekonomike të zonës së programit, por cilësia dhe standardet e produkteve, si edhe qasja e tyre në Kosovë dhe jashtë tregut mbeten një sfidë.

NVM-të me më pak se 4 punonjës dominojnë hartën e bizneseve, ndërsa rrjeti ekzistues i biznesit në zonat kufitare është një potencial i pashfrytëzuar. Një sfidë kyçe është qasja e dobët e SME-ve në financim. Politikat tepër të kujdesshme të kreditimit të miratuara nga institucionet financiare për të dy përfituesit IPA II janë një pengesë serioze në rritjen e ndërmarrjeve në zonën e programit. Niveli i bashkëpunimit të biznesit përtej kufirit është relativ. Sinergjitë midis komuniteteve të biznesit duhet të zhvillohen brenda zonës së programit dhe të mbështeten nga iniciativat CBC.

Bujqësia mbetet sektori më i rëndësishëm i ekonomisë së zonës së programit, duke pasur parasysh faktin se pjesa më e madhe e popullsisë jeton në zonat rurale dhe të ardhurat e tyre kryesore vijnë nga aktivitetet që lidhen me bujqësinë. Bujqësia është një potencial i madh ekonomik në zonën e programit, por i pashfrytëzuar. Në përgjithësi ekonomia rurale është e fragmentuar dhe njësitë e vogla bujqësore kanë vështirësi aksesit në tregje. Prodhimi është mesatarisht i larmishëm dhe gama e prodhimeve kryesore bujqësore në të dyja anët e kufirit është më shumë komplementar se sa konkurrues. Përmirësimi i aksesit në treg dhe forcimi i sistemit



të sigurisë ushqimore dhe organeve inspektuese do të jetë i rëndësishëm për rritjen e konkurrueshmërisë së sektorit bujqësor.

Papunësia mbetet në një shkallë shqetësuese për popullatën e zonës së programit, veçanërisht në anën e Kosovës, ku ka papunësi shumë më të lartë, veçanërisht, në mesin e të rinjve, popullsinë rurale dhe femrat (në disa zona ajo e tejkalon 50%). Papunësia e lartë ka çuar në shpopullimin dhe rrjedhjen/largimin e njerëzve të aftë dhe të arsimuar në pjesën rurale të zonës së programimit dhe një integrim të ulët të tregjeve të punës ndërkufitare, dhe lëvizshmërinë e ulët ndërkufitare. Për shkak të pasigurisë së punës ka pasur një normë të lartë të migrimin, veçanërisht nga zonat rurale drejt rajoneve më të zhvilluara apo jashtë vendit. Asistenca sociale si rezultat i papunësisë është një barrë e rëndë për shpenzimet publike.

Disa nga sfidat kryesore përpara përfshijnë nevojën për të përmirësuar nivelin e arsimit profesional, në funksionin për t'i shërbyer më mirë nevojave të tregut të punës me aftësitë e nevojshme në mënyrë që të rrisë aftësitë e fuqisë punëtore të të rinjve dhe për të rritur mundësitë e punësimit, veçanërisht të rinjtë më të mirë. Nevoja për të promovuar aktivitetet e kërkimit dhe zhvillimit, duke përdorur kërkimet ekzistuese dhe qendrat e larta arsimore në fusha me interes të përbashkët që rrisin përfitimet që rrjedhin nga bashkëpunimi ndërkufitar është, gjithashtu, një prioritet sfidues për ndërhyrjet ndërkufitare.

Standardet e ulëta të jetesës në zonën kufitare po shkaktojnë një shpopullim të vazhdueshëm, veçanërisht në zonat e largëta dhe malore, standardet e jetesës janë përkeqësuar gjatë viteve të fundit dhe së bashku me krizën e tregut të punës kanë rritur fenomenin e marginalizimit, vështirësitë sociale dhe emigracionin të të rinjtë. Prania e flukseve migratore të forta ka ndikuar në fuqinë punëtore dhe rezultoi në humbjen e punëtorëve të kualifikuar dhe të arsimuar në zonat më të ulëta të urbanizuara. Shpopullimi i vazhdueshëm i disa rajone në favor të zonës qendrore është një kërcënim real për zhvillimin e turizmit dhe bujqësisë, në veçanti, pasi varet në një pjesë të madhe nga prania e një popullate rurale aktive dhe relativisht e dendur.

Mbrojtja e mjedisit ka nevojë për konsideratë serioze në planet e zhvillimit të

zonës së programit të ardhshëm. Zona është e pasur në burime natyrore, prandaj mbrojtja e mjedisit dhe ruajtja e këtyre burimeve është vendimtare për zhvillimin e saj të qëndrueshëm. Disa nga sfidat kryesore kanë të bëjnë me shfrytëzimin e pakontrolluar të resurseve natyrore në zonën e programimit dhe nivelin e ulët të zbatimit të rregullave dhe standardeve të mjedisit për të siguruar një menaxhim më të mirë të zonave pyjore dhe të mbrojtura për të parandaluar degradimin e mjedisit. Promovimi i sensibilizimit mjedisor dhe i edukimit mbi rëndësinë e mbrojtjes së burimeve natyrore është, gjithashtu, një sfidë. Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve, kontrolli i ndotjes, një përdorim efikas i burimeve të energjisë dhe përmirësimi i menaxhimit të tokës janë ndër prioritetet kryesore për t'u trajtuar nga planet qeveritare dhe lokale të zhvillimit. Valorizimi i mëtejshëm i burimeve natyrore në funksion të zhvillimit ekonomik është një çështje kyçe për zhvillimin e zonës.

Investimi i fundit i madh në infrastrukturën rrugore ka qenë efektiv për nxitjen e zhvillimit të zonës së programit, por rrjeti më i gjerë i infrastrukturës ende mbetet pengesë për një zhvillim të qetë ekonomik dhe social. Zhvillimi i qëndrueshëm dhe përmirësimi i transportit dhe infrastrukturës publike mund të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe një rritje të përgjithshme të pasurisë në zonën e programit. Zhvillimi i infrastrukturës që lehtëson biznesin dhe përhapjen e rrjeteve dhe shërbimeve për të mbështetur zhvillimin e biznesit dhe inovacionit, mund të kontribuojë në një rritje të përgjithshme të pasurisë dhe ekonomisë në zonë.

Potenciali turistik është një tjetër mundësi e humbur në të dyja anët. Zona ka një trashëgimi të pasur historike-kulturore-artistike që duhet të ruhet dhe promovohet. Valorizimi i mëtejshëm i trashëgimisë historike dhe i kulturës mund të kontribuojë në forcimin e identitetit të zonës. Sfidat kryesore mbeten: nevoja për të zhvilluar lloje të ndryshme të turizmit (kulinari e turizmit malor dhe agroturizëm) në të gjithë zonën e programimit; vizibiliteti i ulët i trashëgimisë së pasur historike dhe kulturore dhe veçantitë tradicionale, duhet të rriten të ardhurat në zonën e programimit, duke nxitur aktivitetet për të ruajtur traditën, trashëgiminë kulturore dhe natyrore; duhet të rritet niveli i bashkëpunimit ndërmjet aktorëve në fushën



e zhvillimit të turizmit dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore dhe natyrore. Potenciali turistik është një mundësi që duhet të vlerësohet në të dyja anët dhe të shfrytëzohet më mirë. Iniciativat CBC duhet të mbështesin zhvillimin e ofertave të përbashkëta turistike.

Zona ka një trashëgimi të pasur historike-kulturore-artistike që duhet të ruhet dhe promovohet. Valorizimi i mëtejshëm i trashëgimisë historike dhe i kulturës mund të kontribuojë në forcimin e identitetit të zonës. Trashëgimia kulturore është një pasuri për zhvillimin ekonomik të zonës së programit. Bashkëpunimi mes institucioneve të kulturës është i pranishëm, por mund të intensifikohet edhe më tej.

Përmirësimi i sistemit arsimor në të gjitha nivelet është një përparësi e madhe për zonën e programit, veçanërisht në zonat rurale. Aksione të përbashkëta të mëtejshme mund të ndërmerren për të krijuar rrjetin e qendrave të trajnimit profesional si dhe institucioneve të arsimit të lartë dhe agjencitë kërkimore dhe organizatat. Avantazhet që vijnë nga gjuha e përbashkët duhet të shfrytëzohen edhe më tej në zhvillimin e kurrikulave arsimore.

Shërbimet sociale janë pak të zhvilluara dhe në mënyrë të pabarabartë. Veçanërisht shërbimi shëndetësor ka nevojë për përmirësime të mëdha, si në mbulimin dhe në cilësinë. Kuadri ligjor për sigurimin shëndetësor (në anën shqiptare të zonave rurale) ende pengon përparimin e zhvillimit të ofrimit të shërbimit shëndetësor. Duke pasur parasysh se sektori i shëndetësisë menaxhohet nga qendra, ndoshta mund të bëhet jo shumë nën programet CBC, por sigurisht që ka vend për aktivitete potenciale të përbashkëta që lidhen me fushatat e promovimit dhe edukimit shëndetësor.

Inkurajimi i rrjeteve rajonale të OSHC-ve (duke përfshirë sportin, rininë dhe organizatat kulturore) mund të kontribuojë në ruajtjen dhe forcimin e lidhjeve ndërmjet komuniteteve në të dyja anët e kufirit në këtë zonë multi-etnike të programit.

Kërkimi dhe zhvillimi dhe depërtimi i TIK-ut është në nivele dukshëm të ulëta. Ka investime, mbështetje qeveritare, rajonale ose vendore të pamjaftueshme të aktiviteteve për K&ZH, pavarësisht nga fakti se universitetet janë të pranishme në zonën e programit. Nuk ka të dhëna specifike për K&ZH, por ka pothuajse mungesë të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve

të arsimit në të dy përfituesit IPA II; kërkimi shkencor, zhvillimi dhe fusha e inovacionit nuk eksplorohehen.

Qeveritë vendore dhe rajonale janë në përgjithësi financiarisht dobët dhe nuk mund të nxisin zhvillimin lokal. Atyre u mungojnë aftësitë në menaxhimin, kontrollin financiar dhe buxhetimin, si edhe qasjet demokratike në proceset vendimmarrëse. Përthithja/absorbimi i fondeve të BE-së është i ulët. Bashkëpunimi mes qeverive vendore dhe rajonale ndërmjet përfituesve IPA II mund të përmirësohet. Procesi i decentralizimit është në vazhdim e sipër në të dy përfituesit.

Seksioni 3: Strategjia e programit

3.1 Argumentimi - Arsytimi për strategjinë e përzgjedhur për fushat e ndërhyrjes

Programi Ndërkufitar midis Shqipërisë dhe Kosovës do të synojë të promovojë zhvillimin social-ekonomik të qëndrueshëm në zonën ndërkufitare përmes nxitjes së bashkëpunimit mes njerëzve, komuniteteve dhe institucioneve. Në kuadër të këtij programi, **prioritetet tematike** të mëposhtme (TPs) janë identifikuar të jenë në shënjestër për periudhën 2014–2020:

Prioriteti tematik 1: Mbrojtja e mjedisit, promovimi i politikave të zbutjes dhe të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rreziqeve

Zona e programit është jashtëzakonisht e pasur me biodiversitet dhe burime natyrore. Mbrojtja dhe valorizimi i këtyre asetëve është padyshim një nga pikat kyçe për zhvillimin e qëndrueshëm dhe mund të ofrojë mundësi të shumta për bashkëpunim ndërkufitar. Zona e programit ofron një klimë dhe biodiversitet të pasur, duke përfshirë një peizazh të pasur, që nga malet më të larta në zonë, kodra, fusha, liqen, lumenj dhe bregdet. Prandaj, aksionet sipas këtij prioriteti do të mbështesin mbrojtjen, ruajtjen dhe vlerësimin e burimeve mjedisore në zonën e programit përmes iniciativave të përbashkëta për trajtimin e mbrojtjes së mjedisit dhe promovimin në fushën e programit, si: promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të burimeve mjedisore, nxitja e energjisë së rinovueshme, duke mbështetur aksionet e përbashkëta në lidhje me strategjitë, planet e veprimit, hulumtimin që synon çështjet mjedisore, duke përfshirë menaxhimin e mbetjeve të ngurta, menaxhimin e ujit, përgatitjen e strategjive dhe të planeve të veprimit mbi erozionin e tokës,



përgatitjen e strategjive dhe të planeve të veprimit për parandalimin dhe zbutjen e rreziqeve të shkaktuara nga njeriu dhe fatkeqësive natyrore. Gjithashtu, nxitja e aktiviteteve ekonomike miqësore me mjedisin, përmes partneriteteve dhe formimit të rrjeteve ndërmjet autoriteteve vendore dhe rajonale nga të dyja anët e kufirit, me fokus problematikat mjedisore dhe garantimin e nismave vendore, për të mbështetur ndërhyrjet mjedisore në shkallë të vogël të infrastrukturës dhe prokurimin e pajisjeve, si dhe promovimin e ndërgjegjësimit mjedisor dhe edukimin.

Përafërsisht 1/3 e alokimeve të përgjithshme të programit IPA , d.m.th. 2 520 000 euro, do t'u kushtohet aksioneve sipas këtij prioriteti tematik.

Prioriteti tematik 2: Inkurajimi i turizmit dhe i trashëgimisë kulturore dhe natyrore

Prioriteti i dytë do të promovojë iniciativa të përbashkëta ndërkufitare dhe aksione që synojnë turizmin, promovimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, si një mënyrë për të promovuar zhvillimin ekonomik të zonës. Ky prioritet është shumë i rëndësishëm për t'u shënjestruar nga programi, për shkak të faktit se edhe pse turizmi ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e zonës, madhësia e madhe e tregut të turizmit rajonal tregon një potencial të pashfrytëzuar në masë të madhe.

Zhbllokimi i këtij potenciali do të japë një stimul të konsiderueshëm në rritjen ekonomike të të dyja anëve të kufirit. Veç kësaj, zona e programit ofron një larmi të karakteristikave lokale që janë të përshtatshme për aktivitete turistike, si: natyra e bukur dhe peizazhet spektakolare, folklori tradicional dhe disa vende kulturore dhe historike me famë botërore.

Ky prioritet i programit do të kontribuojë për përmirësimin dhe rritjen e standardeve të jetesës, duke ofruar mundësi për partneritete dhe shkëmbime të gjera të interesit të përbashkët përtej kufirit për të zhvilluar turizmin dhe vlerësuar trashëgimisë kulturore të zonës. Pritet të zbatohen aksione që do të ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe produkteve.

Përafërsisht 1/3 e alokimeve të përgjithshme të programit të IPA-së, d.m.th. 2 520 000 euro, do t'u kushtohet aksioneve sipas këtij prioriteti tematik.

Prioriteti tematik 3: Investimi në rini, arsimim dhe aftësi

Zona e programit është relativisht e re dhe

përballet me sfida, të tilla si: mungesa e mundësive të punësimit, akses i kufizuar në arsim dhe arritjen e aftësive, çështjet e shëndetit dhe aftësinë e pamjaftueshme për të ndikuar hartimin e politikave (politikëbërjen) dhe integrimin gjinor në të gjitha nivelet në arsim. Edukimi/arsimi, në veçanti, mbetet një nga prioritetet kryesore në fushën e programimit. Ai kërkon reformë, duke përfshirë trajnimin e mësimdhënësve, masat për sigurimin e cilësisë, transparencën dhe përvojat praktike të të mësuarit.

Ekziston nevoja për të orientuar sistemin arsimor drejt kërkesave të tregut, për të mundësuar kontributin e tij në drejtim të rritjes së konkurrueshmërisë së tregut dhe në përmirësimin e jetesës së qytetarëve. Prandaj, ky prioritet renditet i treti për t'u trajtuar nga programi, me qëllim për të fuqizuar të rinjtë dhe për të promovuar edukimin dhe aftësitë në zonën ndërkufitare.

Kjo do të arrihet përmes promovimit të fuqizimit të rinisë, përmes iniciativave të vetëpunësimit, fillimin e bizneseve, shkëmbimet dhe rrjetet, teknologjinë bashkëkohore dhe moderne, organizimin e programeve të shkëmbimit të të rinjve, duke mbështetur aktivitetet e rrjeteve rinore, si: turne sportive, festivale kulture dhe muzike dhe evente, duke inkurajuar zërin e rinisë në procesin e vendimmarrjes në nivelin vendor, forcimin e partneritetit mes grupeve rinore, OJQ-të me pushtetin vendor për të ndërmarrë iniciativa të përbashkëta, duke investuar në arsim, duke përfshirë aftësitë dhe mësimin për gjatë gjithë jetës duke zhvilluar arsimin dhe infrastrukturën e trajnimit, trajnimin e mësuesve dhe kualifikimin, integrimi gjinor në të gjitha nivelet e sistemit arsimor dhe të AFP-së, promovimin e shëndetit dhe të jetesës së shëndetshme në shkollë dhe aksione të përbashkëta në fushën e kërkimit dhe zhvillimit.

Përafërsisht 1/3 e alokimeve të përgjithshme të programit të IPA-së, d.m.th. 2 520 000 euro, do t'u kushtohet aksioneve sipas këtij prioriteti tematik.

Prioriteti tematik 4: Asistenca teknike

Asistenca teknike (AT) do të synojë të sigurojë menaxhim efektiv, efikas dhe të përgjegjshëm të programit ndërkufitar. Mbështetja do të sigurohet në 2 nivele:

- Në nivel menaxhimi, përmes mbështetjes për strukturat operative dhe strukturat e menaxhimit të përbashkët, në mënyrë që të sigurohet zbatimi



efektiv, monitorimi, kontrolli dhe vlerësimi i programit CBC.

- Në nivel operacional, përmes mbështetjes së Sekretariatit të Përbashkët Teknik (SPT) që gjendet në Kukës (Shqipëri) dhe antena e tij në Prizren (Kosovë). AT-ja do të mbështesë aksionet që sigurojnë përgatitjen dhe përzgjedhjen e operacioneve të cilësisë së lartë të programit dhe shpërndarjen e informacionit mbi aktivitetet dhe arritjet e programit.

Tabela 1: Pasqyra sintetike e arsytimit për përzgjedhjen e prioriteteve tematike

Prioritetet e zgjedhura tematike

Mbrojtja e mjedisit, promovimi i politikave të zbutjes dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rreziqeve

Inkurajimi i turizmit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore

Arsyetime për përzgjedhjen

□ Zona e programit është jashtëzakonisht e pasur në biodiversitet dhe burimet natyrore. Mbrojtja dhe valorizimi i këtyre asetëve është padyshim një nga pikat kyçe për zhvillimin e qëndrueshëm dhe mund të ofrojë mundësi të shumta për bashkëpunimin ndërkuftar.

□ Zona e programit ofron një klimë dhe biodiversitet të pasur, duke përfshirë një peizazh të mrekullueshëm, malet më të larta në zonë, kodra, fusha, liqen, lumenj dhe bregdet.

□ Kërkohe promovimi dhe përmirësimi i zbatimit të rregullores dhe i standardeve të mjedisit për të siguruar menaxhim më të mirë të pyjeve dhe për të parandalur degradimin.

□ Nevojitet të promovohen përpjekjet e përbashkëta në menaxhimin dhe kontrollin e burimeve natyrore dhe parandalimin e shfrytëzimit të pakontrolluar të burimeve natyrore.

□ Duhet të promovohet sensibilizimi i palëve të interesuara për përdorimin më të mirë të burimeve

natyrore, potencialit ekzistues të lartë në pyje dhe energjitë e rinovueshme dhe, gjithashtu, promovimi ektoturizmit.

□ Potenciali turistik është një mundësi që duhet të valorizohet në të dyja anët dhe të shfrytëzohet më mirë.

□ Iniciativat CBC duhet të mbështesin zhvillimin e ofertave turistike të përbashkëta.

□ Zona e programit ofron një larmi të karakteristikave lokale që janë të përshtatshme për aktivitetet e turizmit, si: natyra e bukur dhe peizazhet spektakolare, folklori tradicional, si edhe disa vende kulturore dhe historike me famë botërore.

□ Zona ka një trashëgimi të pasur historike-kulturore-artistike që ka nevojë të ruhet dhe promovohet. Valorizimi i mëtejshëm i trashëgimisë historike dhe i kulturës mund të kontribuojë në forcimin e identitetit të zonës. Trashëgimia kulturore është një pasuri për zhvillimin ekonomik të zonës së programit.

□ Nevojitet të promovohet zhvillimi i llojeve të ndryshme të turizmit (kulinaria e turizmit malor dhe agroturizmi), meqenëse zona e programimit ka një zhvillim të pabalancuar të turizmit me prevalencë turizmin bregdetar.

□ Nevojitet të rritet niveli i bashkëpunimit ndërmjet aktorëve në fushën e zhvillimit të turizmit dhe të ruajtjes së trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

□ Është e nevojshme të investohet te rinia meqenëse zona e programit ka një popullsi relativisht të re.

□ Nevojitet përmirësimi i nivelit të arsimit profesional në funksion të shërbimit më mirë të nevojave të tregut të punës me aftësitë e nevojshme në mënyrë që të rriten aftësitë e forcës së punës të rinjve, si edhe për të rritur mundësitë e punësimit.



3.2 Përshkrimi i prioriteteve të programit

Tabela e mëposhtme zbërthen secilin prioritet në objektiva, rezultate, aktivitete dhe tregues.

PRIORITETI 1				
MBROJTJA E MJEDISIT, PROMOVIMI I POLITIKAVE TË ZBUTJES DHE TË PËRSHTATJES NDAJ NDRYSHIMEVE KLIMATIKE, PARANDALIMI DHE MENAXHIMI I RISKUT				
Objektivat specifikë	Rezultatet	Treguesit	Burimet për skenarin bazë	Aktivitetet
<p>Objektivi specifik 1</p> <p>Mbrojtja, ruajtja dhe valorizimi i burimeve mjedisore në zonën e programit</p>	<p>Rezultati 1.1</p> <p>Burimet mjedisore dhe biodiversiteti të menaxhuara dhe të promovuara më mirë</p>	<p>1.1.1 Të paktën 30% e popullsisë së zonës së programit ka qenë e përfshirë në aktivitetet për sensibilizimin mjedisor</p> <p>1.1.2 Harmonizimi i të paktën një kurrikule për edukimin mjedisor dhe/ose futja e një programi jashtëshkollor në arsimin dytësor/i mesëm në të dyja anët e kufirit deri në 2022</p> <p>1.1.3 Të paktën 5 partneritete të OSHC-ve dhe të pushtetit vendor në menaxhimin e burimeve mjedisore dhe biodiversitetit deri më 2022-shin</p> <p>1.1.4 Të paktën 30% e zonës ndërkufitare përfituese e mbuluar me strategji dhe plane veprimi (për mbetjet e ngurta, ujërat e përdorura, erozionin e tokës deri më 2022-shin</p> <p>1.1.5. Të paktën një strategji dhe plan veprimi i miratuar për parandalimin dhe zbutjen e rreziqeve të shkaktuara nga njeriu dhe fatkeqësive natyrore</p> <p>1.1.6 Prania e të paktën një skuadre ndërkufitare specializuar në menaxhimin e riskut dhe krizash</p>	<p>Zyrat Kombëtare të Statistikave</p> <p>Raportet nga ministrinë/autoritetet qendrore përgjegjëse</p> <p>Raportet e BE-së</p> <p>Raportet e bashkive/organeve vendore</p> <p>Raportet monitorimi/të projekteve</p>	<p>* Përgatitje strategjish dhe planesh veprimi për menaxhimin e mbetjeve të ngurta dhe të ujërave të përdorura</p> <p>* Përgatitje strategjish dhe planesh veprimi kundër erozionit të tokës</p> <p>* Përgatitje strategjish dhe planesh për parandalimin dhe zbutjen e rreziqeve të shkaktuara nga dora e njeriut dhe e fatkeqësive natyrore (p.sh., shpyllëzimet, emergjencat civile etj.)</p> <p>* Nxitja e aktiviteteve ekonomike miqësore me mjedisin, përmes partneriteteve dhe formimit të rrjeteve ndërmjet autoriteteve vendore dhe rajonale nga të dyja anët e kufirit, me fokus problematikat mjedisore dhe garantimin e nismave vendore</p> <p>* Promovimi i sensibilizimit mjedisor dhe i edukimit mbi rëndësinë e mbrojtjes së burimeve natyrore</p> <p>* Mbështetje për ndërhyrjet dhe prokurimin e pajisjeve për infrastrukturën mjedisore të shkallës së vogël</p> <p>* Sisteme hartëzimi ndërkufitare dhe sisteme monitorimi mjedisore të integruara</p> <p>* Ndërhyrje në shkallë të vogël për të nxitur energjinë e rinovueshme</p>



PRIORITETI 2				
NXITJA E TURIZMIT DHE E TRASHËGIMISË KULTURORE DHE NATYRORE				
Objektivat specifikë	Rezultatet	Treguesit	Burimet për skenarin bazë	Aktivitetet
<p>Objektivi specifik 2.1</p> <p>Turizmi, trashëgimia kulturore dhe natyrore valorizohet si mënyrë për të promovuar zhvillimin ekonomik të zonës</p>	<p>Rezultati 2.1</p> <p>Cilësia e shërbimeve dhe e produkteve të turizmit përmirësohet dhe bëhet konkurrese</p>	<p>2.1.1 Rritja me 20% e numrit të turistëve që vizitojnë zonën e programit <i>(numri bazë më 2014-ën është rreth 120 000 turistë)</i></p> <p>2.1.2 Rritja me 20% e kontributit të turizmit në PBB-në rajonale nga secila anë e turizmit deri më 2020-ën <i>(shifra bazë e 2014-ës është rreth 10%)</i></p> <p>2.1.3 Të paktën 10 nisma biznesi turizmi të ngritura dhe funksionale deri më 2022-shin</p> <p>2.1.4 Të paktën 5 produkte turizmi të përbashkët të krijuara deri më 2022-shin</p>	<p>Zyrat kombëtare të statistikave</p> <p>Raportet nga ministrinë/autoritetet qendrore përgjegjëse</p> <p>Raportet e BE-së</p> <p>Raportet e bashkive/organeve vendore</p> <p>Raportet monitorimi/të projekteve</p>	<p>* Ndërhyrje të shkallës së vogël (përfshi fuqizimin e zonave turistike më pak të njohura, por me potencial, shtigjet turistike, si edhe prokurimin e pajisjeve)</p> <p>* Promovimi i zonave turistike dhe i ofertave të përbashkëta, shkëmbimi i praktikave të mira, strategjive dhe planeve për të shtrirë rrezen e nismave turistike dhe për të përmirësuar standardet e ofertës turistike</p> <p>* Promovimi i nismave dhe i konkurrueshmërisë së sipërmarrjeve vendore turistike dhe i cilësisë së produkteve dhe të shërbimeve që ofrojnë në zonën ndërkufitare, përfshi turizmin aktiv dhe shëndetësor</p> <p>* Transferimi i dijeve dhe i aftësive, duke futur teknologji të reja, teknika të reja marketingu dhe promovimi, përfshi hartëzimin, përdorimin e TIK-ut, multimedias, kërkimor-shkencor në turizëm dhe ofrimin e shërbimit</p> <p>* Futja e hartëzimit të integruar turistik (historik e gastronomik)</p> <p>* Zhvillimi dhe promovimi i markave rajonale të reja/ekzistuese të produkteve tipike vendore (produktet agrourbushqimore, zejet etj.) në zonën e programit</p>
	<p>Rezultati 2.2</p> <p>Trashëgimia kulturore, historike dhe</p>	<p>2.2.1. Të paktën 2 000 pjesëmarrës më shumë në evenimente kulturore deri më 2022-shin</p> <p>2.2.2 Të paktën 1 000 vizitorë në zonat kulturore dhe</p>	<p>Zyrat Kombëtare të Statistikave</p> <p>Raportet nga ministrinë/autoritetet qendrore përgjegjëse</p> <p>Raportet e BE-së</p>	<p>* Aksione të përbashkëta për të mbështetur dhe promovuar trashëgiminë kulturore në zonën e programit</p> <p>* Organizimi i festivaleve, i panairëve, konkurseve vendore në kufi, në lidhje me</p>



	natyrore ruhet dhe promovohet më mirë	natyrore	Raportet bashkive/organeve vendore Raporte monitorimi/të projekteve	vlerat kulturore dhe/ose trashëgiminë kulturore * Programe sensibilizimi dhe edukimi (si trajnime, përfshi shkollat) për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve në zonat kulturore dhe natyrore * Zhvillimi dhe promovimi i markave rajonale të reja/ekzistuese të produkteve tipike vendore (produktet agroushqimore, zejet etj.) në zonën e programit * Promovimi i artistëve të rinj dhe nismave rinore për shkëmbimet kulturore përmes shtëpive të kulturës, qendrave të burimeve etj. * Programe trajnimi dhe sensibilizimi/edukimi, përfshi shkolla për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve në zonat kulturore dhe natyrore * Nisma që restaurojnë, ruajnë dhe përmirësojnë zonat kulturore dhe historike përmes ndërhyrjeve në shkallë të vogël
--	---------------------------------------	----------	--	--

PRIORITETI 3
INVESTIME NË RINI, ARSIMIM DHE AFTËSI

Objektivat specifikë	Rezultatet	Treguesit	Burimet për skenarin bazë	Aktivitetet
Objektivi specifik 3 Forcimi i integritimit socioekonomik të rinisë	Rezultati 3.1 Aksesi në punësim, arsimim dhe aftësi i të rinjve përmirësohet	3.1.1 Të paktën 10% të të rinjve (të ndarë sipas gjinisë) të përfshirë në nisma ndërkufitare arrijnë të gjejnë punë 3.1.2 Të paktën 300 të rinj (të ndarë sipas gjinisë) të trajnuar mbi shërbimet e reja të nxënies për gjithë jetën deri me 2022 3.1.3 Të paktën 10% të të rinjve (të ndarë sipas gjinisë) të përfshirë në masat e vetëpunësimit hapën biznes të tyre deri më 2022-shin	Zyrat Kombëtare të Statistikave Raportet nga ministrinë/autoritetet qendrore përgjegjëse Raportet e BE-së Raportet e bashkive/organeve vendore Raporte monitorimi/të projekteve	* Mbështetja e nismave të rinisë për vetëpunësim, bizneset e reja, shkëmbimet dhe formimin e rrjeteve, duke futur praktika novatore, teknologji moderne etj. * Mbështetja e programeve të shkëmbimit, aktivitetet e formimit të rrjeteve, si turne sportive, festivale dhe ngjarje kulturore dhe muzikore * Promovimi i përfshirjes sociale dhe ekonomike të rinisë * Inkurajimi i pjesëmarrjes së rinisë në procesin e vendimmarrjes në nivel vendor



				<p>* Forcimi i partneriteteve mes grupeve rinore, OJF-ve me pushtetin vendor për të ndërmarrë nisma të përbashkëta</p> <p>* Investime në arsimim, përfshi aftësi dhe të nxëniet për gjithë jetën, duke përgatitur programe edukimi dhe trajnimi dhe duke ngritur infrastrukturën</p> <p>* Parandalimi i braktisjes së shkollës, veçanërisht në zonat rurale</p> <p>* Mundësimi i shkëmbimeve për mësuesit dhe trajnime për kualifikime të reja</p> <p>* Forcimi i lidhjeve të formimit profesional me tregun e punës</p> <p>* Forcimi i integritit gjinor në të gjitha nivelet e sistemeve arsimore dhe AFP-në</p> <p>* Promovimi i shëndetit dhe i stileve të jetesës të shëndetshme nëpër shkolla</p>
	<p>Rezultati 3.2</p> <p>Rrjetet dhe shkëmbimet rinore forcohen</p>	<p>3.2.1 Të paktën 3 rrjete shkëmbimi rinor vazhdojnë përtej mbështetjes së programit</p> <p>3.2.2 Të paktën 1 000 pjesëmarrës (të ndarë sipas gjinisë) marrin pjesë në aktivitetet e organizuara në kufi, si turne sportive rinore dhe/ose festivale rinore deri më 2022-shin</p>	<p>Zyrat Kombëtare të Statistikave</p> <p>Raportet nga ministritë/autoritetet qendrore përgjegjëse</p> <p>Raportet e BE-së</p> <p>Raportet e bashkive/organeve vendore</p> <p>Raportet monitorimi/të projekteve</p>	<p>* Promovimi i nismave për fuqizimin e rinisë</p> <p>* Mbështetja e programeve të shkëmbimit, aktivitetet e formimit të rrjeteve, si turne sportive, festivale dhe ngjarje kulturore dhe muzikore</p> <p>* Promovimi i përfshirjes sociale dhe ekonomike të rinisë</p> <p>* Inkurajimi i zërit të rinisë në procesin e vendimmarrjes në nivel vendor</p>



Prioriteti 4: Asistenca teknike

Objektivi specifik

Objektivi specifik i asistencës teknike është të garantojë zbatim efikas, efektiv, transparent dhe në kohë të programit të bashkëpunimit ndërkufitar, si edhe të sensibilizojë komunitetet kombëtare, rajonale dhe vendore të programimit, si edhe popullsinë në përgjithësi në zonën e programit. Gjithashtu, mbështet aktivitetet sensibilizuese në nivel të gjerë, me qëllim që qytetarët të informohen për IPA II. Për më tepër, siç ka dëshmuar përvoja gjatë ciklit të programimit 2007–2013, ky prioritet do të përforcojë kapacitetet administrative të autoriteteve dhe përfituesve, që zbatojnë programin, me qëllim përmirësimin e “autorësisë” dhe përshtatshmërisë së rezultateve të projekteve dhe programit.

Asistenca teknike do të përdoret për të mbështetur punën e strukturave operuese (SO) dhe të Komitetit të Përbashkët Monitorues (KPM), në garantimin e ngritjes eficiente, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të programeve, si edhe në përdorimin optimal të burimeve. Kjo do të arrihet përmes ngritjes dhe funksionimit të Sekretariatit të Përbashkët Teknik (SPT), që do të ngarkohet me menaxhimin e përditshëm të programit dhe do të raportojë pranë SO-së dhe KPM-së.

Rezultatet e synuara

1. Mbështetja administrative për strukturat operuese (SO) dhe Komitetin e Përbashkët Monitorues të Programit forcohet

Ky prioritet do të garantojë zbatim normal të programit gjatë të gjitha fazave. Ai përfshin disponimin e mjeteve financiare dhe stafin e kualifikuar të aftë që të asistojë strukturat operuese dhe Komitetin e Përbashkët Monitorues, si edhe ngritjen dhe forcimin e menaxhimit, monitorimit, mekanizmat e kontrollit dhe procedurat. Nëse

nevojitet, do të kontribuojë edhe në përgatitjen e ciklit financiar pasues (2001–2007).

Treguesit e rezultateve

Treguesi	Njësia	Skenari bazë	Objektivi 2022
Përqindja e përfituesve të kënaqur me mbështetjen për zbatimin e programit	%	Nuk ka të dhëna	75%

* Për sa i përket treguesit të rezultatisë 1, vini re se programi Shqipëri–Kosovë ka shpallur vetëm një thirrje për aplikime dhe zbatimin e projekteve nën këtë thirrje fillon në dimrin 2014, prandaj ky tregues është shënuar me “nuk ka të dhëna”. Për referenca në të ardhmen, kur të bëhet vlerësimi i programit të tanishëm, do të merret parasysh për programimin e periudhës së ardhshme 2014–2020, përfshi skenarin bazë dhe objektiva më të saktë.

2. Kapacitetet teknike dhe administrative për menaxhimin dhe zbatimin e programit forcohen

Ky prioritet do të japë mundësi për përmirësimin e kompetencave dhe aftësive të strukturave drejtuese të programit, si edhe të aplikantëve potencialë dhe fituesve të granteve. Për forcimin e kapaciteteve do të përgatiten aktivitete të posaçme, që do të zbatohen mbi bazën e nevojave të evidentuara gjatë zbatimit të programit. Si pjesë e mësimave të nxjerra nga cikli i programit 2007–2013, do të forcohen këto aspekte: i. pjesëmarrja e anëtarëve të KPM-së në detyrat që parashikon kadri ligjor i IPA II; ii. kapacitetet e aplikantëve potencialë për të krijuar partneritete ndërkufitare të qëndrueshme; iii. kapacitetet e përfituesve të granteve për të përmbushur kënaqshëm detyrimet kontraktuale të tyre.

Treguesit e rezultateve

Treguesi	Njësia	Skenari bazë	Objektivi 2022
Rritja mesatare e numrit të aplikimeve të dorëzuara gjatë secilës thirrje *	%	Numri i aplikimeve të dorëzuara në thirrjen e parë të programit në vazhdim (2007–2013)	20%
Përqindja mesatare e koncept-notave që kualifikohen për vlerësim të mëtejshëm **		Nuk ka **	Rritja e përqindjes gjatë ciklit të programit



* Vini re se në perspektivën financiare 2014–2020 parashikohen thirrje për propozime të mundshme specifike/strategjike, me fokus të qartë dhe/ose kërkesa të caktuara në lidhje me përfituesit potencialë. Gjithashtu, thirrjet për propozime mund të përzgjedhin prioritetet tematike (PT) dhe objektivat specifikë të tyre mbi bazën e parimit të rotacionit, prandaj, në këtë aspekt, numri i propozimeve nuk është e sigurt që do të rritet. Për këto arsye, rritja potenciale në numrin e aplikimeve të dorëzuara mund të llogaritet për çdo thirrje të njëpasnjëshme individualisht dhe do të ndikohet nga një faktor që mund të llogaritet, mbi bazën e: 1. Buxhetit total të disponueshëm; 2. Prioritetet tematike, objektivat specifikë dhe rezultatet e përfshira në thirrjen për propozime; 3. Shumat minimale dhe maksimale të granteve të lejuara; 4. Numri i aplikimeve dhe i granteve të lejuara për çdo aplikant/bashkëpunues/subjekt i ndërlidhur; 5. Çfarëdo dispozite tjetër që ndikon në kriteret e pranueshmërisë për një thirrje specifike.

**Nuk ka për shkak të faktit se skenari bazë nuk mund të përcaktohet, sepse thirrjet për propozime u hapën pasi dokumentacioni u dorëzua në një vend pa koncept-notë.

4.1.3. Vizibiliteti i programit dhe rezultatet garantohen

Programet BNK kanë qenë shumë të përhapura në zonat përfituese falë, ndër të tjera, masave të vizibilitetit të ndërmarra gjatë ciklit të programit 2007–2013. Nisur nga numri i aplikantëve në thirrjet pasuese, vihet re rritje e interesit për nisma bashkëpunimi. Këto arritje duhet të ruhen dhe të konsolidohen përmirësohet edhe gjatë zbatimit të perspektivës financiare 2014–2020. Duhet të përgatiten një sërë kanalesh komunikimi dhe mekanizma publiciteti, për të garantuar informim të rregullt të palëve të interesuara të programit dhe audiencë sa më të madhe.

Treguesit e rezultateve

<i>Treguesi</i>	<i>Njësia</i>	<i>Skenari bazë</i>	<i>Objektivi 2022</i>
Rritja e njerëzve pjesëmarrës në aktivitetet promovuese *	Nr.	550	30%
Klikimet në faqen e internetit të programit **	Nr.	Nuk ka të dhëna	Të paktën 1 000 vizitorë në vit. 50%

* Faqja e internetit e programit është në ndërtim e sipër dhe aktualisht nuk ka një mekanizëm për të matur vizitorët.

Lloji i aktiviteteve

Lista joshteruese me aktivitete potenciale që mbulohen me asistencë teknike mund të jetë e tillë:

- ngritja dhe funksionimi i Sekretariatit të Përbashkët Teknik dhe Antenës së tij;
- organizimi i evenimenteve, mbledhjeve, trajnimeve, vizitave studimore apo shkëmbimeve për të mësuar mbi praktikën më të mira nga nisma zhvillimi territorial të tjera;
- pjesëmarrja e personelit në strukturat drejtuese në forumet e Ballkanit Perëndimor apo BE-së;
- përgatitja e manualeve të brendshëm dhe të jashtëm;
- asistencë për aplikantët potencialë për krijim partneritetesh dhe përgatitje projekti (kërkimi për partner, forume etj.);
- këshillimi i përfituesve të grantit për çështjet e zbatimit të projektit;
- monitorimi i zbatimit të projektit dhe programit, përfshi ngritjen e një sistemi monitorimi dhe mekanizma raportimi;

- organizimi i vlerësimeve, analizave, anketave dhe/ose studimeve përmblendhëse;

- informimi dhe publiciteti, përfshi përgatitjen, miratimin dhe rishikimin periodik të një plani vizibiliteti dhe komunikimi, shpërndarjen e informacionit (info-ditët, mësimet e nxjerra, studimi i rasteve më të mira, artikuj shtypi dhe komunikata), evenimente promovuese, printime, mekanizma komunikimi, mirëmbajtja, si edhe përditësim dhe fuqizim i faqes së internetit të programit etj.

- mbështetja e punës së Task-Forcës së Përbashkët të ngarkuar me përgatitjen e ciklit të programit 2021–2026;

- të tjera.

Grupet e synuara dhe përfituesit përfundimtarë (listë joshteruese)

- strukturat drejtuese të programit, përfshi autoritetet kontraktuese;
- aplikantët potencialë;
- përfituesit e granteve;
- përfituesit përfundimtarë të projekteve;



- publiku i gjerë.

3.2 Çështje horizontale ndërsektoriale

Programi ka reflektuar rëndësinë që BE-ja u kushton çështjeve horizontale ndërsektoriale. Ajo do të integrojë dhe do të inkorporojë këto çështje në përputhje me objektivat dhe politikat e BE-së. Çështje të tilla janë reflektuar në të gjitha prioritetet e zgjedhura për programin, si krijimi i partneriteteve ndërkufitare, “autorësia” vendore dhe mundësitë e barabarta, garantimi i mosdiskriminimit të minoriteteve dhe të kategorive të cenushme, pjesëmarrja e organizatave të shoqërisë civile, mbrojtja e mjedisit, të drejtat gjinore, si edhe qeverisja e mirë.

Programi fokusohet në çështjen e mbrojtjes së mjedisit, në prioritetin 1, duke mbuluar ndërhyrjet për mbrojtjen e mjedisit ndaj rreziqeve, si edhe ato për edukimin mjedisor dhe qëndrueshmërinë e mjedisit.

Ky program BNK mund të financojë projektet e përgatitura me qasjen “Zhvillim Bazuar në Zonë” (ZBZ) që synojnë të lehtësojnë rritjen e qëndrueshme në zona të caktuara gjeografike të rajoneve ndërkufitare të Ballkanit Perëndimor, veçanërisht zonat rurale me probleme zhvillimi të

ndërlikuara dhe specifike. Do të shikohet edhe puna përgatitore për qasjen ZBZ që është ndërmarrë deri tani në rajonin ndërkufitar që shtrihet në Shqipëri dhe Kosovë.

Çështja e integritimit gjinor trajtohet përballë prioritetit të tretë, me qëllim që të arrihet fuqizim dhe integrim gjinor në të gjitha nivelet e sistemit arsimor dhe AFP, si në zonat urbane, edhe ato rurale.

Gjithashtu, programi mbështet edhe partneritetet mes shoqërisë civile dhe pushtetit vendor, me qëllim garantimin e “autorësisë” vendore dhe masave të qëndrueshme. Programi mban parasysh edhe kategoritë e cenushme, gjithëpërfshirjen dhe të drejtat e njeriut.

Seksioni 4: Plani financiar

Tabela 1 tregon shumën indikativë vjetore të kontributit të BE-së për programin BNK për periudhën 2014–2020.

Tabela 2 paraqet një shpërndarje indikativë të buxhetit për çdo prioritet tematik, afërsisht 1/3 për çdo prioritet, si edhe shumën maksimale të bashkëfinancimit të BE-së

Tabela 1: Fondet treguese të akorduara çdo vit për programin e bashkëpunimit ndërkufitar 2014–2020

Viti	Programi IPA BNK Shqipëri–Kosovë							Total (euro)
	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2014–2020
Operacionet BNK (të gjitha prioritetet tematike)	840 000	1 200 000	1 200 000	840 000	1 200 000	1 200 000	1 080 000	7 560 000
Asistenca teknike	360 000	0	0	360 000	0	0	360 000	840 000
Total (EUR)	1 200 000	1 200 000	1 200 000	1 200 000	1 200 000	1 200 000	1 200 000	8 400 000

Tabela 2: Fondet treguese të akorduara çdo vit për periudhën 2014–2020 dhe përqindja e kontributit të BE-së

PRIORITETET	Programi IPA BNK Shqipëri – Kosovë 2014-2020			
	Kontributi i BE-së	Bashkëfinancimi i përfituesit/ve	Financimi total	Norma e kontributit të BE-së
	(a)	(b)	(c)=(a)+(b)	(d)=(a)/(c)
1. Prioriteti tematik	2 520 000	444 706	2 964 706	85%
2. Prioriteti tematik	2 520 000	444 706	2 964 706	85%
3. Prioriteti tematik	2 520 000	444 706	2 964 706	85%
4. Prioriteti tematik	84 000	0	84 000	100%
TOTALI	8 400 000	1 334 118	9 734 118	



Kontributi i BE-së është llogaritur në raport me shpenzimet e pranueshme, që bazohen në totalin e shpenzimeve të pranueshme, duke përfshirë shpenzimet publike dhe private. Norma e bashkëfinancimit të BE-së për çdo prioritet tematik duhet të jetë jo më pak se 20% dhe jo më shumë se 85% e shpenzimeve të pranueshme.

Shuma e dedikuar për asistencën teknike duhet të përbëjë jo më shumë se 10% të buxhetit total akorduar për programin. Norma e bashkëfinancimit e BE-së është 100%.

Fondet për prioritetet tematike angazhohet përmes vendimeve zbatuese të Komisionit që akordojnë fonde mbi bazë trevjeçare, kur është e mundur. Fondet për asistencën teknike akordohen mbi bazën e një vendimi zbatues të posaçëm të Komisionit.

Seksioni 5. Dispozitat zbatuese

Të tria prioritetet e programit do të realizohen përmes thirrjeve për propozime. Komiteti i Përbashkët Monitorues do të jetë përgjegjës për identifikimin e prioritetëve tematike, objektive specifike, përfituesve të synuar, si edhe do të përcaktojë fokusin specifik të secilës thirrje për propozime që do të miratohet nga Komisioni Evropian. Në këtë aspekt, një proces konsultimi shtesë mund të zhvillohet me palët e interesuara në nivel vendor dhe qendror, si edhe me komunitetin e donatorëve.

Gjatë përgatitjes së programit, nuk është evidentuar ndonjë projekt strategjik që të përzgjidhet jashtë thirrjes për propozime. Megjithatë, gjatë periudhës së zbatimit të programit, mund të vendoset që një pjesë të buxhetit të programit (një apo dy vite) të financojnë projektet më strategjike, veçanërisht ato që lidhen me prioritetet tematike të Mjedisit dhe Turizmit. Kjo zgjidhje është mbështetur

gjatë procesit të konsultimit programit nga disa prej përfituesve potencialë.

Projektet strategjike mund të zgjidhen përmes thirrjeve për projekte strategjike ose edhe jashtë thirrjes për propozime. Në këtë rast, Komisioni duhet të miratojë ndryshim/e në programin BNK, pas propozimit dhe pëlqimit nga KPM-ja, me qëllim integrimin në program të një projekti strategjik të tillë.

Projektet strategjike përkufizohen si ndërhyrje me ndikim të rëndësishëm ndërkuftar në të gjithë zonën e programit i cili, në mënyrë të pavarur ose në kombinim me projekte të tjera strategjike, kontribuon ndjeshëm në arritjen e objektivave madhorë në nivel prioritet. Disa kritere të përgjithshme për përzgjedhjen e projekteve strategjike mund të jenë: ndikimi në të dyja anët e zonës së programit; lidhja me strategjitë rajonale apo të tjera për zhvillimin e zonave kufitare; norma e kontributit dhe bashkëfinancimit nga autoritetet rajonale; numri i banorëve që përfitojnë nga ndërhyrjet; kosto-efektiviteti i ndërhyrjeve; komplimentariteti me aksione paralele dhe qëndrueshmëria e ndërhyrjeve. Për më tepër, këto projekte duhet të kenë dokumentacion të plotë tenderi dhe, në rast të investimeve në infrastrukturë, duhet të kenë të gjitha lejet e nevojshme për ndërtimin dhe shfrytëzimin, bashkë me vlerësimet e nevojshme të ndikimit në mjedis.

Prioriteti i tretë “Edukimi i rinisë dhe aftësitë” do të zbatohet vetëm përmes thirrjeve për propozime, me financim me buxhet 1- apo 2-vjeçar. Me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe ndikimit të programit, rezultatet e synuara mund të kërkohen në disa raste thirrjesh, sipas një modeli të ngjashëm me ilustrimin në tabelën më poshtë.

Raundi i thirrjeve për propozime	Objektivat specifike	Lloji i thirrjeve për propozime
I PARI	Objektivi specifik 1, rezultati 1.1 Thirrje për propozime e përgjithshme: Menaxhimi dhe promovimi më i mirë i burimeve mjedisore dhe biodiversitetit Objektivi specifik 2, rezultati 1.2 Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve turistike për t'u bërë më konkurruese Objektivi specifik 3, rezultati 1.3 Përmirësimi i aksesit në punësim, arsimim	



	dhe formim profesional për të rinjtë	
I DYTI	Objektivi specifik 2, rezultati 2.1 Thirrje për propozime e përgjithshme: Menaxhimi dhe promovimi më i mirë i burimeve mjedisore dhe biodiversitetit Objektivi specifik 2, rezultati 2.2 Përmirësimi i ruajtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore, historike dhe natyrore Objektivi specifik 3, rezultati 2.3 Fuqizimi i rrjeteve dhe shkëmbimeve rinore	
I TRETË	Objektivi specifik 3, rezultati 3.1 Thirrje për propozime e përgjithshme: Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve dhe produkteve turistike për t'u bërë më konkurruese Objektivi specifik 3, rezultati 3.2 Përmirësimi i aksesit në punësim, arsimim dhe formim profesional për të rinjtë	

SITUATA DHE ANALIZA SWOT
PROGRAMI IPA CBC SHQIPËRI–
KOSOVË*
2014–2020

* Ky emërtim nuk cenon qëndrimet në lidhje me statusin dhe është në pajtim me rezolutën 1244/1999 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe me Opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GjND) për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

1. HYRJJE

Zona²⁶ e programit për programin ndërkufitar ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës mbulon një territor prej 8,335 km², me një popullsi prej rreth 936,761 banorësh. Gjatësia e përgjithshme e vijës kufitare është 114 km².

Harta e zonës së programit



Në Shqipëri zonat përfituese mbulojnë 3,994 km², që përfshijnë 2 rajone dhe 8 bashki me një

²⁶ Zona ndërkufitare përfituese është përcaktuar në përputhje me nenin 88 të rregullores zbatuese IPA.

total prej 36²⁷ vendbanime. Të dyja rajonet nga Shqipëria²⁸ përfshijnë:

Rajoni i Kukësit përfshin rrethet Kukës, Has dhe Tropojë, 3 bashki, 24 komuna dhe 206 vendbanime.

Rajoni i Lezhës përfshin rrethet: Lezhë, Mirditë dhe Kurbin, 5 bashki, 16 komuna dhe 170 vendbanime.

Në Kosovë²⁹ zona përfituese mbulon 4,341 km² dhe përfshin rajonet ekonomike të mëposhtme:

Rajoni Ekonomik Jugor përbëhet nga 6 komuna: Prizren, Dragash/Dragaš, Rahovec/Orahovac, Suharekë/Suva Reka, Malishevë/Mališevo dhe Mamusha/Mamuša.

Rajoni Ekonomik Perëndimor përbëhet nga 6 komuna: Pejë/Peć, Deçan/Dečani, Gjakovë/Đakovica, Istog/Istok, Klinë/Klina dhe Junik.

As Shqipëria dhe as Kosova nuk kanë paraqitur ende zyrtarisht klasifikimet³⁰ e Nomenklaturës së Njësive Territoriale për Statistikat (NUTS), si rrjedhojë, zonat përfituese bazohen, për Shqipërinë në rajonet administrative dhe për Kosovën në përcaktimin “rajon ekonomik”.

²⁷ Agjencia e Statistikave të Kosovës: Kosova në shifra 2012.

²⁸ Censuri i Popullsisë dhe Banesave 2011, INSTAT, Shqipëri.

²⁹ Agjencia Kadastrale e Kosovës 2013.

³⁰ Nomenklatura e Njësive Territoriale për Statistikat.



Tabela 1: Gjeografia e zonës së programit

	Sipërf. (km ²)	% e territorit të përgjithshëm
Shqipëria	28,748	100%
Zonë ndërkuftare	3,994	48%
Rajoni i Kukësit (rrethet Kukës, Has dhe Tropojë)	2,374	28.48%
Region of Lezha (<i>Distriktet of Lezha, Mirdita and Kurbin</i>)	1,620	19.44%
Kosova	10,908	100%
Zonë ndërkuftare	4,341	52%
Rajoni Ekonomik Jugor	2,016	24%
Rajoni Ekonomik Perëndimor	2,325	28%
Zona e programit - TOTALI	8,335	AL: 48%, KOS: 52%

Madhësia e territorit të zonës së programit për Shqipërinë është pak më e vogël (48%) në krahasim me territorin në Kosovë (52%). Në anën kosovare ka 4 komuna në kufi të drejtpërdrejtë me Shqipërinë (Deçan/Decani, Gjakovë/Đakovica, Prizren dhe Dragash/Dragaš) dhe në Kukës është përgjatë territorit të saj në kufirin me Kosovën.

Aktualisht gjenden gjashtë pika të kalimit kufitar që operojnë mes Shqipërisë dhe Kosovës. Nga këto, tri pikat e kalimit të kufirit (Shishtavec/Kukës, Orgjosë/Kukës dhe Borje/Kukës) janë vetëm për këmbësorët; ndërsa tre janë për transportin e mallrave dhe automjeteve (Morinë/Kukës, Qafa Prush/Kukës dhe Qafë Morinë/Tropojë, njëra në autostradën midis Kukësit dhe Prizrenit, dhe dy të tjerat në rrugët kufitare lokale që lidhin Rajonin e Kukësit me Pejë/Peć dhe Gjakovën/Đakovica në Kosovë). Të tria pikat e kalimit kufitar për makinat dhe kamionët janë të keqpajisura për kryerjen e kalimit të mallrave.

E gjithë zona e programit është e pasur me vargmale, pyje, kafshë të egra dhe kullota, si edhe me minerale dhe ujë. Terreni, gjithashtu, është mjaft i vështirë me vendndodhje të pashfrytëzuara duke e bërë atë një atraksion për turizmin në të dyja anët e kufirit. Zona ka kontraste të terreneve malore dhe fushore, burime ujore, liqene, peshkim, lumenj, që rrjedhin nga të dyja anët e kufirit me dalje në det nëpërmjet Lezhës. Autostrada e re e ndërtuar që kalon përmes Durrësit për në Kukës dhe pastaj përmes kufirit në Prishtinë ka kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në rritjen e lëvizshmërisë së njerëzve dhe mallrave për

qëllime të ndryshme, si tregtisë, turizmit, arsimit dhe shkëmbimeve, që nga viti 2009.

Në anën **shqiptare**, të dyja rajonet e zonës së programit me Kosovën mbulojnë rreth 13.9% të territorit të Shqipërisë.

Rajoni i **Kukësit** ka një territor prej 2374 km². Është i vendosur në pjesën verilindore të Shqipërisë dhe paraqet një model të terrenit të vështirë. Rajoni është i vendosur në një lartësi mesatare prej 680 metrash mbi nivelin e detit. Rajoni i Kukësit është shumë i pasur me ujë dhe burime hidrike.

Ajo çka e bën atë me interes të veçantë është mbledhja e të gjitha rrjedhave, përrenj dhe lumenj që rrjedhin në lumin Drin. Liqeni i Fierzës është qendra e të gjitha rrjedhave dhe mjediseve ujore dhe është i përshtatshëm për të kultivuar peshq të ndryshëm. Pasuritë ujore të rajonit përdoren edhe si burime të energjisë. Rajoni ka akses në infrastrukturën rrugore dhe lidhjen me pjesën tjetër të vendit, veçanërisht me kryeqytetin, aeroportin ndërkombëtar dhe portin, përmirësuar ndjeshëm, veçanërisht pas investimeve në autostradën Durrës–Kukës–Morinë.

Rajoni i **Lezhës** mbulon një territor prej 1,620 km² dhe shtrihet përtej detit Adriatik, me një vijë bregdetare prej 38 km në anën veriperëndimore të Shqipërisë. Rajoni i Lezhës kufizohet me rajonin e Kukësit në anën e tij verilindore.


Territori i Lezhës është i përbërë nga zonat malore në lindje (65%) dhe zonën fushore në perëndim (35%). Pozita e tij gjeografike - të qenët në qendër të kalimit kryesor të transportit që lidh veriun me jugun dhe lindjen me perëndimin dhe afërsia e tij me portet kryesore



bregdetare, si Durrës dhe Shëngjin (ky i fundit duke qenë pjesë e territorit të Lezhës), e bën rajonin një tërheqje të madhe dhe lehtësisht të arritshëm jo vetëm në nivel kombëtar, por edhe në atë ndërkombëtar). Rajoni ka burime ujore, duke qenë i vendosur pranë rrjedhave të lumenjve (Drin, Gjadër, Fan i Vogël, Fan i

Madh, Drojë, Urakë, Mat), detit Adriatik, maleve dhe kodrave me një florë dhe faunë të pasur - që i shtohen interesit ekonomik dhe potencialit turistik. Lezha ka zona arkeologjike, objekte të kultit, monumente të kulturës me vlerë historike kombëtare.

Figura 2: Zona e Programit në km²



Në anën e Kosovës, të dyja rajonet ekonomike në zonën kufitare me Shqipërinë mbulojnë rreth 39,8% të territorit të Kosovës. Komunat, në vijë kufitare të drejtpërdrejtë me Shqipërinë mbulojnë një sipërfaqe prej 1,967 km², ose 18% të të gjithë territorit të Kosovës.

Rajoni Ekonomik Jugor me 2,016 km² ka Prizrenin si qytet të lashtë historik që shtrihet përgjatë brigjeve të lumit Lumëbardhë, në luginat piktoreske pranë maleve të Sharrit/Šar; i cili në një lartësi prej 2,496 m dhe me liqenet e tij akullnajore përbën një atraksion të fuqishëm turistik. Gryka e Mírushës/Míruša me 13 liqenet e saj dhe 12 ujëvarat është një prej katër burimeve natyrore të rajonit. Gjetjet arkeologjike dëshmojnë se Prizreni është një nga qytetet më të vjetra të Evropës Juglindore e më gjerë. Ka të kultivuar trashëgiminë kulturore, vendet turistike dhe zhvillimin e turizmit. Komunat e tjera si Dragash/Dragaš janë të pasura në kullotë, livadhe, male dhe fusha bujqësore.

Rajoni Ekonomik Perëndimor me 2,325 km² është portali perëndimor i Kosovës në kufi me Shqipërinë, Malin e Zi dhe Serbinë. Peja/Peć, e cila konsiderohet si qendra e rajonit, është e

vendosur në këmbët e malit mbresëlënës Bjeshkët e Nemuna. Zona është e mbuluar kryesisht nga rrafshi i Dukagjinit që kufizohet me Alpet shqiptare. Maja më e lartë është Gjeravica (2,656 m), e cila është edhe maja më e lartë në Kosovë. Gjenden burime të nxehta termale dhe minerale, 3 lumenj karstikë, një ujëvarë e fuqishme e quajtur Burimi i Drinit të Bardhë (Drini i Bardhë/Beli Drim) duke e bërë atë një atraksion turistik.

Zona e programit ka një profil të ndryshëm gjeografik. Ajo është e pasur me vargmale, fusha, lugina, lumenj dhe liqene. Gjithashtu është e pasur me pyje, kafshë të egra dhe kullota (pyjet, kullotat dhe livadhe mbulojnë mbi 50% të sipërfaqes së përgjithshme). Kjo është një zonë tradicionale për mbarështimin e deleve dhe konsiderohet si zonë e madhe e kullotave në Evropë. Është e pasur me minerale, si krom, qymyr, hekur-nikel, bakër, gëlqere, rërë kuarci, mermer dhe përmban monumente të shumta natyrore.

Zona e programit njihet për grupet e rëndësishme të maleve, që përbëhen nga masive alpine, të cilat ofrojnë mundësi të mëdha për



zhvillimin e turizmit dhe industrisë së drurit, por edhe që e pengojnë infrastrukturën e transportit dhe komunikimin me fqinjët.

Zona është pjesa më e pasur e Kosovës; me burime ujore, me lumenjtë Drin, që rrjedhin në Shqipëri, Bistricë, Lumëbardhë, Lepenec duke kaluar relievin malor. Disa liqene, si liqenet Livadhi, Strbacko, Jazhnica, si dhe kamionët Brod janë burime me potencial të madh për zhvillimin e sporteve dimërore, peshkimit dhe aktiviteteve të tjera turistike. Malet e Sharrit/Šar, një nga dy parqet kombëtare në Kosovë, shtrihen përgjatë tri komunave: të Prizrenit, Dragashit/Dragaš dhe Suharekës/Suva Reka.

Shqipëria është e dominuar nga zinxhiri i maleve Dinarike. Lumenjtë kryesorë janë Drini, që vjen nga Kosova, dhe Valbona. Gjenden liqenet natyrale dhe artificiale, të cilat janë me vlerë potenciale për turizmin, dy liqenet më të rëndësishme artificiale në rajonin e Kukësit, Komen dhe Fierzë. Lumi Drin, i cili rrjedh nëpër territorin e Shqipërisë dhe Kosovës, përfaqëson një mundësi për bashkëpunim ndërkuftar. Një pjesë tjetër e rëndësishme e zonës përbëhet nga luginat, fushat dhe pjesa malore, të cilat ndryshojnë në madhësi, dendësinë e popullsisë, bimësisë dhe lartësisë dhe ofrojnë kushte të favorshme për kultivimin e drithërave, foragjereve, perimeve dhe frutave. Fushat më të mëdha dhe më pjellore në anën e Kosovës gjenden në basenin e Dukagjinit. Tokat më pjellore bujqësore në anën shqiptare shtrihen në rajonin e Lezhës.

Klima e zonës varion nga kontinentale e ndryshueshme në male, në mesdhetare e ndryshueshme përgjatë bregdetit Adriatik dhe fushave, me dimër të ftohtë dhe të lagësht dhe verë të nxehtë e të thatë.

2. ANALIZA PESTLE

2.1 Konteksti i përgjithshëm politik dhe ekonomik

3.1.1 Reformat e politikave dhe procesi i integritimit në BE

Shqipëria dhe Kosova aspirojnë të bëhen anëtare të Bashkimit Evropian. Sondazhet e përsëritura, sipas perceptimit publik tregojnë se ato mbeten ndër përfituesit IPA II me qëndrimin më pozitiv (më shumë se 95%) për t'u bërë anëtar i familjes së Bashkimit Evropian. BE-ja

nënvizon³¹ një numër sfidash të rëndësishme përpara me të cilat përballet Shqipëria dhe Kosova, si: qeverisja ekonomike dhe konkurrueshmëria, sundimi i ligjit, funksionimi i institucioneve që garantojnë demokracinë, të drejtat themelore dhe, në rastin e Kosovës, kapërcimi i së kaluarës.

Shqipëria

Duke pasur parasysh progresin e **Shqipërisë** me reformat politike dhe ekonomike, Bashkimi Evropian (BE) ka nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit me Shqipërinë, në qershor të vitit 2006, e cila hyri në fuqi më prill 2009. Shqipëria iu bashkua NATO-s në prill 2009. Liberalizimi i vizave për qytetarët e Shqipërisë që hyjnë në shtetet e Shengenit hyri në fuqi më 15 dhjetor 2010.

Hyrja në fuqi e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit shënoi një etapë cilësishme të re në marrëdhëniet dypalëshe, që sjell detyrime dhe reforma të reja të rëndësishme në fushën e drejtësisë, lirisë dhe sigurisë, lëvizjes së lirë të punëtorëve, të drejtës së vendosjes dhe lëvizjes së lirë të kapitalit dhe shërbimeve, si dhe për transportin, fushën audiovizuale dhe telekomunikacionin. Përmirësime thelbësore janë bërë në fusha, të tilla si reformat e brendshme dhe të ekonomisë së tregut, të rendit publik dhe menaxhimit të kufijve, reformat ligjore dhe administratën publike, prokurimin publik, statistikat, drejtësinë, lirinë dhe sigurinë, si dhe doganat.

Duke pasur parasysh se Shqipëria ka arritur përparimin e nevojshëm, Komisioni Evropian rekomandoi në tetor 2013 që Këshilli Evropian duhet t'i japë Shqipërisë statusin e vendit kandidat në BE³².

Shqipëria duhet të përshpejtojë reformën³³ e sistemit të drejtësisë, për të siguruar pavarësinë, transparencën, përgjegjshmërinë dhe efikasitetin. Shqipëria duhet të përparojë në zbatimin e reformës së administratës publike, në veçanti në lidhje me ligjet strukturore dhe aktet administrative; të bëjë përpjekje shtesë për të siguruar zbatimin efektiv të rregulloreve të

³¹ KE - Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore, 2013–2014, tetor 2013.

³² Një vendim pritet të merret në dhjetor 2013.

³³ Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Shqipërinë, tetor 2013.



brendshme të tregut, të drejtat e pronësisë intelektuale dhe industriale, për sektorin e energjisë, përfshi diversifikimin e burimeve të energjisë, të përforcojë mbrojtjen e mjedisit, përfshi investimet e qëndrueshme në fushën e menaxhimit të mbetjeve dhe ujërave të zeza. Sfidat e tjera përfshijnë edhe punësimin dhe politikatat sociale. Kapacitetet administrative dhe profesionalizmi i organeve të ngarkuara me zbatimin e *acquis* duhet të forcohen, si edhe pavarësia e organeve rregullatore të sigurisë.

Strategjia Kombëtare e Shqipërisë për Zhvillim dhe Integrim 2014–2020 (SKZHI) konsiderohet si kuadri i politikave gjithëpërfshirëse për vendin në kontekstin e integritimit në BE. Ajo përcakton katër shtyllat e politikës strategjike që përcaktojnë themelet për ndërhyrjet (politikatat e integruara) sektoriale dhe rajonale³⁴:

- *Forcimi i demokracisë dhe shtetit të së drejtës* që trajton aspekte, si: drejtësia dhe çështjet e brendshme, të drejtat e njeriut dhe mediet, qeverisje efektive dhe politikatat e jashtme dhe të mbrojtjes;

- *Krijimi i kushteve për zhvillimin konkurrues dhe të qëndrueshëm ekonomik nëpërmjet përdorimit efikas të burimeve* që mbulon stabilitetin makroekonomik dhe qëndrueshmërinë, ekonominë e tregut konkurrues, përdorimin efikas të burimeve, zhvillimin e integruar rajonal dhe të qëndrueshëm;

- *Nxistja e përfshirjes sociale, mirëqenia dhe zhvillimi i tregut të punës*, të cilat synojnë të promovojnë: politikatat e punësimit dhe përfshirjes sociale, politikatat sociale;

- *Zhvillimi i shoqërisë bazuar në dituri, inovacion dhe teknologji digjitale* që përfshin ndërhyrje në fushat e mëposhtme: arsimit i lartë, kërkimi dhe teknologjia e inovacionit.

Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rajonal të Shqipërisë i klasifikon zonat kufitare si objekt të planifikimit të politikave ndërsektoriale dhe i paraqet çështjet ndërkufitare në planifikimin e politikave të zhvillimit në nivel qarku.

Kosova

Kosova ka bërë progres të shpejtë për të thelluar integrimin e saj në BE. Pas marrëveshjes së arritur më 19 prill 2013 ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në dialogun e lehtësuar nga BE-ja, Komisioni Evropian arriti në përfundimin³⁵, se Kosova i plotësoi të gjitha kushtet afatshkurtra nga studimi i fizibilitetit të tetorit 2012 dhe, si rrjedhojë, rekomandoi që negociatat me Kosovën të hapeshin për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA) me BE-në në tetor 2013. Komisioni Evropian synoi t'i përfundojë këto negociata në pranverë të vitit 2014. Kjo ishte njohje mbi progresin e bërë për reformat kyçe³⁶. Paralelisht, dialogu për liberalizimin e vizave me BE-në është hapur.

Në aspektin e reformave kombëtare, Kosova tani duhet të përqendrohet në zbatimin e reformave për të përmbushur obligimet e veta, sipas MSA-së së ardhshme. Sundimi i ligjit vazhdon të jetë një prioritet kyç për Kosovën, së bashku me nevojën për forcimin e reformave të administratës gjyqësore dhe publike dhe sigurimin e të drejtave të pakicave - përfshi romët. Kosova duhet të trajtojë urgjentisht papunësinë dhe dobësitë strukturore që ndikojnë në tregun e saj të punës, si edhe të vazhdojë zbatimin e kornizës ligjore për tregtinë, konkurrencën dhe tregun e brendshëm. Nevojitet përparim i shpejtë, ndaj ajo duhet të shtojë përpjekjet e saj në një numër fushash fitosanitare dhe veterinare që ndikojnë në sigurinë e ushqimit. Në sektorin e energjisë, duhet të rriten përpjekjet për mbylljen e termocentralit të Kosovës. Si pjesë e politikave të përfshirjes sociale, qeveria ka nisur një program të veçantë për të mbështetur kthimin e qëndrueshëm dhe riintegrimin e personave të zhvendosur dhe riintegrimin ekonomik të komuniteteve³⁷.

Një element i veçantë dhe mjaft negativ që lidhet drejtpërdrejt me kalimin e kufirit është trafikimi i qenieve njerëzore. Reformat në këtë

³⁴ Draftstrategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, 2014–2020 (SKZHI).

³⁵ Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Kosovën, tetor 2013.

³⁶ Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Kosovën, tetor 2013.

³⁷ Strategjia për Komunitete dhe Kthim 2009–2013.



fushë janë përqendruar³⁸ në parandalimin e trafikimit, mbrojtjen e viktimave të trafikimit dhe ndjekjen penale të trafikantëve. Disa reforma/iniciativa të rëndësishme kombëtare që lidhen me CBC/BNK përfshijnë: reformat ligjore dhe rregullatore për të përmirësuar mjedisin e bërjes së biznesit, lehtësimi i procedurave të regjistrimit të biznesit, *Small Business Act* (korniza gjithëpërfshirëse e politikës së BE-së për NVM-të) është zbatuar nga Agjencia për Mbështetjen e NVM-ve; krijimi i zonave ekonomike të biznesit dhe parqeve industriale, qendrave të inovacionit dhe përmirësimit të legjislacionit përkatës që i lejon komunat të kenë të drejtë vetëm për themelimin e zonave ekonomike; masat që përmirësojnë mbrojtjen e investimeve me ndryshimin e legjislacionit përkatës (duke përfshirë shkrijen e Agjencisë për Mbështetjen e NVM-ve dhe Agjencisë për Promovimin e Investimeve në një institucion të vetëm); krijimi i stimuljeve për investime dhe, përmirësimi i kuadrit ligjor dhe procedurat për tërheqjen e IHD-ve (duke shmangur tatimin e dyfishtë, përmirësimi i rregullave doganore, garancitë e investimeve dhe tokës³⁹); krijimi i Asociacionit të Agjencive për Zhvillim Rajonal (ARDA); përmirësimi i kuadrit rregullator dhe zbatimi i aktiviteteve të CBC-së në fushën e mbrojtjes së mjedisit, ndryshimet klimatike dhe parandalimi i rrezikut, parandalimi i ndotjes industriale.

Kosova përfiton nga joreciprociteti, duke pasur akses të plotë pa dogana në tregun e BE-së bazuar në Regjimin Autonom të Preferencave Tregtare (ATP). Përpjekjet për zhvillim të Kosovës mbështeten, gjithashtu, duke u bërë anëtar i BERZH-it, BEI dhe CEDB⁴⁰. Në shkurt të vitit 2013, Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal vendosi të ndryshojë statutin e saj për të lejuar

Kosovën të bëhet pjesëmarrëse në të drejtën e vet.

Kuadri i politikës së ardhme shprehet qartë në Programin e Qeverisë së Kosovës, e cila është e bazuar në katër shtylla kryesore⁴¹:

- *Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik* mbulon investimet në ekonomi, përmirësimin e mjedisit të investimeve që stimulon sektorin privat, sektorin e energjisë dhe mineraleve, infrastruktura dhe mjedisi, zhvillimi rural, arsimiti i lartë, sektori financiar.

- *Qeverisje e mirë dhe sundimi i ligjit*, e cila, përveçse qëllimit të forcimit të sundimit të ligjit, synon gjithashtu të rrisë mbrojtjen dhe sigurinë, reformimin e administratës publike, si edhe për të siguruar të drejtat dhe liritë e qytetarëve dhe komuniteteve.

- *Zhvillimi i kapitalit njerëzor* mbulon arsimimin, kulturën, rininë dhe sportet, si dhe rritjen e kujdesit për diasporën dhe politikën e emigrimit.

- *Mirëqenia sociale* synon politikën dhe programet sociale, shëndetësinë dhe përmirësimin e mjedisit të jetesës

2.1.2 Konteksti i përgjithshëm ekonomik

Shqipëria ka performuar relativisht mirë gjatë dekadës së fundit. Vendi ka qëndruar larg nga recesioni, duke ruajtur ritmet pozitive të rritjes, pavarësisht ekspozimit të tij ndaj krizës ekonomike që ka goditur fort Greqinë dhe Italinë, si dhe duke u rrethuar nga ekonomitë rajonale kontraktuese. Rritja e PBB-së është ngadalësuar nga një kulmim i normës së rritjes 7.5% në 2008, në një normë më të ulët të rritjes 1.6% në vitin 2012. Sektori i shërbimeve është kontribuesi kryesor i PBB-së, që përbën më shumë se gjysmën e GDP-së së vendit. Shqipëria cilësohet si një vend më të ardhura të mesme më të ulëta me një GDP për frymë, e cila në vitin 2012 qëndroi në 3,415 euro. Shkalla e papunësisë me një mesatare prej 13% është ndër më të ulëtat në rajon. Borxhi publik i përgjithshëm i Shqipërisë arriti në 60.6% të PBB-së deri në fund të vitit 2012. Ekonomia mbetet e brishtë njëjloj si për dobësitë e brendshme strukturore ashtu dhe për paqëndrueshmërinë ekonomike globale. Sfidat kryesore mbeten siguri i rritjes së qëndrueshme afatgjatë duke ndjekur politika të

³⁸ Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit kundër Trafikimit me Qeniet Njerëzore 2011–2014.

³⁹ Në bazë të ligjit për vetëqeverisjen lokale (nr. 03/ L-040), komunat në Kosovë kanë të drejtë të lëshojnë me qira pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme për investitorët e huaj. Qiradhënia mund të jepet për një afat prej dhjetë vjetësh me mundësi zgjatje deri në 99 vjet.

⁴⁰ Kosova iu bashkua Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) në dhjetor 2012. Ajo nënshkroi një marrëveshje kornizë për anëtarësim në Bankën Evropiane të Investimeve dhe Bankën e Këshillit të Evropës për Zhvillim në qershor 2013.

⁴¹ Programi i Qeverisë së Kosovës 2011–2014.



matura fiskale dhe monetare dhe reformat strukturore. Shqipëria duhet të përballojë uljen e niveleve të larta të deficitit buxhetor dhe të borxhit publik. Ajo do të duhet të përmirësojë parashikueshmërinë fiskale, duke hequr dorë nga mbivlerësimi i të ardhurave dhe duke përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme përputhjen e taksave. Përmirësimi i mëtejshëm i mjedisit të biznesit dhe investimeve është thelbësor për diversifikimin e ekonomisë dhe rritjen e potencialit të saj afatgjatë. Përforsimi i sundimit të ligjit, trajtimi i korrupsionit dhe trajtimi i detyrimeve të pashlyera, si edhe zhvillimi i infrastrukturës dhe rritja e kapitalit njerëzor janë kështu fushat kryesore ku duhet të përqendrohen shumë përpjekje. Reduktimi i ekonomisë gri mbetet një sfidë e rëndësishme. Shqipëria ka marrëveshje të tregtisë së lirë me të gjithë rajonin, përfshi edhe Kosovën, dhe është anëtare e CEFTA-s që nga viti 2006.

Kosova ka bërë progres në drejtim të krijimit të një ekonomie funksionale të tregut. Nevojiten reforma dhe investime të konsiderueshme për të mundësuar atë të përballojë për një periudhë të gjatë presionin dhe forcat konkurruese të tregut. Situata e vështirë/sfiduese ekonomike në rajon dhe BE kanë ndikuar ekonominë e Kosovës edhe pse më pak se përfituesit e tjerë IPA II në rajon. GDP-ja e Kosovës u rrit me 2.5% në vitin 2012⁴². Politika fiskale ka qenë e kujdesshme dhe performanca e buxhetit ka qenë në rrugën e duhur. Është ruajtur një rregull fiskal ligjërishit i detyrueshëm, që do të zbatohet në 2014. Papunësia mbetet shumë e lartë. Kosova ka vazhduar me investime të konsiderueshme në infrastrukturën e saj. Kërkohen përpjekje të vazhdueshme për të mbështetur stabilitetin makroekonomik dhe përmirësimin në situatën sociale. Kosova ka nevojë për të përmirësuar konkurrueshmërinë dhe mjedisin e biznesit, dhe të mbështesë sektorin privat në mënyrë që të ulë papunësinë. Politikat ekonomike të Kosovës kanë për qëllim zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, siç saktësohet në Programin e Qeverisë së Kosovës (2011–2014), i cili thotë se “Gjeneruesi kryesor i rritjes ekonomike do të jenë investimet private dhe zhvillimi i mëtejshëm

i sipërmarrjes”; “strategjia për zhvillimin e sektorit privat 2013–2017” përcakton më tej bazën e politikave ekonomike për vitet e ardhshme. Një mjedis i shëndoshë i biznesit kërkon masa të mëtejshme për të trajtuar sundimin e dobët të ligjit dhe korrupsionin. Privatizimi duhet të vazhdojë. Sektori informal mbetet një sfidë e rëndësishme.


2.2 Karakteristikat Ekonomike të Zonës së Programit

Dallimet rajonale në aspektin e zhvillimit ekonomik dhe social janë të dukshme jo vetëm në të gjithë zonën e programit, por edhe brenda rajoneve.

Zona e programit ka një ekonomi kryesisht industriale-agrare, me industrinë më të zhvilluar në anën e Kosovës, ndërsa rajonet shqiptare janë të dominuara nga bujqësia dhe shërbimet. Për momentin rritja ekonomike është modeste, por megjithatë ka shenja të rimëkëmbjes ekonomike pas një periudhe stanjacioni. Disa faktorë të rëndësishëm që përfaqësojnë një pengesë për zhvillimin ekonomik të rajonit janë, ndër të tjera, mungesa e njohurive dhe aftësive të punës teknologjike të nevojshme për t’iu përgjigjur kërkesave të tregut për shërbime dhe produkte të cilësisë së lartë. Prodhimet vendore nga të dy anët e kufirit kanë, pak ose aspak, qasje në tregjet rajonale dhe ndërkombëtare. Mekanizmat për mbështetjen e biznesit janë të dobët dhe të pamjaftueshëm. Në Kosovë, gjenden Agjencitë e Zhvillimit Rajonal që mund të mbështesin ekonominë. Në Shqipëri, strukturat mbështetëse të biznesit nuk janë shumë aktive.

Në **Shqipëri** pabarazitë rajonale janë të dukshme. Zhvillimi socioekonomik i vendit anon me tepri në favor të rajoneve qendrore. Rajoni i Tiranës kontribuon me më shumë se një të tretën e PBB-së së vendit, dhe është larg nga rajoni më i zhvilluar në krahasim me të gjitha rajonet e tjera të Shqipërisë. Kjo tregon qartë se të gjitha rajonet e tjera janë nën potencialin e tyre të zhvillimit, meqë ato ende nuk kanë gjetur mënyra dhe mundësi që të përqendrohen në përparësitë e tyre krahasuese. Rajonet Kukës dhe Lezhë i pasqyrojnë gjerësisht këto pengesa për sa i përket zhvillimit social-ekonomik.

⁴² Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Kosovën, tetor 2013.



Kukësi është rajoni më i varfër i Shqipërisë, si dhe i zonës së programit që ka një GDP prej 223 milionë eurosh ose të barabartë me 2.4% të GDP-së së vendit⁴³. Mbështetja e rajonit në sektorin e bujqësisë thekson se bujqësia kontribuon me 34% në formimin e PBB së rajonit për vitin 2011. Pjesa e hoteleve, të tregtisë, transportit dhe komunikimit arrin në 20% të PBB-së së rajoneve. Pjesa e sektorëve të pasurive të paluajtshme dhe financiare llogaritet në 17%, e pasuar nga shërbimet e tjera që arrin 13% të GDP-së së rajoneve për vitin 2011. Sektori me kontributin më të ulët është industria, pjesa e të cilës është thjesht 3% e PBB-së së rajonit në vitin 2011.

GDP-ja e rajonit të **Lezhës** për vitin 2011 arriti në 334 milionë euro ose rreth 3.7% e PBB-së së vendit⁴⁴. Sektorët kryesorë janë tregtia, hotelet, transporti dhe komunikimi që arrin në 26%, ndjekur nga sektori i bujqësisë që arrin në 25%. Pjesa e sektorit të pasurive të paluajtshme dhe financiare llogaritet në 19%, pasuar nga shërbimet e tjera që arrin në 13% të PBB-së për vitin 2011. Kontributi i sektorit të ndërtimit është matur me 10%, poshtë mesatares kombëtare që vlerësohet në 12.8%, ndërsa industria është kontribuesi më i vogël për ekonominë e rajonit të Lezhës, duke zënë 8% të PBB-së së rajoneve në vitin 2011.

Përveç sektorit të shërbimeve i cili është kontribuesi kryesor në PBB-në e vendit, sektori i bujqësisë mban një shkallë të lartë të rëndësisë për zhvillimin ekonomik dhe punësimin në zonën e programimit në Shqipëri, meqenëse një pjesë e madhe e popullsisë ende jeton në zonat

rurale, pavarësisht nga lëvizjet e dukshme drejt zonave urbane.

Në **Kosovë**, zhvillimi i sektorit ekonomik dhe privat ka qenë kryesisht në shkallë të vogël dhe jo me shumë kapital intensiv. Rritja e PBB-së në Kosovë arriti kulmin në nivelin e 7.5% në vitin 2008, me rënie në 2.5% në vitin 2012⁴⁵. Pavarësisht rënies së tendencave, norma mesatare vjetore e rritjes së Kosovës ka qenë më e larta në mesin e vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor⁴⁶ në katër vitet e fundit⁴⁷. Megjithatë, ekonomia e Kosovës vazhdon të presë zgjidhje për problemet e saj madhore, që do të thotë, vendi është duke jetuar përtej mundësive dhe kushteve të tij. Kosova vuan nga një mosbalancim i pagesave me importet, që dukshëm dominojnë eksportet. Kjo ndodh kryesisht, për shkak të faktit që NVM-të e Kosovës nuk janë ndërkombëtarisht konkurruese⁴⁸.

NVM-të e orientuara dobët nga eksporti pengojnë kontributin e mëtejshëm të NVM-ve për GDP, si krijimi i vendeve të punës dhe rritja ekonomike. Eksportet dominohen nga metalet bazë dhe mineralet e prodhuara nga kompanitë e mëdha. Kosova duhet të krijojë një ekonomi me mjedis miqësor me konkurrues dhe të promovojë eksportet (deficitit tregtar i Kosovës mbetet në një mesatare rreth 90%, ose e shprehur në terma monetare rreth 2.2 miliardë euro⁴⁹), dhe përmirësimin e infrastrukturës që lehtëson tërheqjen e investitorëve të huaj. Në Kosovë nuk ka të dhëna për kontributin e PBB-së sipas rajoneve ose GDP-së rajonale për frymë, por është e bazuar në treguesit e tjerë makro të sektorit; rajoni i Qendrës është duke ofruar kontributin më të madh në zhvillimin e përgjithshëm të ekonomisë së Kosovës, ndërsa

⁴⁵ Efekti i krizës globale dhe eurozonës në ekonominë e Kosovës ka qenë në shkallë më të ulët për shkak të nivelit të ulët të integritimit në tregun financiar dhe bazës së ulët të eksportit (MTEF 2014–2020).

⁴⁶ Raporti i FMN-së për vendin nr. 223, qershor 2013.

⁴⁷ Banka Botërore, “Raporti i rregullt për vendet e Evropës Juglindore (SEE)”, nga recesioni i dyfishitë në reformat e përsheptuara, dhjetor 2012.

⁴⁸ Strategjia e Zhvillimit të NVM-ve në Kosovë 2012–2016 me vizion 2020.

⁴⁹ Banka Botërore, “Raporti i rregullt për vendet e Evropës Juglindore (SEE)”, “Nga recesioni i dyfishitë në reformat e përsheptuara”, dhjetor 2012.

⁴³ INSTAT, Llogaritë Rajonale 2013.

⁴⁴ INSTAT, Llogaritë Rajonale 2013.



dy rajonet ekonomike jugore dhe perëndimore kontribuojnë pak a shumë në të njëjtin nivel.

Zona e programit nga ana e Kosovës ka një ekonomi industriale-agrare. Aktivitetet ekonomike ndryshojnë ndërmjet të dyja rajoneve ekonomike dhe madje edhe brenda tyre. Shërbimet, bujqësia, tregtia, ndërtimi dhe përpunimi ushqimor janë duke gjeneruar pjesën më të madhe të xhiros dhe të ardhurave lokale. Ekonomia e të dyja rajoneve ka vuajtur shumë nga dëmtimet gjatë konfliktit të viteve nëntëdhjetë në Kosovë dhe për shumë vite ka përjetuar një stanjacion (ngecje ekonomike) të rëndë tranzicioni. Disa pjesë të zonës kanë vuajtur edhe për shkak të largësisë së tyre nga zona qendrore ekonomike dhe politike e Kosovës.

Aktualisht, pikat e forta kryesore të rajoneve ekonomike jugore dhe perëndimore qëndrojnë në vendndodhjen e tyre gjeografike si një portë për vendet fqinje (Shqipëria dhe Mali i Zi), me të cilat ata kanë një traditë të gjatë të tregtisë. Rajonet kanë një industri ushqimore relativisht të zhvilluar me ndërmarrjet që furnizojnë tregun e Kosovës dhe eksportin me vendet fqinje. Sektori i ndërtimit (ndërtesave të banimit, apartamentet), si dhe industria ushqimore dhe e pijeve/lëngjeve janë veçanërisht duke u zgjeruar. Të dyja rajonet janë shumë të pasur me produkte të pyjeve, të cilat janë shumë të kërkuara në tregun e jashtëm, si edhe industria e drurit që është duke u rimëkëmbur.

2.2.1 Sektori privat

Operatorët ekonomikë në zonën e programit janë shumë të fragmentuar dhe të vegjël në madhësi, që pasqyrojnë strukturën e ndërmarrjeve në nivel vendi dhe tregun se biznesi është më së shumti familjar dhe mbizotërohet nga vetëpunësimi. Struktura e ndërmarrjeve është e dominuar nga ndërmarrje shumë të vogla, që punësojnë 1–4 persona, të cilat përbëjnë pothuajse 90% të totalit të ndërmarrjeve në zonën përfituese.

Zona e programit shqiptar, e përbërë nga dy rajonet - Lezhë dhe Kukës - regjistron një total prej 3,797 ndërmarrjesh⁵⁰. Ajo ka një përqindje të regjistrimit të lindjeve të NVM-ve prej 10.8%,

më e ulët në krahasim me mesataren kombëtare prej 12.2%.

Numri total i ndërmarrjeve në rajonin e Kukësit në fund të 2012 arrinte në 914 ndërmarrje⁵¹, që përbën më pak se 1% të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve në Shqipëri, duke regjistruar një përqindje të lindjeve prej 10.8%, nën mesataren kombëtare prej 12.2%. Rreth 81.7% e ndërmarrjeve të regjistruara në rajonin e Kukësit operojnë në sektorin e shërbimeve. Shumica e këtyre ndërmarrjeve - rreth 54.7% - operojnë në sektorin e tregtisë, ndërsa 120 ndërmarrje ose 16% operojnë në sektorin e hoteleve dhe restoranteve. Pjesa e mbetur prej 17.6% janë të regjistruar që veprojnë në shërbime të tjera. Sektori i prodhimit regjistron 167 ndërmarrje, brenda të cilit rreth 50% operojnë në sektorin e industrisë; 37.1% në sektorin e ndërtimit dhe pjesa e mbetur 13.2% operojnë në sektorin e bujqësisë. Rreth 84% e ndërmarrjeve në rajonin e Kukësit punësojnë 1–4 persona, me vetëm 12 ndërmarrje që punësojnë më shumë se 50 persona. Pjesa e ndërmarrjeve e menaxhuar nga femrat në rajonin e Kukësit është më e ulëta në Shqipëri me 14.2%.

Numri total i ndërmarrjeve në rajonin e **Lezhës** në fund të vitit 2012 arrinte në 2,883 ndërmarrje⁵², që përfaqëson 2.76% të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve të regjistruara në Shqipëri, me një natalitet prej 10.8%, nën mesataren kombëtare prej 12.2%. Shumica e ndërmarrjeve 80.6% operojnë në sektorin e shërbimeve. Rreth 1201 apo 41.7% të ndërmarrjeve operojnë në sektorin e tregtisë, ndërsa 448 ndërmarrje operojnë në hotele dhe restorante, si nënsektor i shërbimeve. Sektori i prodhimit regjistron 557 ndërmarrjeve ose më pak se 1/5 e totalit të ndërmarrjeve në rajonin e Lezhës, shumica e të cilave në sektorin e industrisë - 327 njësi ose 58.7%, e ndjekur nga 153 ndërmarrje që operojnë në sektorin e ndërtimit. Rreth 91.3% e të gjitha ndërmarrjeve në rajonin e Lezhës punësojnë 1–4 persona, ndërsa vetëm 25 ndërmarrje punësojnë më shumë se 50 persona. Rreth 24.7% e ndërmarrjeve në rajonin e Lezhës menaxhohen nga femrat.


⁵⁰ INSAT, Regjistri Statistikor i Bizneseve 2013.

⁵¹ INSAT, Regjistri Statistikor i Bizneseve 2013.

⁵² INSAT, Regjistri Statistikor i Bizneseve 2013.



Figura 3: Numri i ndërmarrjeve të regjistruara



Në **Kosovë**, zona e programit ka një total prej 34,767 ndërmarrje të regjistruara, që përbën rreth 32% të totalit të ndërmarrjeve të regjistruara në Kosovë⁵³. Duke analizuar të gjithë zonën e programimit, Shqipëri dhe Kosovë, në total 38,564 ndërmarrje, është qartësisht e dukshme se zona e Kosovës ka pjesën më të madhe të ndërmarrjeve, rreth 90%. Në kushtet e ndarjes së sektorit, NVM-të në Kosovë janë kryesisht të përqendruara në tregtinë me pakicë (rreth 50%); transporti, magazinimi dhe shpërndarja (14%); produktet ushqimore, pijet dhe duhani (9%); hotelet dhe restorantet (9%).

Rajoni Ekonomik Jugor regjistron 34,767 ndërmarrje ose 15% të shumës totale të ndërmarrjeve në tërë territorin e Kosovës⁵⁴. Shpërndarja sektoriale e bizneseve të regjistruara tregon varësinë e e madhe të ekonomisë në sektorin e shërbimeve⁵⁵. Pothuajse gjysma e bizneseve të regjistruara (49%) janë në tregtinë me shumicë dhe me pakicë të kombinuar me sektorin e tregtisë së automobilave dhe të shërbimit auto. Rreth 11% e bizneseve janë në shërbimet e turizmit dhe të mikpritjes (hotele, restorante etj.) e ndjekur nga transporti (9%). Vetëm 12% e bizneseve janë të përfshirë në përpunim (përfshi industrinë ushqimore) dhe më tej 5% në sektorin e ndërtimit. Vetëm 5% e bizneseve të regjistruara janë aktive në sektorin e bujqësisë.

Rajoni Ekonomik Perëndimor i Kosovës regjistron 34,767 ndërmarrje, ose 17% të shumës totale të ndërmarrjeve në tërë territorin e Kosovës. Nga perspektiva e ndërmarrjeve të reja

të biznesit, rajoni perëndimor ka shënuar një rritje të numrit të ndërmarrjeve të reja; në vitin 2011 kishte 963 biznese të reja të regjistruara, ndërsa në vitin 2012 ka pasur 1,459 biznese të krijuara, që shënon një rritje prej 51.5%. Ndërsa në tremujorin e parë të vitit 2013 ka pasur 4,846 biznese të reja të regjistruara, që në krahasim me tremujorin e parë të vitit 2012 shënon një rritje prej 31.9%. Nga ana tjetër, sipas raporteve të njëjtë të ASK në vitin 2011 ka pasur 164 biznese ekzistuese të shpërbëra në rajonin perëndimor, 152 në vitin 2012, dhe 49 në tremujorin e parë të vitit 2013. Kjo për sa i përket lidhjes ndërmjet bizneseve të reja dhe atyre të shpërbëra, për çdo 100 biznese të reja, 13 të tjerë janë shpërbërë. Përsëri në një nivel të përgjithshëm, i cili nuk dallon shumë nga ai rajonal, bizneset janë fokusuar kryesisht në pesë sektorët e mëposhtëm, nga të cilët tregtia përfaqëson 50%, e ndjekur nga transporti në një shkallë shumë më të ulët prej 14%, produktet e ushqimit dhe turizmi (mikpritja) me 9% dhe të tjerët me 12% (ARBK, dhjetor 2012). Bizneset individuale në mënyrë të qartë dominojnë strukturën e pronësisë me 90%. Pjesa e mbetur përbëhet nga kompanitë me përgjegjësi të kufizuar (5.8%) dhe partneritetet e përgjithshme (3.2%). Sigurisht, lloji i pronësisë i paraqitur më sipër është përfaqësues i mangësive të bizneseve në Kosovë, çka tregon hezitimin e pronarëve që ta sjellin kapitalin e tyre financiar dhe burimet njerëzore në forma më të avancuara të biznesit (ARBK, dhjetor 2012). Ndër faktorët e rëndësishëm që përfaqësojnë një pengesë për zhvillimin e NVM-ve në të gjithë zonën e programit janë mungesa e njohurive dhe aftësive të punës teknologjike (ekspertiza) të nevojshme për t'iu përgjigjur kërkesave të tregut për shërbime dhe produkte të cilësisë së lartë. Në industrinë ushqimore, mungesa e veçantisë (paketimi, strategjia e marketingut etj.), markimi (çaktimi i markave) i dobët dhe mungesa e standardeve të cilësisë janë pengesat më të mëdha jo vetëm për eksportin, por edhe për furnizimin e tregjeve kombëtare.

2.2.2 Tregu i punës

Situata në tregun e punës paraqet një pasqyrë të qartë mbi pabarazitë e rajonit. Shkalla e punësimit për Kosovën në vitin 2012 ishte

⁵³ Strategjia e Zhvillimit të NVM-ve në Kosovë 2012–2016 me Vizion 2020.

⁵⁴ Strategjia e NVM-ve në Kosovë.

⁵⁵ Strategjia e Zhvillimit Rajonal për Rajonin Ekonomik Jugor 2010–2013.



25.6%⁵⁶. Në Rajonin Ekonomik Perëndimor në vitin 2011 ka pasur 87,989 persona të konsideruar si “ekonomikisht aktiv”, por vetëm 52% e tyre ishin të punësuar⁵⁷. Sektorët kryesorë të punësimit në rajonin perëndimor janë shërbimi i tregtisë dhe ai artizanal me 17.02%, ndjekur nga administrata publike me 14.8%. Edhe pse është vërejtur një ndryshim i vogël pozitiv, përqindja e punëkërkuësve që konsiderohet si e pakualifikuar është 57% (duke përfshirë edhe grupin pa ndonjë arsimim formal dhe atë vetëm me arsimin fillor), ndërsa ata me arsim të lartë dhe universitar janë vetëm 3%, dhe me arsim të mesëm 28%⁵⁸. Në Rajonin Ekonomik Jugor, bujqësia është sektori që ka punësuar 16.4% të forcës aktive të punës, pasuar nga tregtia dhe shërbimi artizanal me 16%. Përveç kësaj, 38,388 banorë, ose 12.38%, sigurojnë jetesën e tyre nga pensionet, asistenca sociale dhe programet e tjera të mirëqenies dhe kujdesit shëndetësor, ndërsa 38,388 banorë të tjerë ose 12.19% varen nga remitancat e huaja dhe burime të tjera. Gjithashtu, 160,556 banorë ose rreth 51% e popullsisë mbështeten nga të tjerët për jetesën e tyre, një shifër që mbulon edhe pjesën “ekonomikisht joaktive” të popullsisë.

Fuqia punëtore në **Shqipëri** në total arrinte në 2,229,652 në fund të dhjetorit 2012⁵⁹. Ajo nuk ka pasur zhvillime të mëdha, përkundër faktit se ekonomia është ngadalësuar gjatë 2–3 viteve të fundit. Punësimi i përgjithshëm në Shqipëri arriti në 56.4% në vitin 2012, ndërsa norma mesatare e papunësisë arriti në 13.9%, duke ndalur në të njëjtat nivele të vitit 2011. Papunësia në rajonin e Kukësit pasqyron të njëjtën normë mesatare të papunësisë në nivel kombëtar dhe, gjithashtu, strukturën e njëjtë të punësimit. Numri i të papunëve në Lezhë ishte 15,021 nga fundi i 2012. Personat e papunë në Lezhë përbënin 10.6% të totalit të forcës aktive të punës, ndërsa në Kukës 10,322 të papunët përbënin rreth 7% të totalit⁶⁰.

⁵⁶ Agjencia Kosovare për Statistikat dhe Banka Botërore: Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore Kosovë 2012.

⁵⁷ Agjencia e Statistikave të Kosovës: Të dhënat e tregut të punës sipas komunave 2011: Rezultatet përfundimtare të regjistrimit të popullsisë 2011.

⁵⁸ Puna dhe Punësimi - Raporti i Performancës 2012 - MPMS, prill 2013.

⁵⁹ INSTAT, Tregu i Punës 2011–2012.

⁶⁰ INSTAT, TAT, Buletini Tremujor Statistikor, nr. 2, 2013.

Sistemi i mbrojtjes sociale siguron mbështetje për një pjesë të konsiderueshme të popullsisë në të dyja zonat e programimit.

2.2.3 Bujqësia dhe zhvillimi rural

Toka bujqësore mbulon 22% të territorit të Shqipërisë e cila arrin në 0.22 hektarë për frymë. Përqindja e bujqësisë në PBB-në e Shqipërisë arrinte në 21% të PBB-së në vitin 2012. Në Kosovë, kontributi në sektorin e bujqësisë në PBB është 14%. Kullotat, pyjet dhe livadhet përbëjnë rreth 78% të territorit të përgjithshëm të Shqipërisë, që përfaqëson një mundësi të pashfrytëzuar për prodhimin blegtoral. Rreth 59% është e vendosur në këtë zonë të programit.

Investimi i fundit madhor në infrastrukturën ka qene i efektshëm për zhvillimin e zonës së programit, por pjesa më e madhe e rrjetit të infrastrukturës vazhdon të jetë penguese për zhvillimin ekonomik dhe social. Zhvillimi i qëndrueshëm dhe përmirësimi i transportit dhe infrastrukturës publike, mund të ndihmojë në rritjen e qëndrueshme ekonomike dhe në një rritje të përgjithshme të mirëqenies në zonën e programit. Zhvillimi i një infrastrukture që lehtëson biznesin dhe shpërndarjen e rrjeteve dhe shërbimeve për mbështetjen e zhvillimit të biznesit dhe inovimit, mund të ndihmojë në rritjen e përgjithshme të mirëqenies dhe ekonomisë në zonë.

Një tjetër mundësi e humbur në të dyja palët është potenciali i sektorit të turizmit. Duhet të merren parasysh nismat e BNK-së, në lidhje me krijimin e një oferte të përbashkët turistike.

Zona ka një trashëgimi të pasur historike-kulturore-artistike, e cila nevojit për mbrojtje dhe promovim. Valorizimi i mëtejshëm i trashëgimisë historike dhe kulturore mund të ndihmojë në përforcimin e identitetit të kësaj hapësirë të përbashkët. Trashëgimia kulturore është një vlerë e shtuar për zhvillimin ekonomik të zonës së programit. Ka bashkëpunim midis institucioneve që veprojnë në fushën kulturore, por është e nevojshme që ky bashkëpunim të intensifikohet akoma.

- Përmirësimi i sistemit arsimor në të gjitha nivelet është një prioritet madhor për zonën e e programit, në veçanti në zonat rurale. Veprimtari të tjera të përbashkëta do të mund të ndërmerren për krijimin e rrjeteve të qendrave të



trajnimin, si edhe të institucioneve më të larta, agjencive kërkimore dhe organizatave. Avantazhet e përdorimit të së njëjtës gjuhë, mund të përdoren për zhvillimin e kurrikulave arsimore.

- **Shërbimet sociale nuk janë të zhvilluara mjaftueshëm dhe në mënyrën e duhur.** Në veçanti, shërbimi shëndetësor ka nevojë për shumë përmirësime për sa i përket cilësisë së mbulimit. Baza ligjore për sigurimet shëndetësore (në zonat rurale të palës Shqiptare) pengohet akoma nga zhvillimi i shërbimit shëndetësor të përgjithshëm. Duke qenë se sistemi shëndetësor administrohet në nivel qendror, nën programet BNK nuk ka shumë mundësi veprimtarie, por me siguri ka hapësira për aktivitete potenciale të përbashkëta në fushën e fushatave për prevencionin shëndetësor dhe për edukimin shëndetësor.

- **Inkurajimi i rrjeteve rajonale të organizatave të shoqërisë civile – CSO** (përfshirë organizatat sportive, të të rinjve dhe kulturore) mund të ndihmojë për ruajtjen dhe përfortimin e marrëdhënieve/lidhjeve të

komuniteteve në të dyja anët e kufirit në këtë zonë multietnike të programit.

- **Aktivitetet e lidhura me kërkim dhe zhvillim – R&D – dhe IT janë akoma në nivele të ulëta.** Investimet dhe aktivitetet qeveritare, rajonale ose lokale në fushën e R&D janë ende të pamjaftueshme, edhe pse ka universitete në zonën e programit. Nuk ka të dhëna të posaçme mbi kërkimin dhe zhvillimin, por virtualisht, ka një mungesë bashkëpunimi midis institucioneve në të dyja vendet përfituese të IPA II dhe fushat e kërkimit, zhvillimit dhe inovacionit, vazhdojnë të jenë të paeksploruara.

- **Qeveritë vendore dhe rajonale në përgjithësi janë të dobëta nga pikëpamja financiare dhe nuk mund të nxisin zhvillimin lokal.** Nuk kanë aftësi të mjaftueshme menaxhuese, kontrolli financiar dhe buxhetimi, qasje demokratike në procesin e vendimmarrjes. Përthithja e fondeve të BE-së vazhdon të jetë e ulët. Bashkëpunimi midis qeverisjeve lokale dhe rajonale të dy vendeve përfituese IPA II ka hapësira për përmirësim. Procesi i decentralizimit është në proces në të dyja vendet përfituese IPA II.

	PIKAT E FORTA	DOBËSITË	MUNDËSITË	RREZIQET
MBROJTJA E MJEDISIT, PROMOVIMI I ADAPTIMIT DHE MITIGIMIT TË NDRYSHIMIT KLIMATERIK, PARANDALIMI DHE MENAXHIMI I RISKUT	<ul style="list-style-type: none"> Biodiversiteti i pasur natyror, mjedis i paprekur dhe atraktiv, diversiteti i peisazheve natyrore; Prania e disa zonave të mbrojtura dhe parqeve kombëtare të përshtatshme për zhvillimin e eko-turizimit; Zona të gjëra pyjore dhe pyje cilësore; Potencial i lartë për përdorimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë (hidroenergjitikë, fuqi e erës, energji diellore dhe biomasat); Zona të pastra pa ndotje industriale, veçanërisht zonat bregdetare dhe malore të Shqipërisë. 	<ul style="list-style-type: none"> Përfortim i dobëti rregullorë dhe standardeve mjedisore; Menaxhim dhe mekanizma kontrolluese të dobëta për mbrojtjen e burimeve natyrore; Menaxhim i papërshtatshëm i mbetjeve solide dhe mungesë e sistemeve të përpunimit të ujrave të zeza; Menaxhim i papërshtatshëm i tokës dhe shpyllëzimi; Burime natyrore të pashfrytëzuara; Njohuri e pamjaftueshme mbi çështjet mjedisore. 	<ul style="list-style-type: none"> Menaxhim më i mirë i pyjeve dhe zonave të mbrojtura; Rritje e programeve dhe projekteve mbi mbrojtjen e mjedisit, pyjeve, bujqësi e qëndrueshme, përpunim i mbetjeve solide dhe i ujrave të zeza, etj.; Realizimi i programeve të përbashkëta për përpunimin e mbetjeve; Interes lokal për prodhimin e energjisë së gjelbër; Rritja e ndërgjegjësimit publik mbi masat për mbrojtjen e mjedisit, nën presionin e kërkesës së eko-turistave. 	<ul style="list-style-type: none"> Ndotja e tokës dhe e burimeve ujore për shkak të papërshtatshmërisë ose mungesës së sistemeve të përpunimit të mbetjeve solide dhe ujrave të zeza; Procesi i urbanizimit i pakontrolluar dhe jashtë standardeve; Shfrytëzim i pakontrolluar i burimeve natyrore (lëndët e drurit, shtrati i lumenjve, frytet e pyjeve) në veçanti shpyllëzimi; Presione mbi mjedisin bregdetar, shkaktuar nga një turizëm i përhapur; Zgjerimi i industrisë së çimentos në zonën e Lezhës, me risqe të larta për mjedisin përreth.



	PIKAT E FORTA	DOBËSITË	MUNDËSITË	RREZIQET
INKURAJIMI I TURIZMIT DHE I TRASHËGIMISË KULTURORE DHE NATYRORE	<ul style="list-style-type: none"> -Klimë e kënaqshme kontinentale që mundëson zhvillimin e tipave të ndryshëm të turizmit në të gjithë zonën e programit; -Kulturë e pasur dhe e shumëllojshme që i përshtatet mirë aktiviteteve dhe kalimit jashtë të kohës së lirë; -Trashëgimi e pasur kulturore dhe historike; -Shoqata të shumta komuniteti të përfshira në aktivitete për ruajtjen e kulturës dhe natyrës; -Diversitet multikulturor dhe traditë në shkëmbimet kulturore; -Tradita kulinare të pasura të përshtatshme për agroturizëm. 	<ul style="list-style-type: none"> -Infrastrukturë e pazhvilluar e turizmit në raport me standardet ndërkombëtare; -Financime dhe përpjekje të pamjaftueshme për mbrojtjen dhe ruajtjen e natyrës dhe trashëgimisë historike dhe arkeologjike; -Njohje e kufizuar e potencialit të trashëgimisë historike dhe kulturore si një burim të ardhurash nga turizmi dhe aktivitete kulturore; -Aftësi të kufizuara dhe nivel i varfër i shërbimeve në lidhje me turizmin; -Njohje ndërkombëtare e kufizuar për rajonin, si një destinacion turistik tërheqës. 	<ul style="list-style-type: none"> -Nxitja e iniciativave për përmirësimin e aftësive dhe infrastrukturës së turizmit; -Përfshirja e mëtejshme e trashëgimisë kulturore në ofertat turistike; -Promovimi i traditave të veçanta kulinare dhe prodhimeve agroushqimore për të kontribuar në forcimin e identitetit të zonës; -Zhvillimi dhe forcimi i kapaciteteve institucionale lokale në lidhje me promovimin e aseteve të turizmit, kulturës dhe traditës; -Zhvillimi i ekoturizmit i lidhur me eksperiencën në natyrë si një paketë e integruar (p.sh., alpinizmi, rafting, trekking, biking); -Promovimi i bashkëpunimit ndërmjet agjencive turistike për ofrimin e paketave të integruara turistike përgjatë kufirit. 	<ul style="list-style-type: none"> -Promovimi i pamjaftueshëm i turizmit, si në nivel kombëtar dhe rajonal, për shkak të pamjaftueshmërisë së financimit; -Ndotja mjedisore në zonat me potencial të lartë për ekoturizëm; -Mungesa e kuptimit të potencialit të trashëgimisë kulturore dhe historike në zonën e programit; -Mungesa e mbrojtjes së duhur të monumenteve dhe qendrave kulturore dhe historike; -Ndërtime të paligjshme afër bregdetit, parqeve natyrore dhe qendrave të trashëgimisë kulturore.

	PIKAT E FORTA	DOBËSITË	MUNDËSITË	RREZIQET
INVESTIM NË RINI, EDUKIM DHE AFTËSI	<ul style="list-style-type: none"> -Popullsia e re relativisht dhe shkallë e lartë lindjesh; -Prezenca e universiteteve publike dhe private; -Multietniciteti si një avantazh për zhvillimin social dhe kulturor; -Ekzistenca e arsimit profesional dhe e trajnerëve joformalë; -Një mjedis shumëgjuhësh; -Një gjeneratë e re entuziaste e etur për të mësuar dhe e zhvilluar; -Gjuhë e përbashkët për shumicën e popullsisë në zonë. 	<ul style="list-style-type: none"> -Curriculum i palidhur me kërkesat e tregut të punës dhe trajnim profesional inefficent i paorientuar drejt punësimit; -Nivel i ulët i edukimit të popullsisë rurale dhe grupe shoqërore të marginalizuara si romët, ashkalët etj.; -Niveli i braktisjes së arsimit elementar dhe sekondar si rezultat i arsimimit të varfër të ofruar veçanërisht në disa zona rurale; -Sistem i pazhvilluar i arsimimit gjatë gjithë jetës; -Penetrim i ulët i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK). 	<ul style="list-style-type: none"> -Përmirësimi i nivelit të arsimit profesional për t'i shërbyer më mirë nevojave të tregut të punës me aftësitë e nevojshme; -Zhvillimi i veprimtarive të kërkimit dhe zhvillimit, duke përdorur kërkimet ekzistuese dhe qendrat e arsimit të lartë; -Promovimi i TIK-ut për përmirësimin e aksesit në arsimim në zonat rurale dhe rritja e kontakteve virtuale në zonën ndërkufitare dhe bashkëpunimi. 	<ul style="list-style-type: none"> -Akses i kufizuar i popullsisë rurale në sistemin formal të arsimit profesional, për shkak të varfërisë; -Infrastrukturë e varfër ose joekzistente që rrit pabarazitë rajonale; -Migrimi i rinisë për shkak të mungesës së mundësive.



	PIKAT E FORTA	DOBËSITË	MUNDËSITË	RREZIQET
PROVIMI I PLANIFIKIMIT DHE I QEVERISJES LOKALE DHE RAJONALE DHE NDËRTIMI I KAPACITETEVE ADMINISTRATIVE	<ul style="list-style-type: none"> -Marrëveshje ekzistuese bashkëpunimi ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës; -Ekzistenca e strategjisë së zhvillimit rajonal për të gjitha rajonet; -Ekzistenca e planeve të zhvillimit rajonal dhe në nivel bashkie; -Procesi në vazhdim i decentralizimit. 	<ul style="list-style-type: none"> -Kapacitete të kufizuara të njëjve të pushtetit lokal për zbatimin e politikave zhvillimore; -Burime financiare të pamjaftueshme për financimin e objektivave të zhvillimit; -Mungesa e njohurive të duhura nga ana e administratës lokale për përthithjen dhe zbatimin e fondeve të BE-së. 	<ul style="list-style-type: none"> -Pjesëmarrja e njëjve të pushteti lokal në iniciativa të përbashkëta apo programe për forcimin e kapaciteteve institucionale; -Programe trajnimi për fuqizimin e kapaciteteve të aktorëve lokalë. 	<ul style="list-style-type: none"> -Njësitë e pushtetit lokal të dobëta financiarisht; -Mungesë fondesh për trajnimin e administratës të pushtetit lokal për rritjen e kapaciteteve të tyre për hartimin dhe zbatimin e politikave; -Mungesë bashkëpunimi ndërmjet strukturave të duhura rajonale.

	PIKAT E FORTA	DOBËSITË	MUNDËSITË	RREZIQET
FORCIMI I KËRKIMEVE, ZHVILLIMIT TEKNOLOGJIK, INOVACIONIT DHE TIK-ut	<ul style="list-style-type: none"> -Prezenca e universiteteve publike dhe private në zonën e programit; -Rritja e përqindjes së popullsisë aktive që përdor TIK; -Ekzistenca e planeve të zhvillimit rajonal dhe në nivel bashkie; -Procesi në vazhdim i decentralizimit. 	<ul style="list-style-type: none"> -Praktika të varfra inovacioni dhe kërkimi të universiteteve dhe operatorëve të tjerë në zonën e programit; -Penetrim modest i internetit; -Literaturë e varfër kompjuterike; -TIK e varfër që përdoret nga universitetet, shkollat ose bizneset. 	<ul style="list-style-type: none"> -Zhvillimi dhe zbatimimi i projekteve ndërkufitare për TIK-un; -Investime në TIK dhe programet e zhvillimit rajonal që mund t'u përshtaten nevojave për zhvillim të sektorit privat; -Forcimi i kërkimit, teknologjisë dhe inovacionit në zonën e programit; -Programe për shkëmbimin e studentëve. 	<ul style="list-style-type: none"> -Mungesë e strategjive kombëtare për promovimin e TIK-ut dhe zhvillimit rajonal; -Financime të kufizuara për kërkime dhe zhvillime dhe -Interes i pamjaftueshëm i sektorit privat për zhvillimin teknologjik dhe modernizimin e proceseve të prodhimit.



Marrëveshja e Financimit IPA II, programet vjetore të veprimit BNK – Shtojca II: Kushtet e përgjithshme v. 3.1, shtator 2018

SHTOJCA II KUSHTET E PËRGJITHSHME

Përmbajtja
SHTOJCA II: KUSHTET E PËRGJITHSHME

Pjesa e parë: Dispozita të përgjithshme

Neni 1 - Periudha e ekzekutimit, periudha e zbatimit operacional dhe afati kontraktues

Neni 2 - Përfituesit e IPA II dhe detyrat e tyre të përbashkëta

Neni 3 - Kërkesat e raportimit

Neni 4 - Vizibiliteti dhe komunikimi

Neni 5 - Të drejtat e pronësisë intelektuale

Neni 6 - Pranueshmëria e shpenzimeve

Pjesa e dytë: Dispozitat e zbatueshme të menaxhimit të tërthortë nga përfituesi i IPA-së II

Neni 7 - Parime të përgjithshme

Neni 8 - Procedurat e dhënies së prokurimit dhe granteve

Neni 8 - Detyrimi për të informuar, sanksionet administrative dhe mosveprimi

Neni 9 - Kontrollat paraprake mbi procedurat e granteve dhe prokurimeve dhe kontrollat paraprake të kontratave dhe granteve që do të kryhen nga komisioni

Neni 10 - Llogaritë bankare, sistemet e kontabilitetit dhe kostot e njohura

Neni 11 - Dispozita për pagesat e bëra nga Komisioni për përfituesit IPA II që është autoriteti kontraktues

Neni 12 - Ndërprerja e pagesave

Neni 13 - Kthimi i fondeve

Pjesa e tretë: Dispozitat përfundimtare

Neni 14 - Konsultimi ndërmjet përfituesve të IPA II dhe Komisionit

Neni 15 - Amendimi i kësaj Marrëveshjeje Financimi

Neni 16 - Pezullimi i kësaj Marrëveshjeje Financimi

Neni 17 - Përfundimi i kësaj Marrëveshjeje Financimi

Neni 18 - Rregullimet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

PJESA E PARË DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Periudha e ekzekutimit, periudha e zbatimit operacional dhe afati kontraktues

1. Periudha e ekzekutimit është periudha gjatë së cilës zbatohet Marrëveshja e Financimit dhe përfshin periudhën operative të zbatimit, si dhe një fazë të mbylljes. Kohëzgjatja e periudhës së ekzekutimit është e përcaktuar në nenin 2(1) të Kushteve të veçanta dhe do të fillojë me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financimi.

2. Periudha e zbatimit operacional është periudha në të cilën kanë përfunduar të gjitha aktivitetet operative të mbuluara nga prokurimi dhe kontratat e grantit të programit të veprimit. Kohëzgjatja e kësaj periudhe është përcaktuar në nenin 2(2) për Kushtet e veçanta dhe do të fillojë me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financimi;

3. Periudha operationale e zbatimit dhe ekzekutimit duhet të respektohet nga Autoriteti Kontraktues në mbyllje dhe zbatim të prokurimit dhe kontratave të granteve, në kuadër të kësaj Marrëveshjeje Financiare.

4. Kostot që lidhen me projektet e këtij Programi Veprimi do të jenë të pranueshme për financimin e BE-së vetëm nëse janë kryer gjatë periudhës së zbatimit operativ.

5. Prokurimet, kontratat e grantit dhe marrëveshjet e kontributit do të përfundojnë maksimumi brenda tre vjetëve nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes Financiare, përveç:

a) në ndryshimet në kontratat tashmë të lidhura;

b) kur kontratat individuale të prokurimit përfundojnë pas një ndërprerjeje të parakohshme të kontratës ekzistuese të prokurimit;

c) kontratave që lidhen me auditimin dhe vlerësimin, të cilat mund të jenë të nënshkruara pas zbatimit operacional;

d) ndryshimi i subjektit të ngarkuar me detyra të besuara.

6. Kur një kontratë granti ose prokurimi nuk ka sjellë asnjë pagesë brenda dy viteve nga nënshkrimi i saj, do të ndërpritet automatikisht dhe fondet e saj do të bllokohen, me përjashtim të çështjeve gjyqësore pranë gjykatave ose në organet e arbitrazhit.



Neni 2

Përfituesit e IPA II dhe detyrat e tyre të përbashkëta

1. Siç parashikohet në nenin 76(3) të kuadrit të marrëveshjeve përkatëse, përfituesit e IPA II do të bashkëpunojnë ngushtë dhe duhet të përmbushin bashkërisht në veçanti funksionet e mëposhtme dhe të marrin përsipër përgjegjësitë e mëposhtme:

a) përgatisin programet e bashkëpunimit ndërkufitar, në përputhje me nenin 68 të Marrëveshjeve Kuadër përkatëse ose rishikimet e tyre;

b) sigurojnë pjesëmarrjen në Komitetin e Përbashkët të Monitorimit (KPM), mbledhje dhe takime të tjera dypalëshe;

c) emërojnë përfaqësuesin e tyre në KPM;

d) krijojnë Sekretariatit e Përbashkët Teknik (SPT) dhe sigurohen që ajo të ketë stafin e duhur;

e) përgatisin dhe zbatojnë vendimet strategjike të KPM;

f) mbështesin punën e KPM-së dhe sigurojnë informacionin e kërkuar për të kryer detyrat e veta, në veçanti të dhënat që lidhen me ecurinë e programit operativ në arritjen e objektivave specifike dhe synimeve për prioritet tematike si ngritja e programit të bashkëpunimit ndërkufitar;

g) krijojnë një sistem për të mbledhur informacion të besueshëm mbi zbatimin e programit të bashkëpunimit ndërkufitar;

h) hartojnë raportet vjetore dhe finale të zbatimit, siç janë përmendur në nenin 80 të Marrëveshjes Kuadër përkatëse në përputhje me nenin 3;

i) të përgatisin dhe të zbatojnë një plan koherent për komunikim dhe vizibilitet;

j) të hartojnë një plan vjetor të punës për Sekretariatit e Përbashkët Teknik, të miratuar nga KPM-ja.

2. Me qëllim zbatimin e nenit 25 të Marrëveshjes Kuadër mbi Mbrojtjen e të Dhënave, të dhënat personale do të jenë:

- përpunuar në mënyrë të ligjshme, të drejtë dhe transparente në lidhje me subjektin e të dhënave;

- të mbledhura për qëllime të specifikuar, të qarta dhe të ligjshme dhe të mos përpunohen më tej në atë mënyrë që është e papajtueshme me ato qëllime;

- të mjaftueshme, të rëndësishme dhe të kufizuara në çka është e nevojshme në lidhje me qëllimet për të cilat përpunohen;

- të sakta dhe, kur është e nevojshme, të përditësuara;

- përpunuar në atë mënyrë që garantojnë sigurinë e duhur të të dhënave personale; dhe

- të mbajtura në një formë që lejon identifikimin e subjekteve të të dhënave jo më gjatë se sa është e nevojshme për qëllimet për të cilat përpunohen të dhënat personale.

Të dhënat personale të përfshira në dokumente që duhen mbajtur nga përfituesi i IPA II, në përputhje me nenin 8.5, duhet të fshihen pasi të kenë përfunduar afatet e përcaktuara në nenin 8.5.

Neni 3

Kërkesat e raportimit

1. Për qëllimet e kërkesave të raportimit të përcaktuara në nenin 80(1) të Marrëveshjes përkatëse Kuadër, strukturat operuese do të përdorin modelin e parashikuar në shtojcën III të kësaj marrëveshjeje financimi.

2. Për qëllim të kërkesave të përgjithshme të raportimit në Komision, të përcaktuara në nenin 58 të Marrëveshjes Kuadër dhe kërkesat specifike të raportimit nën menaxhimin e tërthortë të përcaktuara në nenin 59(1) të Marrëveshjes Kuadër përkatëse në raportin vjetor për zbatimin e asistencës IPA II, NIPAC do të përdorë modelin e dhënë në shtojcën IIIA të kësaj marrëveshjeje financimi.

3. Për qëllim të kërkesave specifike të raportimit sipas menaxhimit të tërthortë të përcaktuar në pikën “a”, të nenit 59(2) të Marrëveshjes Kuadër mbi raportin vjetor financiar apo deklaratat, NAO si përfitues i IPA II që është Autoriteti Kontraktues, do të përdorë modelin e parashikuar në shtojcën IV të kësaj marrëveshjeje financimi.

4. Për qëllim të nenit 59(4) të Marrëveshjes Kuadër, NIPAC (KKIPA) si përfitues i IPA II që është Autoriteti Kontraktues, do t'i paraqesë Komisionit një raport përfundimtar mbi zbatimin e asistencës së IPA II të Programit të Veprimtarojve jo më vonë se katër muaj pas disbursimit (pagesës) të fundit për kontraktuesit e saj ose përfituesit e granteve.

5. Për qëllim të nenit 59(6) të Marrëveshjes Kuadër, ZKA si përfitues i IPA II ku është



Autoriteti Kontraktues, do të sigurojë deri në datën 15 janar të vitit financiar vijues, në format elektronik, një kopje të të dhënave të mbajtura në sistemin e kontabilitetit, të krijuar, sipas nenit 10(5). Kjo duhet të mbështetet nga një raport i nënshkruar i paaudituar përmbledhës financiar, në përputhje me pikën “c” të shtojcës IV.

Neni 4

Vizibiliteti dhe komunikimi

1. Siç parashikohet në dispozitat e nenit 24 (1), 76 (3) (k) dhe nenit 78 (8) (f) të Marrëveshjes Kuadër përkatëse, përfituesit e IPA II duhet të përgatisin një plan koherent të aktiviteteve të vizibilitetit dhe të komunikimit, të cilat do t'i paraqiten Komisionit për një marrëveshje, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje Financimi.

2. Këto aktivitete të vizibilitetit dhe komunikimit duhet të jenë në përputhje me Manualin e Komunikimeve dhe Vizibilitetit për veprimet e jashtme të BE-së, të përcaktuara dhe të publikuara nga Komisioni, në fuqi në kohën e aktiviteteve.

Neni 5

Të drejtat e pronësisë intelektuale

1. Kontratat e financuara sipas kësaj Marrëveshjeje Financiare, duhet të garantojnë që përfituesit e IPA II të fitojnë të gjitha të drejtat e nevojshme të pronësisë intelektuale në lidhje me teknologjinë e informacionit, studimet, skicat, planet, publicitetin dhe çdo material tjetër të përgatitur për qëllime të planifikimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit.

2. Përfituesi IPA II që është autoriteti kontraktues, do të garantojë që Komisioni ose dikush apo personi i autorizuar nga Komisioni dhe përfituesit e të tjerë të IPA II, do të kenë qasje dhe të drejtën për të përdorur një material të tillë. Komisioni do ta përdorë një material të tillë vetëm për qëllimet e veta.

Neni 6

Pranueshmëria e shpenzimeve

1. Shpenzimet e mëposhtme nuk do të jenë të pranueshme për financim sipas kësaj Marrëveshjeje Financiare:

- a) borxhet dhe pagesat e shërbimit të borxhit (interesi);
- b) dispozitat për humbje ose detyrime të mundshme në të ardhmen;
- c) kostoja e deklaruar nga përfituesi dhe e financuar nga një veprim apo program pune që merr një grant nga unioni;
- d) humbjet e këmbimit valutor;
- e) kreditë për palët e treta;
- f) gjobat, penalitetet financiare dhe shpenzimet e procesit gjyqësor.

2. Blerja e tokës që nuk është e ndërtuar dhe e tokës me ndërtim në shumën deri 10% të totalit të shpenzimeve të lejueshme për aktivitetin në fjalë, do të jetë e ligjshme/e pranueshme për financim, sipas asistencës për bashkëpunim ndërkufitar IPA II, nëse është e justifikuar nga natyra e veprimit dhe të dhënat në shtojcën I.

PJESA E DYTË

**DISPOZITAT E ZBATUESHME TË
MENAXHIMIT TË TËRTHORTË NGA
PËRFITUESI IPA II**

Neni 7

Parime të përgjithshme

1. Qëllimi i pjesës së dytë është të vendosë rregullat për zbatimin e Programit të Veprimit nën menaxhimin e tërthortë dhe, në veçanti, rregullat që lidhen me detyrat që i janë besuar zbatimit të buxhetit, siç përshkruhet në shtojcën I dhe për të përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e përfituesit të IPA II që është Autoriteti Kontraktues dhe Komisioni në kryerjen e këtyre detyrave.

2. Siç parashikohet në pikën “b” të nenit 76 (3) të Marrëveshjes Kuadër përkatëse, përfituesit e IPA II, bashkërisht, duhet të përgatisin një marrëveshje dypalëshe dhe të sigurojnë zbatimin e saj.

3. Përfituesi i IPA II që nuk është Autoritet Kontraktues, do të bashkëpunojë me përfituesin e IPA II që është Autoritet Kontraktues, për të siguruar se detyrat në vijim janë plotësuar:



a) të kryejë ndjekjen operative dhe menaxhimin e operacioneve, siç parashikohet në pikën “b” të nenit 76 (4) të Marrëveshjes Kuadër;

b) të kryejë verifikime në përputhje me nenin 76(5) të Marrëveshjes Kuadër;

c) të mbrojë interesin financiar të Unionit, siç parashikohet në nenin 51 të Marrëveshjes Kuadër.

Neni 8

Procedurat e dhënies së prokurimit dhe granteve

1. Detyrat e përmendura në nenin 7(3) duhet të kryhen nga përfituesi i IPA II që është Autoritet Kontraktues, në përputhje me procedurat dhe dokumentet standarde të përcaktuara dhe të publikuara nga Komisioni për dhënien e prokurimit dhe kontratave të granteve, në veprimet e jashtme, në fuqi në kohën e fillimit të procedurës në fjalë (PRAG), si dhe në përputhje me standardet e kërkuara të vizibilitetit dhe komunikimit, të përmendura në nenin 4(2).

2. Në përputhje me nenin 18(2) të Marrëveshjes Kuadër, Komisioni do të pajisë përfituesin e IPA-II që është Autoritet Kontraktues, me udhëzime të mëtejshme për përshtatjen e procedurave dhe dokumenteve standarde, të përcaktuara dhe të publikuara nga Komisioni për dhënien e kontratave të prokurimit dhe granteve në veprimet e jashtme, në rastin specifik të bashkëpunimit ndërkuftar.

3. Përfituesi IPA II që është Autoritet Kontraktues do të kryejë procedurat e prokurimit dhe dhënies së grantit, të lidhë kontratat që pasojnë dhe të sigurojë që të gjitha dokumentet përkatëse për gjurmët e auditimit janë në gjuhën e kësaj marrëveshjeje të financimit. Në zbatim të pjesës së dytë të kësaj Marrëveshjeje Financiare, çdo referencë për dhënien e kontratave duhet të përfshijë gjithashtu kontratën e kontributit dhe çdo referencë për përfituesit e granteve do të përfshijë edhe organizatat që kanë nënshkruar marrëveshje kontributi.

4. Përfituesit e vendeve IPA II do të bashkëpunojnë plotësisht në vendosjen e komisioneve të vlerësimit, siç parashikohet në pikën “a” të nenit 76 (4) i Marrëveshjes përkatëse Kuadër.

5. Përfituesi i IPA II që është Autoritet Kontraktues, do të mbajë të gjitha dokumentet ndihmëse financiare dhe kontraktuale përkatëse,

nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financiare ose nga një datë më e hershme, në rast se procedurat e prokurimit, thirrjet për propozime, ose procedurat e dhënies së granteve të drejtpërdrejta, kanë filluar para hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje të Financimit:

a) Për procedurat e prokurimit, në veçanti:

a) njoftim i mëparshëm me dëshminë e publikimit të njoftimit të prokurimit dhe të çdo korigjimi;

b) caktimi i panelit të zgjedhur;

c) raporti i listës së të përzgjedhurve (duke përfshirë anekset) dhe aplikimet;

d) dëshmi e publikimit të njoftimit të listës së përzgjedhurve

e) letra e kandidatëve jo të përzgjedhur;

f) ftesë për tender ose ekuivalente e saj;

g) dosja e tenderit, duke përfshirë anekset, sqarime, procesverbalet e mbledhjeve, dëshmitë e publikimit;

h) caktimi i komisionit të vlerësimit;

i) raporti për hapjen e tenderave, duke përfshirë anekset;

j) raporti i vlerësimit/negocimit, duke përfshirë anekset dhe ofertat e pranuar;⁶¹

k) letra e njoftimit;

l) shkresë për dorëzimin e kontratës;

m) letrat për kandidatët e pasuksesshëm;

n) dhënia/njoftimi i anulimit, përfshirë dëshminë e publikimit;

o) kontratat e nënshkruara, ndryshimet, dispozitat shtesë, raportet e zbatimit, dhe korrespondenca përkatëse.

b) Për thirrjet për propozime dhe dhënien e drejtpërdrejtë të granteve, në veçanti:

a) emërimi i komisionit të vlerësimit;

b) raporti i hapjes dhe raporti administrativ, duke përfshirë shtojcat dhe aplikimet e marra;⁶²

c) letrat për aplikantët e suksesshëm dhe të pasuksesshëm, pas vlerësimit të hartimit të notës;

d) raporti i vlerësimit të hartimit të notës;

e) raporti i vlerësimit të aplikimit të plotë ose raporti i negocimit me shtojcat përkatëse;

f) kontrolli i pranueshmërisë dhe dokumentet e tjera shoqëruese;

⁶¹ Eliminimi i ofertave të pasuksesshme pesë vjet pas mbylljes së procedurës së prokurimit.

⁶² Eliminimi i aplikimeve të pasuksesshme tre vjet pas përfundimit të procedurës së grantit.



g) letrat për aplikantët e suksesshëm dhe të pasuksesshëm me listën e miratuar rezervë, pas vlerësimit të plotë të aplikimit;

h) shkresa përcjellëse për dorëzimin e kontratës së grantit;

i) dhënia/njoftimi i anulimit, me dëshmi të publikimit;

j) kontratat e nënshkuara, ndryshimet, dispozitat shtesë dhe korrespondencat përkatëse.

Përveç kësaj, dokumentet financiare dhe kontraktuale të përmendura në paragrafin 6(a) dhe (b) të këtij neni, do të plotësohen nga të gjitha dokumentet e tjera shoqëruese përkatëse, siç kërkohen nga procedurat e përmendura në pikën 1 të këtij neni, si dhe të gjithë dokumentacionin përkatës në lidhje me pagesat, rikuperimin dhe shpenzimet operative, për shembull raportet e projektit dhe raportet e kontroleve të vendeve, pranimi i furnizimeve dhe punëve, sigurimet dhe garancitë, raportet e inxhinierëve të mbikëqyrjes.

Të gjitha dokumentet përkatëse financiare dhe kontraktuale do të mbahen për të njëjtën kohëzgjatje, në përputhje me nenin 49 të Marrëveshjes Kuadër.

Neni 8a

Detyrimi për të informuar, sanksionet administrative dhe mosveprimi

1. Gjatë zbatimit të procedurave dhe dokumenteve standarde të përcaktuara dhe të publikuara nga Komisioni për dhënien e kontratave të prokurimit dhe grantit, përfituesi i IPA II do të sigurojë që asnjë kontratë e prokurimit ose grantit të financuar nga BE nuk i jepet një operatori ekonomik ose aplikanti për grante, nëse operatori ekonomik ose kërkuesi i grantit, nëse ai personalisht ose një person me kompetenca të përfaqësimit, vendimmarrjes ose kontrollit mbi të, ndodhet në një nga situatat e përjashtimit të parashikuara në procedurat përkatëse dhe dokumentet standarde të Komisionit.

2. Përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues do të informojë Komisionin, kur një kandidat, ofertues ose aplikant ndodhet në një situatë përjashtimi nga pjesëmarrja në procedurat e dhënies së prokurimit dhe grantit, ka kryer parregullsi dhe mashtrime ose është konstatuar në shkelje të rëndë të detyrimeve të tij kontraktuale.

3. Përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues, do të marrë parasysh informacionin përfshirë në Sistemin e Zbulimit të Parakohshëm dhe të Përjashtimit (EDES), gjatë dhënies së kontratave të prokurimit dhe granteve. Aksesit në informacione mund të sigurohet përmes pikës/ve së ndërlidhjes ose nëpërmjet konsultimeve me mënyrat e mëposhtme: (Komisioni Evropian, Drejtoria e Përgjithshme për Buxhetin, nëpunësi i kontabilitetit të Komisionit, BRE2-13/505, B-1049 Bruksel, Belgjikë dhe me email: BUDG-C01-EXCL-DB@ec.europa.eu bashkë me adresën e Komisionit, të identifikuar në nenin 3 të Kushteve të veçanta).

4. Kur përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues është në dijeni për një situatë përjashtimi në zbatimin e detyrave të përshkuara në shtojcën I, përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues, do t'i vendosë një operatori ekonomik ose aplikuesi granti përjashtim nga prokurimet e saj të ardhshme ose procedurat e dhënies së granteve. Përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues, gjithashtu mund të vendosë një penalitet financiar proporcional me vlerën e kontratës në fjalë. Përjashtimet dhe/ose penalitetet financiare do të vendosen pas një procedure për gjetjen dhe paraqitje e provave që siguron të drejtën e mbrojtjes së personit në fjalë. Përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues, njofton Komisionin në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni.

5. Në lidhje me paragrafin 4 të këtij neni, përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues, merr përsipër mosveprimin, nëse nuk vendos përjashtim dhe/ose një penalitet financiar ndaj operatorit ekonomik ose kërkuesit të grantit.

6. Në rastin e mosveprimit, përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues, duhet të njoftojë Komisionin për të shpjeguar arsyet për mosveprimin e tij. Komisioni rezervon të drejtën për të përjashtuar një operator ekonomik ose një aplikues granti nga procedurat e ardhshme të financimit të BE-së dhe/ose të vendosë një penalitet financiar ndaj operatorit ekonomik ose kërkuesit të grantit ndërmjet 2% dhe 10% të vlerës totale të kontratës në fjalë.



Neni 9

Kontrollet paraprake mbi procedurat e granteve dhe prokurimeve dhe kontrollet paraprake të kontratave dhe granteve që do të kryhen nga Komisioni

1. Komisioni mund të ushtrojë kontrolle paraprake (*ex ante*) për tenderimin e kontratave, hapjen e thirrjeve për propozime dhe dhënien e kontratave dhe granteve për fazat e mëposhtme të prokurimit ose dhënies së granteve:

- a) për miratimin e njoftimeve të kontratës për prokurim, programet e punës për thirrjet për propozime dhe çdo korrigjim të tij;
- b) për miratimin e dosjeve të tenderit dhe udhëzimeve për aplikantët për grante;
- c) për miratimin e përbërjes së komisioneve të vlerësimit;
- d) për miratimin e raporteve të vlerësimit dhe vendimet e dhënies së kontratës⁶³;
- e) për miratimin e dosjeve të kontratës dhe shtesën e kontratës.

2. Lidhur me kontrollin paraprak, komisioni duhet të vendosë:

- a) të kryejë kontrolle paraprake për të gjitha dosjet; ose
- b) të kryejë kontrolle paraprake në përzgjedhjen e këtyre dosjeve; ose
- c) të heqë dorë plotësisht nga kontrollet paraprake.

3. Nëse Komisioni vendos për të kryer kontrolle paraprake në përputhje me paragrafin 2, shkronjat “a” ose “b” të këtij neni, ai duhet të informojë përfituesin e IPA II që është Autoriteti Kontraktues i dosjeve të përzgjedhura, në lidhje me kontrollet paraprake. Ky përfitues i IPA II do të japë të gjithë dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm për Komisionin, pasi të informohet se një dosje është përzgjedhur për kontroll paraprak maksimumi në kohën e dorëzimit të njoftimit të kontratës ose programit të punës për publikim.

4. Komisioni mund të vendosë për të kryer kontrolle të mëpasshme (*ex-post*), duke përfshirë auditimet dhe kontrollet në vend, në çdo kohë, për ndonjë kontratë ose grantet e dhëna nga përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues që rrjedhin

nga kjo Marrëveshje Financimi. Ky përfitues i IPA II do të të vërë në dispozicion të gjithë dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm për Komisionin, pasi të informohet se kjo dosje është përzgjedhur për kontroll të mëpasshëm (*ex post*). Komisioni mund të autorizojë një person ose njësi ekonomike për të kryer kontrolle *ex post* në emër të tij.

Neni 10

Llogaritë bankare, sistemet e kontabilitetit dhe kostoja e njohur

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financimi, Fondi Kombëtar dhe struktura operative e përfituesit të IPA II që është Autoriteti Kontraktues për Programin e Veprimit, duhet të hapë të paktën një llogari bankare në euro. Bilanci i përgjithshëm bankar për programin e veprimit do të jetë shuma e bilanceve në të gjitha llogaritë bankare të programit të veprimit, të mbajtura nga fondi kombëtar dhe të gjitha strukturat pjesëmarrëse që operojnë te përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues.

2. Përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues do të përgatisë dhe dorëzojë në komision planet e parashikimit të disbursimit për kohëzgjatjen e periudhës së zbatimit të Programit të Veprimit. Këto parashikime duhet të përditësohen për raportin vjetor financiar të përmendur në nenin 3(2) dhe për çdo kërkesë për fonde. Parashikimet do të bazohen në një analizë të dokumentuar dhe të detajuar (duke përfshirë edhe kontraktimin e planifikuar dhe orarin e pagesave sipas kontratës për dymbëdhjetë muajt në vijim), të cilat do të jenë në dispozicion të Komisionit në bazë të kërkesës.

3. Plani fillestar i parashikimit të disbursimit duhet të përmbajë përmbledhjen e parashikimit vjetorë të disbursimit për të gjithë periudhën e zbatimit dhe parashikimet mujore të disbursimit për dymbëdhjetë muajt e parë të programit të veprimit. Planet e mëvonshme duhet të përmbajnë përmbledhjen vjetore të parashikimeve të disbursimit për bilancin e periudhës së zbatimit të programit të veprimit dhe parashikimet mujore të disbursimit për katërmëdhjetë muajt në vijim.

4. Përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues, është i detyruar të krijojë dhe mirëmbajë një sistem të kontabilitetit në përputhje

⁶³ Për kontratat e shërbimit këta hapa përfshijnë kontrollet paraprake në lidhje me miratimin e listës së përzgjedhur.



me pikën 2(3)(b) të shtojcës A të Marrëveshjes Kuadër, i cili do të mbajë të paktën informacionin për kontratat që menaxhohen nën Programin e Veprimit të treguar në shtojcën V.

5. Kostoja e njohur në sistemin e kontabilitetit e mbajtur nën seksionin 4 të këtij neni, duhet të jetë kryer, paguar dhe pranuar dhe të korrespondojë me kostot aktuale të provuara nga dokumentet mbështetëse dhe të përdoret kur është e përshtatshme, për të nisur parafinancimin e paguar nga përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues sipas kontratave lokale.

6. Kostoja e njohur në sistemin e kontabilitetit do të shfrytëzohet nga Komisioni për njohjen e përkohshme të kostos së saj, gjatë zbatimit të programit të veprimit (duke përfshirë autorizimin e parafinancimit që i paguhet përfituesit të IPA II, i cili është Autoriteti Kontraktues) për procesin e miratimit për pagesat, autorizimin përfundimtar të procedurës së llogarive në fund të Programit të Veprimit, praktikat vjetore të ndërprera dhe çdo zbatim tjetër të menaxhimit dhe të shqyrtimeve të performancës.

7. Përfituesi i IPA II që është autoriteti kontraktues, do t'i sigurojë Komisionit raportet në vijim:

- a) raportin përmbledhës, siç është përcaktuar në nenin 3(5);
- b) raportet vjetore, siç janë përcaktuar në paragrafët 2 deri 4 të nenit 3;
- c) kërkesa për raportet e fondeve, siç përmenden në nenin 11.

Neni 11

Dispozita për pagesat e kryera nga Komisioni për përfituesit IPA II, që është autoriteti kontraktues

1. Përfituesi IPA II që është autoriteti kontraktues, duhet të paraqesë parashikimin e tij fillestar të disbursimit (pagesës) për programin e veprimit, të përgatitur në përputhje me nenin 10(2), me kërkesën e parë për pagesë të parafinancuar. Pagesa e parë e parafinancimit do të bëhet për 100% të pagesës së parashikuar për vitin e parë të planit të parashikuar për disbursim.

2. Përfituesi IPA II, që është autoriteti kontraktues, do të paraqesë kërkesa të vazhdueshme të pagesës së parafinancimit, kur bilanci i përgjithshëm bankar për programin e

veprimit përfshihet nën pagesën e parashikuar për pesë muajt në vazhdim të programit të veprimit.

3. Çdo kërkesë për parafinancim shtesë do të mbështetet nga dokumentet e mëposhtme:

- a) një deklaratë përmbledhëse të të gjitha pagesave të kryera për programin e veprimit;
- b) balancat bankare për programin e veprimit në datën e përcaktuar të kërkesës;
- c) një parashikim të pagesave për programin e veprimit për katërmbëdhjetë muajt në vazhdim në datën e përcaktuar të kërkesës në përputhje me shtojcën IV pika “d”.

4. Përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues, mund të kërkojë për çdo parafinancim pasues, shumën e totalit të disbursimeve të parashikimit për katërmbëdhjetë muaj, pas datës së përcaktuar të kërkesës, pa balancat e referuara në nenin 3(b) të këtij neni në datën e përcaktuar të kërkesës për fondet e rritura nga ndonjë shumë e financuar nga përfituesi IPA II, sipas paragrafit 5 të këtij neni dhe që nuk është rimbursuar ende.

Komisioni gëzon të drejtën për të reduktuar çdo pagesë pasuese të parafinancimit, nëse tepricat totale bankare të mbajtura nga përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues në bazë të këtij programi dhe në të gjitha programet e tjera të IPA I apo IPA II që menaxhohen nga përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues, tejkalon parashikimin e disbursimit për katërmbëdhjetë muajt e ardhshëm.

5. Në rastet kur pagesa është reduktuar sipas paragrafit 4 të këtij neni, përfituesi i IPA II që është autoriteti kontraktues, duhet ta financojë programin nga burimet e veta, deri në shumën e reduktimit. Përfituesi i IPA II që është autoriteti kontraktues, më pas mund të kërkojë rimbursimin e këtij financimi, si pjesë e kërkesës së ardhshme për fonde të përcaktuara në paragrafin 4 të këtij neni.

6. Komisioni ka të drejtë për të rikuperuar balancat e tepërta bankare, të cilat kanë mbetur të papërdorura për më shumë se dymbëdhjetë muaj. Para se të ushtrojë këtë të drejtë, Komisioni e fton përfituesin e IPA II që është autoriteti kontraktues, për të dhënë arsyet e vonës në disbursimin e fondeve dhe të demonstrojë nevojën për to në vazhdim gjatë dy muajve të ardhshëm.



7. Interesi i gjeneruar nga llogaritë bankare të përdorura për këtë program nuk njihet nga Komisioni.

8. Sipas nenit 33(4) të marrëveshjes kuadër, kur ndërprerja e afatit për kërkesën për pagesë tejkalon dy muaj, përfituesi i IPA II, që është autoriteti kontraktues, mund të kërkojë një vendim nga Komisioni, nëse ndërprerja e afatit duhet vazhdojë.

9. Pasqyra financiare përfundimtare e përmendur në nenin 37(2) të marrëveshjes kuadër do të dorëzohet nga ZKA-ja, jo më vonë se 16 muaj pas përfundimit të periudhës së zbatimit operacional.

Neni 12

Ndërprerja e pagesave

1. Pa cenuar pezullimin ose përfundimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi, sipas përkatësisht neneve 16 dhe 17 dhe, përveç nenit 39 të Marrëveshjes Kuadër, Komisioni mund të ndërpresë pagesat pjesërisht ose plotësisht, në qoftë se:

a) Komisioni ka vendosur ose paraqet shqetësime serioze, pasi përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues ka bërë gabime të konsiderueshme, ka parregullsi apo mashtrime që vënë në dyshim ligjshmërinë ose rregullsinë e transaksioneve në fjalë, në implementimin e programit të veprimit ose nuk ka përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj marrëveshjeje financiare;

b) Komisioni ka vendosur ose paraqet shqetësime serioze, nëse përfituesi IPA II që është autoriteti kontraktues ka kryer gabime sistemike ose të përsëritura, ose ka parregullsi, mashtrime apo shkelje të detyrimeve në këtë ose në të tjera Marrëveshjeje Financimi, me kusht që ato gabime, parregullsi, mashtrime ose shkelje të detyrimeve të kenë ndikim material në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financiare apo vënë në dyshim besueshmërinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të përfituesit të IPA II ose ligjshmërinë dhe rregullsinë e shpenzimeve bazë.

Neni 13

Kthimi i fondeve

1. Përveç rasteve të përmendura në nenin 41 të Marrëveshjes Kuadër, Komisioni mund të rimarrë fondet nga përfituesi i IPA II që është Autoriteti

Kontraktues, siç parashikohet në rregulloren financiare, veçanërisht në rast se:

a) Komisioni vendos se objektivat e programit të veprimit të përcaktuara në shtojcën I nuk janë arritur;

b) shpenzimet janë të papërshtatshme;

c) shpenzimet janë shkaktuar si rezultat i gabimeve, parregullsive, mashtrimeve apo shkeljeve të detyrimeve në zbatimin e programit të veprimit, në veçanti në procedurën e prokurimit dhe dhënies së granteve.

2. Në përputhje me ligjin kombëtar, përfituesi i IPA II, që është autoriteti kontraktues, do të rimarrë kontributin e unionit që i paguhet përfituesit të IPA II, i cili është autoriteti kontraktues, nga marrësit të cilët ndodhen në një prej situatave të përcaktuara në paragrafin 1, pika “b” ose “c” të këtij neni ose të referuara në nenin 41 të Marrëveshjes Kuadër. Fakti se përfituesi IPA II, që është Autoriteti Kontraktues, nuk ka sukses në kthimin e të gjithë ose një pjese të fondeve nuk do ta pengojë Komisionin për rikuperimin e fondeve nga përfituesi i IPA II, që është autoriteti kontraktues.

3. Përfituesi i IPA II, që nuk është autoriteti kontraktues, do të bëjë përpjekje maksimale për të mbështetur përfituesin e IPA II, që është autoriteti kontraktues, në rimëkëmbjen e saj, kur përfituesi vendoset në territorin e tij. Marrëveshja për rikuperimin do të parashikohet në një marrëveshje dypalëshe, që do të lidhet në përputhje me nenin 69 të Marrëveshjeje Kuadër përkatëse.

4. Shumat e paguara padrejtësisht apo të mbuluara nga përfituesi IPA II, që është autoriteti kontraktues, shumat e garancive financiare, performancës dhe parafinancimit, të paraqitura në bazë të prokurimit dhe dhënies së procedurave të granteve, shumat nga gjobat e vendosura nga përfituesi IPA II, që është autoriteti kontraktues për kandidatët, ofertuesit, aplikantët, kontraktuesit ose përfituesit e granteve, të paguara për përfituesit e IPA II, që është autoriteti kontraktues, ose do të ripërdoren për programin e veprimit, ose do t'i kthehen Komisionit.



PJESA E TRETË
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 14

**Konsultime ndërmjet përfituesve të IPA II
dhe Komisionit**

1. Përfituesit e IPA II dhe Komisioni do të konsultohen me njëri tjetrin para se të krijojnë mosmarrëveshje, në lidhje me zbatimin ose interpretimin e mëtejshëm të kësaj Marrëveshjeje Financimi, në përputhje me nenin 18 të këtyre Kushteve të përgjithshme.

2. Kur Komisioni vihet në dijeni për problemet në kryerjen e procedurave që lidhen me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi, ai duhet të krijojë të gjitha kontaktet e nevojshme me përfituesit e IPA II për të korrigjuar situatën dhe ndërmarrë hapat e nevojshëm.

3. Konsultimi mund të çojë në një ndryshim, në pezullimin ose përfundimin e kësaj marrëveshjeje financimi.

4. Komisioni do të informojë rregullisht përfituesit e IPA II për zbatimin e aktiviteteve të përshkruara në shtojcën I, të cilat nuk përfshihen në pjesën e dytë të këtyre Kushteve të përgjithshme.

Neni 15

Ndryshimi i kësaj Marrëveshjeje Financimi

1. Çdo ndryshim i kësaj Marrëveshjeje Financiare duhet të bëhet me shkrim, duke përfshirë dhe shkëmbimin e shkresave.

2. Nëse përfituesit e IPA II, kërkojnë një amendament, kërkesa duhet t'i paraqitet bashkërisht Komisionit të paktën gjashtë muaj para se ndryshimi që kërkohet të hyjë në fuqi.

3. Komisioni mund të amendojë dokumentet model në shtojcën III, IIIA, IV dhe V, pa nevojën e një amendamenti të kësaj Marrëveshjeje Financiare. Përfituesit e IPA II do të informohen me shkrim për çdo amendament të tillë dhe për hyrjen e tij në fuqi.

Neni 16

Pezullimi i kësaj Marrëveshjeje Financimi

1. Zbatimi i kësaj Marrëveshjeje Financiare mund të pezullohet në rastet e mëposhtme:

a) nëse ndonjë përfitues IPA II shkel një detyrim sipas kësaj marrëveshjeje financiare;

b) nëse përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues shkel ndonjë detyrim të përcaktuar në bazë të procedurave dhe dokumenteve standarde të përmendura në nenin 18(2) të Marrëveshjes përkatëse Kuadër, pa cenuar dispozitat në nenin 8(2);

c) nëse përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues, nuk i plotëson kërkesat për zbatimin e detyrave të besuara të buxhetit;

d) nëse përfituesit e IPA II nuk i përmbushin bashkërisht funksionet dhe përgjegjësitë e përmendura në nenin 2(1) dhe, kur është e mundur, edhe menaxhimin e tërthortë sipas nenit 7(3);

e) nëse ndonjë përfitues i IPA II vendos të pezullojë ose të ndërpresë procesin e pranimit të anëtarësimit në BE;

f) nëse ndonjë përfitues i IPA II shkel një detyrim në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut, parimet demokratike dhe sundimin e ligjit, si dhe në raste të rënda të korrupsionit ose nëse përfituesi IPA II është fajtor për sjellje të rëndë profesionale të provuar me ndonjë mënyrë të justifikuar. Shkelje e rëndë profesionale nënkupton një nga sa më poshtë:

- shkelje e ligjeve ose rregulloreve në fuqi ose e standardeve etike të profesionit të cilit i përket një person ose subjekt; ose

- çdo sjellje e gabuar e një personi ose subjekti që ka ndikim në kredibilitetin e tij profesional, kur sjellja e tillë nënkupton qëllimin e gabuar ose neglizhencën e rëndë;

g) në rastet e forcës madhore, siç përcaktohet më poshtë. "Forcë madhore" do të thotë çdo situatë e paparashikueshme dhe e jashtëzakonshme ose ngjarje përtej kontrollit të palëve, e cila pengon secilën prej tyre në përmbushjen e ndonjë prej detyrimeve të tyre, gjë që nuk i atribuohet gabimit ose neglizhencës nga ana e tyre (ose pjesës së kontraktuesve të tyre, agentëve ose të punësuarve) dhe vërteton pakapërcyeshmërinë e situatës, pavarësisht se janë bërë përpjekjet e duhura. Defektet në pajisje ose materiale, ose vonesat e tyre të mundshme, mosmarrëveshjet e punës, grevat ose vështirësitë financiare nuk mund të përdoren si forcë madhore. Një palë nuk duhet të konsiderohet si shkelëse e detyrimeve të saj, nëse është penguar nga përmbushja e tyre për shkak të një force



madhore, për të cilën pala tjetër është informuar siç duhet. Një palë që përballet me një forcë madhore duhet ta informojë palën tjetër pa vonesë, duke deklaruar natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektet e parashikueshme të problemit, dhe të marrë çdo masë për të minimizuar dëmet e mundshme.

Asnjëra prej palëve nuk do të konsiderohet përgjegjëse për shkelje të detyrimeve të veta, sipas kësaj Marrëveshjeje Financiare, nëse është penguar nga përmbushja e tyre nga forca madhore, me kusht që ajo palë të marrë masa për të minimizuar dëmtimet e mundshme.

2. Komisioni mund ta pezullojë këtë Marrëveshje Financimi pa njoftim paraprak.

3. Komisioni mund të marrë masat e duhura parandaluese para se të bëhet pezullimi.

4. Kur pezullimi është njoftuar, duhet të tregohen pasojat e prokurimit dhe kontratave të granteve në vazhdim dhe marrëveshjet e delegacionit për këto kontrata, si dhe marrëveshjet që duhen nënshkruar për këto kontrata.

5. Pezullimi i kësaj marrëveshjeje financimi nuk e cenon ndërprerjen e kësaj Marrëveshjeje Financimi nga Komisioni, në përputhje me nenin 17.

6. Palët do të rifillojnë zbatimin e Marrëveshjes Financiare, sapo kushtet ta lejojnë, me miratimin paraprak me shkrim të Komisionit. Kjo nuk cenon asnjë amendim të kësaj Marrëveshjeje Financiare që mund të jenë të nevojshme për të përshtatur programin e veprimit me kushtet e reja zbatuese, duke përfshirë, nëse është e mundur, zgjatjen e periudhës së zbatimit ose përfundimin e kësaj Marrëveshjeje Financiare në përputhje me nenin 17.

Neni 17

Përfundimi i kësaj Marrëveshjeje Financimi

1. Nëse çështjet të cilat çuan në pezullimin e Marrëveshjes së Financimit nuk janë zgjidhur brenda një periudhe maksimale 180-ditore, secila palë mund ta përfundojë Marrëveshjen Financiare me njoftim 30 ditë para.

2. Kur ndërprerja është njoftuar, duhet të tregohen pasoja e prokurimeve dhe kontratave të granteve në vazhdim dhe kontratat ose grantet e tilla që duhen nënshkruar.

3. Përfundimi i kësaj Marrëveshjeje Financiare nuk do të përjashtojë mundësinë e Komisionit që

të kryejë korrigjime financiare, në përputhje me nenet 43 dhe 44 të Marrëveshjes Kuadër.

Neni 18

Rregullimet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

1. Çdo mosmarrëveshje në lidhje me Marrëveshjen e Financimit që nuk mund të zgjidhet brenda një periudhe gjashtëmujore nga konsultimet midis palëve, të parashikuara në nenin 14, mund të zgjidhet nga arbitrazhi me kërkesën e njëres prej palëve.

2. Secila palë do të caktojë një gjyqtar brenda 30 ditëve nga data e kërkesës për arbitrazh. Nëse kjo nuk arrihet, secila palë mund t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit (Hagë) të caktojë një gjyqtar të dytë. Të dy gjyqtarët, nga ana e tyre, caktojnë një gjyqtar të tretë brenda 30 ditëve. Nëse kjo nuk arrihet, secila palë mund t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit të caktojë gjyqtarin e tretë.

3. Përveç kur arbitrat vendosin ndryshe, do të zbatohen procedurat e parashikuara në Gjykatën e Përhershme të Arbitrazhit, rregullat opsionale për Arbitrazhin që përfshijnë organizatat ndërkombëtare dhe shtetet. Vendimet e arbitrave merren me shumicë brenda një periudhe tremujore.

4. Secila palë do të jetë e detyruar të marrë masat e nevojshme për zbatimin e vendimit të gjyqtarëve.

SHTOJCA III

**RAPORTI VJETOR I ZBATIMIT BNK.
MARRËVESHJA E FINANCIMIT BNK IPA II.
Version i janarit 2018**

MODEL

**RAPORTI VJETOR I ZBATIMIT: <viti>
BASHKËPUNIMI NDËRKUFITAR
NDËRMJET PËRFITUESVE TË VENDEVE
IPA II**

(Neni 80 i marrëveshjes kuadër)

Tabela e përmbajtjes

Fjalori i akronimeve

1. Identifikimi

2. Pasqyrë e zbatimit të programit ndërkufitar

2.1 Analiza e progresit dhe arritjeve



2.2 Progresi i bërë në zbatimin e programit ndërkufitar

2.2.1 Analiza sasiore

2.2.2 Analiza cilësore

2.3 Informacion i detajuar mbi ekzekutimin financiar të programit ndërkufitar

2.4 Informacion mbi hapat e ndërmarrë nga struktura operuese dhe/ose nga Komiteti

Përbashkët i Monitorimit për të siguruar cilësinë dhe efektivitetin e zbatimit

2.4.1 Monitorimi dhe vlerësimi

2.4.2 Problemet e hasura dhe veprimet korrigjuese

2.5 Vizibiliteti dhe publiciteti

2.6 Përdorimi i asistencës teknike

2.7 Ndryshimet në kontekstin e zbatimit të programit ndërkufitar

2.8 Ndërveprimet me sektorët e tjerë, politikat apo instrumentet

2.9 Historitë e suksesit

Fjalori i akronimeve

<...>

1. Identifikimi

PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR	Titulli i programit: Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar <vendi A> – <vendi B>
	<Përfitimet/alokimet për vitin 20XX–20XX: <shuma, duke përfshirë Kontratën e Shërbimit të Asistencës Teknike (KSHAT)>
RAPORTI VJETOR MBI ZBATIMIN	Viti i Raportimit <nga 1 janari 20XX deri më 31 dhjetor 20XX>
	Përgatitur nga: - <struktura operuese, vendi X> - < struktura operuese, vendi Y>
	Data e shqyrtimit të raportit vjetor nga Komiteti i Përbashkët Monitorues: <data dhe lloji i procedurës së miratimit, p.sh., mbledhje apo me shkrim>
	Zona e lejueshme e programit: <...>

Baza ligjore: Neni 80 i Marrëveshjes Kuadër IPA II

2. Përmbledhje e zbatimit të programit të bashkëpunimit ndërkufitar

2.1 Arritjet dhe analiza e progresit

<Përmbledhje e zbatimit të programit gjatë periudhës së mbuluar, të tilla si:

1. Progresi me thirrjet për propozime:

Numri i thirrjeve të planifikuara për t'u shpallur deri në fund të periudhës së programimit dhe kalendari i tyre;

- Situata e thirrjeve për propozime (numri i thirrjeve për propozime të hapura dhe në cilën datë, numri i thirrjeve për propozime të mbyllura dhe në cilën datë, kohëzgjatja e procesit të vlerësimit - kohëzgjatja totale dhe për secilin hap etj.);

- Analiza e procesit të vlerësimit (numri i aplikimeve të marra sipas llojit të përfituesit dhe vendit, numri i aplikimeve të refuzuara në secilën fazë të procesit të vlerësimit, arsyet më të zakonshme të refuzimit, lista e aplikimeve të refuzuara (shihni modelin e tabelës më poshtë);

- Lista e kontratave të nënshkruara (shihni modelin e tabelës më poshtë);



- Eventet e organizuara për ngritjen e kapaciteteve për aplikantët e ardhshëm dhe për përfituesit e granteve (numri i eventeve, numri i pjesëmarrësve sipas llojit të eventit për secilin vend, numri i kërkesave për informacion nga përfituesit e granteve të adresuara etj.).

- Numri i takimeve të mbajtura dhe rezultateve të stafit të sekretariatit të përbashkët teknik dhe strukturave operuese; numri i takimeve të komitetit të përbashkët të monitorimit dhe rezultatet; numri i takimeve të strukturave operuese dhe rezultatet.>

2. Progresi me projektet strategjike;

<N.q.s. është e zbatueshme, duke përfshirë gjithashtu informacion mbi rishikimin e programit 2014-2020 ose mbi programimin e 2021–2027.>

<Modeli i tabelës për kontratat BNK të nënshkuara dhe në zbatim gjatë periudhës raportuese:

Tabela nr.: XX> Lista e aplikimeve ndërkuftare të marra – të miratuara/të refuzuara

Numri i thirrjes për propozime	Prioriteti tematik	Titulli	Emri, lloji dhe vendi i origjinës i koordinatorit dhe i partnerëve të përfshirë	Shuma e kërkuar e grantit të BE-së	Kontrolli administrativ (PO/JO)	Vlerësimi teknik (PO/JO)	E miratuar (PO/JO)	Arsyet e refuzimit

Tabela nr.: XX> Lista e kontratave të nënshkuara ndërkuftare dhe nën zbatim

Prioriteti tematik: <...>

Titulli dhe numri i kontratave	Emri, lloji dhe vendi i origjinës së koordinatorit dhe partnerëve të përfshirë	Informacion i shkurtër i projektit	Data e fillimit dhe e mbarimit	Kostoja totale e lejueshme dhe vlera e grantit të BE-së	Arritjet kryesore deri më sot	Komente >

2.2 Progresi i realizuar gjatë zbatimit të programit të bashkëpunimit ndërkuftar

<Prezantim shumë i shkurtër i prioriteteve tematike dhe i objektivave specifike të Programit BNK, së bashku me një përmbledhje të progresit të bërë në zbatimin e programit të bashkëpunimit ndërkuftar dhe, në veçanti, të arritjeve lidhur me objektivat specifike për çdo prioritet tematik (si edhe për prioritetin e AT-së), duke përfshirë elemente cilësore dhe sasiore, të cilat do të tregojnë progresin e realizuar lidhur me objektivat.>

2.2.1 Analiza sasiore

<Informacion mbi progresin e realizuar gjatë zbatimit të programit, duke pasqyruar dhe të dhëna sasiore, kur është e mundur, si dhe duke përdorur objektivat dhe indikatorët e përfshirë në program dhe në projekte.

- Analiza e arritjeve të matura nga produktet, rezultatet dhe ndikimi, si dhe treguesit fizikë dhe financiarë. Treguesit do të ndahen sipas gjinisë, kur është e mundur.

- Nëse shifrat (të dhënat) nuk janë ende të disponueshme, duhet siguruar informacion se kur do të jenë të disponueshme dhe kur do të përfshihen në raportin vjetor të zbatimit. Përveç kësaj, informacioni mund të paraqitet grafikisht.

Modeli i tabelës së indikatorëve (rezultate, produkte dhe ndikimi), me një shembull për secilin prioritet të programit, objektivi specifik dhe rezultati:



Tabela nr.: XX Të dhënat e grumbulluara në nivel programi, bazuar në informacionin e mbledhur prej projekteve

Prioriteti tematik <...> Objektivi specifik <...> Rezultati <...>											
Emri dhe tipi ⁶⁴	Përkufizimi	Baza		Arritjet				Synimi		Burimi i të dhënave	Mbledhja e të dhënave dhe shpeshtësia
		Vlera	Viti	Vlera	Viti	Vlera	Viti	Vlera	Viti		
% e studentëve të punësuar	% e të rinjve/rejave që kanë mbaruar arsimin e nivelit të dytë dhe punësohen brenda një viti pas përfundimit të shkollimit	50%	2017	60%	2019	65%	2021	70%	2023	Shërbimi i statistikave të punësimit publik	Përfituesit e granteve Raport tremujor

2.2.2 Analiza cilësore

<Analizë cilësore e progresit (përparimet konceptuale dhe përsosja e ndërhyrjeve) të realizuar gjatë zbatimit të programit të bashkëpunimit ndërkufitar, duke përfshirë analizën e ndikimit të programit në zonën e tij, me diferencim të qëllimit gjeografik (shpërndarja harmonike/përqendrimi) dhe diferencim të zonave (rurale/urbane).

Shpjegoni se si programi ka kontribuar ose do të kontribuojë në përmirësimin e marrëdhënies ndërkufitare, si dhe se si mund ta matim apo demonstrojmë atë.

Shpjegoni se si strukturat operuese dhe strukturat e ndërmjetme të ngritura gjurmojnë këto elemente të përmirësimit që ndodhin gjatë zbatimit të programit, për shembull, për ngritjen dhe funksionalitetin e sistemit të mbledhjes së të dhënave (për qëllime statistikore dhe administrative).

Për analizën cilësore, strukturat e programit duhet të bëjnë përpjekje për të siguruar informacion mbi pikepamjet, mendimet ose vëzhgimet e publikut. Këto të dhëna mblidhen kryesisht nga vlerësimet, vizitat studimore, intervistat, takimet, grupet e fokusuar, anketave etj. Në përfundim, shtjelloni se si çështjet e ndërlidhura (veçanërisht ato që janë të rëndësishme për politikën e kohezionit: mundësi të barabarta, zhvillim të qëndrueshëm dhe luftë kundër diskriminimit) zhvillohen gjatë hartimit të thirrjeve për propozime dhe zbatimit të kontratave të granteve.>

2.3 Informacione të hollësishme rreth ekzekutimit financiar të programit të bashkëpunimit ndërkufitar

- Informacion i detajuar mbi kontraktimin dhe nën menaxhimin e tërthortë, disbursimin e alokimeve vjetore për secilin prioritet tematik dhe tip grant kontrate, duke përfshirë dhe partnerët e projekteve (bashkëpërfituesit)

- Analiza e faktorëve të mëposhtëm:

- Statusi financiar
- Informacion mbi bashkëfinancimin
- Faktorët që kanë penguar dhe/ose vonuar zbatimin financiar
- Faktorët që kanë pasur ndikim pozitiv në zbatimin financiar

Tabela model mbi ekzekutimin financiar të kontratave të BNK-së gjatë zbatimit të periudhës raportuese:

<Tabela nr. XX>

Prioriteti tematik: <...>						
Numri i kontratës	Emri, tipi dhe vendi i origjinës i koordinitorëve dhe partnerëve	Dita e fillimit/mbarimit	Vlera e parashikuar e kostove të lejuara dhe vlera e grantit të BE-së	Vlera e akumuluar e pagesave	Përqindja e pagesave të ekzekutuara ⁶⁵	Komente

⁶⁴ Çdo indikator duhet të identifikohet si tregues ndikimi, rezultati ose produkti.

⁶⁵ (Vlerë kumulative e pagesave/vlera e grantit të BE-së) x 100.



2.4 Informacion mbi hapat e ndërmarrë nga strukturat operuese dhe/ose Komiteti i Përbashkët Monitorues për të siguruar cilësinë dhe efektivitetin e zbatimit

2.4.1 Monitorimi dhe vlerësimi

<Masat monitoruese të ndërmarrë nga struktura operuese ose nga Komiteti i Përbashkët i Monitorimit, duke përfshirë marrëveshjet e mbledhjes së të dhënave, rishikimet e raporteve të grant kontratave, gjetjet dhe zbatimin e rekomandimeve të vizitave monitoruese.

Në programet të cilat kanë menaxhim të tërthortë, përgatitja, ekzekutimi, gjetjet, rekomandimet dhe zbatimi i rekomandimeve të ndërmarrë nga struktura operuese ku ndodhet autoriteti kontraktues (neni 57 MK). Në programet e zbatuara nën menaxhim të tërthortë, rekomandimet dhe zbatimi i rekomandimeve të ndërmarrë prej Komisionit.>

2.4.2 Problemet e hasura dhe veprimet korrigjuese

<Përmbledhje e problemeve të rëndësishme të hasura gjatë zbatimit të programit, si dhe i masave rregulluese të ndërmarrë.

Rekomandimet për veprime (të tjera) rregulluese.>

2.4.5 Vizibiliteti dhe promovimi

<Masat e ndërmarrë për të garantuar vizibilitetin dhe publicitetin e programit (plani i vizibilitetit, shihni nenin 78 të MK-së), duke përfshirë materiale promovuese, reklama në masmedia, shembuj nga praktikatat më të mira që theksojnë aktivitetet më të rëndësishme të seminareve, konferencave, tryezave të përbashkëta, forume, ditës së Bashkëpunimit Evropian dhe panaiereve të projekteve, mbajtjes së një baze të dhënash me aplikantët e ardhshëm, faqes së internetit të programit etj.>

2.6 Shfrytëzimi i asistencës teknike

<Sqarime të detajuara mbi përdorimin e fondeve të asistencës teknike dhe çdo problemi serioz të hasur gjatë zbatimit të buxhetit të AT-së. Si përfundim, një analizë e rezultateve dhe indikatorëve të ndikimit të kësaj kontrate të asistencës teknike duhet të prezantohet në të njëjtën mënyrë si seksioni 2.2.1 më lart.>

2.7 Ndryshimet në kuadër të zbatimit të programit ndërkufitar (nëse ka)

<Nëse është e zbatueshme, përshkrimi i çdo elementi, i cili edhe pse nuk rrjedh drejtpërdrejt nga

asistenca e programit, ka ndikim të drejtpërdrejtë në zbatimin e tij (p.sh., ndryshimet legjislative, ndryshimet e rëndësishme në socio-ekonomi etj.).>

2.8 Sinergjia me politikat ose instrumentet e tjera të sektorit

<Një përmbledhje e koordinimit dhe koherencës aktuale të programit me shtetet e tjera anëtare të BE-së dhe me programet ose iniciativat kombëtare. Koordinim dhe koherenca e programit me politikat e Komunitetit. Komplementariteti me instrumentet e tjera financiare të asistencës ndërkombëtare.>

2.9 Histori suksesi

<Shpjegoni në lidhje me rezultatet e arritura me një ose mundësisht dy shembuj të grant kontratave, periudha e zbatimit të të cilave ka mbaruar gjatë periudhës raportuese dhe e cila mund të konsiderohet si histori suksesi:

Dimensioni real i BNK-së (ju lutem tregoni se cili përkufizim i BNK-së është përdorur për të vlerësuar projektpropozimet, siç tregohet në udhëzimet përkatëse për aplikuesit: a) “Zbatimi i përbashkët i aktiviteteve nga partnerët që rezultojnë në intensifikimin e lidhjeve ndërkufitare dhe partneriteteve të qëndrueshme ndërkufitare dhe heqjen e pengesave ndërkufitare për zhvillimin e qëndrueshëm socioekonomik; ose b) “zbatimin e përbashkët të aktiviteteve nga partnerët që rezultojnë në intensifikimin e lidhjeve ndërkufitare dhe partneriteteve të qëndrueshme ndërkufitare ose heqjen e pengesave ndërkufitare për zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë socioekonomike”.

Ndikimi real i BNK-së: fqinjësi më e mirë dhe përfitim për njerëzit nga të dyja anët në një mënyrë që një “projekt kombëtar” nuk do të kishte arritur.

Inovacioni: sipas fushës, partnerëve të përfshirë dhe aktiviteteve e metodave të zbatuara.

Efikasiteti: rezultatet e arritura në kohë dhe në përputhje me buxhetin e planifikuar.

Përhapja e duhur: vizibiliteti, replikueshmëria, shumëfishimi dhe efekti i shpërndarjes.

Perspektiva të mira të qëndrueshmërisë: përfitimet e mundshme pas kohëzgjatjes së projektit dhe partneritet afatgjatë.>

<Historitë mund të kenë strukturën e mëposhtme:

Fjali e gjetur që përmbledh suksesin e projektit
Titulli i projektit



Prioriteti tematik
 Vendndodhja: bashkitë sipas vendit
 Tipi i partnerëve të projektit
 Vlera e buxhetit (duke përfshirë grantin e BE-së)
 Problematikat
 Objektivat e arritur (duke përfshirë deklaratat e partnerëve)
 Rezultatet kryesore
 Aktivitetet kryesore
 Afatet kohore
 Faqe interneti
 Detajet e kontakteve të partnerëve BNK>

SHTOJCA III A MODEL I RAPORTIT VJETOR

Periudha e mbuluar nga raporti:
 1.1.20XX – 31.12.20XX
 Data e lëshimit të raportit XX.XX.20XX

Raporti vjetor mbi zbatimin e asistencës IPA II nën menaxhimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë nga [vend] i nënshkruar nga Koordinatori Kombëtar i IPA-së.

I. Përmbledhje

1. Referenca ndaj objektivave të Dokumentit Strategjik Kombëtar dhe një pasqyrë mbi sfidat e sektorëve.

2. Përfshirja në programim.

3. Marrëdhëniet me Komisionin Evropian.

4. Problemet e hasura në përmbushjen e kushteve të nevojshme dhe sigurimin e qëndrueshmërisë, masat e ndërmarra/planifikuara, rekomandimet për veprime të mëtejshme.

5. Çështje të rëndësishme, të cilat që rrjedhin nga pjesëmarrja e vendit përfitues IPA II në komitetin e monitorimit dhe në komitetet sektoriale të monitorimit (përfshirë edhe Komitetin e Përbashkët të Monitorimit për CBC), nëse ka ndonjë.

6. Përfshirja në projekte shumëvendëshe dhe çështjet që lidhen me to.

7. Monitorimi dhe vlerësimi i aktiviteteve, mësimet kryesore të nxjerra dhe ndjekja e rekomandimeve.

8. Komunikimi dhe vizibiliteti i aktiviteteve.

9. Koordinimi i donatorëve.

Në rastin e menaxhimit të tërthortë, përmbledhja duhet të përfshijë:

10. Zbatimin e përgjithshëm të asistencës IPA nën menaxhimin e tërthortë (maks. një faqe).

11. Problemet kryesore horizontale të hasura gjatë zbatimit të asistencës IPA dhe masat e marra/planifikuara (maks. gjysmë faqe).

12. Rekomandimet për veprimet e mëtejshme (maks. gjysmë faqe).

13. Auditimet – gjetjet kryesore dhe rekomandimet dhe veprimet korrigjuese të ndërmarra.

II. Informacion për sektorin

Titulli i sektorit⁶⁶: [Transport]

Pjesa narrative: Përmbledhja për sektor, duke përfshirë dhe informacionin që vijon:

1. Përfshirja në programim.

2. Paraqitje e rezultateve drejt një qasjeje të re të sektorit (p.sh., objektivat e arritur sipas udhërrëfyesit të sektorit në dokumentin e planifikimit të tij).

3. Koordinim me instrumente të tjera dhe/ose donator/IFI brenda sektorit.

4. Ndikimi i projekteve IPA II brenda sektorit mbi zhvillimin e kapaciteteve përkatëse administrative kombëtare, planeve strategjike dhe buxhetit.

Nën menaxhimin e tërthortë duhet, gjithashtu, të përfshihet dhe informacioni si më poshtë:

5. Struktura operuese dhe ndryshimet që lidhen me të, nëse janë të rëndësishme: [Ministria e Transportit].

6. Informacion mbi zbatimin e programit në sektor.

7. Arritjet kryesore në sektor.

8. Çdo problem i rëndësishëm i hasur gjatë zbatimit të detyrave, p.sh. vonesat në kontraktim, dhe masat e mëtejshme të ndërmarra/planifikuara.

9. Rekomandime për veprimet e mëtejshme.

10. Aktivitetet monitoruese të zbatuara dhe vlerësuar, gjetjet kryesore dhe mësimet e nxjerra nga auditimi, rekomandimet, ndjekja dhe masat korrigjuese të ndërmarra.

Emërtimi i sektorit: Bashkëpunimi ndërkuftar⁶⁷

1. Përfshirja, sipas rastit, në program.

2. Progresi i realizuar gjatë zbatimit të programeve BNK dhe, në veçanti, në arritjen e

⁶⁶ Sipas sektorëve në dokumentet strategjike.

⁶⁷ Për bashkëpunimin ndërkuftar kërkohet raportim specifik.



objektivave specifike për çdo prioritet tematik (duke përfshirë elementet cilësore dhe sasiore, të cilat tregojnë progresin e realizuar në lidhje me objektivat).

3. Një përmbledhje e problemeve të hasura gjatë zbatimit të programeve BNK dhe masat korrigjuese të ndërmarra, si dhe rekomandimet për masat e tjera korrigjuese që do ndërmerren.

4. Monitorimi, duke përfshirë marrëveshjet për të dhënat e mbledhura dhe aktivitetet e vlerësimit, kur janë të zbatueshme.

5. Komunikimi dhe aktivitetet e vizibilitetit.

6. Koordinimi me vendin partner.

Nën menaxhimin e tërthortë duhet të përfshihet dhe informacioni si në vijim:

1. Struktura operuese dhe ndryshimet përkatëse, nëse ka.

2. Çdo problem i rëndësishëm i hasur gjatë zbatimit të detyrave, p.sh., vonesat në kontraktim dhe masat pasuese të ndërmarra/planifikuara.

3. Rekomandime për veprimet e mëtejshme.

4. Auditimi – Gjetjet kryesore dhe rekomandimet dhe veprimet korrigjuese të ndërmarra.

Shtojca III A – Modeli i Raportit Vjetor

II a. Performanca e treguesve në sektor [p.sh. Transporti], duke mbuluar menaxhimin e drejtpërdrejtë dhe atë të tërthortë:

Treguesit³ për program

Marrëveshja Financiare/Referenca e programit ⁴	Treguesit për sektor [Transporti]	Burimi	Baza	Komponentët kryesorë (2017)	Objektivat (2020)	Vlera (2014 ⁵)
Programi i vendit për vitin 2014	Reduktimi i kohës mesatare të udhëtimit të pasagjerëve ndërmjet qendrave kryesore nga mënyrat e transportit					
2014-20xx Programi shumëvjeçar	Reduktimi i kostove të transportit për njësi prodhimi					

³ Këto duhet të jenë kryesisht rezultate, si dhe tregues përkatës të përzgjedhur.

⁴ Duhet të jetë në përputhje me mënyrën e programimit (vjetor, shumëvjeçar, me ose pa angazhime të ndara) dhe me raporin NAO.

⁵ Numri i kolonave të përshatet për të gjitha vitet nga 2014 deri në vitin e periudhës së raportimit. Vlerat duhet të jenë kumulative.

II b. Përmbledhje për sektorin në nivel veprimi [p.sh., Transporti]

Marrëveshja Financiare/Referenca e programit	Projekti	Situata/Progresi për projekte të veçanta (p.sh. Termat e Referencës në përgatitjen për shpalljen e tenderit, kontraktimin, zbatimin, përfundimin)	Arritjet kryesore dhe vlerësimi i tyre	Problemet kryesore të hasura gjatë zbatimit të detyrave të caktuara dhe masat e ndërmarra/planifikuara për kapërcimin e tyre	Zhvillimet që ndikojnë në zbatimin e ardhshëm	Rekomandime për masa të tjera korrigjuese
[Programi i vendit për vitin 2014]	Elektrifikimi i linjës hekurudhore nga kufiri xxx deri në kufirin xxx	p.sh. Kontrata e shërbimit për përgatitjen e Termave të Referencës për kontratën e punimeve të jetë nënshkruar dhe në zbatim, tenderi për kontratën e punimeve të fillojë në tremujorin e dytë të vitit 2015		p.sh. Kontrata e shërbimit për përgatitjen e Termave të Referencës për kontratën e punimeve është vonuar për shkak se procedura e negociimit ka dështuar dhe duhet të ri-shpallet	p.sh. ndryshimi i ligjit vendor, si qasje dhe zbatimin e paketës së katërt hekurudhore	



Nën menaxhimin e tërthortë duhet të sigurohen shtojcat si më poshtë vijon:

Shtojca 1

Përmbledhje e funksioneve të sistemit të menaxhimit dhe kontrollit (duke përfshirë ndryshimet në strukturën institucionale) (maks. një faqe).

Transparenca, vizibiliteti, informacioni dhe aktivitetet e komunikimit, në përputhje me marrëveshjen kuadër (maks. një faqe)

Shtojca 2

Histori suksesi (Shënim. Ky seksion mund të përdoret për raportin vjetor të asistencës financiare i cili përgatitet nga Komisioni Evropian).

Shtojca 3

Plani vjetor i prokurimit

Shtojcat e mëposhtme duhet të sigurohen si për menaxhimin direkt ashtu dhe për atë të tërthortë:

Shtojca 4

Udhërrëfytyesi i qasjes sektoriale – arritjet (duke theksuar nëse objektivat e planifikuar janë përmbushur ose jo).

DEKRET

Nr. 11898, datë 5.1.2021

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe të nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 160/2020, “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Integritimit Evropian, dhe Komisionit Evropian për programin e bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Shqipëri–Kosovë, 2014–2020, alokimet për vitin 2019”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

LIGJ Nr. 166/2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 8097, DATË 21.3.1996, “PËR PENSIONET SHTETËRORE SUPLEMENTARE TË PERSONAVE QË KRYEJNË FUNKSIONE KUSHTETUESE DHE TË PUNONJËSVE TË SHTETIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 1 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 7 ndryshohet si më poshtë:

“7. Me termin “pagë referuese” kuptohet paga e muajit më të fundit, sipas legjislacionit në fuqi që zbatohet për atë funksion a detyrë.

Për funksionet e parashikuara dhe të referuara në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe për funksionet, paga e të cilëve referohet te ligji i sipërcituar, me termin “pagë referuese” kuptohet:

a) për personat, të cilët kanë vite shërbimi deri më 31.12.2018, pavarësisht datës së lindjes të së drejtës për përfitim, paga e muajit të fundit që zbatohet për atë funksion apo detyrë, sipas legjislacionit në fuqi, deri në datën 31.12.2018;

b) për personat, të cilët kanë vite shërbimi pas datës 1.1.2019, paga e muajit të fundit që zbatohet për atë funksion, sipas legjislacionit në fuqi, në momentin e lindjes të së drejtës për përfitim, por në asnjë rast kjo pagë referuese nuk e tejkalon pagën e Presidentit të Republikës;



c) për personat, të cilët kanë vite shërbimi para dhe pas datës 31.12.2018, paga referuese për periudhën e shërbimit është paga mesatare mujore referuese që llogaritet si raport i shumës së pagave referuese të të gjitha funksioneve e detyrave që kanë gëzuar personat, respektivisht sipas përcaktimeve të shkronjave “a” dhe “b”, me shumën e muajve që njihet si periudhë shërbimi për të gjitha funksionet e detyrat, por në asnjë rast kjo pagë referuese nuk e tejkalon pagën e Presidentit të Republikës.

Paga referuese është bazë e llogaritjes së pensioneve suplementare dhe e pagesës kalimtare.”

2. Në pikën 8, “Grupi i parë”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në shkronjën “a” shtohen funksionet:

- Kryetar i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit;
- Komisioneri Publik;
- Kryetar i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit;
- Kryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor;
- Kryetar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë;
- Drejtues i Strukturës së Posaçme të

Antikorrupsionit dhe Krimet të Organizuar;

b) Në shkronjën “b” shtohen funksionet:

- Gjyqtar i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit;
- Komisioner i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit;

- Anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor;

- Anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë;

- Inspektori i Lartë i Drejtësisë;

- Drejtor i Shkollës së Magjistraturës.

c) Në shkronjën “b”, funksioni “Zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë” shfuqizohet.

3. Në pikën 9, “Grupi i dytë”, bëhen këto shtesa:

a) Në shkronjën “a” shtohen funksionet:

- Sekretar i Përgjithshëm i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit;

- Sekretar i Përgjithshëm i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit;

- Kancelar i Komisionerit Publik;

- Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Lartë Gjyqësor;

- Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Lartë të Prokurorisë;

- Sekretar i Përgjithshëm në Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë;

- Magjistrat;

- Pedagog i brendshëm në Shkollën e Magjistraturës.

b) Në shkronjën “d” shtohen funksionet:

- Këshilltar i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit;

- Këshilltar i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit;

- Këshilltar i Komisionerit Publik;

- Kancelar në Shkollën e Magjistraturës;

- Punonjës të tjerë të barazueshëm me ta, sipas përcaktimeve me vendim të Këshillit të Ministrave.”

4. Pika 11 ndryshohet si më poshtë:

“11. Me termin “pagesë kalimtare” kuptohet pagesa që përfitojnë personat, subjekt i këtij ligji, pas ndërprerjes së funksionit ose kur punësohen në një funksion me pagë më të ulët se paga pararendëse. Për efekt të këtij ligji, dorëheqja, alternimi i funksionit titullar me anëtar brenda institucionit nuk konsiderohet ndërprerje e funksionit.”

Neni 2

Në nenin 7 fjalët “pas largimit nga funksioni” zëvendësohen me fjalët “pas ndërprerjes së funksionit”.

Neni 3

Në fund të nenit 9 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Për personat, të cilët kanë kryer funksionet e parashikuara dhe të referuara në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe për funksionet, paga e të cilëve referohet te ligji i sipërcituar, masa e pensionit llogaritet sipas përcaktimeve të bëra në këtë nen, por llogaritja e përfitimit për periudhat e shërbimit të kryera nga individët dhe të njohura si të tilla nga ky ligj bëhet sipas pagave referuese respektive, të përcaktuara në pikën 7 të nenit 1 të këtij ligji”.

Neni 4

Në fund të nenit 11 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Për personat, të cilët kanë kryer funksionet e parashikuara dhe të referuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në



Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe për funksionet paga e të cilëve referohet te ligji i sipërcituar, masa e pensionit llogaritet sipas përcaktimeve të bëra në këtë nen, por periudhat e shërbimit të kryera nga individët vlerësohen sipas pagave referuese respektive, të përcaktuara në pikën 7 të nenit 1 të këtij ligji.”.

Neni 5

Pas nenit 17 shtohet neni 17/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 17/1

Indeksimi i pagës referuese

Paga referuese e përcaktuar në shkronjën “a” të pikës 7 të nenit 1 të këtij ligji, mbi të cilën llogariten pensionet shtetërore suplementare për personat që kanë kryer funksionet e parashikuara dhe të referuara në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe për funksionet, paga e të cilëve referohet te ligji i sipërcituar, indeksohet sipas indeksit të çmimeve të konsumit deri në datën e lindjes së të drejtës për përfitim.

Procedurat e indeksimit të pagës referuese sipas funksioneve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.12.2020.

Shpallur me dekretin nr. 11913, datë 12.1.2021 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

DEKRET

Nr. 11913, datë 12.1.2021

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe të nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 166/2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8097, datë 21.3.1996, Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Ilir Meta

VENDIM

Nr. 1117, datë 16.12.2020

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË KUFIRIT 2021–2027 DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT 2021–2023

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021–2027 dhe të planit të veprimit 2021–2023, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, ministritë dhe institucionet përgjegjëse të përmendura në tekstin e kësaj strategjie për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe



**Strategjia Ndërsektoriale e Menaxhimit të
Integruar të Kufirit dhe plani i veprimit 2021–
2027**

**STRATEGJIA
NDËRSEKTORIALE E MENAXHIMIT TË
INTEGRUAR TË KUFIRIT
(2021–2027)**

Përgatitur nga:

Ministria e Brendshme - Policia e Shtetit/Departamenti për Kufirin dhe Migracionin;
Ministria e Financave dhe Ekonomisë - Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural - Autoriteti Kombëtar i Ushqimit;
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale - Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor;
Ministria e Mbrojtjes - Forca Detare/Roja Bregdetare - Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile;
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme - Drejtoria e Çështjeve Konsullore;
Ministria e Drejtësisë;
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë - Drejtoria e Përgjithshme Detare;
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
Ministria e Kulturës - Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore;
Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD);
Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTIMEVE

PJESA I: KONTEKSTI STRATEGJIK

1. Hyrja dhe qëllimi i dokumentit
2. Kuadri ligjor, institucional, arritjet dhe lidhja me dokumentet dhe prioritetet strategjike
 - 2.1 Analiza dhe arritjet
 - 2.3 Sfidat
3. Pozicioni gjeopolitik dhe karakteristikat e kufirit
 4. Vizioni i strategjisë
 - 4.1 Vizioni
 - 4.2 Misioni dhe vlerat
 - 4.3 Treguesit e impaktit dhe treguesit e rezultatit

PJESA II: QËLLIMI I POLITIKAVE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKE TË STRATEGJISË

1. Qëllimi i politikës 1 – Mbrojtja e sigurisë së brendshme dhe menaxhimi i flukseve migratore, me qëllim parandalimin e migracionit të parregullt, si dhe parandalimin dhe goditjen e krimit ndërkufitar

1.1 Objektivi specifik 1, i qëllimit të politikës 1: Rritja e nivelit të përputhshmërisë me standardet evropiane dhe të *Schengen-it*, në aspektin legjislativ, administrativ dhe institucional në fushën e menaxhimit të integruar të kufijve, veçanërisht në fushën e kontrollit dhe mbikëqyrjes së kufirit dhe forcimi i bashkëpunimit ndëragjenci dhe bashkëpunimit ndërkombëtar

1.2 Objektivi specifik 2, i qëllimit të politikës 1: Përmirësimi i sistemit për mbikëqyrjen e hapësirës detare, kontrollit kufitar dhe kërkim–shpëtimit në det

1.3 Objektivi specifik 3, i qëllimit të politikës 1: Reduktimi i vulnerabilitetit (ndjeshmërisë) në kufi duke reaguar në mënyrë më efektive me vendosjen e burimeve të disponueshme, bazuar në analizën e rrezikut të kryer dhe kërcënimit që mund të ndikojë në sigurinë kufitare, në përputhje me modelin e CIRAM-it të BE-së

1.4 Objektivi specifik 4, i qëllimit të politikës 1: Bashkëpunim i zgjeruar ndërinstitucional në menaxhimin e integruar të kufijve për të përmirësuar trafikun ndërkufitar, përmirësimin e sigurisë kufitare, luftën ndaj krimit ndërkufitar, mbrojtjen e jetës, shëndetit dhe pronën e njerëzve, shëndetin e kafshëve, bimësinë dhe ekosistemet përgjatë kufirit shtetëror

1.5 Objektivi specifik 5, i qëllimit të politikës 1: Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar, veçanërisht me vendet fqinje, institucionet e BE-së dhe Agjencinë Evropiane të Rojës Kufitare dhe Bregdetare (FRONTEX) për çështjet e kufijve, parandalimin e migracionit të paligjshëm, krimin ndërkufitar dhe ripranimin e personave me qëndrim të parregullt

1.6 Objektivi specifik 6, i qëllimit të politikës 1: Përmirësimi i sistemit të ripranimit (kthimit dhe pranimit) të shtetasve të huaj dhe vendas në përputhje me marrëveshjet e lidhura dhe në bashkëpunim me misionet diplomatike dhe konsullore

2. Qëllimi i politikës 2: Lehtësimi i qarkullimit legal të shtetasve dhe mallrave



2.1 Objektivi specifik 1, i qëllimit të politikës 2: Përmirësimi i infrastrukturës në pikat e kalimit kufitar me qëllim krijimin e kushteve që sigurojnë kalim të lehtësuar dhe të sigurt të shtetasve dhe mallrave

2.2 Objektivi specifik 2, i qëllimit të politikës 2: Negocimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve për ngritjen e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar dhe doganor

2.3 Objektivi specifik 3, i qëllimit të politikës 2: Alokimi i burimeve të nevojshme njerëzore, në pikat e kalimit të kufitar, në përputhje me fluksin e qarkullimit ndërkuftar

2.4 Objektivi specifik 4, i qëllimit të politikës 2: Forcimi i kapaciteteve logjistike për zbulimin e dokumenteve të falsifikuara të udhëtimit

2.5 Objektivi specifik 5, i qëllimit të politikës 2: Forcimi i kapaciteteve profesionale të rojeve kufitare që shërbejnë në pikat e kalimit kufitar

3. Qëllimi i politikës 3: Respektimi i plotë i të drejtave themelore, përfshirë trajtimin e çdo individi me respekt të plotë për dinjitetin dhe mundësimin e qasjes në mbrojtjen ndërkombëtare të atyre që kanë nevojë

3.1 Objektivi specifik 1, i qëllimit të politikës 3: Përmirësimi i nivelit të respektimit, mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave themelore, sjelljes profesionale të oficerëve të kontrollit kufitar, si dhe të aftësive të tyre profesionale për përdorim më efikas të pajisjeve teknike, trajnimit dhe zhvillimit profesional

3.2 Objektivi specifik 2, i qëllimit të politikës 3: Kontrolli i cilësisë në zbatimin e ligjit, për menaxhimin e kufijve dhe sjellja e policëve dhe doganierëve të përfshirë në kontrollin kufitar dhe doganor, të kryhet në përputhje aktet ligjore dhe nënligjore dhe me standardet e BE-së

3.3 Objektivi specifik 3, i qëllimit të politikës 3: Sigurimi i qasjes në mbrojtjen ndërkombëtare të atyre që kanë nevojë

PJESA III: PROJEKTET KRYESORE PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË

PJESA IV: ZBATIMI, PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, RAPORTIMI DHE MONITORIMI

1. Përgjegjësia e institucioneve

2. Llogaridhënia, raportimi dhe monitorimi

PJESA V: KOSTIMI DHE BURIMET FINANCIARE

ANEKS 1: PLANI I VEPRIMIT 2021–2023 ANEKS 1: PASAPORTA E INDIKATORËVE

Lista e shkurtimeve

AKU	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
ASCAP	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë të Arsimit Parauniversitar
BE	Bashkimi Evropian
CIRAM	Modeli i Përbashkët i Analizës së Integruar të Riskut
CRO	Fluturime të Grupuar të Kthimit
DKM	Departamenti për Kufirin dhe Migracionin
DPAP	Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
DPSSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
DVKM	Drejtori Vendore për Kufirin dhe Migracionin
DVP	Drejtori Vendore e Policisë
EUROSUR	Sistemi Evropian i Mbikëqyrjes së Kufijve
EXBS	Kontrolli i Eksporteve lidhur me Sigurinë Kufitare
FER	Regjistri Elektronik për të Huajt
FRONTEX	Agjencia Evropiane për Kufirin dhe Rojën Bregdetare
IKRKT	Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore
IOM	Organizata Ndërkombëtare e Migracionit
IT	Teknologjia e Informacionit
KE	Këshilli i Evropës
MASR	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
MB	Ministria e Brendshme
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MIK	Menaxhim i Integruar i Kufirit
MK	Ministria e Kulturës
MM	Ministria e Mbrojtjes
MSA	Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
Ombudsman	Avokati i Popullit
PAMECA	Misioni i Asistencës së Komunitetit Evropian për Shqipërinë
PE	Parlamenti Evropian
PIK	Pikë e Kalimit Kufitar
PISCES	Sistemi për Krahasimin dhe Vlerësimin e Sigurt të Identifikimit Personal
PKIE	Plani Kombëtar për Integrimin Evropian
PKK	Pikë e Kalimit Kufitar
PKM	Policia Kufitare dhe e Migracionit
PNR	Regjistri i Emrit të Pasagjerit
PPKK	Pikë e Përbashkët e Kalimit Kufitar
PSH	Policia e Shtetit
PSP	Procedura Standarde të Punës
QKK	Qendra Kombëtare e Koordinimit
QMH	Qendra e Mbyllur për të Huajt
QNOD	Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare
QRK	Qendrat Rajonale të Koordinimit
QSHI	Qendrat e Përbashkëta të Shkëmbimit të Informacionit
RB	Roja Bregdetare
RCC	Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal
RSH	Republika e Shqipërisë
SELEC	Qendra për Zbatimin e Ligjit në Evropën Juglindore
SE-V	Sistemi Evropian i Vizave
SHDSH	Shërbimi Doganor Shqiptar
SHKSH	Shërbimi Konsullor Shqiptar
SHSA	Shërbimi Veterinar Antiepidemik
SIS	Sistemi Evropian i Vizave
SIVHD	Sistemi i Vëzhgimit të Hapësirës Detare
SPK	Stacioni i Policisë Kufitare
TMS	Sistemi i Menaxhimit Total të Informacionit
UNHCR	Komisariati i Lartë i OKB-së për Refugjatët
VIS	Sistemi i Informacionit për Vizat
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave



PJESA I: KONTEKSTI STRATEGJIK

1. Hyrja dhe qëllimi i dokumentit

Anëtarësimi në Bashkimin Evropian (BE) është orientimi strategjik dhe prioritet i deklaruar për Republikën e Shqipërisë, i cili nënkupton përqaftimin e vlerave dhe standardeve evropiane të miratuara në të gjitha fushat politike, publike, sociale e më gjerë. Qarkullimi i lirë i personave dhe mallrave ndërmjet vendeve anëtare të BE-së kërkon përafrimin dhe aplikimin e masave të caktuara, ndër të tjera, arritjen e standardeve të larta të kontrollit të kufijve të jashtëm. Duke marrë në konsideratë faktin se, Republika e Shqipërisë ndodhet në kufijtë e jashtëm të BE-së, si dhe anëtarësimin e pritshëm në BE të vendeve të tjera fqinje, për vendin tonë ka një rëndësi të madhe prezantimi dhe zbatimi në vazhdimësi i konceptit të menaxhimit të integruar të kufijve, i cili duhet të jetë në përputhje me zgjidhjet aktuale në rajon dhe BE.

Miratimi i Strategjisë së Menaxhimit të Integruar të Kufirit, këtu e më tej të quajtur Strategjia, përbën jo vetëm një parakusht për integrimin e plotë në BE, por zbatimi i këtij koncepti bashkëkohor është, njëkohësisht, një tregues i qartë se Republika e Shqipërisë është e gatshme të kontribuojë për sigurinë në rajon, si një partner i besueshëm i Bashkimit Evropian në kontrollin e kufijve të saj.

Republika e Shqipërisë, nëpërmjet miratimit të këtij dokumenti strategjik, si dhe të gjitha investimeve në këtë drejtim, ka si qëllim arritjen e standardeve të BE-së në fushën e Menaxhimit të Integruar të Kufirit. Arritja e këtyre standardeve ofron siguri për qytetarët shqiptarë dhe të huaj për lëvizjen e lirë dhe të sigurt, si dhe për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike dhe ndërkufitare pa barriera.

Ky dokument strategjik bazohet në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim dhe në reformat aktuale në vendin tonë, në Strategjinë Evropiane Teknike dhe Operacionale të Menaxhimit të Integruar të Kufirit⁶⁸, në udhëzimet e Komisionit Evropian për Menaxhimin e

Integruar të Kufirit⁶⁹, katalogun *Schengen*, legjislacionin komunitar në fushën e kufijve të jashtëm, konventat ndërkombëtare të nënshkuara në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, të drejtat e azilkërkuesve dhe ato të refugjatëve, si dhe në praktikën më të mira nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian dhe të rajonit.

Menaxhimi i Integruar të Kufirit dhe siguria kufitare përbën një angazhim të veçantë në raport me legjislacionin në fuqi, situatën politike dhe sigurinë kombëtare të vendit, si dhe me marrëdhëniet ndërkombëtare, veçanërisht në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian, si dhe në organizmatë tjera ndërkombëtare.

Menaxhimi i Integruar të Kufirit (MIK) synon të garantojë një qarkullim ndërkufitar në mënyrë efektive dhe adresimin e sfidave migratore, kërcënimeve të mundshme ndaj sigurisë kufitare, duke kontribuar në:

- parandalimin dhe goditjen e krimeve të rënda me dimension ndërkufitar siç janë: trafiket e paligjshme, kontrabandimi i migrantëve, trafikimi i qenieve njerëzore, terrorizmi, kontrabanda;
- parandalimin e krimeve mjedisore;
- parandalimin, zbulimin dhe reagimin ndaj kërcënimeve ndërkufitare në fushën shëndetësore;
- garantimin e një niveli të lartë të sigurisë së brendshme duke kontribuar në këtë mënyrë në stabilitetin e vendeve fqinje dhe të vendeve të tjera;
- respektimin e plotë të të drejtave themelore të qytetarëve.

Strategjia ka për qëllim të përcaktojë politikat e duhura për të përmirësuar më tej:

- standardet e sigurisë kufitare, nëpërmjet përmirësimit të mëtejshëm të kuadrit ligjor dhe rregullator me synim përafrimin me *acquis communautaire*;
- kapacitetet e analizës së riskut;
- kapacitetet e reja dhe përmirësimin e mëtejshëm të kapaciteteve teknologjike të kontrollit dhe mbikëqyrjes së kufirit;
- forcimin e mëtejshëm të burimeve njerëzore dhe kapaciteteve operacionale e profesionale të autoriteteve kompetente dhe agjencive që operojnë në kufi, me qëllim parandalimin dhe goditjen e krimit ndërkufitar;

⁶⁸Technical and Operational Strategy for European Integrated Border Management, miratuar me vendimin nr. 2/2019 të Bordit të Menaxhimit të Agjencisë Evropiane të Rojës Kufitare dhe Bregdetare (FRONTEX).

⁶⁹Guidelines for Integrated Border Management in European Commission External Cooperation, November 2010.



- forcimin e mëtjshëm të bashkëpunimit ndërkufitar (me vendet fqinje, vendet e rajonit, vendet anëtare të Bashkimit Evropian dhe agjencitë e tij, si dhe me organizatat ndërkombëtare);

- konsolidimin dhe riorganizimin e strukturave të integruara në kufi;

- forcimin e kapaciteteve dhe koordinimin e bashkëveprimit ndërinstitucional për kërkimin dhe shpëtimin e shtetasve në situatë të rrezikshme në det;

- vendosjen e një mekanizmi të kontrollit të cilësisë dhe të respektimit rigoroz të të drejtave themelore të njeriut.

Menaxhimi i Integruar i Kufirit është bashkërendimi dhe bashkëpunimi kombëtar dhe ndërkombëtar ndërmjet të gjitha autoriteteve dhe agjencive, të përfshira në sigurinë kufitare dhe lehtësimin e tregtisë, me qëllim përsosjen e sistemeve të efektshme dhe me rendiment të Menaxhimit të Integruar të Kufirit, me synimin e arritjes së qëllimit të përbashkët të kufijve të hapur, por të kontrolluar dhe të sigurt.

Implementimi i filozofisë së Menaxhimit të Integruar të Kufirit është jetik për ruajtjen e sigurisë së brendshme, për parandalimin e imigracionit të parregullt, parandalimin dhe goditjen e krimit ndërkufitar dhe për sigurimin e qarkullimit legjitim, të lehtësuar të udhëtarëve dhe mallrave, si dhe parandalimin e kërcënimeve ndërkufitare të shëndetit publik. Në këtë mënyrë, koncepti i Menaxhimit të Integruar të Kufirit siguron efikasitet me kosto-efektive në menaxhimin e kufijve dhe kontrollin e qarkullimit të shtetasve dhe mallrave.

Komponentët kryesorë të Menaxhimit të Integruar të Kufirit janë:

- Kontrolli dhe mbikëqyrja e kufirit;

- Kërkim–shpëtimi në situata që mund të ndodhin gjatë operacioneve të mbikëqyrjes së kufirit;

- Parandalimi dhe goditja e krimit ndërkufitar;

- Analiza e riskut;

- Bashkëpunimi ndërkufitar dhe ndërkombëtar;

- Bashkëpunimi ndëragjenci;

- Masat teknike dhe operacionale për kontrollin e territorit;

- Aftësia për të reaguar në situata të papritura;

- Kthimi i shtetasve me qëndrim të parregullt;

- Përdorimi i teknologjisë moderne për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit;

- Mekanizmi i kontrollit të cilësisë;

- Mekanizmat e solidaritetit.

Komponentët horizontal të Menaxhimit të Integruar të Kufirit janë:

- Të drejtat themelore të individit;

- Edukimi dhe trajnimi;

- Inovacioni.

Qëllimet e politikave të Strategjisë Ndërsektoriale të Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021–2027 janë zhvillimi i një sistemi të integruar të administrimit të kufijve në përputhje me sistemin evropian të mbikëqyrjes kufitare dhe rritja e sigurisë kufitare duke përmirësuar bashkëpunimin në të gjitha nivelet dhe forcimin e kapaciteteve administrative, infrastrukturore dhe teknike



Nevoja për Strategjinë e Menaxhimit të Integruar të Kufirit

Strategjia Ndërsektoriale e Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021–2027 dhe plani i veprimit 2021–2027 në zbatim të saj, vjen si një nevojë për rinovimin e Strategjisë së Menaxhimit të Integruar të Kufirit dhe planit të veprimit 2014 – 2020, e cila është gjithashtu pjesë e masave të Planit Kombëtar të Integritimit Evropian.

Duke pasur parasysh që rregullorja e re e BE-së, e cila hyri në fuqi në 4 dhjetor 2019, modifikoi pjesërisht konceptin e MIK të BE-së, ishte e nevojshme të përafrohej më tej Strategjia. Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Kufijve dhe plani i veprimit janë në përputhje me konceptin më të fundit të BE-së për MIK dhe me Strategjinë Evropiane Teknike dhe Operacionale të Menaxhimit të Integruar të Kufirit.

Dokumenti strategjik është gjithashtu në përputhje me angazhimet në kuadër të procesit të integritimit dhe hapjes së negociatave për anëtarësim në BE, kryesisht në pjesën që lidhet me:

- Rekomandime nga raporti i Komisionit Evropian për Republikën e Shqipërisë, për kapitullin 24, për Kufirin e Jashtëm dhe në zonën *Schengen*-in;

- Rregulloren (BE) 2019/1896, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, e 13 nëntorit 2019, për Faqe | 1384

Agjencinë Evropiane të Rojës Kufitare dhe Bregdetare;

- Kodin i kufijve të zonës *Schengen* dhe katalogun e azhurnuar të *Schengen*-it të BE-së;

- Rekomandimet dhe praktikat më të mira për mbikëqyrjen e kufijve të jashtëm, kthimin dhe ripranimin (Këshilli i Bashkimit Evropian nr. 7864/09);

- Strategjinë Evropiane Teknike dhe Operacionale të Menaxhimit të Integruar të Kufirit;

- Sistemi Evropian i Mbikëqyrjes së Kufijve (EUROSUR).

Vëmendje e veçantë iu kushtua përafrimit të Strategjisë me rregulloren (BE) 2019/1896, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 13 nëntorit 2019, “Për krijimin e një Kufiri Evropian dhe Rojës Bregdetare” dhe “Strategjinë Evropiane Teknike dhe Operacionale të Menaxhimit të Integruar të Kufirit”, në mënyrë që të sigurohet një menaxhim i integruar evropian i kufijve të jashtëm, si dhe menaxhimin e kufijve të saj, në përputhje me të drejtat themelore dhe përparimin e politikës së kthimit të unionit.

Republika e Shqipërisë, si një vend kandidat për anëtarësim në BE, është përpjekur të harmonizojë konceptin e saj të MIK me kërkesat e BE-së në fazën e pranimit, megjithëse, në këtë fazë të



integritimit, nuk është e mundur të implementohen plotësisht të gjithë përbërësit strategjikë të MIK-ut Evropian. Megjithatë, Shqipëria mbetet e gatshme për të zbatuar plotësisht këtë koncept me hyrjen e Republikës së Shqipërisë në BE.

Strategjia është e përgatitur në përputhje me standardet e BE-së, duke marrë parasysh edhe elemente shtesë kombëtar të rëndësishëm për MIK-un, në mënyrë që Strategjia të jetë funksionale dhe ndërvepruese me atë evropiane.

Zbatimi i masave të përcaktuara, në periudhën 2021 – 2027, është i rëndësishëm për forcimin e mëtejshëm të sigurisë kufitare, lehtësimin e qarkullimit ndërkufitar të shtetasve dhe mallrave, arritjen e kriterëve të Sistemit Evropian të Sigurisë, për forcimin e aftësisë për të marrë përsipër detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi në BE, si dhe për të përmbushur kërkesat e *Schengen-it*.

Burimet e nevojshme financiare për zbatimin e masave të Strategjisë së MIK-ut do të planifikohen brenda planeve të veprimit dhe do të vendosen në baza vjetore, brenda buxhetit aktual dhe kapitalit të Republikës së Shqipërisë, për nevojat e ministrive dhe autoriteteve të tjera administrative kompetente, për zbatimin e planit të veprimit, siç sugjerohet në përfundimet në lidhje me shqyrtimin dhe miratimin e Strategjisë dhe planit të veprimit 2021–2027. Dinamika e sigurimit të fondeve gjithashtu do të varet nga gatishmëria e bashkësisë ndërkombëtare për të aprovuar mbështetjen e donatorëve në kuadrin e fondeve ndërkombëtare të ndihmës së paraaderimit për zbatimin e masave konkrete, si dhe dinamikën e proceseve integruese të Republikës së Shqipërisë. Shumica e veprimtarive të organeve me kompetencë në zbatimin e Strategjisë dhe planit të veprimit, kornizë në këtë fushë, do të realizohen brenda aktiviteteve të rregullta të këtyre autoriteteve.

Metodologjia

Siç është shpjeguar në nënkapitullin 2, kuadri ligjor dhe institucional në fuqi dhe lidhja me dokumentet dhe prioritetet strategjike të këtij dokumenti, përputhet plotësisht me dokumentet strategjike në nivel ndërkombëtar e kombëtar të miratuar nga Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave duke bërë që vizioni, objektivat strategjike dhe specifike të parashikuara të përputhen plotësisht me këto dokumente strategjike.

Nisma për hartimin e kësaj Strategjie është ndërmarrë nga Ministria e Brendshme si institucion

përgjegjës për fushën e menaxhimit të integruar të kufijve, bazuar kjo dhe në fushën e saj të përgjegjësisë të rregulluar me vendimin nr. 502, datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme”.

Ministria e Brendshme, dhe institucione të tjera si: Ministria e Financave dhe Ekonomisë – Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural – Autoriteti Kombëtar i Ushqimit; Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale – Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor; Ministria e Mbrojtjes – Forca Detare/Roja Bregdetare – Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile; Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme – Drejtoria e Çështjeve Konsullore; Ministria e Drejtësisë; Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë – Drejtoria e Përgjithshme Detare; Ministria e Turizmit dhe Mjedisit; Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë; Ministria e Kulturës; Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD); Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale kanë dhënë kontribut të veçantë gjatë procesit të hartimit të kësaj Strategjie.

Në hartimin e këtij dokumenti, krahas infrastrukturës ligjore, programeve të ndryshme shtetërore, në analizën për vlerësimin e gjendjes dhe planifikimin e prioritetëve, objektivave dhe alternativave të zhvillimit për të ardhmen, janë marrë në konsideratë të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, aktet ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë, si dhe rekomandimet e Komisionit Evropian.

Dokumenti është shpërndarë për konsultim publik në faqen e Kryeministrisë për Konsultim publik, në fillim të dhjetorit 2020, në adresën: <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/311>.

2. Kuadri ligjor, institucional, arritjet dhe lidhja me dokumentet dhe prioritetet strategjike

Zbatimi efektiv i Strategjisë së Menaxhimit të Integruar të Kufijve 2014 – 2020, ishte i rëndësishëm për përafrimin me Sistemin Evropian të Sigurisë, jetësimin e angazhimeve të Shqipërisë që rrjedhin nga procesi i anëtarësimi në BE, si dhe



nevojave për forcimin e sigurisë kombëtare, rajonale dhe më gjerë. Kjo Strategji u vlerësua në përputhje të plotë me standardet evropiane.⁷⁰

Qëllimi i përgjithshëm strategjik i Qeverisë Shqiptare për Menaxhimin e Integruar të Kufijve, ishte përsosja e Sistemit të Sigurisë Kufitare, duke arritur përafrimin e plotë me atë të vendeve anëtare të BE-së, ndërsa qëllimi specifik i Strategjisë së MIK ishte konsolidimi i arritjeve në fushën e Menaxhimit të Integruar të Kufirit për përmirësimin e sigurisë së kufirit, lehtësimin e lëvizjes së shtetasve dhe shkëmbimeve tregtare, në mënyrë që të garantohen kufijtë e hapur dhe të sigurt, në funksion të përmirësimit të cilësisë së jetës së qytetarëve.

Objektivat e Strategjisë dhe planit të veprimit (2014–2020) janë realizuar dhe përparim i mirë mund të vërehet në lidhje me arritjen e të gjitha objektivave individuale të përcaktuara në Strategji.

Ky proces u pasua nga një seri aktivitete të ndërmarra në bashkëpunim me Bashkimin Evropian, me prioritetet e mëposhtme:

- harmonizimi i legjislacionit me *acquis* të BE-së;
- përfundimi i marrëveshjeve bilaterale për kufirin shtetëror, vendkalimet kufitare dhe trafikun kufitar;

- nënshkrimi i marrëveshjeve bilaterale të bashkëpunimit policor dhe protokolleve për patrullime të përbashkëta;

- harmonizimi i konceptit organizativ dhe të personelit;

- modernizimi dhe përmirësimi i sistemeve të arsimit dhe të aftësimin, si dhe ngritja e nivelit të profesionalizmit të oficerëve të kufirit;

- përmirësimi i sistemit të informacionit dhe infrastrukturës kufitare;

- prokurimi i pajisjeve teknike të nevojshme për kryerjen e kontrolleve kufitare dhe mbikëqyrjen kufitare;

- krijimi dhe përditësimi i analizës së rrezikut dhe shkëmbimi i informacionit në përputhje me një model të përbashkët të analizës së rrezikut;

- forcimi i aftësive për të luftuar korrupsionin dhe forcimi i kornizës ligjore dhe mekanizmave për bashkëpunim dypalësh dhe shumëpalësh.

Ky dokument strategjik është i ndërlidhur, kontribuon dhe i bazuar në parimet që rrjedhin nga dokumente strategjike kombëtare dhe ndërkombëtare, si më poshtë:

- Programi qeverisës për periudhën 2017–2021;
- Prioritetet e Qeverisë që lidhet me Rendin dhe Sigurinë Publike;

- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2015–2020; kapitulli “Qeverisja e Mirë, Demokracia dhe Shteti i së Drejtës”, e lidhur me objektivat e mëposhtme:

1. Forcimin e forcës zbuluese në luftën kundër krimit ndërkufitar nëpërmjet:

- rritjes së shkallës së zbulimit të trafikimit të paligjshëm;

- rritjes së shkallës së zbulimit dhe eliminimit të tregtisë së lëndëve narkotike.

2. Rritjen e profesionalizmit dhe aftësive teknike për zbulimin dhe luftën kundër përdorimit të dokumenteve të falsifikuara për kalimin e kufirit.

3. Përmirësimin e standardeve të kontrollit dhe mbikëqyrjes përmes standardizimit të Pikave të Kalimit të Kufirit (PKK) sipas standardeve të BE-së dhe Kodit *Schengen*.

4. Parandalimin dhe pakësimin e rasteve të migrimit të paligjshëm dhe të qytetarëve të huaj që kapen në territorin e Shqipërisë me dokumente të parregullta, përmes:

- kryerjes së analizave të sakta të riskut;

- dislokimit të forcave në zonat më problematike; dhe

- furnizimit me pajisje moderne për parandalimin e migracionit të paligjshëm.

5. Parandalimin dhe uljen e migracionit të paligjshëm nëpërmjet:

- rritjes së shkallës së zbulimit dhe eliminimit të migracionit të paligjshëm;

- uljes së rasteve të migracionit të paligjshëm dhe të qytetarëve të huaj të kapur në territorin e Shqipërisë me dokumente të parregullta;

- monitorimit të flukseve të migracionit përmes analizave mujore dhe vjetore të riskut në përputhje me standardet e FRONTEX-it.

- monitorimit të fluksit të migracionit nëpërmjet analizave mujore dhe vjetore të riskut në përputhje me modelin e CIRAM-it; dhe

⁷⁰Commission staff working document Albania 2015 report, accompanying the document communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions; <http://integrimi-ne-be.puneteshqiptme.gov.al/anetaresimi-ne-be/dokumente/dokumente-te-be/>.



- forcimit të bashkëpunimit me vendet fqinje në parandalimin dhe luftimin e migracionit të parregullt të qytetarëve shqiptarë dhe të shtetasve të vendeve të treta, në kuadër të marrëveshjeve ekzistuese dypalëshe, Konventës së Bashkëpunimit Policor për Evropën Juglindore dhe iniciativat rajonale.

6. Forcimin e përgjithshëm të kapaciteteve të Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare.

- **Lidhja me PKIE-n dhe legjislacionin e BE-së (kapitulli 24 – Drejtësia, Liria dhe Siguria, nënkupitulli: Kufijtë e jashtëm).** Kjo Strategji nuk përafuron në vetvete një akt të legjislacionit të Bashkimit Evropian, por do të shërbejë si instrument për adresimin e rekomandimeve të Bashkimit Evropian për përafrimin me *acquis communautaire* të BE-së, për fushën e rendit dhe sigurisë publike.

Politikat dhe objektivat specifike të Strategjisë Ndërsektoriale të Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021–2027 dhe plani i veprimit 2021–2023, janë gjithashtu, në përputhje me “Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ/SDG) dhe Agjendës 2030”, respektivisht:

OZHQ 10: Zvogëlimi i pabarazisë brenda dhe ndërmjet vendeve.

Qëllimi 10.7: Lehtësimi i migrimit të organizuar, të sigurt, të rregullt dhe të përgjegjshëm dhe lëvizshmërinë e njerëzve, duke përfshirë zbatimin e politikave të planifikuara dhe mirë të menaxhuara të migracionit.

2.1 Analiza dhe arritjet

Në fushën e Menaxhimit të Integruar të Kufirit, Shqipëria, gjatë viteve 2014 – 2020, ka realizuar progres të vazhdueshëm në të gjithë komponentët përbërës të MIK, si: në fushën e përmirësimit të kuadrit ligjor, të organizimit dhe të menaxhimit të agjencive kufitare, të rritjes së kapaciteteve administrative dhe profesionale të strukturave, të zbatimit të procedurave standarde të punës, të zbatimit të programeve të trajnimit dhe kurrikulave, të përmirësimit të infrastrukturës dhe teknologjisë së informacionit, në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve, lehtësimi të shkëmbimeve tregtare, dhe në drejtim të forcimit të goditjes së aktivitetit të paligjshëm nëpërmjet kufirit shtetëror dhe rritjes së sigurisë kufitare.

Komisioni Evropian ka vlerësuar në vazhdimësi përparimin e bërë në lidhje me Menaxhimin e Integruar të Kufirit, por sfidat për MIK në Shqipëri

kërkojnë përmirësime të mëtejshme brenda agjencive të kufirit, si dhe në bashkëpunimin ndëragjenci e ndërkombëtar. Me konkretisht do të përmendim sa më poshtë:

- Përmirësime të mëtejshme të kuadrit ligjor rregullator, të strukturave të agjencive kufitare, të procedurave të punës, të burimeve njerëzore dhe trajnimeve, të shkëmbimit të informacionit dhe të infrastrukturës dhe pajisjeve me qëllim përafrimin me standardet e Bashkimit Evropian dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare;

- Forcimi i bashkëpunimit ndëragjenci në funksion të rritjes së cilësisë dhe shpejtësisë së shkëmbimit të informacionit, procedurave për kontroll të përbashkët, analizës së përbashkët të riskut për komponentë të caktuar në kontrollin kufitar, në përdorimin e përbashkët të infrastrukturës kufitare dhe pajisjeve, si dhe në zhvillimin e mëtejshëm të programeve të përbashkëta të trajnimit për personelin e agjencive kufitare.

Përmirësimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ndërkombëtar, për të zbatuar një zinxhir masash në luftën e autoriteteve kufitare ndaj aktiviteteve të kundërligjshme nëpërmjet kufirit përfshirë dhe terrorizmin.

Kuadri ligjor rregullator

Në zbatim të objektivave strategjike dhe të masave të parashikuara në planin e veprimit të Strategjisë së Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2014 – 2020, janë përmbushur të gjitha nënobjektivat e parashikuara, duke realizuar në total gjithë paketën ligjore për kontrollin kufitar, duke u përafruar me legjislacionin komunitar të menaxhimit të kufirit. Për pasojë u përgatitën dhe u miratuan aktet ligjore si më poshtë:

- Ligji nr.71/2016, “Për kontrollin kufitar”⁷¹;

- Ligji nr.102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”;

- Ligj nr. 22/2020, “Për disa shtesa në ligjin nr. 71/2016, ‘Për kontrollin kufitar’”⁷²;

⁷¹ Përafruar pjesërisht me rregulloren (BE) 2016/399, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 9 mars 2016, “Mbi Kodin e Bashkimit Evropian që përcakton rregullat e regjimit të lëvizjes së personave përmes kufijve (Kodi i Kufijve Schengen)”.

⁷² Ky ligj është përafruar pjesërisht me direktivën 2004/82/KE, të Këshillit të Evropian, të datës 29 prill 2004, mbi detyrimin e transmetimit të të dhënave të pasagjerit dhe direktivën e BE-së 2016/681, të Parlamentit dhe Këshillit, datë 27.4.2016, mbi përdorimin e të dhënave



- Ligji nr. 74/2016, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 108/2013, ‘Për të huajt’”⁷³,

- Ligji nr. 121/2014, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”; udhëzimi nr. 293/2015, i ministrit të Brendshëm, “Për procedurat e trajtimit të të huajve me qëndrim të parregullt në Shqipëri”;

- Ligji nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”;

- Ligji nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”;

- Udhëzimi i përbashkët nr. 515, datë 27.9.2016, i ministrit të Punëve të Brendshme dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit e Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Për përpunimin e të dhënave personale nga Roja Kufitare”;

- Vendimi nr. 729, datë 20.10.2016, “Për përcaktimin e tabelave dhe simboleve në pikat e kalimit kufitar dhe zonat e verifikimit kufitar”;

- Vendimi nr. 745, datë 26.10.2016, “Për kryerjen e verifikimeve të përbashkëta kufitare”;

- Vendimi nr. 806, datë 16.11.2016, “Për përcaktimin e rregullave të verifikimit kufitar që zbatohen për kategori të caktuara të personave dhe mjeteve”;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 824, datë 23.11.2016, “Për përcaktimin e formatit dhe të specifikimeve teknike të vulave të verifikimit kufitar dhe të rregullave të vendosjes së tyre në dokumentet e udhëtimit gjatë hyrje/daljeve në kufirin shtetëror”;

- Udhëzimi i ministrit të Brendshëm nr. 469, datë 22.8.2016, “Për listën e pikave të kalimit kufitar dhe zonave transit në Republikën Shqipërisë”;

- Udhëzim i ministrit të Brendshëm nr. 579, datë 20.10.2016, “Për informacionin që u jepet personave të cilët janë subjekt i verifikimeve të vijës së dytë në pikat e kalimit kufitar”;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 441, datë 15.6.2016, “Për miratimin e formës dhe të përmbajtjes së lejes së qëndrimit për të huajt”;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 442, datë 15.6.2016, “Për caktimin e elementeve të sigurisë dhe miratimin e formës dhe të modelit të dokumenteve të udhëtimit për të huajt”;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 651, datë 10.11.2017, “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 104, datë 31.7.2014, ‘Kodi Doganor i RSH-së’”;

- VKM-ja nr. 439, datë 13.5.2011, “Për miratimin e dokumentit ‘Politikat dhe procedurat e funksionimit të Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD)’”;

- Urdhri nr. 1146/2014, i ministrit të Brendshëm “Për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin nr. 851/2009, ‘Për miratimin e procedurave standarde të punës për kufirin dhe migracionin’”.

- VKM-ja nr. 729, datë 13.11.2019, “Për miratimin e Planit Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit në Republikën e Shqipërisë dhe planit të veprimit të tij”.

Në përmbushje të objektivave janë rishikuar marrëveshjet me vendet fqinje për PKK-n duke i kthyer ato në pika të përbashkëta të kalimit kufitar; është nënshkruar memorandum bashkëpunimi mes PSH-së dhe TIA-s, i cili është në përputhje me Programin Kombëtar të Sigurisë në Aviacion; janë miratuar aktet ligjore dhe masat plotësuese për kontrollin e territorit; si dhe është përmirësuar legjislacioni kombëtar në lidhje me shkëmbimin efikas të informacionit ndërmjet agjencive kufitare dhe ndërmjet agjencive të tjera ligjzbatuese dhe mbrojtjen e të dhënave.

Në përmbushje të masave të parashikuara në MIK, janë hartuar akte nënligjore që kanë rregulluar bashkëpunimin ndërmjet agjencive të përfshira në të, për shkëmbimin e informacionit, analiza risku, shërbime, operacione dhe hetime të përbashkëta. Në këtë kuadër është përmirësuar

të regjistrimit të emrit të pasagjerit (PNR) me qëllim parandalimin, zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale veprave me qëllime terroriste dhe krimeve të rënda.

⁷³ Ky ligj është i përafuar pjesërisht me direktivën 2014/66/BE, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 15 maj 2014, “Mbi kushtet e hyrjes dhe të qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta në kuadër të transferimit brenda ndërmarrjes”; direktivën 2014/36/BE, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 26 shkurt 2014, “Mbi kushtet e hyrjes dhe të qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta për qëllime punësimi si punonjës sezonal”; direktivën e Këshillit 2009/50/KE, datë 25 maj 2009, “Mbi kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta me qëllim pune tepër të kualifikuar”; direktivën 96/71/KE, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 16 dhjetori 1996, “Në lidhje me transferimin e punëtorëve në kuadër të ofrimit të shërbimeve”.



mekanizmi i monitorimit të hapësirës detare dhe është rritur goditja e aktivitetit të kundërligjshëm.

Gjithashtu është përmirësuar kuadri legjislativ për funksionimin e QNOD-it, me qëllim përsosjen e koordinimit ndërinstitucional për monitorimin e hapësirës detare dhe kryerjen e operacioneve të përbashkëta të zbatimit të ligjit në det.

Këto akte ligjore dhe nënligjore janë hartuar duke u bazuar në rekomandimet e BE-së dhe në Standardet Schengen, të parashikuara në Strategjinë për Menaxhimin e Integruar të Kufirit 2014–2020.

Procedurat

Në fushën e procedurave u zhvilluan dhe u përmirësuan procedurat standarde të punës nga agjencitë e përfshira në MIK. Në përmbushje të objektivave janë miratuar “*Procedurat Standarde të Punës*” për të gjitha strukturat e Departamentit për Kufirin dhe Migracionin, bazuar me ligjin nr. 71/2016, “*Për kontrollin kufitar*”, dhe në Manualin Schengen për PKM-n. Këto procedura janë përmirësuar dhe përditësuar me ndryshimet e Kodit Schengen.

Gjithashtu, u përmirësuan procedurat doganore për të lehtësuar shkëmbimet tregtare dhe marrjen nga ky shërbim të përgjegjësive në fushën e sigurisë kufitare. Në kuadër të funksionimit të QNOD-it, për koordinimin e punës midis agjencive ligjzbatuese, janë miratuar “*Politikat dhe Procedurat e Funksionimit të Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare*”.

Këto procedura janë në zhvillim sipas konceptit dhe detyrimeve që rrjedhin nga iniciativa e Schengenit Ballkanik dhe të rregullores së Agjencisë për Kufirin Evropian dhe Rojën Bregdetare.

Bashkëpunimi në përgjithësi dhe bashkëpunimi ndërkombëtar në veçanti është realizuar me partnerët ndërkombëtarë, në përputhje të plotë me standardet e vendeve të BE-së. Aktiviteti i kundërligjshëm identifikohet dhe shkëmbehet me vendet e tjera, duke siguruar veprime të përbashkëta për goditjen e tij. Gjithashtu janë hartuar procedura të përbashkëta për shkëmbimin e informacionit, operacionet dhe hetimet e përbashkëta, janë miratuar procedurat standarde për largimin/dëbimin e shtetasve të huaj me qëndrim të parregullt në Shqipëri, si dhe është krijuar një mekanizëm për kontrollet e kontejnerëve në porte.

Në qëllimet strategjike për bashkëpunimin ndërmjet agjencive të Policisë Kufitare dhe Migracionit, Shërbimit Doganor Shqiptar, Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Shërbimit Sanitar Antiepidemik dhe agjencive të tjera të përfshira në MIK, është parashikuar ngritja e një Qendre Kombëtare Koordinimi për Menaxhimin e Integruar të Kufirit. Për shkak të mungesës së fondeve, kjo qendër nuk është bërë e mundur të krijohet. Si pasojë nuk është realizuar as nënobjektivi për hartimin e procedurave të punës për mekanizmin e Koordinatorit Kombëtar të MIK dhe as për Qendrën. Nisur nga domosdoshmëria e menaxhimit të integruar të sistemeve teknologjike, të pajisjeve tjera speciale, si dhe të të gjitha shërbimeve të agjencive të përfshira, ky mbetet një ndër objektivat kryesore në Strategjinë e re.

Gjithashtu, nuk janë hartuar procedurat e përbashkëta për Qendrën Rajonale të Monitorimit të Hapësirës Detare në bashkëpunim me palët pjesëmarrëse dhe me asistencën ndërkombëtare, sepse nuk është krijuar Qendra për mungesë fondesh.

Sa më sipër, miratimi i legjislacionit të ri për kufirin dhe migracionin u ndoq nga miratimi i procedurave të reja standarde të punës në këto fusha, të cilat u përshtaten plotësisht me legjislacionin e ri, si më poshtë:

- Urdhri nr. 163, datë 8.2.2018, “Procedura e punës për organizimin, planizimin dhe kryerjen e shërbimit në SPK&M, sipas situatës dhe analizës së riskut”;

- Urdhri nr. 164, datë 8.2.2018, “Procedurat e punës për mbikëqyrjen e kufirit”;

- Urdhri nr. 165, datë 8.2.2018, “Procedurat e punës për verifikimin kufitar në PKK e PPKK-së”;

- Urdhri nr. 166, datë 8.2.2018, “Procedurat e punës për verifikimin e trafikut tokësor, trafikut ajror, detar e liqenor në kufi”;

- Urdhri nr. 167, datë 8.2.2018, “Procedura e punës për lehtësimin e verifikimeve kufitare”;

- Urdhri nr. 168, datë 8.2.2018, “Procedura standarde për refuzimin e hyrjes në kufi të RSH-së, të shtetasit të huaj”;

- Urdhri nr. 169, datë 8.2.2018, “Procedurat standarde të punës për refuzimin e daljes së shtetasve shqiptarë dhe të huaj në kufi”;



- Urdhri nr. 175, datë 8.2.2018, “Procedurat e regjistrimit në sistemin TIMS të verifikimit që kryhet për kontrollin e hyrje/daljeve”;

Urdhri nr. 170, datë 8.2.2018, “Procedurat standarde për trajtimin e shtetasve të huaj me leje qëndrimi”;

- Urdhri nr. 171, datë 8.2.2018, “Procedurat standarde e punës për lëshimin e vizave në kufi dhe anulimin e tyre”;

-Urdhri nr. 172, datë 8.2.2018, “Procedurat standarde për përzgjedhjen e shtetasve të huaj të parregullt dhe masat që merren”;

- Urdhri nr. 173, datë 8.2.2018, “Procedurat standarde për zgjatjen e qëndrimit mbi afatin e përcaktuar ligjor të shtetasit të huaj”;

- Urdhri nr. 174, datë 8.2.2018, “Procedurat standarde për vlerësimin e aplikimeve për vizë në Shqipëri të shtetasve të huaj”;

- Urdhri nr. 176 datë 8.2.2018 “Procedurat standarde për largimin/dëbimin e shtetasit të huaj me qëndrim të parregullt në RSH”;

- Urdhri nr. 1294/1, datë 17.5.2016, “Procedura e punës për zbulimin e lëndëve radioaktive”;

- Urdhri nr. 18378, datë 8.8.2017, “Procedurat standarde të punës që drejtojnë përzgjedhjen dhe skanimin e bazuar në risk të ngarkesave dhe mjeteve të transportit që kalojnë kufijtë e Republikës së Shqipërisë me anë të skanerëve fiks dhe të lëvizshëm”;

- Ligji nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, i ndryshuar;

- Ligji nr. 16/2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9863, datë 28.1.2008, ‘Për ushqimin’ i ndryshuar”;

- Ligji nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

- Ligj nr. 18/2018, “Për ratifikimin e protokollit shtesë 5, të marrëveshjes për amendimin dhe aderimin në marrëveshjen e tregtisë së lirë të Evropës Qendrore”.

- Manuali për inspektimin fitosanitar në pikat e kalimit kufitar nr. 4635, datë 16.10.2006;

- VKM-ja nr. 403, datë 13.5.2015, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 654, datë 30.9.2009, të KM-s, “Për organizimin, strukturën, funksionimin e QNOD-it dhe bashkëveprimin me institucionet shtetërore që kanë interesa në det, të ndryshuar”;

- VKM-ja nr. 585, datë 1.7.2015, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 439, datë

13.5.2011, të KM-s ‘Për miratimin e dokumentit ‘Politikat dhe procedurat e funksionimit të QNOD-it’”’.

Menaxhimi dhe organizimi (kuadri institucional)

Në drejtim të menaxhimit dhe organizimit (kuadrit institucional), u konsolidua struktura e Policisë Kufitare dhe Migracionit, sipas rekomandimeve dhe e bazuar në objektivat e Strategjisë, si dhe struktura e analizës së riskut dhe sektori i hetimit, e cila është ndryshuar dhe përmirësuar. Shërbimi i analizës së riskut dhe të hetimit është shtrirë në të gjitha drejtoritë vendore. Organizmi i ri strukturor u propozua dhe miratua në përputhje me praktikat më të mira të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian.

Me urdhrin nr. 177, datë 18.3.2018, të ministrit të Brendshëm, është miratuar struktura e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, përfshirë këtu edhe strukturën e Departamentit për Kufirin dhe Migracionin, ndërsa, me urdhrin nr. 328/1, datë 2.5.2018, të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit është miratuar struktura dhe përbërja organike e drejtorive vendore për kufirin dhe migracionin. Në kuadër të miratimit të strukturës së re dhe përbërjes organike, janë ngritur strukturat e zbatimit të masave plotësuese për kontrollin e territorit në nivel qendror dhe vendor.

Megjithatë, suprimimi i strukturave të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe logjistike, në vitin 2016, si dhe suprimimi i strukturave të hetimit në Policinë Kufitare dhe Migracionit, cenoi autonominë e këtyre strukturave, filozofi mbi të cilën u bë organizimi i tyre dhe nuk ishte në përputhje me rekomandimet e partnerëve ndërkombëtarë. Suprimimi i strukturave të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe logjistike solli paqartësi në menaxhimin e këtyre burimeve. Vështirësi të mëdha u hasën sidomos në përgatitjen dhe menaxhimin e dokumentacionit për burimet njerëzore, si dhe të donacioneve të shumta në mbështetje të shërbimeve të Policisë Kufitare dhe Migracionit. Suprimimi i strukturave të hetimit shkaktoi humbjen e aftësive operacionale në fushën e krimit ndërkufitar, për veprat penale që mbuloreshin nga këto struktura dhe ishte në kundërshtim me rekomandimet e progresraportit të Komisionit Evropian të vitit 2016, ku nënvizohet se, “...Kompetencat hetimore të policisë kufitare duhet të



forvohen, në mënyrë të veçantë për zbulimin e personave të kontrabanduar dhe rastet e trafikimit”.

Gjithsesi, struktura aktuale ka garantuar funksionimin operacional të strukturave qendrore dhe vendore për kufirin dhe migracionin. Struktura e PKM-së ka lehtësuar bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit brenda saj, ndërmjet agjencive dhe në nivel ndërkombëtar.

Në funksion të çështjes së kontrollit civil mbi operacionet detare dhe harmonizimin e marrëdhënieve midis institucioneve që kanë përgjegjësi dhe interesa në det, u konsolidua Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare.

Në përmbushje të masave të MIK, janë realizuar dhe implementuar ndryshimet në strukturë. Megjithatë problem mbetet moshja mesatare e lartë e stafit të policisë kufitare dhe migracionit (*aktualisht rreth 50 vjeç*). Për këto arsye rritja e numrit të rojeve kufitare dhe konsolidimi i mëtejshëm i strukturës mbetet objektiv për t'u përfshirë në Strategjinë e re, në zbatim kjo edhe të rekomandimit të progresraportit të Komisionit Evropian dhe të ekspertëve të misioneve të BE-së.

Gjithashtu në përmbushje të masave të MIK, janë krijuar dhe funksionojnë GLO-të (grupet e lëvizshme operacionale) në çdo drejtori vendore, të cilat kryejnë, krahas patrullave të zakonshme, kontrollin dhe monitorimin e territorit në bazë dhe të informacioneve shtesë të marra në rrugë ligjore për veprimtari të k/ligjshme.

Planëzimi elektronik i punës së Policisë Kufitare nuk është realizuar për shkak të mungesës së fondeve për vënien në funksionim të programit të përgatitur për këtë qëllim nga PAMECA.

Sistemi Blu Box për mjetet e peshkimit, aktualisht nuk funksionon, për mungesë të fondeve dhe menaxhimit të tyre. Ndërkohë, *Sistemi i Komunikimit Tetra* është funksional në të gjithë hapësirën detare, dhe po punohet për krijimin e bazës së të dhënave për mjetet lundruese, midis agjencive ligjzbatuese.

Gjithashtu, me qëllim të përmbushjes së veprimtarisë administrative, realizimit të misionit institucional dhe në funksion të rritjes së eficiencës në punë, për t'u përgjigjur sfidave të reja, me VKM-në nr. 9, datë 11.1.2017, është miratuar struktura e re organizative e Administratës Doganore Shqiptare. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave përbëhet nga 1.052 punonjës, të shpërndarë në nivel qendror dhe vendor.

Burimet njerëzore dhe trajnimi

Lidhur me këtë fushë, në Strategjinë aktuale u parashikuan aktivitete që kanë të bëjnë me rekrutimin dhe përzgjedhjen e personelit të agjencive që operojnë në kufi, bazuar në standardet e BE-së. Në përmbushje të objektivave të kësaj fushe nga agjencitë e kufirit bëhet menaxhimi i burimeve njerëzore dhe ndiqet ecuria e tyre në karrierë. Për vendet e punës bëhet përzgjedhja e personelit bazuar në kritere të mirëpërcaktuara dhe të miratuara.

Duke parë nevojën imediate për forcimin e kapaciteteve njerëzore të Policisë Kufitare dhe Migracionit, nevojë që u evidentua më së shumti gjatë periudhës së krizës migratore që preku edhe vendin tonë, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin bëri një studim të hollësishëm të nevojave për burimet shtesë, ku u theksua nevoja për shtimin e 500 funksioneve shtesë. Nga ana tjetër, nevoja për burime njerëzore shtesë ishte rekomanduar në vazhdimësi nga Komisioni Evropian, në progresraportet e tij ndër vite. Në progresraportin e Komisionit Evropian të vitit 2016 shkruhet: “...*Stafi i përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme për Kufirin dhe Migracionin është i limituar (1 653 punonjës), në veçanti kundër sfondit të krizës së migrimit që prek të gjithë rajonin*”.⁷⁴

Në muajin gusht të vitit 2020, në zbatim të urdhrit të ministrit të Brendshëm nr. 207, datë 30.7.2020, me urdhrin e drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 665, datë 1.8.2020, u miratuan shtesa prej 200 funksionesh të rolit bazë për Policinë Kufitare dhe Migracionit, ose 12% e numrit ekzistues të punonjësve të shërbimeve të policisë kufitare dhe migracionit.

Gjatë viteve në fjalë, për forcimin e kapaciteteve profesionale të Policisë Kufitare dhe Migracionit, personeli i PKM-së i është nënshtruar trajnimeve të ndryshme, në përgjigje të nevojave të saj, të reflektuara në planet vjetore të trajnimeve, por edhe trajnimeve të zhvilluara nga ekspertë të organizatave partnere.

⁷⁴ *Commission Staff Working Document, Albania 2016 Report Accompanying the document Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions, 2016 EU Enlargement Policy, {COM (2016) 715 final}; https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_albania.pdf; f. 69.*



Bazuar në Strategjinë e MIK, janë krijuar mekanizma trajnimi të cilat ndjekin ecurinë e trajnimeve të personelit të agjencive të kufirit. Për PKM-në ky aktivitet zhvillohet në bazë të Strategjisë së Trajnimeve, me qëllim përgatitjen për të qenë pjesë e operacioneve për kufijtë e jashtëm, pas pranimit në BE. Në këtë kuadër janë realizuar trajnime me strukturat e tjera të policisë, trajnime mes agjencive ndërkufitare.

Trajnimi i personelit të PKM-së bëhet në bazë të 30 kurrikulave të FRONTEX-it, të miratuara dhe të përditësuara me zhvillimet e reja të dokumenteve të BE-së për kufijtë e jashtëm. Në zbatim të programit vjetor zhvillohen trajnime 4-mujore për nivelin bazë dhe trajnime të avancuara 1-mujore.

Në muajin janar të vitit 2018, është miratuar kurrikula e trajnimit bazë e Policisë Kufitare dhe Migracionit, me shtrirje kohore prej tre muajsh, e cila është në përputhje të plotë me kurrikulën e përbashkët të FRONTEX-it (*Common Core Curricula*) dhe që është përgatitur në bashkëpunim me ekspertin afatgjatë të projektit PAMECA V, si anëtar i grupit të punës dhe njëkohësisht trajner në këtë trajnim. Rekrutët e rinj të Policisë Kufitare dhe Migracionit i nënshtrohen trajnimit bazë të Policisë Kufitare sipas kësaj kurrikule.


Gjithashtu, janë zhvilluar programe trajnimi për agjencitë që operojnë në kufi, të ofruara nga

donatorë ndërkombëtarë si: FRONTEX; DCAF; EXBS; OSCE; IOM, Policia Federale Gjermane; Policia Franceze; Policia Holandeze, etj.

Puna e PKM-së, përveç masave parandaluese nëpërmjet kontrolleve, analizave të fenomeneve dhe ndëshkimeve administrative dhe penale, monitorohet edhe nëpërmjet mbikëqyrjes, vëzhgimit e kontrollit me pajisje elektronike dhe sistemit TIMS. Megjithatë, për shkak të zhvillimeve teknologjike dhe procedurale, përditësimi i këtij sistemi mbetet objektiv për t'u përfshirë në Strategjinë e re.

Gjatë vitit 2018–2019, janë zhvilluar trajnime 2-4-6-javore, të personelit të Policisë Kufitare në Qendrën Stërvitore të Forcës Detare, nën drejtimin e instruktorëve të Rojës Bregdetare. Kurset e zhvilluara kanë qenë të fokusuara në certifikimin e personelit si drejtues i mjeteve detare, përdorimin e sistemeve elektromekanike dhe të komunikimit të anijes, si dhe planifikimit e pjesëmarrjes në një operacion kërkim-shpëtimi (SAR).

Gjatë periudhës 2014–2020 janë zhvilluar trajnime të ndryshme që kanë adresuar nevojat dhe prioritetet në drejtim të forcimit të kapaciteteve profesionale të shërbimeve për kufirin dhe migracionin. Konkretisht gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar 474 trajnime dhe seminare, me pjesëmarrjen e 4690 punonjësve të Policisë Kufitare dhe Migracionit.





Në zbatim të VKM-së nr. 921, datë 29.12.2014, “Për personelin e administratës doganore”, të ndryshuar, janë analizuar të gjithë kriteret kualifikuese të rekrutimit në administratën doganore dhe janë miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Mbi këto kriteret dhe përshkrime të punës mundësohet rekrutimi i kapaciteteve me performancë të lartë dhe kompetente.

Për rritjen e aftësisë profesionale dhe në përputhje me nevojat e punonjësve të Administratës Doganore janë zhvilluar trajnime nga drejtori të ndryshme në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave si: Drejtoria e Tarifës dhe Origjinës, Laboratorit Doganor, Procedurave Juridike, Mbrojtjes së Pronësisë Intelektuale, Auditit të Brendshëm, Vlerës Doganore dhe Departamenti i Akcizës, si dhe në bashkëpunim me institucione të tjera brenda vendit, ku mund të përmendet, ILDKPKI-ja, QTATD-ja (Qendra e Trajnimeve të Administratës Tatimore dhe Doganore); ASPA (Shkolla Shqiptare e Administratës Publike); DAP-i (Departamenti i Administratës Publike), Instituti i Fizikës Bërthamore; Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Mbrojtjes, Kryeministria, etj.

Gjithashtu edhe shumë institucione të tjera jashtë vendit kanë dhënë një kontribut të veçantë në trajnimin e punonjësve të Administratës Doganore Shqiptare. Vlen të përmendim: EXBS (Programi i Kontrollit të Eksporteve dhe Sigurisë Kufitare - Ambasada Amerikane); CROËN AGENTS, BE (Bashkimi Evropian); CEFTA (Central European Free Trade Agreement); IPA 2013 Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Taksave Indirekte Franceze; OBD (Organizata Botërore e Doganave); TAIEEX (Asistenca Teknike dhe Shkëmbimi i Informacionit në Komisionin Evropian); GIZ (Fondi i Hapur Rajonal për Promovimin e Tregtisë së Jashtme), UK *Border Force*, Doganat franceze etj. Gjatë periudhës 2014–2020 janë zhvilluar 461 trajnime dhe seminare, me pjesëmarrjen e 7267 punonjësve të Administratës Doganore.

Për sa i përket QNOD-it, me VKM të veçantë është miratuar struktura e saj. Në vitin 2016, në strukturën e QNOD-it u shtua sektori i Administratorëve të Sallës Operacionale, ndërsa në vitin 2018, sektori i IT-së i QNOD-it i kaloi AKSHIT. Ndryshimet strukturore në zbatim të

këtyre VKM-ve janë implementuar në vitin 2016 dhe 2018.

Me qëllim përmirësimin e koordinimit të veprimtarisë dhe ndërveprimit midis agjencive ligjzbatuese dhe trajnimit të personelit të këtyre agjencive, Roja Bregdetare organizon dhe zhvillon çdo vit stërvitjet “SAREX” dhe “IMPONIMI”. Stërvitja SAREX ka për qëllim njohjen e procedurave SAR, të përcaktuara në konventat ndërkombëtare dhe aktet ligjore kombëtare, koordinimin dhe unifikimin e veprimeve të agjencive kombëtare që veprojnë në hapësirën detare gjatë një operacion kërkim–shpëtimi (SAR) në det. Stërvitja IMPONIMI kryhet në bashkëpunim me të gjitha institucionet ligjzbatuese dhe me interesa në det, si dhe ka për qëllim trajnimin dhe rritjen e ndërveprimit ndërinstitucional në situatat e ndotjeve detare dhe zbatimin e ligjshmërisë në det.

Personeli i Rojës Bregdetare kryen trajnime vjetore në Qendrat e Trajnimit të Rojës Bregdetare në SHBA, Itali, Angli dhe Turqi.

Komunikimi, shkëmbimi dhe teknologjia e informacionit

Komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit u zhvillua në mënyrë të shpejtë në këtë periudhë. Vlen të përmendet informatizimi i të gjitha shërbimeve të kufirit dhe pajisja e tyre me mjete komunikimi. U miratuan akte administrative të brendshme dhe të përbashkëta. Gjithashtu janë përgatitur manuale përdorimi dhe procedura që lehtësojnë shkëmbimin e informacionit. Të gjitha PKK-t e Republikës së Shqipërisë janë të lidhura *online* me sistemin TIMS, një sistem ku policia kufitare evidenton hyrje/daljet në kufirin shtetëror dhe të gjithë problematikën që lind në kufi.

Sistemi TIMS ka vijuar të funksionojë në pothuajse të gjitha pikat e kalimit kufitar. Njohfimet e vendosur nga strukturat e ndryshme të Policisë së Shtetit dhe për llogari të agjencive të tjera të zbatimit të ligjit, ka forcuar ndjeshëm punën e Policisë Kufitare në kontrollin e qarkullimit të shtetasve, mjeteve dhe mallrave. Ndërfajja me sistemin ASF2 të INTERPOL-it ka vijuar të jetë një mjet i pazëvendësueshëm në identifikimin e personave, dokumenteve të udhëtimit dhe mjeteve në kërkim, apo të shtetasve me rekorde kriminale. Aksesimi i TIMS-it nga shërbimet e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave siguron shkëmbimin e informacionit në kohë reale.



Aktualisht është në proces ratifikimi memorandumit të bashkëpunimit me Qeverinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikë, për instalimin e sistemit PISCES, fillimisht në 8 pikat më të mëdha të kalimit kufitar. Ky sistem, ofron grumbullimin dhe përpunimin e një game më të madhe të informacionit në Pikat e Kalimit Kufitar, si dhe verifikimin në kohë reale të identitetit të shtetasve nëpërmjet gjurmëve papilare.

Megjithatë, gjatë periudhës së kaluar janë hasur vështirësi për sa i përket instalimit dhe përdorimit të TIMS-it në disa stacione të Policisë Kufitare dhe Migracionit, si më poshtë:

- Në DVKM Shkodër, në Stacionin e Policisë Kufitare Bajzë nuk ka as linjë interneti dhe as sistem TIMS;

- Në stacionin e Policisë Kufitare Bashkim, interneti sigurohet me sinjal satelitor, por nuk funksionon;

- Në DVKM Durrës, në Stacionet e Policisë Kufitare Spille dhe Divjakë nuk është instaluar asnjëherë TIMS-i;

- Në DVKM Korçë, TIMS-i nuk është instaluar asnjë herë në Stacionet e Policisë Kufitare Pustec, Shtikë dhe Leskovik;

- Në DVKM Vlorë, TIMS-i nuk është i instaluar në Stacionet e Policisë Kufitare Livadhja, Borsh, Triport, Hoxhare dhe Dhërmi;

- Në DVKM Kukës, në Stacionet e Policisë Kufitare Shishtavec dhe PKK Orgjost, interneti është me sinjal satelitor, por TIMS-i nuk funksionon. Në këtë rast interneti shërben vetëm për komunikim me *email*;

- Në Pikën e Kalimit Kufitar Borje, nuk është instaluar TIMS-i dhe as nuk ka internet;

- Në Stacionin e Policisë Kufitare Vçisht nuk ka shërbim internet dhe as TIMS;

- Në Pikën e Përbashkët të Kalimit të Kufirit Trebisht/Xhepsht, interneti ofrohet me sinjal satelitor, por nuk funksionon.

Me financim të Bashkimit Evropian është mundësuar instalimi i sistemit të komunikimit TETRA për hapësirën detare, i cili aktualisht është në funksion por ka probleme që duhen zgjidhur në lidhje me mirëmbajtjen dhe përmirësimin e tij. Për më tepër, Policisë Kufitare dhe Migracionit, në shumicën e juridiksionit të saj, i mungon një sistem i komunikimit me radio, mjaftueshëm efektiv dhe i sigurt. Oficerët e Patrullës Kufitare janë tepër të varur nga komunikimi me celularë për të siguruar

komunikimin “një me një”. Mungesa e sigurisë së komunikimit dhe informacionit, boshllëqet në mbulim dhe qëndrueshmëria, kanë krijuar një numër rreziqesh dhe dobësish operationale aktuale dhe potenciale. Një audit i IT-së, në maj 2015, ka theksuar se ekziston nevoja kritike për të ripërcaktuar dhe ridizenjuar platformat e vjetruara të teknologjisë së komunikimit operacional të shërbimeve në terren.

Në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga MIK, është realizuar:

- Aksesit i PKM-s në sistemin e regjistrimit të mjeteve të transportit dhe në *e-gjoha*;

- Janë hartuar dhe miratuar procedura standarde me synim përmirësimin dhe evidentimin e migrantëve dhe azilkërkuesve, me qëllim integrimin e informacionit respektiv dhe lehtësimin e shkëmbimit të informacionit ndër-agjenci dhe ndërkombëtar;

- Është në proces përpilimi të regjistrimit të përbashkët me Kapitanerinë e Porteve, për regjistrimin detar të mjeteve lundruese.

Monitorimi i hapësirës detare realizohet nëpërmjet sistemit SIVHD (Sistemi i Integruar i Vëzhgimit të Hapësirës Detare). Forca Detare është struktura përgjegjëse për SIVHD.

Në QNOD grumbullohen dhe dokumentohen të dhënat nga të gjitha institucionet pjesëmarrëse me interesa në hapësirën detare dhe përgatiten e zhvillohen analiza risku ndërinstitucionale dy herë në vit (6-mujore dhe vjetore), sipas modelit Evropian “*Common Integrated Risk Analyses Model*” CIRAM 2.0.

Për mungesë fondesh nuk janë vendosur radarë në Kepin e Rodonit dhe Gjuzës në përmbushje të nënobjektivit për përmirësimin e shkëmbimit të informacionit. Gjithashtu, nuk është realizuar masa për realizimin e shkëmbimit të informacionit me vendet e BE-së në kohë reale, duke gjetur mirëkuptimin e palëve për aksesim të sistemeve, për shkak të statusit të vendit tonë, vend i tretë, jo pjesë e BE-së dhe nuk ka akses në databazën e BE-së. Mbetet detyrim dhe objektiv përmirësimi dhe kompletimi me sisteme të reja të kontrollit, dhe shkëmbimit të informacionit, si përmirësimi i sistemit aktual TIMS, implementimi i sistemit PISCES, implementimi i sistemit PNR/API, sistemi i radiokomunikimit, etj., për shkak se pajisjet aktuale nuk mundësojnë, si në sasi dhe në cilësi, përmbushjen e detyrave.



Shërbimi doganor ka realizuar në bashkëpunim me OBD-në, implementimin e CEN-it (*National Customs Enforcement Network*), për të ndihmuar doganat në mbledhjen, ruajtjen, analizimin e informacionit/të dhënave të zbatimit të ligjit në mënyrë efektive, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, në mënyrë që të fuqizohen aftësitë e inteligjencës, dhe të përmirësohet profilizimi në një nivel strategjik, taktik dhe operacional, me mundësinë për të shkëmbyer këtë informacion në nivel rajonal dhe ndërkombëtar. Gjithashtu, Shërbimi Doganor shkëmben informacion dhe dokumentacion për procedura doganore dhe transaksione të dyshimta me strukturat homologe bazuar në marrëveshjet bilaterale dhe shumëpalëshe, si dhe protokollet e mirëkuptimit: të tilla si vendet anëtare të Bashkimit Evropian në kuadër të protokollit 6 të: “Marrëveshjes së stabilizim-asocimit midis Komuniteteve Evropiane dhe shteteve të tyre anëtare nga njëra anë dhe Republikës së Shqipërisë nga ana tjetër”, Konventa e Nairobit, Konventa e Johannesburgut; Konventa e Qendrës së Zbatimit të Ligjit të Evropës Juglindore (Konventa SELEC), në kuadër të marrëveshjeve dypalëshe për bashkëpunim dhe ndihmë të ndërsjellë në fushën e doganave me autoritetet Homologe të: Turqisë, Italisë, Greqisë, Maqedonisë, Sllovenisë, Bullgarisë, Moldavisë, Rumanisë, Polonisë, Sllovakisë, Qipros, Austrisë, Spanjës, Malit të Zi, Kroacisë, Kosovës, Bosnje Hercegovinës, Hungarisë, Serbisë, Britanisë së madhe, Irlandës së Veriut dhe Kinës.

ADSH-ja ka përfunduar me sukses projektin e binjakëzimit nga IPA 2012 me Agjencinë e Doganave dhe Monopoleve të Italisë për asistencë në ngritjen e kapaciteteve dhe menaxhimin e zbatimit të sistemit të ri të kompjuterizuar të transportit (NCTS).

Kodi Doganor dhe dispozitat zbatuese lidhur me NCTS-në janë përafuar me ato të BE-së dhe janë të miratuara. Mbetet zhvillimi i modulit NCTS, testimi dhe vlerësimi nga ekspertet e BE-së dhe më pas ndjekja e procedurave ligjore për aderimin në Konventën e Transitit të Përbashkët.

Infrastruktura dhe pajisjet

Agjencitë e kufirit kanë infrastrukturën e duhur për realizimin e misionit të tyre. Në zbatim të marrëveshjeve ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve fqinje, janë hapur PKK të reja, të përcaktuara si PPKK (Pika të Përbashkëta të Kalimit Kufitar) me

Kosovën, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, si dhe janë rikonstruktuar dhe ndërtuar ambiente bashkëkohore pune (2 PKK: një PPKK me Kosovën dhe një Malin e Zi). Megjithëse janë hartuar projektet për përmirësimin e infrastrukturës në PKK Hani i Hotit, PKK Morinë, PKK Kapshticë dhe PKK Kakavijë, është realizuar financimi vetëm për PKK Hani i Hotit dhe Muriqan.

Gjithashtu shërbimet kufitare kanë përmirësuar në vijimësi inventarin e pajisjeve të kontrollit dhe survejimit të kufirit, disa prej të cilave janë futur për herë të parë në këtë shërbim. Këtu mund të përmenden si vijon: pajisje për kontrollin e dokumenteve; të mjetëve të transportit gjatë kontroleve në vijën e parë dhe të dytë; pajisje të vëzhgimit ditën dhe natën; sistemin SMARTDEC i cili është vendosur në drejtëmet me risk të kufirit shtetëror dhe sistemi i monitorimit me kamera në PKK.

Për sa i përket monitorimit të hapësirës detare është realizuar përmirësimi i infrastrukturës së QNOD-it, duke bërë të mundur marrjen dhe shkëmbimin e informacionit nga të gjitha institucionet pjesë të QNOD-it, nga sistemet SIHVD, TETRA, BLU BOX, TIMS, etj. Bashkëpunimi ndërinstitucional në luftën kundër korrupsionit është rritur. Mekanizmi i ngritur për të monitoruar aktivitetin e agjencive kufitare si: strukturat antikorrupsion në agjencitë e kufirit, vendosja e kamerave në PKK, zbatimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit në kryerjen e procedurave kufitare dhe një sërë masash të tjera ka bërë që të arrihet progres në këtë fushë.

Megjithatë, Sistemi i Monitorimit të Anijeve të Peshkimit është jashtë funksionit që nga 30 marsi i vitit 2017. Ky sistem është në fazën e prokurimit nga AKSHI dhe pritet që më 2021-shin të implementohet sistemi i ri. SIVHD-ja pritet që të përmirësohet sipas kontratës që Ministria e Mbrojtjes ka nënshkruar me kompaninë amerikane “Lockheed Martin”, në kuadër të detyrimeve që ka RSH-ja në NATO. Projekti i bazës së të dhënave të trafikut detar, është në fazën e implementimit nga AKSHI në bashkëpunim me QNOD-in. Financimi i këtij projekti është deklaruar se do të financohet nga “Border Force”, Mbretëria e Bashkuar. Në kuadër të bashkëpunimit me partnerët, nga data 17 janar 2020, oficerët e shërbimit 24-orësh pranë



sallës operationale të QNOD-it, kanë akses edhe në aplikacionin “Lloyd’s informa” për marrjen e të dhënave të trafikut detar, të siguruar dhe financuar nga “Border Force”, Mbretëria e Bashkuar.

Gjithashtu është e domosdoshme ngritja e Sistemit të Vëzhgimit të Policisë së Shtetit (PKM) për mbikëqyrjen e hapësirës detare, sistem i cili të jetë burim shtesë informacioni në QNOD, si dhe përcjellja e transmetimit të panoramës së përgjithshme të hapësirës detare në Qendrën Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Kufirit.

Në realizim të objektivit për përmirësimin e infrastrukturës për akomodimin e migrantëve dhe azilkërkuesve, në bashkëpunim me agjencitë e përfshira në këtë proces janë hapur Qendra të Përkohshme Pritjeje në Gjirokastër, Kakavijë, Ersekë.

Tashmë, në sajë të mbështetjes së ofruar nga organizata dhe institucione partnere, Policia Kufitare dhe Migracionit situata e furnizimit me pajisje ka ndryshuar dukshëm, duke forcuar kapacitetet e kontrollit dhe mbikëqyrjes së kufirit. Mbështetja e EXBS, Policisë Federale Gjermane, IOM, UNHCR dhe Bashkimit Evropian ka mundësuar një flotë të mjeteve të patrullimit dhe transportit thuasht të re, ku përfshihen rreth 70 automjete të kapaciteteve të ndryshme. Për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit janë siguruar fibroskopë, videoskopë, kamera termike, dylbi dite dhe dylbi nate me rreze të gjatë, lupa zmadhuese me burime të ndryshme drite, një laborator për ekzaminimin e dokumenteve të udhëtimit, dy sisteme të mbikëqyrjes së kufirit (TVV Vans), një sistem të lëvizshëm të zbulimit të radioaktivitetit (dhuruar nga Departamenti i Energjisë i Shteteve të bashkuara të Amerikës), skaner portativ, pajisje për kontrollin e kamionëve dhe autobusëve, pajisje për kontrollin e dendësisë (*baster*), 16 mikrobuse, elektrike dore. Ndërsa me financim nga buxheti i shtetit, janë siguruar lexues optik të dokumenteve të udhëtimit për çdo post pune në Pikat e Kalimit Kufitar.

Në kuadër të bashkëpunimit që ka Shërbimi Doganor me Departamentin e Energjisë së Shteteve të Bashkuara dhe IAEA-n për të përmirësuar infrastrukturën për zbulimin bërthamor, për zbulimin dhe parandalimin e trafikut të materialeve të veçanta bërthamore dhe materialeve të tjera radioaktive, janë siguruar 13 polimastera dhe një sistem i lëvizshëm për zbulimin

e radioaktivitetit MDS (*Mobile Detection Van*). Në PKK, Hani Hotit është në fazën e zbatimit të projektit me IAEA-n, për instalimin e portaleve të monitorimit të radioaktivitetit (RPM). Nga programi i EXBS-së për personelin doganor janë siguruar 5 CT 40 pajisje të kontrollit në vijë të dytë, një “Hazmat 360” dhe 6 *identifinder*.

Ndërkohë, vendimi Këshillit të Ministrave nr. 745, datë 26.10.2016, “Për kryerjen e verifikimeve të përbashkëta kufitare”, jo vetëm ka forcuar kuadrin e bashkëpunimit institucional të agjencive që operojnë në kufi, por ka parashikuar përdorimin e përbashkët të pajisjeve të kontrollit kufitar.

Në vitin 2018, Komisioni Evropian miratoi financimin e projektit “Për forcimin e kapaciteteve të policisë kufitare në luftën kundër trafikëve të paligjshme”, në shumën 6.000.000 euro, ku parashikohet blerja e mjeteve të lundrimit të kapaciteteve dhe fuqive motorike të ndryshme për mbikëqyrjen e kufirit blu, sisteme të mbikëqyrjes së kufirit (TVV Vans), pajisje të lëvizshme për mbikëqyrjen e kufirit (radarë, kamera termike, dylbi dite dhe nate), si dhe pajisje për verifikimet kufitare në Pikat e kalimit Kufitar.

Në muajin korrik të vitit 2019, u përfundua përfundimi i punimeve në Pikën e Kalimit Kufitar Morinë, i cili u mundësua me financim nga Bashkimi Evropian prej 1 (një) milion euro. Tashmë PKK Morinë vlerësohet se është në përputhje me standardet e *Schengen*-it dhe do të ketë efekt përmirësues në menaxhimin e kufijve të Shqipërisë në përputhje me standardet e BE-së. Këtij financimi i është shtuar edhe financimi nga Buxheti i Shtetit, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave me një fond prej 85.8 milion lekë ose rreth 684 000 euro, për ndërtimin e terminalit të autobusëve, godinës së inspektimit (kontrolli i vijës së dytë), godinës së inceneratorit (për mallrat e ndaluara nga AKU-ja) dhe punime të jashtme duke kompletuar kështu projektin e plotë të Pikës së Kalimit Kufitar.

Në muajin gusht të vitit 2019 është inauguruar përfundimi i rikonstruksionit të Pikës së Kalimit Kufitar Hani i Hotit. Rikonstruksioni i kësaj pike kalimi është mundësuar me fondin prej 2.4 milion euro të Bashkimit Evropian, ndërtimi i ndërtesës administrative me financim nga Buxheti i Shtetit, me një fond prej 4.2 milionë lekë.

Në kuadër të parandalimit të trafikimit, nëpërmjet proceseve dhe pajisjeve të përmirësuar,



në shkurt 2020 u inaugurua Njësia për Kontrollin e Kargove dhe Kolive Ajrore në Rinas. Ky projekt i ofruar nga UNODC, por edhe me mbështetjen e OBD-së, Qeverisë Gjermane dhe asaj Franceze, u dha një njësi me staf të trajnuar për një kontroll të sigurt të kargove dhe të postës ajrore në aeroportin e Rinasit, me fibroskop por edhe pajisje detektuese të eksplozivëve.

Punimet vijnë për ndërtimin e pikës së përbashkët të kalimit Zatriebačka Cijevna – Grabon, ndërsa protokollin për implementimin e kontrollit të përbashkët të kufirit dhe pagesën e shpenzimeve në pikën e përbashkët të kalimit kufitar Zatriebačka Cijevna – Grabon, është nënshkruar me 5 prill, në Podgoricë dhe 28 maj 2018, në Tiranë.


Referuar gjendjes aktuale, si dhe kërkesave në rritje për t'iu afruar nivelit të standardeve të Schengen-it/BE për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit, duhet të përmirësohet infrastruktura e PKK/Stacioneve të PKM-së, sistemi i vëzhgimit dhe mbikëqyrjes së kufirit blu dhe të gjelbër me radar, kamera termike, SMARTDEC dhe mjete e pajisje të tjera të teknologjisë bashkëkohore.

Parandalimi dhe goditja e krimin ndërkufitar


Nga analizimi i vazhdueshëm i situatës dhe i statistikave të kriminalitetit me karakter ndërkufitar, **trafiqet e paligjshme** vijnë të mbeten një nga

kërcënimet kryesore të sigurisë kufitare. Parandalimi dhe goditja e trafikut të lëndëve narkotike dhe trafikimi i mjeteve motorrike ka qenë dhe mbetet një nga objektivat kryesore të shërbimeve për kufirin dhe migracionin. Gjatë periudhës 2014 – 2020, shërbimet e Policisë Kufitare në Pikat e Kalimit të Kufirit apo në kufirin shtetëror kanë evidentuar 560 raste të lëndëve narkotike ku janë sekuestruar sasi të ndryshme të lëndëve të ndryshme narkotike që arrin në total prej afërsisht 51 414 kg. Bashkëpunimi ndërkufitar me vendet fqinje është forcuar në këtë drejtim. Gjatë periudhës 2014 – 2020, në sajë të bashkëpunimit me njësinë e *Guardia di Finanza* në vendin tonë, si dhe Rojën Bregdetare Greke dhe autoritetet kufitare Malazeze, janë zhvilluar në total 258 operacione të përbashkëta, ku janë sekuestruar një sasi lëndë narkotike afërsisht prej 70663 kg.

Operacionet e përbashkëta kundër fenomenit të trafikimit të lëndëve narkotike janë zhvilluar dhe me autoritetet kufitare të Malit të Zi dhe Rojën Bregdetare Greke. Këto operacione kanë qenë të limituara për shkak edhe të tendencës që fenomeni i trafikimit të lëndëve narkotike ka pasur kryesisht destinacion Italinë nëpërmjet hapësirës detare, ndërsa me Greqinë dhe Malin e Zi kjo tendencë e trafikimit të lëndëve narkotike kryesisht është zhvilluar nëpërmjet kufirit të gjelbër.



Gjatë të njëjtës periudhë, janë goditur 367 raste të trafikimit të mjeteve motorrike.



Fenomeni i **migracionit të parregullt** me prejardhje afrikane dhe aziatike, në drejtim të vendeve të Bashkimit Evropian, ka disa vite që ekziston duke u zhvilluar në rrugë dhe në mënyra të ndryshme. Ky migracion është klasik i përzier, pra që përfshin grupe që largohen për shkak të konflikteve të luftës dhe grupe që i largohen gjendjes së vështirë ekonomike. Në linja të përgjithshme ky migracion zhvillohet në rrugë detare, tokësore dhe nga ajri. Me mbylljen e rrugëve që synonin territoret spanjolle në Atlantik, intensiteti i lëvizjeve u shtua në drejtimin nga Libia në Mesdhe, në rrugë detare dhe nëpërmjet Ballkanit Perëndimor në rrugë tokësore.

Gjatë viteve të kaluara politika migratore e shteteve anëtare të BE-së ndryshoi, herë duke ndjekur atë të “dyerve të hapura”, që çoi në krijimin e rrugës së Ballkanit Perëndimor Greqi–Maqedoni–Serbi–Hungari dhe Greqi–Maqedoni–Serbi–Kroaci–Austri, e herë në atë të politikave kombëtare, që çoi njëherë në profilizimin sipas shtetësisë të imigrantëve, dhe më tej në kufizimin e numrit që pranohej të kalonte në këtë rrugëtim e deri në mbylljen totale të saj.

Sa i përket ndikimit të këtij fluksi nga Greqia në Shqipëri, shumica e të intervistuarve të kapur në kufi apo në brendësi të territorit, kanë deklaruar se kanë mbërritur në Shqipëri nëpërmjet transportit publik nga Athina, Selaniku dhe qytete të tjera në afërsi të pikës së kalimit Kakavijë e Kapshticë, dhe më tej kanë hyrë

nëpërmjet kufirit të gjelbër duke synuar Malin e Zi dhe Kosovën me destinacion kryesisht Gjermaninë. Topografia e kufirit të gjelbër në këtë rajon lejon kalim relativisht të lehtë. Infrastruktura rrugore në të dyja anët e këtyre zonave kufitare është më e mirë se në zonat e tjera kufitare, duke e bërë atë pikën më të mundshme të hyrjes. Infrastruktura aktuale në vend nuk është e mjaftueshme për të trajtuar flukse të mëdha hyrëse të imigrantëve dhe azilkërkuesve.

Gjithashtu, një tregues pozitiv që duhet theksuar është edhe fakti që përgjatë gjithë këtyre viteve, si pasojë e masave të marra dhe kontrollit të pandërprerë të vijës bregdetare nuk ka asnjë rast të kalimit nëpërmjet rrugëve detare në drejtim të Italisë të imigrantëve të parregullt. Ky është një sukses i madh dhe përvojë shumë e mirë për të cilën po punohet në vazhdimësi për ta ruajtur këtë standard. Theksojmë se kontrolli i vijës së kalimit kufitar detar është një rrugë që ka problematika edhe në vendet më të zhvilluara të BE-së. Për këtë arsye Forca Detare ka hartuar planin e modernizimit të rritjes së kapaciteteve të Rojës Bregdetare.

Për më të shumtën e emigrantëve të paligjshëm që udhëtojnë në vendet e tjera të destinacionit nëpërmjet së ashtuquajturës rrugë e Ballkanit Perëndimor, Shqipëria është kryesisht vend transit. Duke pasur parasysh që linja kufitare jugore e juglindore shtrihet përgjatë kufijve malorë dhe zonave më pak të populluara




në një masë më të madhe, zbulimi i migrantëve të parregullt nënkupton që policia kufitare nuk është e pajisur në mënyrë të duhur për të luftuar dhe zbuluar këtë lloj të krimit ndërkuftar.

Gjithashtu, një dukuri e dukshme, e cila është rritur në mënyrë të vazhdueshme, me të cilën Shqipëria është përballur vitet e kaluara, është numri i azilkërkuesve. Duke qenë në kufi me një vend anëtar të BE-së, si Greqia, në të cilin aktualisht ka grumbullime të mëdha imigrantësh të ardhur nga vendet e lindjes, statusi i Italisë si


vend anëtar i BE-së dhe hyrja e Kroacisë në Bashkimin Evropian, janë një motiv shtesë për ardhjen dhe rritjen e numrit të azilkërkuesve në Shqipëri, me qëllim lëvizjen drejt këtyre vendeve.

Siç shihet nga grafiku, më poshtë, viti 2015, 2016 dhe 2017, njohu rënie të numrit të imigrantëve të parregullt, por viti 2018 dhe 2019 dhe viti 2020 shënon një trend rritjeje, me hapa të shpejtë, gjë që tregon se Shqipëria vijon të jetë vend atraktiv për kalimin transit nga Greqia drejt vendeve të Bashkimit Evropian.




Përveç këtyre rrjedhave të migracionit, të cilat janë shoqëruar nga fenomene të ndryshme kriminale si: trafikimi i qenieve njerëzore, kontrabandimi i imigrantëve (dhënia ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit) dhe falsifikimi i dokumenteve, apo qarkullimi i mundshëm i elementeve ekstremiste të dhunshme dhe atyre terroriste, duhet të theksohet se e ashtuquajtura rrugë ballkanike është ende rrugë aktuale për kontrabandën e drogave të paligjshme, automjeteve të vjedhura dhe armëve dhe lidhjen e vendeve të Bashkimit Evropian me Lindjen e Mesme dhe Lindjen e Largët, që është një sfidë për të gjitha autoritetet e përfshira në menaxhimin e kufijve.

Gjatë periudhës 2014–2020, nga ana e Policisë Kufitare dhe Migracionit, janë evidentuar 231 raste të dhënies ndihmë të kalimit të paligjshëm të kufirit (kontrabandimin e imigrantëve). Kalimi i paligjshëm i kufirit, kryesisht i shtetasve shqiptar drejt vendeve fqinje, ka mbetur fenomen i përhapur. Ky fenomen është më i përhapur në kufirin juglindor, me Greqinë, ku shtetasit shqiptar, qëllimi i të cilëve është punësimi sezonal apo që kanë shkelur, në të kaluarën, afatet e qëndrimit, kalojnë ose tentojnë të kalojnë kufirin duke iu shmangur kontrolleve kufitare. Gjatë periudhës 2014–2020, janë evidentuar 3985 raste të kalimit të paligjshëm të kufirit.



Mosdeklarimi i të hollave dhe sendeve me vlerë në kufi ka qenë fenomen tjetër që ka kërcënuar sigurinë kufitare. Gjatë periudhës 2014 – 2020, nga shërbimet e Policisë Kufitare janë evidentuar 148 raste të tilla dhe janë sekuestruar 8 584 584 €.

Përdorimi i dokumenteve të falsifikuara të udhëtimit vijon të mbetet tjetër kërcënim. Të dhënat flasin kryesisht për falsifikim të dokumenteve të huaja nga shtetas shqiptar që kërkojnë të udhëtojnë drejt vendeve të Bashkimit Evropian por edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Britanisë së Madhe, por nuk kanë munguar rastet e përdorimit të dokumenteve të falsifikuara të udhëtimit nga shtetas të huaj, të cilët tentojnë të kalojnë transit, nëpërmjet vendit tonë, drejt vendeve të tjera. Gjatë periudhës 2014 – 2020, nga ana e strukturave të Policisë Kufitare dhe Migracionit janë evidentuar 1734 raste të falsifikimit të dokumenteve të udhëtimit dhe janë sekuestruar 1923 dokumente të falsifikuara.





Krimet në fushën e doganave kanë qenë dhe mbeten tjetër objektiv prioritar i agjencive që operojnë në kufi. Gjatë periudhës 2014 – 2020, nga strukturat e Policisë Kufitare në bashkëpunim edhe me shërbimin doganor, janë evidentuar 328 vepra penale në fushën e kontrabandës së mallrave.

Qarkullimi i mundshëm i elementeve terroriste dhe individëve ekstremist të dhunshëm, ndonëse jo shumë i përhapur, mbetet kërcënim serioz. Eksperienca e vendeve që kanë qenë objekt i sulmeve terroriste dhe rasti i një luftëtari të huaj terrorist të kapur në vendin tonë dhe me pas të ekstraduar, është tregues i qarkullimit të mundshëm të tyre nëpërmjet vendit tonë.

Trafikimi dhe mbajtja pa leje e armëve të zjarrit, ndonëse është reduktuar ndjeshëm, mbetet kërcënim për sigurinë kufitare dhe rrjedhimisht edhe për atë kombëtare.

2.2 Sfidat

Në përputhje me konceptin e ri të Menaxhimit të Integruar të Kufirit të BE-së dhe procedurat e standardizuara në kufijtë e jashtëm, sfidat me të cilat përballen vendet anëtare të BE-së, kërkesat për forcimin e bashkëpunimit operacional në kontrollin kufitar, nevojën për të përmirësuar analizën e rrezeve, si dhe bashkëpunimin ndërministror dhe ndërkombëtar, është përgatitur Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021–2027 dhe plani i veprimit në zbatim të saj, me aktivitete të identifikuar që kërkohen për të arritur në mënyrë efektive objektivat e përcaktuara në këtë dokument.

Strategjia dhe plani i veprimit për zbatimin e Strategjisë pasqyrojnë konceptin e Menaxhimit të Integruar të Kufirit të BE-së, duke marrë parasysh statusin aktual të integritetit të Shqipërisë në BE.

Përveç këtij dokumenti strategjik, agjencitë e zbatimit të ligjit, veçanërisht ato që kanë detyrime të përcaktuara në këtë dokument, do të koordinojnë planet e punës duke siguruar përparim të koordinuar drejt një qëllimi të përbashkët me rëndësi për anëtarësimin në Bashkimin Evropian dhe në zonën *Schengen*.

3. Pozicioni gjeopolitik dhe karakteristikat e kufirit

Shqipëria është një vend evropian, mesdhetar dhe ballkanik me lidhje me të gjithë botën përmes porteve në detin Adriatik e Jon dhe aeroportin e Tiranës. Shqipëria, gjithashtu, ka zona të caktuara ujore në detet Adriatik e Jon dhe në liqenin e Shkodrës, Pogradecit dhe Prespës.

Politikisht Shqipëria është vend kandidat për anëtarësimin në BE, gjeografikisht ndodhet midis Republikës së Greqisë, shtetit anëtar të BE-së, vendeve që kanë statusin e vendeve candidate të BE-së (Mali i Zi, Maqedonia) dhe Kosovës, vend që ka nënshkruar Marrëveshjen e stabilizim-asocimit me BE-në, gjë e cila i vendos, autoritetet e shtetit shqiptar para detyrimit për të miratuar standardet dhe praktikat më të mira të Bashkimit Evropian në fushën e sigurisë kufitare, për shkak të marrjes së përgjegjësisë relativisht të shpejtë për kontrollin e kufijve të jashtëm të Bashkimit Evropian.

Migracioni, si një proces i vazhdueshëm i lëvizjes së njerëzve, është në qendër të interesit politik jo vetëm në Evropë, por në mbarë botën, pasi Bashkimi Evropian po përballlet me presione të vazhdueshme domethënëse të migracionit.

Shqipëria është një vend i Evropës Juglindore dhe Mesdheut dhe ndodhet në kryqëzimin midis Evropës Lindore dhe Perëndimore dhe pjesëve jugore dhe veriore të kontinentit. Për shkak të vendndodhjes së saj gjeografike, është një lidhje natyrore përmes së cilës kalojnë flukse të caktuara migracioni dhe trafiku. Zhvillimi ekonomik, nevojat e tregut të punës dhe veçanërisht lidhjet e transportit që përshkojnë territorin e Shqipërisë dhe kanë kontribuar në flukset e shumta të migracionit.

Duke marrë parasysh pozicionin gjeopolitik, specifikat e kufijve jeshil dhe blu dhe analizën e rrezeve, aspektet kryesore të sigurisë së kufijve kanë të bëjnë me:

Kufiri shtetëror i Republikës së Shqipërisë shtrihet mbi tokë, det, liqene dhe lumenj dhe gjatësia e tij është rreth 1094 km (nëse i shtohet dhe vija bregdetare, gjatësia është 1250 km), si më poshtë:

- Kufi tokësor 627 km;
- Kufi detar 362 km (përfshirë vijën bregdetare, 472 km);
- Kufi liqenor 73 km;
- Kufi lumor 78 km.

Sipas shteteve gjatësia e kufirit është, si më poshtë:

- Me Malin e Zi: gjatësia e kufirit është 220 km, nga të cilat, 126 km tokësor; 22 km detar, 38 km liqenor, 24km lumor dhe 8 km përrenj;



- Me Kosovën: gjatësia e kufirit është 123 km, nga të cilat, 117 km tokësor, 1 km liqenor dhe 5 km përrrenj;

- Me Maqedoninë: gjatësia e kufirit është 186 km, nga të cilat, 137 km tokësor, 28 km liqenor, 12 km lumor dhe 9 km përrrenj;

-Me Greqinë: gjatësia e kufirit është 349 km, nga të cilat, 247 km tokësor, 78 km detar, 7 km liqenor, 9 km lumor dhe 8 km përrrenj.

- Kufiri shtetëror i detit territorial me zonën fqinje (det ndërkombëtar) është 262 km.

Hapësira e detit territorial ku RSH-ja zhvillon autoritet të plotë për zbatimin e ligjit është 5041 km.

- Në territorin e Republikës së Shqipërisë operojnë gjithsej 31 pika të kalimit kufitar të cilat sipas kategorive janë:

- **1** PKK ajrore (PKK Aeroporti Rinas);

- **8** PKK detare (PKK Porti Durrës, PKK Porti Vlorë, PKK Porti Sarandë, PKK Porti Shëngjin, PKK Porti Himarë, PKK Porto Romano për transport karburantesh, PKK Petrolifera, PKK Limion);

- **1** PKK liqenore (PKK Moli i Qytetit Pogradec, me Maqedoninë e Veriut, sezonale verore);

- **1** PKK hekurudhore (PKK Bajzë, shërbim i përbashkët me Policinë Malazeze në Tuz);

- **20** PKK tokësore (PKK Qafë-Botë, PKK Rips, PKK Kakavijë, PKK Tre Urat, PKK Sopik, PKK Kapshticë, PKK Qafë Thanë, PKK Tushemisht, PKK Gorricë, PKK Bllatë, PKK Trebisht, PPKK Morinë, PPKK Qafë-Morinë, PPKK Qafë-Prush, PPKK Shishtavec, PPKK Orgjost, PPKK Borje, PPKK Çerem, PKK Hani i Hotit, PPKK Murriqan, PKK Bashkim, PPKK Grabon (Aktualisht jo funksionale, por në përfundim të procesit për hapje).

Pikat e kalit kufitar sipas shtetit kufitar janë si më poshtë:

- **5** PKK me Malin e Zi (nga këto **1** hekurudhore, **3** pika të përbashkëta të kalimit kufitar);

- **7** PPKK me Kosovën (7 pika të përbashkëta të kalimit kufitar);

- **5** PKK me Maqedoninë e Veriut (nga këto **1** liqenore);

- **9** PKK me Greqinë (nga këto **3** detare);

- **5** PKK me Italinë (**5** detare).

Kompleksiteti i administrimit të kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë përcaktohet nga specifikat e tij: kufiri i gjatë shtetëror në lidhje me sipërfaqen e përgjithshme të territorit të shtetit; një numër i madh i pikave të kalimit kufitar; numër i shumtë i rrugëve që kryqëzojnë vijën e kufirit; kufiri shtetëror që rrjedh përgjatë lumenjve për shkak të niveleve të ulëta të ujit është i përshtatshëm për kalime të paligjshme; vargjet malore e bëjnë të vështirë kontrollin e kufirit të gjelbër dhe si e tillë lehtëson kalimin e flukseve migratore, por edhe krimin ndërkufitar të të gjitha llojeve.

4. Vizioni i Strategjisë

4.1 Vizioni

Sigurimi i një qarkullimi të sigurt të shtetasve dhe mallrave nëpërmjet kufirit shtetëror dhe marrja e masave të nevojshme për të parandaluar dhe goditur të gjitha format e krimit ndërkufitar dhe të migrimit të parregullt.


Vizioni i kësaj Strategjie është në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015 – 2020, ku siguria kufitare lidhet me shtyllën e “Mirëqeverisjes, Demokracisë dhe shtetit të së Drejtës” dhe mbështet vizionin e SKZHI-së “Konsolidimi i arritjeve të menaxhimit të konsoliduar të kufirit për të siguruar kufij të hapur dhe të sigurt, në harmoni të plotë me standardet e BE-së”, në lidhje me objektivat e parashikuara për: - Forcimin e forcës zbuluese në luftën kundër krimit ndërkufitar; - Rritjen e profesionalizmit dhe aftësive teknike për zbulimin dhe luftën kundër përdorimit të dokumenteve të falsifikuara për kalimin e kufirit; - Përmirësimin e standardeve të kontrollit dhe mbikëqyrjes përmes standardizimit të Pikave të Kalimit të Kufirit (PKK) sipas standardeve të BE-së dhe Kodit *Schengen*; - Parandalimin dhe pakësimin e rasteve të migrimit të paligjshëm dhe të qytetarëve të huaj që kapen në territorin e Shqipërisë me dokumente të parregullta; - Parandalimin dhe uljen e migracionit të paligjshëm; - Forcimin e përgjithshëm i kapaciteteve të Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare.

4.2 Misioni dhe vlerat

Kjo Strategji ka si mision menaxhimin e integruar të kufirit, koordinimin dhe veprimin e përbashkët të autoriteteve të përfshira në sistemin MIK, për të minimizuar kërcënimet ndaj sigurisë kufitare, kushtet e brendshme të sigurisë dhe pjesë

të sistemit të përgjithshëm të sigurisë të Republikës së Shqipërisë.

Strategjia Ndërsektoriale e Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021–2027, përshkohet nga një set vlerash që qëndrojnë në themel të funksionimit të agjencive të përfshira në sigurinë kufitare dhe lehtësimin e tregtisë, si profesionalizmi, respekti për të drejtat themelore, bashkëpunimi, transparencja dhe llogaridhënia.



4.3 Treguesit e impaktit dhe treguesit e rezultatit

Në përputhje me qëllimin strategjik të Republikës së Shqipërisë për t'u bërë anëtar i Bashkimit Evropian, Shqipëria është zotuar të përmbushë kriteret që rrjedhin nga procesi i pranimit në Bashkimin Evropian dhe të zbatojë plotësisht parimet e përcaktuara të Bashkimit Evropian në lidhje me lirinë, demokracinë, respektimin e të drejta vetë njeriut, dhe sundimin e ligjit. Për të përmbushur angazhimin e saj për menaxhimin e kufijve dhe për të forcuar më tej partneritetin, stabilitetin dhe rritjen e ekonomisë, si dhe për të zvogëluar rreziqet e sigurisë, Shqipëria ka vendosur një sistem të integruar të administrimit të kufijve dhe vazhdon të përmirësojë këtë sistem në përputhje me rekomandimet e BE-së dhe praktikatat më të mira.

Qëllimi i miratimit të Strategjisë Ndërsektoriale së Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021–2027, është vazhdimi i përpjekjeve për të përmirësuar më tej menaxhimin e integruar të kufijve, duke mbajtur një nivel të lartë të sigurisë kufitare, kushteve të brendshme të sigurisë si një pjesë integrale e sistemit të sigurisë së përgjithshme të Republikës së Shqipërisë, sigurimin e mbikëqyrjes së besueshme të kufirit shtetëror, lehtësimin e qarkullimit ndërkufitar në pikat e kalimit kufitar, parandalimin dhe menaxhimin e migracionit të parregullt,

parandalimin dhe goditjen e krimit ndërkufitar, dhe përmirësimin e procesit të kthimit të personave që nuk janë të autorizuar të qëndrojnë në Shqipëri. Migracioni i parregullt, terrorizmi, krimi i organizuar dhe ai ndërkombëtar, kërcënimet në internet, si dhe rritja e ndjeshmërisë së shoqërisë moderne janë sfida që kërkojnë zhvillimin e aftësive për të menaxhuar kufirin në mënyrë që të parandalohen këto kërcënime.

Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Administrata Doganore janë autoritetet kryesore përgjegjëse për zbatimin e sistemit të Menaxhimit të Integruar të Kufirit, në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, Autoritetet e Shëndetësisë, Forcën Detare/Rojën Bregdetare dhe Drejtorinë e Përgjithshme Detare, si dhe organeve të tjera me kompetencë kufitare.

Koncepti MIK është një model i pranuar gjerësisht për menaxhimin e kufijve të jashtëm të BE-së, një element i rëndësishëm për ruajtjen e sigurisë së brendshme, veçanërisht në parandalimin dhe zbulimin e migracionit të parregullt dhe formave të tjera të krimit ndërkufitar, dhe është një tërësi masash operative me të cilin shtetet parashikojnë një sistem efektiv të menaxhimit të kufijve të jashtëm të BE-së, i cili nënkupton një nivel të lartë besimi të ndërsjellë, zbatim të



vazhdueshëm të aktiviteteve të përbashkëta, ndarje të përgjegjësisë dhe solidaritetit.

Koncepti i menaxhimit të integruar të kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor kontribuon ndjeshëm në zonën e Evropës Juglindore si zonë e partneritetit, stabilitetit dhe zhvillimit ekonomik, pasi ulja e rreziqeve të mundshme të sigurisë krijon parakushte për zhvillim më të shpejtë dhe më të mirë të shoqërisë shqiptare dhe fqinjët. Autoritetet kompetente të Republikës së Shqipërisë kanë qenë dhe mbeten shumë të përkushtuar për integrimin e objektivave kryesore të Strategjisë, në veçanti, për të adresuar çështjet bilaterale me vendet fqinje. Gjatë kësaj periudhe, nëpërmjet strukturave buxhetore, qeveria shqiptare, ka dhënë në vijimësi mbështetje për përmirësimin dhe implementimin me sukses të Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Kufijve. Sa më sipër, më tepër përpjekje duhen bërë për të marrë këste të ndryshueshme të programit të BE-së për mbështetjen e buxhetit sektorial për menaxhimin e kufirit.

Indikatori i impaktit që lidhet me vizionin e këtij dokumenti strategjik është: “Indeksi i rritjes së sigurisë kufitare”.

PJESA II: QËLLIMI I POLITIKAVE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKE TË STRATEGJISË

Qëllimi Politikave Strategjike të Strategjisë Ndërsektoriale të Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021–2027 janë zhvillimi i një sistemi të integruar të administrimit të kufijve në përputhje me sistemin evropian të mbikëqyrjes kufitare dhe rritja e sigurisë kufitare duke përmirësuar bashkëpunimin në të gjitha nivelet dhe forcimin e kapaciteteve administrative, infrastrukturore dhe teknike.

Zhvillimi i mëtejshëm i sistemit të menaxhimit të integruar të kufijve, përmirësimi i kontrollit dhe mbrojtjes së kufijve do të vazhdojë të jetë një sfidë kryesore në procesin e pranimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, kryesisht përmes përafrimit të legjislacionit tonë me atë të BE-së në këtë fushë, si dhe bashkëpunimin efektiv të autoriteteve kompetente për të mbrojtur kufijtë dhe në të njëjtën kohë të garantojë sigurinë për qytetarët.

Zbatimi i kësaj Strategjie siguron përsosjen e mëtejshme të Sistemit të Sigurisë Kufitare, duke arritur përafrimin me atë të vendeve anëtare të BE-së.

1. Qëllimi i politikës 1: Mbrojtja e sigurisë së brendshme dhe menaxhimi i flukseve migratore, me qëllim parandalimin e migracionit të parregullt, si dhe parandalimin dhe goditjen e krimit ndërkufitar

1.1 Objektivi specifik 1, i qëllimit të politikës 1: Rritja e nivelit të përputhshmërisë me standardet evropiane dhe të *Schengen*-it, në aspektin legjislativ, administrativ dhe institucional në fushën e menaxhimit të integruar të kufijve, veçanërisht në fushën e kontrollit dhe të mbikëqyrjes së kufirit dhe forcimi i bashkëpunimit ndër-agjenci dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.

Kontrolli kufitar, një nga elementet e konceptit MIK të Shqipërisë, përfshin të gjitha çështjet përkatëse që lidhen me këtë koncept si: parandalimi dhe zbulimi i krimit ndërkufitar; masat ndaj personave që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare; ndërtimi i infrastrukturës kufitare; plani i emergjencave dhe zhvillimi i mëtejshëm i sistemeve të IT-së për përmirësimin e kontrollit kufitar.

Parimet themelore të administrimit efektiv të kufijve janë garantimi i kufijve të hapur për lëvizjen e personave e të mallrave dhe kufijve të sigurt ndaj aktiviteteve kriminale që kërcënojnë stabilitetin, që nënkupton se kontrollet kufitare duhet të mbajnë një ekuilibër midis rrjedhës së qetë të trafikut dhe nevojës për të garantuar sigurinë e brendshme.

Për të realizuar në mënyrën më të mundshme efektive kontrollin kufitar, aktivitetet do të përqendrohen në përmirësimin e kapaciteteve administrative të gjitha shërbimeve të përfshira në menaxhimin e integruar të kufijve, forcimin e kapaciteteve operacionale dhe teknike, duke vazhduar ndërtimin, modernizimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës kufitare dhe përmirësimin e sistemeve të informacionit.

Mbikëqyrja kufitare do të mbështetet në analizën e rrezikut, me angazhimin e patrullave të lëvizshme, të mbështetura nga sistemet teknike, të palëvizshme dhe të lëvizshme, të mbikëqyrjes. Planet e masave të Policisë së Shtetit do të zhvillohen, vazhdimisht, për të përmirësuar gatishmërinë operacionale.

Kompetencat dhe detyrimet ligjore për kontrollet efektive kufitare në pikat e kalimit kufitar janë të ndara sipas detyrave funksionale të punës ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit që operojnë në kufi, me kompetencat e tyre ligjore dhe



autoritetet, përdorim efikas të burimeve njerëzore dhe teknike. Kontrollin e përbashkëta të policisë, doganave duhet të kryhen në të gjitha pikat e kalimit kufitar, me parimin e një ndalesë.

Zhvillimi i sistemeve të ndryshme të informacionit të BE-së, të tilla si sistemi evropian i hyrjes/daljes, Sistemi i Informacionit *Schengen* dhe risitë e tjera të lidhura me IT-n, do të jenë baza për planifikimin e përmirësimit të kontroleve kufitare. Zhvillimi i mëtejshëm i infrastrukturës në pikat e kalimit kufitar do të sigurojë kontroll më efikas të kufirit dhe funksionim të qetë të transportit të udhëtarëve dhe trafikut të mallrave.

Aktualisht, menaxhimi i kufijve të Republikës së Shqipërisë synon arritjen plotësisht të kërkesave të BE-së dhe *Schengen-it*. Për përmirësimin e situatës në këtë fushë, koncepti i Menaxhimit të Integruar të Kufirit, duhet të monitorohet vazhdimisht, veçanërisht në aplikimin e procedurave, pajisjeve teknike dhe infrastrukturës kufitare, të cilat duhet të jenë në përputhje me standardet *Schengen*.

Ky objektiv synohet të arrihet nëpërmjet përmirësimit të masave të mëposhtme:

Masa 1: Vënia në zbatim e sistemit ATS-G të të dhënave të pasagjerit

Kjo masë synon sigurimin e një sistemi funksional të shkëmbimit të të dhënave të pasagjerit. Kjo masë do të realizohet nëpërmjet përgatitjes dhe miratimit të Procedurave Standarde të Punës për grumbullimin dhe përpunimin e informacionin paraprak të pasagjerëve dhe trajnimi të personelit të Komisarariatit të Policisë Kufitare Rinas për grumbullimin dhe përpunimin e informacionin paraprak të pasagjerëve.

Masa 2: Miratimi i rregullores “Për rregullat e mbikëqyrjes së kufijve detare në kuadër të bashkëpunimit operacional të koordinuar midis institucioneve kombëtare dhe Agjencisë Evropiane të Rojës Kufitare dhe Bregdetare (FRONTEX)”.

Kjo masë synon të realizojë një përafrim të pjesshëm të legjislacionit kombëtar me rregulloren e Parlamentit dhe Këshillit të Evropës nr. 656/2014. Kjo masë do të realizohet nëpërmjet ngritjes së grupit të përbashkët të punës, hartimit dhe miratimit të rregullores “Për rregullat e mbikëqyrjes së kufijve të jashtëm detarë në kuadër të bashkëpunimit operacional kombëtar e ndërkombëtar”, si dhe nëpërmjet trajnimit të personelit të agjencive të zbatimit të ligjit, për

zhvillimin e operacioneve të përbashkëta, për kontrollin e kufijve të jashtëm.

Masa 3: Miratimi i legjislacionit për ngritjen dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Kufirit

Kjo masë synon të bëjë përafrim të pjesshëm të legjislacionit kombëtar me rregulloren nr. 1052/2013, e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për ngritjen e Sistemit Evropian të Mbikëqyrjes së Kufirit (*Eurosur*). Kjo masë do të realizohet nëpërmjet aktiviteteve të mëposhtme:

- përgatitja dhe miratimi i vendimit të Këshillit të Ministrave për ngritjen e Qendrës Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Kufirit,

- realizimi i projektit dhe ndërtimi i zyrave të nevojshme për funksionimin normal të QKK-së;

- plotësimi i strukturës organike të QKK-së dhe QKR-së me personelin e nevojshëm;

- ngritja e infrastrukturës për përcjelljen e informacionit të nevojshëm në QKK dhe QKR nga të gjitha sistemet e ngritura dhe ato që do të ngrihen për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit;

- vendosja e bashkëpunimit operacional me qendrën e FRONTEX-it, qendrat e KK-së të shteteve anëtare të BE-së dhe vendeve të treta;

- vendosja e bashkëpunimit operacional me qendrat e Interpol, Europol, SIS/Sirene, oficerët ndërlidhës dhe agjencitë e tjera ndërkombëtare ligjzbatuese në kufi;

- miratimi i procedurave standarde të punës së Qendrës Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Kufirit.

Masa 4: Forcimi i autonomisë së Policisë Kufitare dhe Migracionit në fushën operationale dhe menaxheriale

Kjo masë do të realizohet nëpërmjet:

- ngritjes së strukturës së shërbimeve mbështetëse pranë Departamentit për Kufirin dhe Migracionin;

- krijimit të një banke të të dhënave për menaxhimin e burimeve logjistike të shërbimeve për kufirin dhe migracionin.

Masa 5: Zhvillimi dhe përmirësimi i Procedurave Standarde të Punës (PSP), përafrimi i tyre me standardet e kufijve *Schengen*

Kjo masë synon rishikimin dhe miratimin e procedurave standarde të punës në përputhje me Kodin *Schengen*.



1.2 Objektivi specifik 2, i qëllimit të politikës 1: Përmirësimi i sistemit për mbikëqyrjen e hapësirës detare, kontrollit kufitar dhe kërkim-shpëtimin në det.

Aktualisht mbikëqyrja e hapësirës detare kryhet nëpërmjet Sistemit të Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Detare, sistem ky në varësi të Forcës Detare/Rojës Bregdetare, por që në kuadër të QNOD-it, në të kanë akses dhe marrin informacion të gjitha institucionet shtetërore në këtë Qendër.

Nga analizat e deritanishme, rezulton se ky sistem ka nevojë për përmirësimin e kapaciteteve për kontrollin e plotë të hapësirës ujore, veçanërisht në afërsi të bregut të detit për arsye të thyeshmërisë së terrenit dhe të cilat mund të shfrytëzohen lehtësisht për veprimtari të kundërligjshme. Forca Detare/Roja Bregdetare do të nënshkruajnë një marrëveshje afatgjatë me kompaninë prodhuese të sistemit *Lockheed Martin* për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e këtij sistemi. Këto përmirësime midis të tjerash do të përfshijnë edhe vendosjen e radarëve shtesë për mbulimin e zonave të vdekura të bregdetit, si dhe të kamerave për shikimin natën.

Në funksion të përmbushjes së misionit dhe për zbatimin e detyrimeve ligjore për mbikëqyrjen dhe kontrollin e këtij kufiri, aktualisht shërbimet Policisë Kufitare kanë në dispozicion një numër të mjeteve lundruese. Një pjesë e konsiderueshme e tyre i përkasin një gjeneratë të vjetër teknologjike, kanë plotësuar ciklin jetësor të përdorimit dhe planizohen për heqjen e shpejtë nga përdorimi dhe zëvendësimin e tyre.

Me qëllim zgjidhjen e problematikës dhe rregullimin e gjendjes për përmirësimin e shërbimeve në Sektorin e Kufirit Blu, do të konsiderohet implementimi i projektit të vitit 2017, i cili në mënyrë të përmbledhur konsiston në:

- Heqjen nga përdorimi të mjeteve të vjetra lundruese (të ngelen në përdorim vetëm 7 mjetet lundruese të tipit “*FB Designe*”) dhe zëvendësimi i tyre me të reja, gjithsej 25 të tilla sipas fish projekteve të përgatitura për këtë qëllim;

- Blerjen e motorëve të rinj për mjetet “*FB Designe*” (janë blerë 6 të tillë në vitin 2018, duhen të blihen edhe 4 të tjerë për të cilët të shikohet mundësia për t’u blerë po këtë vit);

- Ndërtimin e 13 vendbazimeve, pasi aktualisht kemi vetëm 2 të tilla për mjetet lundruese të PKM (1 në Durrës dhe 1 në Pogradec).

Ky objektivi synohet të arrihet nëpërmjet përmbushjes së masave të mëposhtme:

Masa 1: Përgatitja e projektit për Sistemin elektronik të Unifikuar të Mbikëqyrjes së Kufirit Shtetëror

Kjo masë synon të realizojë ngritjen e Sistemit Elektronik të Unifikuar të Mbikëqyrjes së Kufirit Shtetëror dhe do të realizohet nëpërmjet sigurimit të mbulimit me vëzhgim të kufirit tokësor në përputhje me analizën e rrezikut dhe vlerësimin e kërcënimit me mbikëqyrje të vazhdueshme, me rritje të aftësive njerëzore dhe teknike me azhurnim të përhershëm të panoramës së situatës nga QKK-ja, ngritjes së një grupi pune ekspertësh, konceptimi i projektit paraprak, si dhe përcaktimit të përparësive për realizimin e projektit.

Masa 2: Forcimi i kapaciteteve të mbikëqyrjes elektronike të kufirit blu

Kjo masë do të realizohet nëpërmjet aktiviteteve të mëposhtme:

- përmirësimin të kapaciteteve të Sistemit aktual të Mbikëqyrjes Elektronike të Kufirit Blu me qëllim eliminimin e mangësive të konstatuara;

- ngritjes së Sistemit të Vëzhgimit të Policisë për Mbikëqyrjen e Kufijve Detarë, sistem (prej 5 radarësh dhe kamera), i cili të jetë i integruar me SIVHD dhe përcjellja nëpërmjet tij e panoramës së hapësirës detare në QKK;

- instalimit të radarëve për mbikëqyrjen elektronike të kufirit blu në liqenet e Shkodrës, Ohrit dhe Prespës;

- lidhjes dhe vendosjes së bashkëpunimit operacional midis QKK Tiranë dhe QKK të vendeve të Detit Adriatik dhe Jon (Itali, Mali i Zi, Greqi dhe Maqedoni e Veriut, për liqenet);

- marrjen dhe azhurnimin e përhershëm të panoramës së situatës në kufirin shtetëror (tokësor dhe detar) nga QKK dhe sigurimi i reagimit efektiv të strukturave në këtë fushë.

Masa 3: Forcimi i kapaciteteve logjistike të Policisë Kufitare dhe Migracionit për mbikëqyrjen e kufirit blu

Kjo masë ka për qëllim të sigurojë një flotë të patrullimit të kufirit detar krejtësisht funksionale.

Kjo masë do të realizohet nëpërmjet aktiviteteve të mëposhtme:

- pajisja e Policisë Kufitare dhe Migracionit me mjete lundruese për mbikëqyrjen e kufirit blu. Përmirësimi i aftësive të reagimit detar, do të përfshijë rinovimin e mjeteve lundruese ekzistuese



(7 të tilla) dhe blerjen e mjeteve të reja të patrullimit (15–18 mjete lundruese) me performancë të lartë, duke shfrytëzuar edhe fondet e BE-së të akorduara për këtë qëllim;

- trajnimi i personelit të Policisë Kufitare për operimin me mjetet lundruese;

- forcimi i kapaciteteve njerëzore dhe teknike të Repartit Special për Kufirin dhe Migracionin “DELTA” për mirëmbajtjen e mjeteve lundruese përmes trajnimit të personelit mirëmbajtës të mjeteve lundruese;

- ngritja e njësisë së lëvizshme të mirëmbajtjes së mjeteve lundruese dhe pajisja me mjetet e nevojshme;

- zhvillimi i trajnimeve dhe mirëmbajtja e mjeteve dhe pajisjeve të mbikëqyrjes së kufirit blu.

Masa 4: Rishikimi i Planit Kombëtar të Kërkimit dhe Shpëtimit në hapësirën detare duke u përafruar në përputhje me standardet dhe detyrimet e BE-së, me detyra të qarta dhe konkrete për të gjitha institucionet pjesëmarrëse

Kjo masë synon zbatimin e detyrimeve të Kërkimit dhe Shpëtimit në hapësirën detare në përputhje me standardet dhe detyrimet e BE, me detyra të qarta dhe konkrete për të gjitha institucionet pjesëmarrëse. Kjo masë do të realizohet nëpërmjet aktiviteteve të mëposhtme:

- përgatitja e urdhrimit dhe ngritja e grupit të punës për përgatitjen e draftit të Planit Kombëtar të kërkim–shpëtimit në det;

- miratimi i Planit Kombëtar të Kërkimit dhe Shpëtimit në hapësirën detare;

- përgatitja e draftit të procedurave të përbashkëta standarde të punës për zhvillimin e operacioneve të kërkim–shpëtimit në det;

- miratimi i procedurave standarde të punës për zhvillimin e operacioneve të kërkim–shpëtimit në det;

- trajnimi i përbashkët i personelit të agjencive të zbatimit të ligjit për zhvillimin e operacioneve të kërkim–shpëtimit në det.

Masa 5: Zhvillimi i fushatave ndërgjegjësuese për detyrimet e subjekteve shtetërore dhe private për shpëtimin e jetëve në det

Kjo masë synon ndërgjegjësim të subjekteve shtetërore dhe private që ushtrojnë aktivitetet në hapësirën blu, për zbatimin e detyrimeve për shpëtimin e jetëve në det, sipas legjislacionit

kombëtar dhe ndërkombëtar. Masa do të realizohet nëpërmjet këtyre aktiviteteve:

- Zhvillimi takimeve informuese me subjektet shtetërore dhe private që ushtrojnë aktivitetet në hapësirën blu, për detyrimin për shpëtimin e jetëve në det, sipas legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar;

- Prodhimi dhe shpërndarja e materialeve informuese rreth detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni ndërkombëtar për shpëtimin e jetëve në det.

1.3 Objektivi specifik 3, i qëllimit të politikës 1: Reduktimi i vulnerabilitetit (ndjeshmërisë) në kufi duke reaguar në mënyrë më efektive me vendosjen e burimeve të disponueshme, bazuar në analizën e rrezikut të kryer dhe kërcënimit që mund të ndikojë në sigurinë kufitare, në përputhje me modelin e CIRAM-it të BE-së.

Departamenti i Policisë Kufitare dhe Migracionit ka krijuar një model të analizës së rrezikut në përputhje me metodologjinë e FRONTEx (CIRAM 2.0). Analiza e rrezikut bëhet në të tre nivelet (qendror, rajonal dhe lokal), e cila është e detyrueshme dy herë në vit, si dhe analiza të synuara siç kërkohet.

Miratimi i një udhëzuesi për zhvillimin e analizës së rrezikut në të tre nivelet, në përputhje me metodologjinë e FRONTEx-it (CIRAM 2.0), është i nevojshëm, i cili të jetë në përputhje me Modelin e Përbashkët të Analizës së Riskut, që po ndiqet në Departament. Në të tria nivelet, për oficerët e përfshirë në analizën e rrezikut, janë kryer trajnime, si dhe janë planifikuar masa të reja në periudhën e ardhshme. Ngritja e një sistemi për përpilimin, vlerësimin, shpërndarjen dhe përcjelljen e informacionit operacional INFOSTREAM, bazuar në modelin 4x4, konsiderohet një domosdoshmëri.

Bashkëpunimi me FRONTEx është konstant dhe zbatohet përmes WB-RAN (Rrjeti i Analizës së Riskut në Ballkanin Perëndimor), brenda së cilës hartohet një AR vjetor për vendet e Ballkanit Perëndimor nga FRONTEx dhe vendet anëtare të WB RAN. Në bashkëpunim me FRONTEx, u zhvillua një broshurë në lidhje me treguesit e rrezikut të zakonshëm për luftëtarët e huaj terroristë, e cila iu dha për përdorim të gjitha vendkalimeve kufitare.



Shkëmbimi i informacionit dhe të të dhënave është konsoliduar gjithnjë e më shumë me vendet fqinje, por nevojitet përmirësim më i qartë i bashkëpunimit. Ndërkohë, me përfaqësuesit e shërbimeve kufitare të vendeve fqinje zhvillohen takime të rregullta në nivelin qendror, rajonal dhe lokal.

Përmirësimi në mënyrë të përhershme, vendosja e kapaciteteve të përbashkëta të sistemit të analizës së rrezikut dhe zbatimi i masave antikorrupsion, është i nevojshëm, pasi kontrollat kufitare bazohen në analizën e rreziqeve dhe inteligjencën kriminale. Planet operationale të Policisë Kufitare hartohen mbi bazën e një analize rreziku dhe azhurnohen vazhdimisht.

Analiza e rrezikut kufitar përfshin sigurinë e brendshme dhe analizën e kërcënimeve që mund të ndikojnë në funksionimin e sigurisë kufitare.

Analiza e rrezikut të menaxhimit të kufijve bazohet në modelin CIRAM të BE-së, sipas të cilit rreziku analizohet përmes katër niveleve të kontrollit të qasjes. Qëllimi i përmirësimit të filtrit të sistemit të administrimit të rreziqeve për menaxhimin e kufijve është të mbështesë vendimmarrjen, si dhe të sigurojë përdorim fleksibël dhe ekonomik të burimeve në zonat ku rreziqet janë më të larta.

Sistemi i analizës së rrezikut të Policisë Kufitare prodhon informacion analitik dhe një tablo situacionale për planifikimin dhe vendimmarrjen, në nivel strategjik, operacional dhe taktik. Sektori i Analizës së Riskut të Policisë Kufitare bashkëpunon ngushtë me Policinë Kriminale, Doganat, vendet fqinje dhe FRONTEx-i për të parandaluar, zbuluar dhe luftuar krimin ndërkufitar. Për më tepër, Policia Kufitare dhe Doganat do të krijojnë një grup të përbashkët për analizën e rrezikut.

Gjithashtu, shërbimet veterinarë dhe fitosanitare kufitare duhet të përfshihen në sistemin e analizës së rrezikut.

Ky objektivi synohet të arrihet nëpërmjet përmirësimit të masave të mëposhtme:

Masa 1: Zhvillimi dhe aplikimi i Modelit CIRAM për analizën e riskut në të gjitha strukturat qendrore dhe vendore për kufirin dhe Migracionin

Kjo masë synon të realizojë aplikimin e Modelit CIRAM të analizës së riskut në të gjitha strukturat

qendrore të DKM, i cili do të ndikojë në rritjen e identifikimit të aktiviteteve të paligjshme në kufi.

Masa 2: Forcimi i kontrolleve në kufi me qëllim uljen e krimit ndërkufitar

Kjo masë synon të rrisë dhe forcojë shërbimet për kontrollin kufitar me qëllim parandalimin dhe reduktimin e kalimeve të paligjshme në kufi.

Kjo masë do të realizohet nëpërmjet aktiviteteve të mëposhtme:

- reduktimi në masën 10 % i numrit të kalimeve të paligjshme në pikat e kalimit kufitar dhe aktiviteteve kriminale ndërkufitare (parandalimi i kalimit të paligjshëm të kufirit në pikat kufitare me dokumentin e udhëtimit të dikujt tjetër ose dokumentin e falsifikuar të udhëtimit dhe hyrjen e paautorizuar në Republikën e Shqipërisë për shkak të mos përmirësimit të kushteve);

- rritja në masën 10 % e numrit të personave, mjeteve motorike dhe dokumenteve të udhëtimit të kapur e të ndaluar në kufi;

- reduktimi i numrit të rrugëve të paligjshme të kalimit kufitar (jashtë PKK-ve) dhe aktiviteteve kriminale ndërkufitare (parandalimi i kalimit të paligjshëm të kufirit nga jashtë brenda dhe nga brenda jashtë pikave të kalimit kufitar).

Masa 3: Hartimi dhe miratimi i një plani masash për reagimin e menjëhershëm sipas analizës së riskut dhe zhvillimeve të mundshme të papritura në kufirin shtetëror

Kjo masë synon hartimin e një plani masash të parashikuara për zbatim të menjëhershëm në rast situatë të paparashikuara.

Masa 4: Forcimi i burimeve njerëzore të Policisë Kufitare dhe Migracionit

Kjo masë synon të plotësojë me burime njerëzore të shërbimeve të PKM sipas nevojave dhe rekomandimeve të BE-së. Masa 4, do të realizohet nëpërmjet aktiviteteve të mëposhtme:

- alokimi i 300 funksioneve shtesë për Policinë Kufitare dhe Migracionit dhe shpërndarja e tyre sipas analizës së riskut dhe nevojave operationale;

- trajnimi bazë për rojet kufitare të rekrutuara pas alokimit të funksioneve shtesë.

Masa 5: Zhvillimi i sistemit të analizës së përbashkët të riskut dhe vlerësimit të kërcënimeve në kuadër të Qendrës Kombëtare të Menaxhimit të Integruara të Kufirit, nëpërmjet së cilës synohet zhvillimi i analizave të përbashkëta 6-mujore dhe vjetore.



Masa 6: Pajisja e shërbimeve të mbikëqyrjes së kufirit me mjete dhe pajisje speciale

Kjo masë ka për qëllim të realizohet nëpërmjet masave të mëposhtme:

- pajisja e shërbimeve të mbikëqyrjes së kufirit me kamera termike, dylbi dite dhe dylbi nate;
- pajisja e shërbimeve të mbikëqyrjes së kufirit me sisteme të mbikëqyrjes së kufirit (TVV Van);
- instalimi i kullave të mbikëqyrjes së kufirit të pajisura me pajisje speciale (radarë, kamera termike, multisensor, mjete të vëzhgimit gjatë ditës).
- pajisja e shërbimeve të mbikëqyrjes së kufirit me kamera SMARTDEC.

Masa 7: Pajisja e shërbimeve të kontrollit të kufirit me pajisje speciale.

Kjo masë do të realizohet nëpërmjet aktiviteteve të mëposhtme:

- pajisja e pikave të kalimit kufitar me fibro/videoskope;
- pajisja e pikave të kalimit kufitar me pajisje për kontrollin e dendësisë (*buster*);
- pajisja e pikave të kalimit kufitar me pajisje për detektimin e radioaktivitetit (*pager*);
- rritja e numri të qenve të policisë për lëndët narkotike.

Masa 8: Sigurimi i radiokomunikimit për të gjitha strukturat vendore të Policisë Kufitare dhe Migracionit.

Kjo masë synon rritjen e efciencës së shërbimeve të kufirit nëpërmjet vënies në funksion të sistemit të radiokomunikimit për Policinë Kufitare dhe Migracionit. Kjo masë do të realizohet nëpërmjet aktiviteteve të mëposhtme:

Kryerja e një studimi të plotë për mundësinë e rivendosjes në funksion të sistemit aktual të radiokomunikimit për strukturat vendore të

Policisë Kufitare dhe identifikimi i buxhetit të nevojshëm për këtë qëllim.

Vënia në funksion e sistemit të radiokomunikimit për Policinë Kufitare dhe Migracionit dhe përmirësimi i sistemit të komunikimit në hapësirën detare TETRA.


Pajisja me radio komunikimi (stacionare dhe portabël) i të gjitha shërbimeve të Policisë Kufitare dhe Migracionit.

Vënia në funksionim e kanaleve VHF 60 dhe 60 (të miratuara nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, AKEP) për komunikimin me radio në hapësirën detare me mjetet lundruese të PKM.

Masa 9: Pajisja e shërbimeve të Policisë Kufitare dhe Migracionit me automjete patrullimi dhe mjete transporti për shërbimet dhe migrantët e parregullt, nëpërmjet së cilës synohet pajisja e DKM me 10 mjete patrullimi dhe 5 furgonë.

1.4 Objektiv i specifik 4, i qëllimit të politikës 1: Bashkëpunim i zgjeruar ndërinstitucional në menaxhimin e integruar të kufijve për të përmirësuar trafikun ndërkuftar, përmirësimin e sigurisë kufitare, luftën ndaj krimit ndërkuftar, mbrojtjen e jetës, shëndetit dhe pronën e njerëzve, shëndetin e kafshëve, bimësinë dhe ekosistemet përgjatë kufirit shtetëror.

Bashkëpunimi ndërsektorial përbën themelin e Menaxhimit të Integruar të Kufirit, që kërkon ndarje të koordinuar të punës, vendosjen e standardeve për bashkëpunim, promovimin e përdorimit të përbashkët të të gjitha kapaciteteve, kanalet e komunikimit dhe sinkronizimin e procedurave të punës.





Bashkëpunimi ndërsektorial mundëson angazhimin dhe përdorimin optimal të burimeve njerëzore, teknike dhe buxhetore të agjencive të përfshira në zbatimin e Strategjisë, me qëllim lehtësimin e qarkullimit legjitim të shtetasve dhe mallrave, përmirësimit të sigurisë kufitare, mbrojtjes së jetës, shëndetit dhe pronës së njerëzve, shëndetit të kafshëve, bimësisë dhe ekosistemeve përgjatë kufirit shtetëror, si dhe parandalimin e goditjen e krimit ndërkufitar.

Ky bashkëpunim në veçanti ka të bëjë me koordinimin e punës dhe promovimin e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve kompetente për kontrollin dhe mbrojtjen e kufijve, analizën e përbashkët të rrezikut, krijimin e ekipeve të përbashkëta të punës, zbatimin e veprimeve të përbashkëta, ofrimin e mbështetjes profesionale dhe teknike, përdorimin e përbashkët të pajisjeve, arsimit dhe trajnime të përbashkëta, bashkëpunimin me autoritete të tjera, bashkëpunimin ndërkombëtar, shkëmbimin e të dhënave dhe informacionit. Ai gjithashtu nënkupton bashkëpunim me institucionet, autoritetet, zyrat dhe agjencitë përkatëse të Bashkimit Evropian, përfshirë shkëmbimin e përhershëm të informacionit përmes përdorimit të instrumenteve ekzistuese, siç është Sistemi Evropian i Mbikëqyrjes së Kufijve “EUROSUR”, i krijuar me Rregulloren (BE) nr. 1052/2013, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të 22 tetorit 2013.

Rregullorja (BE) 2019/1896, u rekomandon shteteve anëtare të krijojnë qendra kombëtare koordinimi në mënyrë që të përmirësojnë shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërmjet shteteve anëtare, në lidhje me mbrojtjen e kufirit kombëtar dhe zbatimin e kontrollit kufitar. Për funksionimin efektiv të EUROSUR-it, është thelbësore që të gjitha autoritetet kombëtare përgjegjëse për mbrojtjen e kufijve të jashtëm të bashkëpunojnë përmes Qendrave Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Kufirit. Në këtë kontekst, Shqipëria do t'i kushtojë vëmendje të veçantë ngritjes së Qendrës Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Kufirit.

Për Menaxhimin e Integruar të Kufirit në nivel lokal, do të ngrihen bordet e Menaxhimit të Integruar të Kufirit. Bordet do të drejtohen nga drejtorët e drejtorive vendore për kufirin dhe

migracionin me anëtar drejtorët e degëve të doganës, drejtorët rajonalë të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, drejtorët rajonalë të Institutit të Shëndetit Publik dhe drejtorët e drejtorive vendore të policisë. Bordet do të mbledhen çdo tre muaj për të analizuar zbatimin e Strategjisë në nivel lokal dhe do të shqyrtojnë hartimin dhe miratimin e mundshëm të planeve të përbashkëta të masave për adresimin e çështjeve në interes të menaxhimit dhe sigurisë kufitare. Pas çdo mbledhje, bordet do të informojnë Sekretariatit Teknik.

Ky objektivi synohet të arrihet nëpërmjet përbushjes së masave të mëposhtme:

Masa 1: Përgatitja e Rregullores së Bashkëpunimit ndërmjet Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave në kuadër të Menaxhimit të Integruar të Kufirit;

Masa 2: Rishikimi i Rregullores së Bashkëpunimit ndërmjet Policisë së Shtetit, Shërbimit Doganor, Shërbimit Veterinar dhe Shërbimit Fitosanitar, të vitit 2009, në përputhje dhe ndryshimet institucionale dhe ligjore;

Masa 3: Ngritja e Grupit të Përhershëm të Punës për studimin e përbashkët të nevojave dhe aplikimin për investime dhe projekte në fushën e sigurisë kufitare;

Masa 4: Studimi i nevojave dhe përgatitja, miratimi dhe implementimi i planeve vjetore të trajnimeve të përbashkëta të personelit të agjencive të zbatimit të ligjit që operojnë në kufi;

Masa 5: Forcimi i kapaciteteve për shkëmbimin e informacionit të kohë reale, ndërmjet Agjencive të Zbatimit të Ligjit që operojnë në kufi;

Masa 6: Forcimi i bashkëpunimit me operatorët në transportin ajror, detar dhe hekurudhor;

Masa 7: Hartimi i modulit me temë “Menaxhimi i integruar i kufirit një nga detyrimet për integrimin e Shqipërisë në BE;

Masa 8: Mundësimi i aksesimit në bazën e të dhënave shtetërore “Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK)”, me qëllim përmirësimin e infrastrukturës për monitorimin e qarkullimit civil dhe fizik të pasurive kulturore.

1.5 Objektivi specifik 5, i qëllimit të politikës 1: Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar, veçanërisht me vendet fqinje, institucionet e BE-së dhe Agjencinë Evropiane të Rojës Kufitare dhe Bregdetare (FRONTEX) për çështjet e kufijve, parandalimin e migracionit të



paligjshëm, krimin ndërkufitar dhe ripranimin e personave me qëndrim të parregullt.

Bashkëpunimi ndërkombëtar është intensifikuar dhe është regjistruar një trend i rritjes së aktiviteteve ndërkombëtare, përmes shkëmbimit të informacionit dhe veprimeve të përbashkëta.

Bashkëpunimi me vendet fqinje

Marrëveshja për ngritjen e Pikave të Përbashkëta të Kalimit Kufitar me Republikën e Kosovës, atë të Grabomit dhe të Zogajve me Malin e Zi, kanë qenë hapa të rëndësishëm në forcimin e bashkëpunimit ndërkufitar për lehtësimin e qarkullimit legjitim të shtetasve dhe mallrave. Ndërkohë, duhet të vijojnë përpjekjet për ndryshim e statusit të të gjitha pikave të kalimit kufitar me Malin e Zi, si dhe nënshkrimin e marrëveshjes për ndryshimin e statusit të të gjitha pikave të kalimit kufitar me Maqedoninë e Veriut.

Ndërkohë, kërkohet të forcohet bashkëpunimi operacional për mbikëqyrjen e përbashkët të kufirit, duke rritur numrin e patrullimeve të përbashkëta me Malin e Zi, Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut.

Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet nënshkrimit të marrëveshjes për ngritjen dhe funksionimin e Qendrës së Bashkëpunimit Policor dhe Doganor me Greqinë, në Kakavijë, ndërsa do të propozohet ngritja e një qendre të tillë edhe në Kapshticë.

Autoritetet shqiptare do të jenë të përkushtuara për të adresuar çështjet bilaterale me vendet fqinje, duke arritur kështu një nga ato përparësi të rëndësishme të politikës së jashtme të Republikës së Shqipërisë, atë të fqinjësisë së mirë.

Bashkëpunimi rajonal

Marrëveshja që aktualisht negociohet, e njohur si “Shengeni Ballkanik”, do të jetë një tjetër hap i rëndësishëm për lehtësimin e qarkullimit të shtetasve, edhe me kartë identiteti, dhe të mallrave. Nga ana tjetër, kjo marrëveshje do të kontribuojë në përafrimin e kuadrit ligjor dhe atij praktik, me ato të Bashkimit Evropian.

Gjithashtu, kërkohet që të gjenden mekanizmat e bashkëpunimit rajonal, për reagimin e shpejtë në rast të përkeqësimit të situatës së migracionit të parregullt në kufijtë e secilit prej vendeve të rajonit, ku të parashikohet mbështetja me burime njerëzore dhe logjistike, për menaxhimin e një situatë të mundshme.

Qendrat rajonale të bashkëpunimit konsiderohen si një mekanizëm efektiv në

menaxhimin e kufijve të përbashkët. Prandaj kërkohet të shikohet mundësia e ngritjes së një qendre rajonale për koordinimin e mbikëqyrjes së kufirit detar, me pjesëmarrjen e vendeve që lagen nga deti Adriatik dhe Deti Jon.

Njëkohësisht, do të forcohet bashkëpunimi dhe pjesëmarrja në aktivitete që do të zhvillohen nga institucionet e bashkëpunimit rajonal si: Sekretariati i Konventës së Bashkëpunimit Policor në Evropën Juglindore; Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC); Qendra për Zbatimin e Ligjit në Evropën Juglindore (SELEC); Iniciativa Rajonale për Migracionin, Azilin dhe Refugjatët.

Bashkëpunimi me Agjencinë Evropiane të Rojës Kufitare dhe Bregdetare (FRONTEX)

Marrëveshja Statutore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian “Për veprimet e ndërmarra nga Agjencia Evropiane e Rojës Kufitare dhe Bregdetare (FRONTEX) në Shqipëri”, ratifikuar me ligjin nr. 6/2019, datë 7.2.2019, përfshin të gjitha aspektet e zbatimit të aktiviteteve të Agjencisë që mund të zhvillohen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Kjo nënkupton zhvillim e operacioneve të përbashkëta në territorin e Republikës së Shqipërisë, siç është Operacionin JO FOA *Western Balkan*, në Shqipëri, i cili filloi zbatimin me 22 maj 2019. Ky është operacioni i parë që Agjencia Evropiane e Rojës Kufitare dhe Bregdetare zhvillon në një vend të tretë, e cila konsiderohet histori suksesi.

Ky bashkëpunim, do të forcohet më tej dhe do të zgjerohet me zhvillimin e Operacioneve të ngjashme në kufirin detar.

Vendosja e oficerit ndërlidhës të FRONTEX-it në Shqipëri, do të jetë një tjetër hallkë e rëndësishme e bashkëpunimit shumëpalësh ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Evropiane të Rojës Kufitare dhe Bregdetare. Ky bashkëpunim do të kontribuojë edhe aplikimin e standardeve Evropiane në Menaxhimin e Integruar të Kufirit, nëpërmjet ekspertizës në mbështetjes në fushën e forcimit të kapaciteteve profesionale dhe logjistike.

Masat në vendet e tjera

Bashkëpunimi ndërkombëtar operacional kërkon ngritjen e një grupi të ekspertëve të fushave të ndryshme të sigurisë kufitare të cilët duhet të jenë të gatshëm në çdo kohë për t'u angazhuar me detyra në vendet e tjera. Identifikimi i këtyre ekspertëve duhet të bëhet mbi baza të forta të



eksperiencës dhe rezultateve në punë, si dhe të aftësisë për të trajnuar dhe operuar në ambiente pune multinacionale.

Situatat e ndryshme që shkaktohen nga fenomene të diktuara nga situatat e sigurisë në vendet tjera, mund të diktojnë nevojën e vendosjes së oficerëve ndërlidhës. Shembulli i qartë është situata e imigracionit të parregullt të shtetasve të vendeve të treta drejt kufijve tanë, por edhe imigracioni i parregullt i shtetasve shqiptar në vendet tjera. Në këto kushte, duhet të merren masa për identifikimin e kandidatëve të mundshëm për oficerë ndërlidhës të migracionit, të cilët do të shërbejnë si ura lidhëse ndërmjet shërbimeve të policisë kufitare dhe migracionit të vendeve të tjera me ato shqiptare, të cilët do të kontribuojnë në shkëmbimin e informacionit në fushën e migracionit dhe do të lehtësojnë procedurat e kthimit. Po kështu, do të punohet për nënshkrimin e marrëveshjeve dypalëshe të ripranimit me këto shtete.

Ndryshimi situatës në kufijtë e vendeve të tjera, qoftë ato fqinje por edhe të vendeve të Bashkimit Evropian, mund të diktojë nevojën e pjesëmarrjes në operacione në nivel bilateral, por edhe të koordinuara nga Agjencia Evropiane e Rojës Kufitare dhe Bregdetare (FRONTEX). Shqipëria ka kontribuar dhe vijon të kontribuojë në operacione të tilla. Pjesëmarrja në këto operacione do të vijojë dhe njëkohësisht do të zgjerohet numri i pjesëmarrësve të mundshëm në këto operacione.

Për shkëmbimin e informacionit midis agjencive ligjzbatuese dhe ndërmjet të gjitha vendeve anëtare të CEFTA-s do të implementohet platforma SEED+, e cila do të mundësojë shkëmbimin e informacioneve paraprake, jo vetëm ndërmjet autoriteteve doganore, por edhe autoriteteve të tjera që veprojnë në kufi.

Ky objektivi synohet të arrihet nëpërmjet përmbushjes së masave të mëposhtme:

Masa 1: Nënshkrimi i Marrëveshjes për ngritjen e Qendrës së Bashkëpunimit Policor dhe Doganor me Greqinë, në Kakavijë dhe vënia në funksionim e kësaj Qendre;

Masa 2: Ndërtimi dhe vënia në funksion e pikës së përbashkët të kalimit kufitar Zogaj;

Masa 3: Vënia në funksion e Pikës së Përbashkët të Kalimit Kufitar me Malin e Zi, në Grabom;

Masa 4: Forcimi i bashkëpunimit me Agjencinë Evropiane të Rojës Kufitare dhe Bregdetare, FRONTEX, nëpërmjet së cilës synohet rritja e nivelit të përgjegjësisë të shërbimeve në kufi për respektimin e të drejtave të njeriut në përputhje me konventat përkatëse, marrja e masave dhe zhvillimi i operacioneve të përbashkëta me FRONTEX për parandalimin dhe bllokimin e migracionit të paligjshëm nëpërmjet kufijve shtetërorë;

Masa 5: Vendosja e bashkëpunimit operacional midis QKK Tiranë dhe Qendrave të Përbashkëta për Bashkëpunimin në Plavë, Vërmicë (Morinë) dhe Qafë Thanë, nëpërmjet së cilës synohet forcimi i bashkëpunimit ndërkufitar me vendet fqinje në zbatim të Marrëveshjeve e Protokolleve për shkëmbimin e informacionit me policinë kufitare të vendeve fqinje;

Masa 6: Forcimi i bashkëpunimit ndërkufitar me vendet fqinje në zbatim të Marrëveshjeve e Protokolleve për patrullimet e përbashkëta kufitare me policinë kufitare të vendeve fqinje, nëpërmjet së cilës synohet rritja e numrit të patrullimeve dhe operacioneve të përbashkëta;

Masa 7: Përmirësimi i sistemit, që mundëson shkëmbimin e informacioneve paraprake me administratat doganore të vendeve anëtare të CEFTA-s dhe ndërmjet agjencive që operojnë në kufi nëpërmjet implementimit të platformës SEED+.

1.6 Objektivi specifik 6, i qëllimit të politikës 1: Përmirësimi i sistemit të ripranimit (kthimit dhe pranimit) të shtetasve të huaj dhe vendas në përputhje me marrëveshjet e lidhura dhe në bashkëpunim me misionet diplomatike dhe konsullore.

Kthimi efektiv i shtetasve të huaj nënkupton kthimin e personave të cilëve u është refuzuar hyrja në kufi ose që kanë një vendim përfundimtar për t'u kthyer, duke u dhënë përparësi atyre që paraqesin një rrezik sigurie. Ministria e Brendshme, nëpërmjet strukturës së Departamentit për Kufirin dhe Migracionin në Policinë e Shtetit; Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nëpërmjet Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen dhe Drejtat e Fëmijës; Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme nëpërmjet strukturës për çështjet konsullore, kanë përgjegjësinë kryesore për hartimin e politikave për kthimin/ripranimin e të huajve me qëndrim të paligjshëm në Shqipëri, si dhe për implementimin e instrumenteve juridike



dypalëshe dhe shumëpalëshe (marrëveshje ripranimi), me qëllim ndjekjen dhe kryerjen e procedurave të kthim/ripranimit të shtetasve të saj, kthimet vullnetare, kthim vullnetar i asistuar, zbatimi i së cilës asistohet nga Organizata Ndërkombëtare për Migracionin në Shqipëri (IOM). Inicimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të ripranimit është një politikë konstante institucionale.

Zbatimi i procesit të kthim/ripranimeve mbështetet nga oficerët e kontaktit shqiptarë dhe/ose të huaj, si dhe stafet konsullore shqiptare dhe/ose të huaja që marrin pjesë në praktikën e bashkëpunimit për realizimin e kthim/ripranimit të personave. Si rezultat i refuzimit të azilkërkimit për shtetas shqiptarë në disa shtete të BE-së, kthimet, pas përfundimit të procesit të azilkërkimit, nga një natyrë detyruese janë konvertuar në një natyrë vullnetare. Bisedimet dypalëshe i kanë paraprirë potencimit të fenomenit të kthimit vullnetar, kryesisht nëpërmjet fluturimeve speciale, me eskortat e tyre, nga shtete të BE-së si Gjermania, Franca, Britania e Madhe, Suedia, Spanja, Holanda, Belgjika, Italia etj. Shumë fluturime të kësaj natyre koordinohen nga FRONTEX (Agjencia Evropiane e Menaxhimit të Kufijve dhe Rojës Bregdetare). Që nga viti 2014 e në vazhdim, në koordinim me FRONTEX dhe në bashkëpunim me disa vende të BE-së (kryesisht Franca), kryhen periodikisht fluturime të përbashkëta riatdhesimi (*CRO-Collecting Return Operation*) me eskortë shqiptare, e trajnuar dhe certifikuar nga FRONTEX. Avokati i Popullit (*Ombudsman*), si monitorues kombëtar, është i pranishëm në çdo fluturim të tillë, me qëllim monitorimin dhe respektimin e të drejtave të shtetasve, subjekte të kthim/ripranimit.

Sistemi elektronik (FER) i hedhjes dhe menaxhimit të dhënave identitare dhe biometrike për shtetasit e huajt me qëndrim të parregullt, implementimi i së cilës ka filluar në gusht 2014, përbën një bazë të fuqishme informacioni që mundëson në kohë reale përfundimin dhe shkëmbimin e informacionit operacional në kuadër të trajtimit të çështjeve të migracionit të parregullt dhe kthimeve.

Për të siguruar kushtet për një kthim efektiv në vendin e origjinës apo të tranzitit policia kufitare dhe migracionit mund të marrë masën e ndalimit administrativ në një qendër. Ndalimi në një Qendër të Mbyllur është masa e fundit administrative që

merret dhe ekzekutohet nga autoriteti shtetëror përgjegjës për trajtimin e të huajve kur janë ezauruar të gjitha masat e mundshme alternative. I huaji mbahet i ndaluar në qendër të mbyllur, të ngritur posaçërisht për këtë qëllim, në afate sa më të shkurtra kohore, derisa të kryhen procedurat ligjore për të mundësuar largimin/dëbimin e tij nga Republika e Shqipërisë.

Inicimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të ripranimit të shtetasve të vendeve të treta/personave pa shtetësi me vendet e origjinës dhe tranzitit, është dhe mbetet një politikë konstante institucionale.

Në fushën e trajtimit të migracionit të parregullt duke siguruar kthimin efikas dhe të qëndrueshëm, për Shqipërinë vazhdon të jetë prioritet në veçanërisht kthimi vullnetar. Në përputhje me direktivën e kthimit, politika e kthimit në Shqipëri mbështet kthimin vullnetar të personave të cilët janë subjekt i një mase ligjore për t'u larguar nga territori i Shqipërisë. Politikën e kthimit, ripranimeve, politika e largim/dëbimeve, politika e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të imigrantëve dhe mbrojtjes së të dhënave personale, masat represive dhe ankimi ndaj tyre etj., janë të shprehura në normativën ligjore për të huajt (ligji nr. 108/2013, "Për të huajt", i ndryshuar, me ligjin nr. 74/2016, dhe aktet normative në zbatim të tij; udhëzimi i ministrit të Brendshëm nr. 293, datë 4.6.2015, "Mbi trajtimin e shtetasve të huaj me qëndrim të parregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë"; procedura standarde për procesin e përzgjedhjes nr. 172, datë 8.2.2018; procedura standarde e largim/dëbimit nga territori i RSH-së nr. 176, datë 8.2.2018).

Departamenti për Kufirin dhe Migracionin ndjek dhe përditëson panoramën situacionale dhe prognozën e situatës së kthimeve. Kthim/ripranimet e shtetasve të huaj përbëjnë një sfidë për autoritetin e policisë kufitare dhe migracionit. Strukturat e interesuara në Ministrinë e Brendshme dhe Departamenti për Kufirin dhe Migracionin në Policinë e Shtetit, në bashkëpunim të vazhdueshëm me Ministrinë e përfshira në çështjet e kthim/ripranimeve, do të ndjekin në dinamike evolucionin ligjor dhe praktikën më të mira evropiane në fushën e kthimeve me qëllim transpozimin e tyre në legjislacionin kombëtar.

Ky objektivi synohet të arrihet nëpërmjet përbushjes së masave të mëposhtme:



Masa 1: Hartimi dhe nënshkrimi i Marrëveshjeve të Ripranimit me: Indinë, Algjerinë, Egjiptin, Pakistanin, Marokun, nëpërmjet së cilës synohet forcimi i bashkëpunimit për përmirësimi i sistemit të ripranimit të shtetasve të huaj dhe vendas në përputhje me marrëveshjet dhe detyrimet reciproke.

Masa 2: Hartimi dhe miratimi i udhëzimit për asistencën në rastet e transitit për qëllim largimi në rrugë ajrore, nëpërmjet së cilës synohet forcimi i bashkëpunimit dypalësh dhe shumëpalësh nëpërmjet krijimit të kuadrit normativ/procedural për ofrimin e asistencës në tranzit për qëllim largimi në rrugë ajrore.

Masa 3: Hartimi dhe miratimi i udhëzimit për organizimin dhe pjesëmarrjen në fluturimet e përbashkëta të dy ose më shumë shteteve, me qëllim dëbimin nga territori të të huajve të cilët janë subjekt i urdhrit individual të dëbimit, nëpërmjet së cilës synohet standardizimi komunitar i kuadrit procedural të bashkëpunimit dypalësh dhe shumëpalësh me qëllim rritjen e numrit të kthimeve efektive në vendet e origjinës.

Masa 4: Hartimi dhe miratimi i udhëzimit ndërinstytucional për procedurat e kthimit vullnetar dhe kthimit vullnetar të asistuar (KVA), nëpërmjet së cilës synohet krijimi i kuadrit procedural të bashkëpunimit ndërinstytucional për kthimin vullnetar të asistuar dhe rritja e numrit të shtetasve të kthyer nëpërmjet kësaj procedure.

Masa 5: Forcimi i kapaciteteve institucionale për realizimin e kthimeve dhe mundësimin e burimeve njerëzore/logjistike dhe trajnimin e specializuar për drejtues eskorte dhe eskorta, nëpërmjet së cilës synohet sigurimi i bazës materiale/logjistike adekuate dhe fillimi i fluturimeve nacionale dhe të përbashkëta të kthimeve në kuadrin e implementimit të marrëveshjeve të ripranimit.

Masa 6: Përmirësimi i kushteve të trajtimit dhe akomodimit të migrantëve në Qendrën e Mbyllur për të Huajt Karreç/Rinovimi i Qendrës së Karrecit, nëpërmjet së cilës synohet plotësimi i standardeve të trajtimit të migrantëve në QMH, në përputhje me konventa ndërkombëtare.

QËLLIMI I POLITIKËS 2: LEHTËSIMI I QARKULLIMIT LEGAL TË SHTETASVE DHE MALLRAVE

2.1 Objektivi specifik 1, i qëllimit të politikës 2: Përmirësimi i infrastrukturës në Pikat e Kalimit

Kufitar me qëllim krijimin e kushteve që sigurojnë kalim të lehtësuar dhe të sigurt të shtetasve dhe mallrave.

Ministria e Brendshme vazhdon të ndërmarrë aktivitete për ndërtimin, rindërtimin, adaptimin dhe pajisjen e vendkalimeve kufitare, duke marrë parasysh që tendenca e vazhdueshme e rritjes së trafikut në pikat e kalimit kufitar kërkon përmirësimin e duhur të infrastrukturës kufitare. Aktivitetet për ndërtimin dhe pajisjen e pikave të kalimit kufitar janë ndërmarrë për të bërë të mundur që kontrolli kufitar të kryhet në mënyrë të sigurt, në përputhje me standardet dhe kushtet e përcaktuara. Përparim të konsiderueshëm ka pasur në drejtim të rregullimit dhe pajisjeve, por jo të gjitha pikat e kalimit kufitar kanë përmbushur kriteret e përcaktuara në përputhje me dekretin për standardet dhe kushtet, të cilat duhet të përmbushen në drejtim të rregullimit dhe pajisjeve, sipas rekomandimeve të BE-së dhe katalogut të praktikave më të mira në këtë fushë. Gjithashtu, analiza e funksionimit të vendkalimeve kufitare është një fokus i vazhdueshëm i Policisë së Shtetit dhe Ministrisë së Brendshme, në kuptim të përmirësimit të infrastrukturës në pikat e kalimit kufitar, me qëllim të lehtësimin e procedurave të kalimit të kufirit shtetëror, veçanërisht gjatë sezonit turistik të verës. Në këtë drejtim, janë instaluar pajisje, kryesisht lexues të dokumenteve të udhëtimit, pajisje kompjuterike dhe kabina shtesë kontrolli në korsitë e trafikut, të cilat shpejtojnë procedurat kufitare dhe shkurtojnë kohën e pritjes në pikat e kalimit kufitar.

Instalimi i kamerave të vëzhgimit dhe lexuesve të targave në pikat e kalimit kufitar do të përmirësojë sistemin e kontrollit kufitar, i cili do të shkurtojë kohën e qëndrimit në pikat e kalimit kufitar, dhe pajisjet e instaluar do të shpejtojnë shumë kontrollin kufitar në pikat e kalimit kufitar.

Plani i Veprimit për zbatimin e Strategjisë parashikon veprimtari të rëndësishme për ndërtimin dhe rindërtimin e infrastrukturës kufitare me qëllim të kontrollit më efikas të kufirit.

Ky objektivi synohet të arrihet nëpërmjet përmbushjes së masave të mëposhtme:

Masa 1: Përfundimi i punës për studimin e nevojave për përmirësimin e infrastrukturës në Pikat e Kalimit Kufitar, nëpërmjet së cilës synohet standardizimi i pajisjeve të përdorura nga Policia



Kufitare dhe Dogana për kontrollet kufitare në përputhje me rekomandimet e Katalogut *Schengen*.

Masa 2: Rindërtimi i Pikave të Kalimit Kufitar, e cila synon rindërtimin dhe riparimi i PKK-së sipas standardeve të kërkuara. Kjo masë synon të realizohet nëpërmjet aktiviteteve të mëposhtme:

- rindërtimi i Pikës së Kalimit Kufitar Qafë-Botë.
- rikonstruksioni i godinës së Degës Doganore Vlorë;
- rikonstruksioni dhe ndërtimi i ambienteve shtesë në Degën Doganore Morinë;
- rikonstruksioni dhe zgjerimi i Terminalit për krijimin e kushteve optimale për udhëtarët e Pikës së Kalimit Kufitar Kakavijë etj.

Masa 3: Përmirësimi i mëtejshëm i infrastrukturës së IT-së për menaxhimin e kufijve, nëpërmjet së cilës synohet lidhja me sistemin TIMS i 13 stacioneve të policisë kufitare në të cilat mungon ky sistem.

Masa 4: Pajisjen e pikave të kalimit kufitar me lexues optik portabël të dokumenteve të udhëtimit, nëpërmjet së cilës synohet, pajisja me 10 lexues portabël.

2.2 Objektivi specifik 2, i qëllimit të politikës 2: Negocimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve për ngritjen e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar dhe doganor.

Marrëveshja për ngritjen e Pikave të Përbashkëta të Kalimit Kufitar me Republikën e Kosovës, atë të Grabomit dhe të Zogajve me Malin e Zi, kanë qenë hapa të rëndësishëm në forcimin e bashkëpunimit ndër-kufitar për lehtësimin e qarkullimit legjitim të shtetasve dhe mallrave. Ndërkohë, duhet të vijojnë përpjekjet për ndryshim e statusit të të gjitha pikave të kalimit kufitar me Malin e Zi, si dhe nënshkrimin e marrëveshjes për ndryshimin e statusit të të gjitha pikave të kalimit kufitar me Maqedoninë e Veriut.

Ndërkohë, kërkohet të forcohet bashkëpunimi operacional për mbikëqyrjen e përbashkët të kufirit, duke rritur numrin e patrullimeve të përbashkëta me Malin e Zi, Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut.

Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet nënshkrimit të marrëveshjes për ngritjen dhe funksionimin e Qendrës së Bashkëpunimit Policor dhe Doganor me Greqinë, në Kakavijë, ndërsa do të propozohet ngritja e një qendre të tillë edhe në Kapshiticë.

Autoritetet shqiptare do të jenë të përkushtuara për të adresuar çështjet bilaterale me vendet fqinje, duke arritur kështu një nga ato përparësi të rëndësishme të politikës së jashtme të Republikës së Shqipërisë, atë të fqinjësisë së mirë.

Ky objektiv synohet të arrihet nëpërmjet përbushjes së masave të mëposhtme:

Masa 1: Përfundimi i negociatave dhe nënshkrimi i marrëveshjes për ngritjen e Pikave të Përbashkëta të Kalimit Kufitar dhe kryerjen e kontrolleve të përbashkëta kufitare dhe doganore me Maqedoninë e Veriut, i cili do të realizohet nëpërmjet aktiviteteve të mëposhtme:

- negociimi dhe nënshkrimi i protokolleve të zbatimit të marrëveshjes për ngritjen e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar dhe kryerjen e kontrolleve të përbashkëta kufitare dhe doganore me Maqedoninë e Veriut, për çdo pikë të kalimit kufitar;

- trajnimi i personelit të pikave të përbashkëta të kalimit kufitar për kryerjen e kontrolleve të përbashkëta kufitare dhe doganore;

- vënia në funksion e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar dhe zbatimin e kontrolleve të përbashkëta kufitare dhe doganore.

Masa 2: Nënshkrimi i marrëveshjes për ngritjen e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar dhe kryerjen e kontrolleve të përbashkëta kufitare dhe doganore me Malin e Zi, i cili do të realizohet nëpërmjet aktiviteteve të mëposhtme:

- fillimi i negociatave, nënshkrimi i marrëveshjes për ngritjen e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar dhe kryerjen e kontrolleve të përbashkëta kufitare dhe doganore;

- negociimi dhe nënshkrimi i protokolleve të zbatimit të marrëveshjes për ngritjen e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar dhe kryerjen e kontrolleve të përbashkëta kufitare dhe doganore me Malin e Zi, për çdo Pikë të Kalimit Kufitar;

- trajnimi i personelit të Pikave të pikë të kalimit kufitar përbashkëta të kalimit kufitar për kryerjen e kontrolleve të përbashkëta kufitare dhe doganore;

- vënia në funksion e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar dhe zbatimin e kontrolleve të përbashkëta kufitare dhe doganore;

Masa 3: Negocimi dhe nënshkrimi i protokolleve të zbatimit të marrëveshjes për ngritjen e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar dhe kryerjen e kontrolleve të përbashkëta kufitare dhe doganore me Republikën e Kosovës, për çdo



Pikë të Kalimit Kufitar, nëpërmjet së cilës synohet ngritja e PKK të përbashkëta si detyrim dhe zbatim i katalogut *Schengen*, në përputhje praktikat më të mira për lehtësimin e kalimit të shtetasve dhe mjeteve.

Masa 4: Fillimi i negociatave për nënshkrimin e marrëveshjes për ngritjen e Pikave të Përbashkëta të Kalimit Kufitar dhe kryerjen e kontrolleve të përbashkëta kufitare dhe doganore me Greqinë, nëpërmjet së cilës synohet nënshkrimi i marrëveshjes për ngritjen e Pikave të Përbashkëta të Kalimit Kufitar dhe kryerjen e kontrolleve të përbashkëta kufitare dhe doganore me Greqinë.

2.3 Objektivi specifik 3, i qëllimit të politikës 2: Alokimi i burimeve të nevojshme njerëzore në Pikat e Kalimit të Kufitar në përputhje me fluksin e qarkullimit ndërkuftar.

Në periudha të veçanta, siç është sezoni turistik veror dhe periudha e festave të fundvitit, krijojnë ngarkesa të mëdha në pikat e kalimit kufitar që kalojnë kufijtë e ngarkesës normale për personelin e këtyre pikave. Me qëllim krijimin e lehtësirave të duhura për kalimin pa vonesë të shtetasve dhe mallrave, tashmë është krijuar një praktikë shumë e mirë e rialokimit të burimeve njerëzore dhe vendosjen e tyre në dispozicion të pikave të kalimit kufitar të cilat përballën me fluks të shtuar. Kjo praktikë është e nevojshme të vijojë të zbatohet dhe në të ardhmen.

Ky objektivi synohet të arrihet nëpërmjet përbushjes së masave të mëposhtme:

Masa 1: Shtimi i numrit të rojeve kufitare në pikat e kalimit kufitar në përputhje me nevojat operacionale, nëpërmjet së cilës synohet plotësimi i të gjitha funksioneve të lira. Kjo masë do të realizohet nëpërmjet aktiviteteve të mëposhtme:

Shtimi i numrit të rojeve kufitare në pikat e kalimit kufitar Morinë, Komisariati i Policisë Rinas, Port Durrës, Qafë Thanë, Kakavijë, Kapshticë etj.;

Plotësimi me personel i funksioneve të lira në Pikat e Kalimit Kufitar.

Masa 2: Rialokimi i përkohshëm i burimeve njerëzore në Pikat e Kalimit Kufitar me fluks të përkohshëm të rritur, nëpërmjet së cilës synohet përballimi me sukses i flukseve të përkohshme të qarkullimit ndërkuftar.

2.4 Objektivi specifik 4, i qëllimit të politikës 2: Forcimi i kapaciteteve logjistike për zbulimin e dokumenteve të falsifikuara të udhëtimit.

Një pjesë e mirë e personelit të Pikave të kalimit Kufitar tashmë është pajisur me mjetet e nevojshme për kontrollin e dokumenteve të udhëtimit, në vijën e parë të kontrollit. Aktualisht është e nevojshme pajisja e këtyre shërbimeve me mjete të specializuara për ekzaminimin e dokumenteve të udhëtimit, në vijën e dytë të kontrollit.

Ky objektivi synohet të arrihet nëpërmjet përbushjes së masave të mëposhtme:

Masa 1: Pajisja e pikave të kalimit kufitar me pajisje speciale për ekzaminimin e dokumenteve të udhëtimit, sipas nevojës dhe analizës së riskut.

Masa 2: Sigurimi i aksesit në bankën e të dhënave të dokumenteve të udhëtimit PRADO.

2.5 Objektivi specifik 5, i qëllimit të politikës 2: Forcimi i kapaciteteve profesionale të rojeve kufitare që shërbejnë në Pikat e Kalimit Kufitar.

Forcimi i kapaciteteve profesionale të punonjësve të agjencive të zbatimit të ligjit do të vijojë të jetë prioritet për të gjitha agjencitë. Profesionalizmi dhe forcimi i aftësive për zbatimin me korrektësi e cilësi i detyrave, përbën një garanci të fortë për menaxhimin e kufirit dhe rrjedhimisht për forcimin e sigurisë kufitare.

Agjencitë e zbatimit të ligjit do t'i kushtojnë një vëmendje të veçantë trajnimit të trajnerëve për fushat e përgjegjësisë, duke synuar forcimin e pavarësisë në fushën e shkollimit dhe trajnimit. Trajnimet do të vijojnë të zhvillohen sipas planeve të miratuara të trajnimeve dhe do të adresojnë prioritetet e përcaktuara nga strukturat qendrore dhe vendore.

Trajnimi me burimet e brendshme do të kombinohet në mënyrë efektive me trajnimit e ofruar nga partnerët ndërkombëtarë, në nivel bilateral, multilateral dhe në kuadër të projekteve apo iniciativave të ndryshme.

Policia Kufitare do të vijojë respektimin e standardeve të trajnimit dhe shkollimit të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, si dhe të praktikave më të mira të identifikuar. Trajnimi bazë i Policisë Kufitare do të vijojë në bazë të kurrikulës të përafëruar plotësisht me Kurrikulën e Përbashkët Bazë të Agjencisë Evropiane të Rojës Kufitare dhe Bregdetare (FRONTEX).

Aplikimi sistemeve të reja të shkëmbimit të informacionit dhe futja në përdorim i teknologjive dhe pajisje bashkëkohore të kontrollit dhe



mbikëqyrjes së kufirit, do të shoqërohen me trajnime të specializuara, me qëllim përdorimin sa më efektiv të këtyre sistemeve dhe pajisjeve.

Ky objektivi synohet të arrihet nëpërmjet përbushjes së masave të mëposhtme:

Masa 1: Krijimi i posteve të punës për trajnimin *online* të rojeve kufitare, i cili do të realizohet nëpërmjet aktiviteteve të mëposhtme:

- Instalimi i 3 (tre) kompjuterëve personal në çdo strukturë vendore (DVKM, Reparti DELTA, Qendra e Mbyllur Karreç, IQP) dhe në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin, për të mundësuar trajnimin *online* të rojeve kufitare.

- Instalimin e *software*-ve të nevojshme për mundësimin e trajnimeve *online*.

- Krijimin në TIMS të portalit të moduleve të trajnimit për Policinë Kufitare dhe Migracionit.

Masa 2: Zhvillimi i trajnimeve për sigurinë e dokumenteve të trajnimit me rojet kufitare të Pikave të Kalimit Kufitar, i cili do të realizohet nëpërmjet aktiviteteve të mëposhtme:

- zhvillimi i trajnimeve rifikuese për sigurinë e dokumenteve të udhëtimit;

- zhvillimin e trajnimeve të avancuara për sigurinë e dokumenteve të udhëtimit, për punonjësit e policisë së vijës së dytë të kontrollit kufitar.

Masa 3: Shkëmbimi i eksperiencës në fushën e sigurisë së dokumenteve të udhëtimit në nivel bilateral dhe në kuadër të operacioneve të koordinuara nga Agjencia Evropiane e Rojës Kufitare dhe Bregdetare, FRONTEx, nëpërmjet së cilës synohet pjesëmarrja në çdo operacion të koordinuar nga FRONTEx.

3. Qëllimi i politikës 3: respektimi i plotë i të drejtave themelore, përfshirë trajtimin e çdo individi me respekt të plotë për dinjitetin dhe mundësimin e qasjes në mbrojtjen ndërkombëtare të atyre që kanë nevojë

3.1 Objektivi specifik 1, i qëllimit të politikës 3: Përmirësimi i nivelit të respektimit, mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave themelore, sjelljes profesionale të oficerëve të kontrollit kufitar, si dhe aftësive të tyre profesionale për përdorim më efikas të pajisjeve teknike, trajnimit dhe zhvillimit profesional.

Punonjësit e Policisë së Shtetit, rojet kufitare dhe ato të menaxhimit të migracionit, punonjësit e Doganës dhe të agjencive të tjera të zbatimit të ligjit që operojnë në kufi, ushtrojnë aktivitetin e tyre në

përputhje me Kushtetutën, aktet ndërkombëtare, ligjet dhe rregulloret e tjera, duke iu përmbajtur normave të sjelljes dhe etikës, veçanërisht atyre që kanë të bëjnë me detyrimin për t'u shërbyer shtetasve shqiptarë dhe të huaj, respektimin e ligjshmërisë, ushtrimi i të drejtave të njeriut, mosdiskriminimi gjatë ushtrimit të funksioneve e detyrave, ndalimin e torturës dhe trajtimit degradues, dhënien e ndihmës së menjëhershme për viktimat, detyrimi për të mbrojtur informacionin e klasifikuar dhe të dhënat personale, detyrimin për të refuzuar urdhrat e paligjshëm dhe të kundërshtojë çdo formë të korrupsionit.

Punonjësit e të gjitha agjencive do të vijojnë të ushtrojnë kompetencat, duke synuar minimizimin e efekteve të dëmshëm, duke parandaluar dhe shmangur, në çdo rast, diskriminim e qytetarëve në bazë të racës, ngjyrës, kombësisë, origjinës sociale ose etnike, përkatësisë së pakicave kombëtare, gjuhës, besimit fetar, mendimit ndryshe, gjinisë, identiteti gjinor, orientimi seksual, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, moshës, statusit martesor, përkatësia në grup ose supozimi i përkatësisë në një grup të caktuar, bindjes politike, anëtarësisë në sindikatë ose organizatë, si dhe në bazë të karakteristikave personale.

Ky objektivi synohet të arrihet nëpërmjet përbushjes së masave të mëposhtme:

Masa 1: Vijimi i trajnimit të rojeve kufitare për procedurat standarde të përzgjedhjes dhe referimit të të huajve të parregullt;

Masa 2: Rishikimi i procedurave për përzgjedhjen e shtetasve të huaj që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare në vendin tonë;

Masa 3: Trajnim i vazhdueshëm i rojeve kufitare për grumbullimin dhe përdorimin e të dhënave personale;

Masa 4: Zhvillimi i trajnimeve të vazhdueshme për trajtimin e shtetasve të huaj në territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin për të huajt.

3.2 Objektivi specifik 2, i qëllimit të politikës 3: Kontrolli i cilësisë në zbatimin e ligjit për menaxhimin e kufijve dhe sjellja e policëve dhe doganierëve të përfshirë në kontrollin kufitar dhe doganor të kryhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore dhe me standardet e BE-së.

Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka miratuar një kod etik që është në përputhje me



standardet e Kodit Evropian të Etikës së Policisë, i cili përcakton standardet dhe rregullat e sjelljes për oficerët e policisë në kryerjen e detyrave të tyre.

Krahas aktivitetit kontrollues të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm dhe Ankesave në Ministrinë e Brendshme, Avokatit të Popullit apo vlerësimeve të organizatave të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, Policia e Shtetit dhe shërbimet e tjera kufitare kanë krijuar një sistem të kontrollit të cilësisë në procesin e punës, zbatimin e autoritetit dhe zbatimin e ligjit. Në përputhje me rregullat e përcaktuara, Policia Kufitare do të hartojë plane kontrolli tematik dhe *ad-hoc*, për çështje të veçanta dhe/apo ankesave, sipas procedurave standarde të punës për raste të tilla. Në përputhje me programet vjetore të punës, nga zyrtarët e autorizuar të Policisë Kufitare (në Departamentet dhe Drejtoritë Vendore të Kufirit dhe Migracionit) do të planifikohen dhe kryhen kontrole, inspektime të rregullta dhe të jashtëzakonshme.

Vëmendje të veçantë do t'i kushtohet ngritjes së mekanizmave të vlerësimit *Schengen*, të vlerësimit të cenueshmërisë (vulnerabilitetit) të sigurisë kufitare dhe mekanizmave të mundshëm kombëtarë për të siguruar zbatimin e ligjit në fushën e menaxhimit të kufijve.

Ky objektiv synohet të arrihet nëpërmjet përmbyshjes së masave të mëposhtme:

Masa 1: Përgatitja dhe miratimi i procedurave standarde të punës për zhvillimin e inspektimeve tematike të aktivitetit të strukturave për kufirin dhe migracionin, nga Departamenti për Kufirin dhe Migracionin.

Masa 2: Hartimi i planit vjetor të inspektimit të strukturave vendore për kufirin dhe migracionin.

Masa 3: Zhvillimi i inspektimeve *ad-hoc* për probleme që mund të ndeshen apo në ndjekje të ankesave të shtetasve të ndryshëm, për aktivitetin e rojeve kufitare dhe/ose strukturave vendore për kufirin dhe migracionin.

3.3 Objektivi specifik 3, i qëllimit të politikës 3: Sigurimi i qasjes në mbrojtjen ndërkombëtare atyre që kanë nevojë.

Ligjshmëria, mosdiskriminimi dhe respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut janë parime që qëndrojnë në themel të veprimtarisë së

Policisë së Shtetit.⁷⁵ Mbrojtja dhe respektimi i të drejtave të njeriut të personave që kalojnë kufirin shtetëror ose kalojnë kufirin shtetëror në mënyrë të paligjshme është vlerë e patjetërsueshme dhe një përparësi e Policisë Kufitare. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet grupeve vulnerabël, veçanërisht të miturve të pashoqëruar dhe viktimave të dyshuara të dhunës ose trafikimit.

Në këtë drejtim, nevojitet të forcohen kapacitetet për identifikimin e personave që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare, për ndihmë juridike, si dhe për kthimin efektiv të personave që nuk kualifikohen për mbrojtje ndërkombëtare.

Në çdo rast nga ana e shërbimeve të policisë kufitare dhe migracionit, është vepruar dhe do të veprohet në përputhje të plotë me të drejtat universale të njeriut ku parashikohet se “gjithkush ka të drejtë të kërkojë dhe gëzojë në vende të tjera azil nga ndjekjet...”⁷⁶, dhe nga legjislacioni shqiptar i cili parashikon se, “Në Republikën e Shqipërisë garantohej e drejta për azil e të huajt apo personit pa shtetësi, i cili, për shkak të frikës së bazuar të persekutimit, për arsye të racës, besimit fetar, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror ose bindjes politike, ndodhet jashtë vendit të shtetësisë së vet ose jashtë vendbanimit të zakonshëm të mëparshëm dhe nuk ka mundësi ose dëshirë të kërkojë mbrojtjen e atij vendi, si pasojë e këtyre ngjarjeve, për arsye të kësaj frike”.⁷⁷

Policia e Shtetit do të respektojë me korrektësi parimin e mos-kthimit, të sanksionuar në legjislacionin shqiptar, ku parashikohet se, “Republika e Shqipërisë njeh dhe respekton detyrimin e autoriteteve për të mos kthyer a prapësuar, ekstraduar apo larguar jashtë territorit të saj personat që kanë përfituar apo kërkuar të drejtën e azilit apo të formave të tjera të mbrojtjes...”⁷⁸

Procesi i azilit kërkon bashkëpunim të ngushtë midis Policisë Kufitare dhe Drejtorisë për Shtetësinë dhe Azilin dhe me çdo organizatë vendase dhe ndërkombëtare për pritjen dhe

⁷⁵ Neni 5, i ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar.

⁷⁶ Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, neni 14/1.

⁷⁷ Ligji nr. 121/2014 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”, neni 4.

⁷⁸ Neni 6, i ligjit nr. 121/2014, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.



trajtimin e shtetasve të huaj që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare.

Ky objektivi synohet të arrihet nëpërmjet përmbushjes së masave të mëposhtme:

Masa 1: Vijimi i trajnimit të rojeve kufitare për procedurat standarde të përzgjedhjes dhe referimit të të huajve të parregullt.

Masa 2: Rishikimi i procedurave për përzgjedhjen e shtetasve të huaj që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare në vendin tonë.

Masa 3: Trajnimi i rojeve kufitare për procedurat e reja për përzgjedhjen e shtetasve të huaj që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare në vendin tonë.

PJESA III. PROJEKTET KRYESORE PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË

Projekti i ngritjes dhe funksionimit të Qendrës Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Kufirit.

Kjo masë synon të bëjë përafrim të pjesshëm të legjislacionit kombëtar me rregulloren nr. 1052/2013, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për ngritjen e Sistemit Evropian të Mbikëqyrjes së Kufirit (Eurosur). Rregullorja (BE) 2019/1896, u rekomandon Shteteve Anëtare të krijojnë qendra kombëtare koordinimi në mënyrë që të përmirësojnë shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërmjet Shteteve Anëtare, në lidhje me mbrojtjen e kufirit kombëtar dhe zbatimin e kontrollit kufitar. Për funksionimin efektiv të EUROSUR, është thelbësore që të gjitha autoritetet kombëtare përgjegjëse për mbrojtjen e kufijve të jashtëm të bashkëpunojnë përmes Qendrave Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Kufirit. Në këtë kontekst, Shqipëria do t'i kushtojë vëmendje të veçantë ngritjes së Qendrës Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Kufirit, në planin e veprimit 2024–2027.

Kosto totale potenciale për realizimin e projektit dhe ndërtimi i zyrave të nevojshme për funksionimin normal të QKK parashikohet të jetë 5,000,000 lekë e cila mund të jetë me financim të huaj ose me buxhet shteti. Ndërsa ngritja e infrastrukturës për përcjelljen e informacionit të nevojshëm në QKK dhe QKR nga të gjitha sistemet e ngritura dhe ato që do të ngrihen për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit parashikohet të jetë 20,000,000 lekë e cila pritet të financohet nga donatorë.

Projekti i rindërtimit të pikave të kalimit kufitar

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Policia e Shtetit vazhdojnë të ndërmarrin aktivitete për ndërtimin, rindërtimin, adaptimin dhe pajisjen e vendkalimeve kufitare, duke marrë parasysh që tendenca e vazhdueshme e rritjes së trafikut në pikat e kalimit kufitar kërkon përmirësimin e duhur të infrastrukturës kufitare. Aktivitetet për ndërtimin dhe pajisjen e pikave të kalimit kufitar janë ndërmarrë për të bërë të mundur që kontrolli kufitar të kryhet në mënyrë të sigurt, në përputhje me standardet dhe kushtet e përcaktuara. Përparim të konsiderueshëm ka pasur në drejtim të rregullimit dhe pajisjeve, por jo të gjitha pikat e kalimit kufitar kanë përmbushur kriteret e përcaktuara në përputhje me Dekretin për Standardet dhe Kushtet, të cilat duhet të përmbushen në drejtim të rregullimit dhe pajisjeve, sipas rekomandimeve të BE-së dhe katalogut të praktikave më të mira në këtë fushë.

Sa më sipër, në planin e veprimit 2021–2023 është parashikuar rindërtimi i disa PKK-ve, si më poshtë:

- rindërtimi i pikës së kalimit kufitar Qafë-Botë, kostoja potenciale e të cilës është 2,000,000 euro, e cila do të financohet nga donatorët;

- rikonstrukcioni i godinës së degës doganore Vlorë, kostoja potenciale e të cilës është 260,000 euro, cila do të financohet nga buxheti i shtetit;

- rikonstrukcioni dhe ndërtimi i ambienteve shtesë në degën doganore Morinë, kostoja potenciale e të cilës është 663,000 euro, cila do të financohet nga buxheti i shtetit;

- rikonstrukcioni dhe zgjerimi i terminalit për krijimin e kushteve optimale për udhëtarët e pikës së kalimit kufitar Kakavijë kostoja potenciale e të cilës është 583,000 euro, cila do të financohet nga buxheti i shtetit.

PJESA IV: ZBATIMI, PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, RAPORTIMI DHE MONITORIMI

1. Përgjegjësia e institucioneve

Siç u theksua me lart, menaxhimi i integruar i kufirit është bashkërendimi dhe bashkëpunimi kombëtar dhe ndërkombëtar ndërmjet të gjitha autoriteteve dhe agjencive, të përfshira në sigurinë kufitare dhe lehtësimin e tregtisë, me qëllim përsosjen e sistemeve të efektshme dhe me rendiment të Menaxhimit të Integruar të Kufirit,




me synimin e arritjes së qëllimit të përbashkët të kufijve të hapur, por të kontrolluar dhe të sigurt.

Për zbatimin e konceptit të Menaxhimit të Integruar të Kufirit në Republikën e Shqipërisë, si dhe të prioriteteve strategjike të përcaktuara nga kjo Strategji angazhohen disa institucione shtetërore, si: Ministria e Brendshme - Policia e Shtetit/Departamenti për Kufirin dhe Migracionin; Ministria e Financave dhe Ekonomisë - Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural - Autoriteti Kombëtar i Ushqimit; Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes

Sociale - Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor; Ministria e Mbrojtjes - Forca Detare/Roja Bregdetare - Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile; Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme - Drejtoria e Çështjeve Konsullore; Ministria e Drejtësisë; Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë - Drejtoria e Përgjithshme Detare; Ministria e Turizmit dhe Mjedisit; Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë; Ministria e Kulturës; Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD); Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.





Ministria e Brendshme

Përgjegjësi kryesore e strukturave të Ministrisë së Brendshme është sigurimi i një politike të brendshme e cila nga një anë kujdeset për zbatimin e ligjit dhe nga ana tjetër është në shërbim të qytetarëve të Republikës së Shqipërisë. Në kohën kur reforma në sektorin e sigurisë në Shqipëri është konsoliduar, politika e brendshme ka pësuar gjithashtu transformimet e saj duke u përfaruar me kuadrin ligjor të Bashkimit Evropian, ashtu edhe me politika të cilat garantojnë një mjedis më të sigurt.

Ministria e Brendshme është institucioni përgjegjës për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike, financimin e investimeve të objekteve në DVKM, Stacione dhe pikat e kalimit kufitar, si dhe objekteve të tjera në interes të shërbimeve të kufirit, hartimin, krijimin, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e teknologjive, sistemeve të informacionit dhe komunikimit, për kontrollin e kufijve dhe përgatitjen për përfundimin dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare për pikat e kalimit kufitar, si dhe krijimin e regjimeve të trafikut kufitar me vendet fqinje.

Strukturat e Ministrisë së Brendshme *do të vijojnë të kontrollojnë hapësirën e ujërave të brendshme detare dhe vijën bregdetare*, me qëllim ushtrimin e plotë të sovranitetit dhe parandalimin e çdo lloj veprimtarie të paligjshme në hapësirën detare të RSH-së.

Implementimi i plotë i *planit të veprimit të Strategjisë së Menaxhimit të Integruar të Kufirit*, i cili bazohet në bashkëpunimin ndërinstitucional do të

jetë në fokus të punës së strukturave të kufirit dhe migracionit.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Kontrolli i plotë i territorit në funksion të garantimit të zbatimit të ligjshmërisë, është një detyrë e rëndësishme e Policisë së Shtetit dhe strukturave të tjera me përgjegjësi në këtë drejtim. Rezultatet e arritura dhe përvoja e fituar në menaxhimin e vijës bregdetare dhe të hapësirave të plazhit, tregojnë për mundësitë dhe hapësirat e shumta që ekzistojnë për një administrim më të mirë të territorit.


Ligji nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe rregullorja e Policisë së Shtetit (miratuar me VKM-në nr. 750, datë 16.9.2015), përcaktojnë mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Policisë së Shtetit si në vijim:

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit përfaqëson nivelin qendror, ndërsa drejtoritë vendore nivelin vendor të policisë. DPPSH-ja organizohet në struktura organizative hierarkike në nivel Departamenti, Drejtorie dhe Sektori, si më poshtë:

- Departamenti për Policinë Kriminale;
- Departamenti për Rendin dhe Sigurinë Publike;
- Departamenti për Kufirin dhe Migracionin;
- Departamenti për Marrëdhëniet Ndërkombëtar;
- Departamenti për Shërbimet Mbështetëse;
- Akademia e Sigurisë;
- Drejtoria e Antiterrorit.



Organizimi i Policisë Kufitare dhe Migracionit



Sipas ligjit “Për Policinë e Shtetit”, në përbërje të Policisë së Shtetit vepron struktura e Policisë Kufitare dhe Migracionit me përgjegjësi kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit *shtetëror, si dhe trajtimin e shtetasve të huaj* në territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Bashkëpunimi mes strukturave dhe institucioneve të ndryshme por edhe ndarja e qartë e përgjegjësiave mes të tyre do të luajë rol të rëndësishëm në përmbushjen e kësaj përgjegjësie.

Ministria e Ekonomisë dhe Financave

Ministria e Ekonomisë dhe Financave ka si përgjegjësi hartimin e politikës makroekonomike dhe fiskale; administrimit të të ardhurave; administrimit të buxhetit të shtetit; menaxhimit të borxhit publik; administrimit financiar; menaxhimit financiar dhe kontrollit; menaxhimit të asistencës financiare të bashkimit evropian dhe menaxhimit të fondeve të bashkimit evropian; inspektimit financiar publik; bashkërendimit të përgjithshëm të auditimit të brendshëm.

Shërbimi Doganor Shqiptar (SHDSH)

Autoritetet doganore kanë si përgjegjësi kryesore mbikëqyrjen e tregtisë ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë, duke kontribuar për tregtinë e hapur e të drejtë në zbatim të politikave tregtare dhe atyre të sektorëve të tjerë të ekonomisë shqiptare, që ndikojnë në sigurinë e të gjithë zinxhirit tregtar. Autoritetet doganore synojnë mbrojtjen e interesave financiarë dhe mjedisorë të

Republikës së Shqipërisë nga tregtia e padrejtë dhe e paligjshme, duke mbështetur ndërkohë aktivitetin e ligjshëm të biznesit; garantimin e sigurisë e të mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë dhe të banorëve të saj, si dhe mbrojtjes së mjedisit, kur është e nevojshme, në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet e tjera; mbajtjen e balancës së duhur ndërmjet kontrolleve doganore dhe lehtësimit të tregtisë së ligjshme.

Struktura e SHDSH organizohet në dy nivele, si më poshtë:

Nivel Qendror, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave:

- Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm;
- Departamentin Teknik;
- Departamenti Administrativ;
- Departamenti i Akcizës dhe Departamenti i TI;
- Departamenti Operativ Hetimor:
- Drejtoria Antitrafik;
- Drejtoria Antikontrabandës;
- Drejtoria Hetimit;
- Drejtoria e Informacionit, Analizës së Riskut dhe Monitorimit;
- Drejtoria për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale.

Nivel Lokal: 17 Degë Doganore

Ministria e Mbrojtjes

Ministria e Mbrojtjes propozon dhe zbaton politikën e mbrojtjes si një element të sistemit të



mbrojtjes, vlerëson sfidat, rreziqet dhe kërcënimet ushtarake dhe në fushën e mbrojtjes. Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si pjesë integrale e Ministrisë së Mbrojtjes, janë një forcë profesionale mbrojtëse e cila, si pjesë e sistemit të mbrojtjes, përveç mbrojtjes së pavarësisë, sovranitetit dhe territorit shtetëror të Republikës së Shqipërisë, ofron mbështetje për institucionet e tjera në raste të kërcënimit të sigurisë kombëtare nga terrorizmi, në rastin e krizave të migrantëve, sfidave dhe kërcënimeve të tjera.

Forca Detare/Roja Bregdetare, sipas misionit të saj kushtetues dhe detyrave ushtarake mbron sovranitetin e plotë të hapësirës detare të RSH-së, si dhe interesat e saj kombëtare në ujërat territoriale, zonën fqinje dhe ZEE. Përveç kryerjes së aktiviteteve të mbikëqyrjes dhe mbrojtjes, Forca Detare/Roja Bregdetare ofron mbështetje për institucionet civile në situata krize dhe emergjente, kryesisht në aktivitetet e kërkimit dhe shpëtimit në det dhe të kontrollit të zbatimit të ligjshmërisë kombëtare e ndërkombëtare në det.

Forca Detare/Roja Bregdetare, sipas ligjit nr. 8875, datë 4.4.2002, (*ndryshuar me ligjin nr. 9788, datë 19.7.2007*) ka detyrat si më poshtë:

- të japë asistencë për sigurimin e lundrimit detar dhe sigurimin e jetës në det (SAR), në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe konventat ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë bën pjesë, i ka ratifikuar ose ka aderuar në to;

- të parandalojë dhe të ushtrojë kontroll për kalimin e paligjshëm të mjeteve lundruese, të mallrave dhe njerëzve në hapësirën detare shqiptare;

- të kryejë afrim, bordim, inspektim, ndalim, kapje dhe bllokim të mjeteve dhe personave që shkelin legjislacionin detar, si dhe shoqërimin e tyre në portin më të afërt, sipas rastit;

- të kryejë ndjekjen e nxehtë të mjeteve detare, sipas konventave ndërkombëtare;

- të kryejë përdorimin e forcës në rastet e mbrojtjes së nevojshme dhe nevojës ekstreme;

- të kryejë përpilimin e dokumentacionit bazë për fillimin e procedurave të mëtejshme për shkelësit e ligjit detar;

- të parandalojë dhe të ushtrojë kontroll për zbatimin e legjislacionit për ndotjen e mjedisit detar dhe bregdetar (MARPOL).

Procedurat për kryerjen e detyrave nga Roja Bregdetare përcaktohen në Manualin e Rojës Bregdetare. Këto detyra janë parashikuar edhe në Kodin Detar të RSH-së.

Struktura të Ministrisë së Mbrojtjes të përfshira në MIK janë:

- Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura;
- Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile;
- Forca Detare/Roja Bregdetare;
- Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare;
- Instituti i Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake;
- Qendra Kombëtare e Kërkimit dhe Shpëtimit.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural garanton në shkallën më të lartë të shëndetit të qytetarëve shqiptar dhe perfeksionimi i sistemit të mbikëqyrjes dhe garantimit të sigurisë ushqimore. Ky sistem do të shërbejë për mbrojtjen sa më të mirë të shëndetit të konsumatorëve nga sëmundjet/dëmtimet si pasojë e konsumimit të produkteve ushqimore me origjinë bimore ose shtazore.

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, institucion në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, i cili ka për qëllim të vendosë bazat për sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve dhe interesat e konsumatorit, mbrojtja e shëndetit të kafshëve, si dhe të mbrojtje bimët dhe produktet bimore nga parazitët;

Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës (DSHPA), është një institucion qendror publik, në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me seli në Tiranë. Sektori i Inspektimit dhe Kontrollit të Peshkimit ka për mision kontrollin në ujë apo në tokë, përfshirë portet, pikat e zbarkimit, mjetet e transportit, qendrat e grumbullimit të peshkut, merkatot, pikat e shitjes dhe restorantet, nëpërmjet aktiviteteve inspektuese sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Sektori i Inspektimit dhe Kontrollit të Peshkimit është gjithashtu, përgjegjëse për të monitoruar respektimin rregullsisë së zënieve që ndodhen në bordin e mjetit lundrues të peshkimit, të magazinuara, të transportuara, në përpunim apo të tregtuara, si dhe vërtetësinë dhe saktësinë e dokumenteve apo transmetimeve elektronike që lidhen me to.



Nëpërmjet këtij plan veprimi kërkohet bashkëpunim në zbatim të ligjshmërisë në fushën e peshkimit, si në hapësirën ujore detare dhe ato të brendshme (liqenore) nëpërmjet koordinimit në kuadër të QNOD-it, ku të organizohen patrullime të përbashkëta të Inspektoratit të Peshkimit me Rojën Bregdetare në hapësirën detare dhe me strukturat e tjera shtetërore në ujërat e brendshme, lumenjtë e liqenet, për parandalimin dhe evidentimin e gjetisë së paligjshme. Gjithashtu bashkëpunim në kontrollin e përbashkët të pikave doganore tokësore mbi kontrollin kalimit të paligjshëm të produkteve peshkore, si dhe kalimin e specieve të ndaluara. Edhe pse Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës nuk disponon inspektorë pranë pikave doganore, në zbatim të plan veprimit do të bëhet e mundur kontrolli i përbashkët periodik.

DSHPA-ja organizohet si Drejtoria e Përgjithshme me juridiksion në të gjithë territorin e vendit dhe përbëhet nga 5 sektorë:

1. Sektori i Inspektimit dhe Kontrollit të Peshkimit;
2. Sektori i Akuakulturës;
3. Sektori i Analizës Ekonomike dhe Buxhetit;
4. Sektori i Monitorimit dhe Infrastrukturës së Peshkimit;
5. Sektori i QNOD-it (Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare).

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme është përgjegjëse, ndër të tjera, për propozimin e një regjimi të vizave të përafuar gjithnjë e më shumë me kodin *Schengen*. Vijimi i përpjekjeve për uljen e numrit të shteteve në listën negative të BE-së.

Drejtoria e Çështjeve Konsullore, ndjek regjimin e vizave me vendet e ndryshme, bashkërendimin e punës ndërmjet aktorëve të përfshirë në procesin e procedimit dhe vlerësimit të aplikimeve për pajisje me vizë të shtetasve të huajt, në përputhje me legjislacionin dhe regjimin në fuqi.

Personeli që trajton çështjet e vizave është i përzgjedhur me kritere të përcaktuara qartë, të aftë profesionalisht dhe të mirëtrajnuar. Konsujt që emërohen kryejnë paraprakisht trajnimet pranë strukturave dhe specialistëve përkatës. Gjithashtu informohen paraprakisht për bazën ligjore të cilës do t'i referohen në vijimësinë e punës së tyre me

procedimin e aplikimeve për pajisje me vizë të shtetasve të huaj.

Gjithashtu, është synuar zhvillimi i teknologjisë së informacionit në përputhje të plotë me standardet e BE-së, me qëllim që të lehtësojë shkëmbimin dhe menaxhimin e informacionit. Sistemet e IT janë në përputhje të plotë me standardet, sigurojnë ruajtjen dhe fshehtësinë e të dhënave, bazuar në legjislacionin kombëtar dhe marrëveshjet e nënshkruara.

Zhvillime të mëtejshme janë bërë lidhur me aplikimet dhe shkëmbimin e informacionit, në bashkëpunim me AKSHI-n. Të gjitha aplikimet për marrjen e shërbimeve (përfshirë edhe vizat), kryhen *online*. Shkëmbimi dhe menaxhimi i informacionit në përputhje me standardet, ka lehtësuar kohën e marrjes së shërbimeve për qytetarët, duke siguruar mbrojtjen e të dhënave.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është institucioni përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikave e të strategjive të zhvillimit në sektorin e kujdesit shëndetësor, është përgjegjëse për rregullimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe për bashkërendimin e punës ndërmjet të gjithë aktorëve, brenda dhe jashtë sistemit të kujdesit shëndetësor, të cilët kontribuojnë dhe synojnë të garantojnë të drejtën kushtetuese, të përcaktuar në nenin 55 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Ajo ka si mision, gjithashtu, garantimin e të drejtave kushtetuese për mbrojtje e përfshirje sociale dhe përkujdesje sociale e shanse të barabarta.

Institucionet e varësisë të cilat luajnë rol kyç në përmbushjen e përgjegjësisë së sektorit shëndetësor dhe atij social sa u përket çështjeve ndërkufitare, janë:

Instituti i Shëndetit Publik është struktura kombëtare përgjegjëse për hulumtimin, studimin dhe analizimin e situatës epidemiologjike të vendit.

1. Përcaktimin e strategjive dhe ndërhyrjeve për parandalimin e sëmundjeve infektive, në bashkëpunim me strukturat vendore të shëndetit publik.

2. Koordinimin, udhëzimin dhe monitorimin e zbatimit të masave të luftës kundër sëmundjeve infektive, në përputhje me Rregulloren ndërkombëtare të Shëndetit.

3. Bashkëpunimin, në përputhje me Rregulloren Ndërkombëtare të Shëndetit, me strukturat



përkatëse për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve infektive në ministrinë përgjegjëse për mbrojtjen, ministrinë përgjegjëse për drejtësinë, ministrinë përgjegjëse për rendin publik, ministrinë përgjegjëse për transportin dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

4. Përcaktimin e rregullave në lidhje me transportin, izolimin, mjekimin dhe masat antiepidemike.

Parandalimi dhe kontrolli i përhapjes së sëmundjeve të rënda të njerëzve përtej kufijve të vendit, në rajon, Bashkimin Evropian e më tej, dhe lufta ndaj kërcënimeve të tjera serioze ndërkuftare për shëndetin realizohet përmes rregullave për survejancën epidemiologjike, monitorimi, njoftimi i hershëm e i shpejtë, planifikimin e përgatitjeve dhe përgjigjes, në lidhje me këto aktivitete, bashkëpunimin dhe koordinimin ndërmjet vendeve ndërkuftare dhe të Bashkimit Evropian. Masat ndërkuftare ndërmerren në kuadër të parashikimeve ligjore dhe rregullatore mbi “Survejancën epidemiologjike ndërkuftare” dhe “Kontrollin e infeksioneve në pikat e kalimit kufitar”.

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor ka për mision garantimin e respektimit të kërkesave ligjore në fushën e shëndetit publik. ISHSH-ja organizohet në dy nivele; në nivel qendror dhe atë rajonal, për çdo qark të vendit. Në degët rajonale të ISHSH-së, që kanë në territorin e tyre pika të kalimit kufitar, funksionojnë njësitë kufitare të inspektimit shëndetësor në zbatim të legjislacionit në fuqi në këtë fushë.

Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor zbaton dhe zbërthen në plane konkrete pune me indikatorë të matshëm politik, strategjitë e zhvillimit, programet, kuadrin rregullator në fushën e shëndetësisë, duke u përqendruar në komponentët që lidhen me ofrimin e shërbimit shëndetësor. OSHKSH ka 4 (katër) Drejtori Rajonale të cilat kanë në strukturën e tyre sektorin e Shërbimit të Inteligjencës Epidemike dhe Shëndetit Mjedisor. Ky shërbim ka për qëllim të monitorojë, zbatojë kuadrin ligjor dhe rregullator për zhvillimin e shërbimeve epidemiologjike dhe mbrojtjen e shëndetit mjedisor në shkallë qarku dhe bashkie. Kjo strukturë kontrollon zbatimin e detyrave në të gjitha strukturat e shërbimit shëndetësor publik ose privat si spitalet infektive dhe jo infektive, poliklinika, dispenseri, qendra

shëndetësore, mjekët e institucioneve shkollore dhe parashkollore, klinikat private, pikat kufitare, etj., për evidentimin e gjendjes së sëmundjeve ngjitëse dhe informimin e rregullt të tyre në shërbimet e epidemiologjisë, për rastet me sëmundje ngjitëse dhe mbulesën e vaksinave, si edhe për marrjen e masave për zbulimin në kohë, shtrimin në spital, ose trajtimin në shtëpi, izolimin e vaksinimit në përputhje me rregullat, legjislacionin përkatës të sëmundjeve infektive dhe udhëzimeve të ISHP-së.

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve. Bazuar në detyrimet që burojnë nga Konventa e OKB “Për të drejtat e fëmijës”, në legjislacionin vendas njihet dhe përcaktohet e drejta e fëmijës për t’u zhvendosur nga vendbanimi ose kthimi i tij në vendin e origjinës duke pasur parasysh mendimin, pëlqimin dhe interesin më të lartë të fëmijës. Zhvendosja e fëmijës brenda ose jashtë vendit bëhet me marrëveshjen e të dy prindërve dhe në rastet e fëmijëve të pashoqëruar ata kanë të drejtën e kthimit, në një kohë sa më të shpejtë pranë prindërve apo kujdestarëve të tyre.

Interesi më i lartë i fëmijës është konsiderata parësore në çdo veprim që ka të bëjë me fëmijën. Në zbatimin e këtij parimi mbahen parasysh nevojat e fëmijës për zhvillim fizik e psikologjik, edukim e shëndet, siguri, qëndrueshmëri, rritjen në një mjedis familjar, si dhe mendimi i fëmijës, në varësi të moshës dhe aftësisë së tij për të kuptuar.

Shërbimi Social Shtetëror. Bazuar në ligjin nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”, SHSSH-i monitorin zbatimin e legjislacionit të shërbimeve shoqërore në të gjithë vendin ndërmjet strukturave të njësisë qendrore dhe drejtorive rajonale.

Roli dhe përgjegjësitë e tij janë të përcaktuara në VKM-në nr. 542, datë 27.7.2005, “Për miratimin e statusit të Shërbimit Social Shtetëror”, i ndryshuar.

Si institucioni ekzekutues ka përgjegjësi për dhënien e shërbimeve vetëm në institucionet që janë në administrim të tij, të cilat ofrojnë shërbime në nivel kombëtar.

Në zbatim të VKM nr. 499/2018, “Procedurat standarde të veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit, SHSSH-ja bashkë me ASHMDF-në janë të përfshirë drejtpërdrejt në procesin e identifikimit dhe referimit të VT.



SHSSH ka në administrim të saj Qendrën Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikimit (QKPVT) i cili është institucion kombëtar i sigurisë së lartë, që ofron shërbimin për strehim, rehabilitim dhe riintegrim të viktimave të trafikimit, vendase dhe të huaja.

Ministria e Drejtësisë

Ministria e Drejtësisë është autoritet qendror në bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar, me qëllim forcimin e bashkëpunimit me shërbimet kufitare në zbatimin e konceptit të MIK, veçanërisht përmes zbatimit të marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale që rregullojnë bashkëpunimin ndërkombëtar.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikes

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikes, ka përgjegjësi veçanërisht në fushën e transportit të mallrave dhe udhëtarëve në territorin e Republikës së Shqipërisë si atë rrugor, hekurudhor, ajror dhe detar të transportit dhe kryerjen e aktiviteteve në lidhje me krijimin e kushteve për ndërtimin e rrugëve dhe hekurudhave, përfshirë ato në pikat e kalimit kufitar.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Operatorët Turistik dhe Agjencitë e Udhëtimeve, jep mbështetje në shkëmbimin e informacionit në lidhje me pritshmëritë e flukseve (hyrje/daljet) në kufirin shtetëror të vizitorëve/turistëve dhe periudhave të këtyre flukseve (sezoni veror, festave fetare, festave të nëntorit dhe festat e fundvitit/sezoni dimëror) dhe vendeve nga vijnë dhe dëshirojnë të udhëtojnë.

Hartimi dhe miratimi i akteve administrative të brendshme dhe të përbashkëta për procedura që lehtësojnë shkëmbimin e informacionit.

Krijimi një “hapësire” në sistemin TIMS, ku policia kufitare evidenton hyrje/daljet në kufirin shtetëror, e cila të shërbejë për shkëmbimin e informacionit me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për të gjeneruar të dhëna në lidhje me qëllimin e udhëtimit, ditë qëndrimit, vendet që dëshirojnë të udhëtojnë, si dhe të informohet me pritshmëritë e flukseve (hyrje/daljet) në kufirin shtetëror të vizitorëve/turistëve dhe periudhave të këtyre flukseve. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit me strukturat e saj të varësisë, të shkëmbejë informacione me policinë e shtetit për turistët që

lëvizin nëpër shtigje malore ndërkufitare dhe që nuk kalojnë nëpërmjet sistemit TIMS.

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë është institucioni përgjegjës për të garantuar të drejtën kushtetuese për arsimimin e shtetasve shqiptarë, të huaj dhe personave pa shtetësi, pa u diskriminuar nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, orientimi seksual, bindjet politike ose fetare, gjendja, ekonomike apo sociale, mosha, vendbanimi, aftësia e kufizuar ose për arsye të tjera që përcaktohen në legjislacionin shqiptar.

MASR, nëpërmjet ASCAP do të angazhohet në trajnimin e punonjësve të cilët ushtrojnë detyra që lidhen MIK. MASR përmes ASCAP dhe në bashkëpunim me Akademinë e Sigurisë do të realizojnë periodikisht module trajnimi mbi fushën përkatëse të secilit institucion të përfshirë në Strategji.

Ministria e Kulturës

Ministria e Kulturës harton politikat mbrojtëse dhe promovuese për trashëgiminë kulturore, materiale ose shpirtërore, si dhe krijon hapësirat e nevojshme, ligjore e mbështetëse, për ruajtjen e kultivimin e kulturës së shkruar, për krijimtarinë artistike në përgjithësi, si dhe për të promovuar arritjet e kulturës shqiptare e për të rritur konkurrencën e produktit shqiptar kulturor përtej kufijve. Kjo ministri ka për detyrë regjistrimin, katalogimin informatik, dokumentimin, vlerësimin, promovimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e respektimit të të drejtave të pronësisë dhe të lëvizjes së pasurive kulturore kombëtare, monitoron dhe koordinon punën me njësitë territoriale në fushën e pasurive kulturore nëpërmjet Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave personale garanton zbatimin e rregullave të legjislacionit për të drejtën e informimit dhe legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, në përputhje me ligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, me rregulloret dhe standardet në traktatet e konfirmuara ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, liritë themelore dhe rregullat e pranuar përgjithësisht të së drejtës ndërkombëtare.



2. Llogaridhënia, raportimi dhe monitorimi Llogaridhënia

Përfaqsa dhe rishikimi i dokumentit strategjik do të jetë sipas kërkesave të VKM-së nr. 290, datë 11.4.2020, “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (SIPI/IPSIS), për të siguruar përputhshmërinë me Sistemin IPSIS”.

Procesi i llogaridhënies, monitorimit dhe analizës vlerësuese do të bëhet nga strukturat koordinuese si më poshtë:

- Grupi i menaxhimit të integruar të politikave (GMIP);

- Komiteti Drejtues Sektorial (KDS) për çështjet e rendit dhe sigurisë publike, i cili do të shqyrtojë dhe miratojë raportet në zbatim të politikave dhe objektivave të përcaktuar në këtë dokument strategjik.

Ministria e Brendshme është institucioni përgjegjës që udhëheq hartimin, koordinimin dhe bashkërendimin e institucioneve të përfshira në këtë Strategji.

Monitorimi

Krahas zbatimit të masave të përcaktuara në Strategji dhe planin e veprimit, monitorimi i vazhdueshëm i strukturave të angazhuara për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga këto dokumente konsiderohet i nevojshëm për të analizuar gjendjen reale gjatë zbatimit të tyre dhe për të mbikëqyrur implementimin periodik, me qëllim përmbushjen e tyre në mënyrë sa më efektive.

Monitorimi dhe vlerësimi i punës së autoriteteve që kanë detyrime për zbatimin e Strategjisë së Menaxhimit të Integruar të Kufirit do të shërbejë për të ndjekur ecurinë e Strategjisë, për të vlerësuar shkallën e realizimit të politikave, objektivave të saj, si dhe përmbushjes së masave dhe aktiviteteve.

Monitorimi i planit të veprimit të Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021–2023, do të kryhet nga Grupi për Menaxhimin e Integruar të Politikave (GMIP), të miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 157, datë 22.10.2018, “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar”.

Procesi do të kryhet me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga institucionet kryesore përgjegjëse për çështjet e sigurisë kufitare (përfshirë MB/DPPSH, MFE/DPD, MBZHR/AKU,

MSHMS, MM/FD-RB, MEPJ, MIE/Drejtoria Përgjithshme Detare, MASR, MK, QNOD), donatorë dhe shoqëria civile, (përfaqësues të organizatave joqeveritare).

Me synim garantimin e përmbushjes së objektivave strategjike të Menaxhimit të Integruar të Kufirit, bazuar në këtë dokument strategjik, do të merren masat e mëposhtme:

- do të monitorohen treguesit e përcaktuar në dokumentin strategjik;

- do të rekomandohen ndryshime në programet sektoriale, duke pasur parasysh arritjet, rrethanat, risqet dhe eksperiencat e mëparshme, si dhe në përputhje me rekomandimet e progres raporteve të Bashkimit Evropian;

- do të sigurohen konsultime me palët e interesit, përfshirë shpërndarjen sistematike të informacionit për publikun;

- do të jepet kontribut në rritjen e konsistencës dhe integritetit të politikave dhe masave të sigurisë në të gjitha nivelet e administrimit, si dhe në përdorimin më të mirë të burimeve.

Monitorimi do të kryhet bazuar në raporte 6-mujore dhe vjetore, për monitorimin dhe koordinimin e zbatimit të objektivave dhe masave të planit të veprimit.

Përmirësimet në sistemin e monitorimit dhe vlerësimit synojnë të lehtësojnë/ndihmojnë në përafrimin e kuadrit strategjik dhe prioritetëve në fusha të ndryshme dhe të informojnë për politikën e vendit të lidhura me menaxhimin e integruar të kufirit. Fuqizimi dhe zgjerimi i kuadrit statistikor si në MB, DPPSH dhe institucionet e tjera përgjegjëse do të lehtësojë hartimin e politikave bazuar në evidenca/të dhëna, si dhe do të mundësojë vlerësimin objektiv për përmbushjen e objektivave specifike.

Raportimi

Të gjithë institucionet të ngarkuara me zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021–2027 dhe planin e veprimit 2021–2023, do të hartojnë raporte mbi bazë 6-mujore dhe njëvjeçare në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në planin e veprimit në zbatim të Strategjisë, si dhe do të hedhin të dhëna në sistemin IPSIS.

Ministria e Brendshme do të jetë institucioni lider, i cili do të mbledhë, përpunojë dhe analizojë raportet periodike 6-mujore dhe 1-vjeçare, që do të



përcillen nga të gjitha institucionet e ngarkuara në përmbushje të objektivave dhe masave përkatëse.

Institucionet duhet të raportojnë periodikisht për realizimin e masave, me periodicitet 6-mujor përmes të dhënave të raportuara në Sistemin Informativ për Planifikimin Strategjik të Integruar (IPSIS) në Këshillin e Ministrave dhe në Sekretariatën Teknik Ndërinstitucional.

Komiteti Drejtues Sektorial “punët e brendshme”, drejtuar nga ministri i Brendshëm, në zbatim të pikës 6 dhe 7, të urdhrit të Kryeministrit nr. 157, datë 22.10.2018, “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar”, do të shqyrtojë, diskutojë dhe miratojë raportet e progresit, të monitorimit të arritjes së synimeve dhe prioriteteve në zbatim të këtij dokumenti strategjik dhe planit të veprimit.

Përveç monitorimit të vazhdueshëm, progresi në përmbushjen e qëllimeve të Strategjisë Ndërsektoriale të Menaxhimit të Integruar të Kufirit do të matet nëpërmjet dy mënyrave të vlerësimit, atë të vlerësimit afatmesëm, që do të kryhet në përfundim të trevjeçarit, në fund të vitit 2023, që do të analizojë rezultatet e arritura, menaxhimin e burimeve dhe cilësinë e zbatimit. Kjo analizë do të tregojë për ndryshimet në kontekstin e përgjithshëm ekonomik dhe social, do të vlerësojë nëse qëllimet janë të qenësishme, duke krahasuar kontekstin fillestar dhe do të identifikojë veprimet e nevojshme. Bazuar në këtë vlerësim, do të hartohet plani i veprimit për vitet 2024–2027 për të arritur objektivat e vendosur në Strategji.

Një vlerësim përfundimtar, pas përfundimit të periudhës së zbatimit, do të analizojë të gjithë Strategjinë dhe ndikimin e saj të përgjithshëm, ku do të vlerësohen rezultatet e masave të ndërmarra, burimeve të investuara dhe masën në të cilën janë arritur efektet e pritura. Vlerësimi përfundimtar do

të kryhet duke analizuar të dhënat nga burime të ndryshme, duke përfshirë gjetjet e monitorimit të performancës dhe vlerësimit të ndikimit të programeve aktive të sigurisë në komunitet. Po në këtë kuadër, do të shërbejnë edhe raportet e vlerësimit të impaktit, si dhe raporte e studime të kryera nga shoqëria civile dhe donatorët.

PJESA V: KOSTIMI DHE BURIMET FINANCIARE

Ky kapitull përshkruan shpërndarjen në vija të përgjithshme të burimeve financiare që financojnë produktet e Strategjisë së MIK 2021–2027. Efektet financiare janë përlogaritur nga çdo institucion bazuar në *implementimin* e aktiviteteve të masave përkatëse që janë të parashikuara në planin e veprimit të kësaj Strategjie. Efektet financiare përballohen nga buxhetet respektive vjetore të institucioneve të ngarkuara, si dhe nga buxheti i donatorëve për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021–2027 dhe planit të veprimit 2021–2023, në mënyrë të detajuar.

Procesi i kostimit është bazuar në konsultimin e dokumenteve kombëtare, përfshirë këtu Programi Buxhetor Afatmesëm 2021–2023, si dhe konsultimet me institucionet e përfshira. Plani i veprimit është shoqëruar me një kostim analitik të secilës masë.

Kostoja e përgjithshme e përlogaritur për zbatimin e kësaj Strategjie është 20,136,430,002 lekë ose 161,091,440 euro. Kursi mesatar për referencë është përlogaritur me 125 lekë për 1 euro.

Qëllimi i Politikës 1, pritet të ketë në terma financiarë peshën më të madhe në zbatimin e planit, përkatësisht në masën 84%. Ndërsa qëllimi i politikës 2 dhe qëllimi i politikës 3 zënë përkatësisht 15% dhe 1% në totalin e buxhetit të planit të veprimit.




Kostoja financiare e SMIK (në lek)

Qëllimi i politikës	Tipologjia e kostove	Kostoja totale	Kostoja e planifikuar në	Kostoja për t'u planifikuar në	Hendeku financiar
		2021–2027	PBA 2021–2023 Buxheti dhe donatorët	PBA 2022–2024 Buxheti dhe donatorët	2021–2027
QP1: MBROJTJA E SIGURISË SË BRENDSHME DHE MENAXHIMI I FLUKSEVE MIGRATORE, ME QËLLIM PARANDALIMIN E MIGRACIONIT TË PARREGULLT, SI DHE PARANDALIMIN DHE GODITJEN E KRIMIT NDËRKUFITAR	Korente	15,894,166,002	7,332,254,001	8,550,712,002	20,200,000
	Kapitale	1,292,406,000	1,140,312,500	143,093,500	
QP2: LEHTËSIMI I QARKULLIMIT LEGAL TË SHITETASVE DHE MALLRAVE	Korente	1,793,500,000	8,500,000	1,428,000,000	357,000,000
	Kapitale	1,149,158,000	1,149,158,000	0	
QP3: RESPEKTIMI I PLOTË I TË DREJTAVE THEMELORE, PËRFSHIRË TRAJTIMIN E ÇDO INDIVIDIT ME RESPEKT TË PLOTË PËR DINJITETIN DHE MUNDËSIMIN E QASJES NË MBROJTJEN NDËRKOMBËTARE TË ATYRE QË KANË NEVOJË	Korente	7,200,000	7,200,000	600,000	-600,000
	Kapitale	0	0	0	
TOTALI [lekë]		20,136,430,002	9,637,424,501	10,122,405,502	376,600,000
TOTALI [euro] <i>1 euro = 125 lekë</i>		161,091,440	77,099,396	80,979,244	3,012,800


Financimi i planit të veprimit të Strategjisë do të realizohet nga dy burime kryesore, nga buxheti i shtetit dhe nga mbështetja financiare e donatorëve. Për periudhën 2021–2023, buxheti i shtetit pritet të financojë zbatimin e planit në masën 36% të financimit të nevojshëm, ndërsa 12% pritet të financohet nga Bashkimi Evropian dhe donatorët e tjerë. Në momentin e hartimit të planit të veprimit, hendeku financiar vlerësohet të jetë në masën 2% të totalit të koston financiare të të gjithë viteve të Strategjisë.



Kosto e PV - NDARJA E SHPENZIMEVE




Natyra ekonomike e kostove të planit të veprimit



Peshën më të madhe për zbatimin e masave të planit të veprimit e zënë kostot korentë, përkatësisht në masën 88%. Ndërsa kostot kapitale përlllogariten në masën 12% të kostos totale të Strategjisë së MIK 2021–2027.

Kostot korentë dhe kapitale të lidhur sipas qëllimit të politikave janë sipas tabelës së mëposhtme:



Plani i veprimit të Strategjisë së MIK, do të rishikohet në periudhë 3-vjeçare për ta përshtatur me progresin në zbatimin e masave, por edhe për ta azhurnuar atë konform programeve buxhetore afatmesme, si dhe prioriteteve të çdo institucioni. Për masa të planit të veprimit ende të pambuluara financiarisht, institucionet përgjegjëse do të planifikojnë nevojat për financime buxhetore nëpërmjet programeve buxhetore përkatëse, si pjesë e procesit të planifikimit të programit afatmesëm buxhetor, dhe buxhetit vjetor.



Organizimi/Agjencija	Niveli i ndërtimit		Vitet		Vendi i ndërtimit			PRA 2021-2023			PRA 2024-2027			Mënyra e ndërtimit	Mënyra e ndërtimit sipas NLP-së	
	Kategoria	Lloji	2021	2022	Kostot	Kostot	Totali	PRA 2021-2023		PRA 2024-2027		Kostot	Kostot			Totali
								Kostot	Kostot	Kostot	Kostot					
Organizimi/Agjencija 1	PRA	100	2021	2022	10,000,000	0	10,000,000	10,000,000	0	10,000,000	0	0	0	0	0	0
Organizimi/Agjencija 2	PRA	100	2021	2022	10,000,000	10,000,000	20,000,000	10,000,000	0	10,000,000	0	10,000,000	10,000,000	0	0	0
Organizimi/Agjencija 3	PRA	100	2021	2022	10,000,000	10,000,000	20,000,000	10,000,000	0	10,000,000	0	10,000,000	10,000,000	0	0	0
Organizimi/Agjencija 4	PRA	100	2021	2022	10,000,000	0	10,000,000	10,000,000	0	10,000,000	0	0	0	0	0	0
Organizimi/Agjencija 5	PRA	100	2021	2022	10,000,000	0	10,000,000	10,000,000	0	10,000,000	0	0	0	0	0	0
Organizimi/Agjencija 6	PRA	100	2021	2022	10,000,000	0	10,000,000	10,000,000	0	10,000,000	0	0	0	0	0	0
Organizimi/Agjencija 7	PRA	100	2021	2022	10,000,000	0	10,000,000	10,000,000	0	10,000,000	0	0	0	0	0	0
Organizimi/Agjencija 8	PRA	100	2021	2022	10,000,000	0	10,000,000	10,000,000	0	10,000,000	0	0	0	0	0	0
Organizimi/Agjencija 9	PRA	100	2021	2022	10,000,000	0	10,000,000	10,000,000	0	10,000,000	0	0	0	0	0	0
Organizimi/Agjencija 10	PRA	100	2021	2022	10,000,000	0	10,000,000	10,000,000	0	10,000,000	0	0	0	0	0	0
Totali					100,000,000	0	100,000,000	100,000,000	0	100,000,000	0	0	0	0	0	0

Organizimi/Agjencija 1

Organizimi/Agjencija 2

Organizimi/Agjencija 3



Objektivat Specifikë	Institucionet përgjegjëse		Afati i zbatimit		Kostoja indikative totale			Burimi i mbulimit deri në 2023						Burimi i mbulimit 2024–2027			Hendeku financiar 2021–2027 (në lekë)	Kostoja totale në EUR (kursi i këmbimit: 1 EUR = 125 ALL)	
	Institucioni përgjegjës	Institucioni kontribues	Afati i fillimit	Afati i mbarimit				PBA 2021–2023			Financim i huaj			PBA-Buxheti 2024–2027					
					Korente	Kapitale	Totali i kostos	Korente	Kapitale	Totali i BSH-së	Korente	Kapitale	Totali i FH-së	Korente	Kapitale	Totali i buxheut			
Objektiv specifik 1: Retja e nivelit të përputhshmërisë me standardet evropiane dhe të Schengen-it, në aspektin legjislativ, administrativ dhe institucional në fushën e menaxhimit të integruar të kufijve, veçanërisht në fushën e kontrollit dhe rrbkëqyrjes së kufirit dhe forcimi i bashkëpunimit ndërgjenerci dhe bashkëpunimit ndërkombëtar	PSH	MB MFE/DPD MM	2021	2027	25,910,000	0	25,910,000	14,110,000	0	14,110,000	0	0	0	600,000	11,200,000	11,800,000	0	207,280	
Objektiv specifik 2: Përmirësimi i Sistemit për rrbkëqyrjen e hapësirës detare, kontrollit kufitar dhe kërkim-shpëtim në det	MB PSH MM/FD-RB	MM FD-RB QNOD MB/DPD MFE/DPD MIE/Drejtoria e Përgjithshme e Detare DONATORE	2021	2027	61,600,000	352,500,000	414,100,000	61,600,000	0	61,600,000	0	232,187,500	232,187,500	0	120,312,500	120,312,500	0	3,312,800	
Objektiv specifik 3: Reduktimi i vulnerabilitetit (ndjeshmërisë) në kufi duke reaguar në mënyrë më efektive me vendosjen e burimeve të disponueshme, bazuar në analizën e rezultateve të kryer dhe kërkimit që mund të ndikojnë në sigurinë kufitare, në përputhje me modelin e CIRAM të BE-së	PSH	MB MBZHR/AKU MFE/DPD	2021	2027	10,102,231,820	277,406,000	10,379,637,820	4,336,270,780	0	4,336,270,780	0	245,625,000	245,625,000	5,765,961,040	11,581,000	5,777,542,040	-20,200,000	83,037,103	
Objektiv specifik 4: Bashkëpunimi i zgjeruar ndërinstitucional në menaxhimin e integruar të kufijve për të përmirësuar trafikun ndërkufitar, përmirësimin e sigurisë kufitare, luftën ndaj krimit ndërkufitar, mbrojtjen e jetës, shëndetit dhe pronës e njerëzve, shëndetit e kafshëve, bimësinë dhe ekosistemet përgjatë kufirit shtetëror	MFE/DPD MB/PSH MASR MK/IKRKT	MB/PSH MFE/DPD MBZHR/AKU ASCAP	2021	2027	8,210,000	0	8,210,000	8,210,000	0	8,210,000	0	0	0	0	0	0	0	0	65,680
Objektiv specifik 5: Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar, veçanërisht me vendet fqinje, institucionet e BE-së dhe Agjencinë Evropiane të Rojës Kufitare dhe Bregdetare (FRONTEX) për qëshjet e kufijve, parandalimin e migracionit të paligjshëm, krijimin ndërkufitar dhe ripranimin e personave me qëndrim të parregullt	MB/PSH DPD	MFE/DPD MEPI MB	2021	2027	5,691,814,182	662,500,000	6,354,314,182	2,103,863,221	0	2,103,863,221	805,000,000	662,500,000	1,467,500,000	2,782,950,962	0	2,782,950,962	0	50,834,513	
Objektiv specifik 6: Përmirësimi i sistemit të ripranimit (kthimit dhe pranimit) të shtetasve të huaj dhe vendas në përputhje me marrëveshjet e lidhura dhe në bashkëpunim me misionet diplomatike dhe konsullore	MB/PSH	MEPI MSHMS	2021	2027	4,400,000	0	4,400,000	3,200,000	0	3,200,000	0	0	0	1,200,000	0	1,200,000	0	35,200	
Kostoja totale e qëllimit të politikës I (objektiva specifike 1+2+3+4+5+6)					15,894,166,002	1,292,406,000	17,186,572,002	6,527,254,001	0	6,527,254,001	805,000,000	1,140,312,500	1,945,312,500	8,550,712,002	143,093,500	8,693,805,502	-20,200,000	137,492,576	

Qëllimi i politikës II: LEHTËSIMI I QARKULLIMIT LEGAL TË SHTETASVE DHE MALLRAVE

Objektivat specifike	Institucionet përgjegjëse		Afati i zbatimit		Kostoja indikative totale			Burimi i mbulimit deri në 2023						Burimi i mbulimit 2024–2027			Hendeku financiar 2021–2027 (në lekë)	Kostoja totale në EUR (kursi i këmbimit: 1 EUR = 125 ALL)
	Institucioni përgjegjës	Institucioni kontribues	Afati i fillimit	Afati i mbarimit				PBA 2021–2023			Financim i huaj			PBA-Buxheti 2024–2027				
					Korente	Kapitale	Totali i kostos	Korente	Kapitale	Totali i BSH-së	Korente	Kapitale	Totali i FH-së	Korente	Kapitale	Totali i buxheut		
Objektiv specifik 1: Përmirësimi i infrastrukturës në Pikat e Kalimit Kufitar me qëllim krijimit e kushteve që sigurojnë kalim të lehtësuar dhe të sigurt shtetasve dhe mallrave	DPD PSH	MFE/DPD MB/PSH	2021	2027	0	1,099,658,000	1,099,658,000	0	721,188,000	721,188,000	0	378,470,000	378,470,000	0	0	0	0	8,797,264
Objektiv specifik 2: Negocimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve për ngjijen e Pikave të Përbashkëta të Kalimit Kufitar dhe Doganar	MB/PSH	MFE/DPD MEPI	2021	2027	3,500,000	0	3,500,000	3,500,000	0	3,500,000	0	0	0	0	0	0	0	28,000
Objektiv specifik 3: Alokimi i burimeve të nevojshme njerëzore në Pikat e Kalimit të Kufitar në përputhje me fluksin e qarkullimit ndërkufitar	PSH	MB	2021	2027	1,785,000,000	0	1,785,000,000	0	0	0	0	0	0	1,428,000,000	0	1,428,000,000	357,000,000	14,280,000
Objektiv specifik 4: Forcimi i kapaciteteve logjistike për zbulimin e dokumenteve të falsifikuara të udhëtimt	PSH	MB	2021	2027	0	47,000,000	47,000,000	0	0	0	0	47,000,000	47,000,000	0	0	0	0	376,000
Objektiv specifik 5: Forcimi i kapaciteteve profesionale të rojeve kufitare që shërbejnë në Pikat e Kalimit Kufitar	PSH	MB	2021	2027	5,000,000	2,500,000	7,500,000	650,000	0	650,000	4,350,000	2,500,000	6,850,000	0	0	0	0	60,000
Kostoja totale e qëllimit të politikës II (objektiva specifike 1+2+3+4+5)					1,793,500,000	1,149,158,000	2,942,658,000	4,150,000	721,188,000	725,338,000	4,350,000	427,970,000	432,320,000	1,428,000,000	0	1,428,000,000	357,000,000	23,541,264



Qëllimi i politikës III: RESPEKTIMI I PLOTË I TË DREJTAVE THEMELORE, PËRFSHIRË TRAJTIMIN E ÇDO INDIVIDIT ME RESPEKT TË PLOTË PËR DINJITETIN DHE MUNDËSIMIN E QASJES NË MBROJTJEN NDËRKOMBËTARE TË ATYRE QË KANË NEVOJË																		
Objektivat specifike	Institucionet përgjegjëse		Afati i zbatimit		Kosto indikative totale			Burimi i mbulimit deri në 2023						Burimi i mbulimit 2024–2027			Hendeku financiar 2021–2027 (në lek)	Kostoja totale në EUR (kursi i këmbimit 1 EUR = 125 ALL)
	Institucioni përgjegjës	Institucioni kontribues	Afati i fillimit	Afati i mbarimit				PBA 2021–2023			Financim i huaj			PBA-Buxheti 2024–2027				
					Korente	Kapitale	Totali i kostos	Korente	Kapitale	Totali i BSH-së	Korente	Kapitale	Totali i FH-së	Korente	Kapitale	Totali i buxhetit		
Objektiv specifik 1: Përmirësimi i nivelit të respektimit, mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave themelore, sjelljes profesionale të oficerëve të kontrollit kufitar, si dhe aftësive të tyre profesionale për përdorim më efikas të pajisjeve teknike, trajnimin dhe zhvillimin profesional	PSH	MB	2021	2027	3,900,000	0	3,900,000	3,900,000	0	3,900,000	0	0	0	600,000	0	600,000	0	31,200
Objektiv specifik 2: Kontrolli i cilësisë në zbatimin e ligjit për menaxhimin e kufijve dhe sjellja e policëve dhe doganierëve të përkrahur në kontrollin kufitar dhe doganor të kybet në përputhje aktet ligjore dhe nënligjore dhe me standardet e BE-së	PSH	MB	2021	2027	1,500,000	0	1,500,000	1,500,000	0	1,500,000	0	0	0	0	0	0	0	12,000
Objektiv specifik 3: Sigurimi i qasjes në mbrojtjen ndërkombëtare atyre që kanë nevojë	PSH	MB	2021	2027	1,800,000	0	1,800,000	1,800,000	0	1,800,000	0	0	0	0	0	0	0	14,400
Kostoja totale e qëllimit të politikës III (objektiva specifike 1+2+3)					7,200,000	0	7,200,000	7,200,000	0	7,200,000	0	0	0	600,000	0	600,000	0	57,600
Kostoja totale e PV					17,694,866,002	2,441,564,000	20,136,430,002	6,538,604,001	721,188,000	7,259,792,001	809,350,000	1,568,282,500	2,377,632,500	9,979,312,002	143,093,500	10,122,405,502	377,200,000	161,091,440

Kostoja totale e PV-së	20,136,430,002
PBA 2021–2023	7,259,792,001
Financim i huaj	2,377,632,500
Buxheti 2024–2027	10,122,405,502
Hendek financiar 2021–2027	376,600,000

	Kostoja korente	Kostoja kapitale	Totali
Qëllimi i politikës I	15,894,166,002	1,292,406,000	17,186,572,002
Qëllimi i politikës II	1,793,500,000	1,149,158,000	2,942,658,000
Qëllimi i politikës III	7,200,000	0	7,200,000

Kosto Korente	17,694,866,002
Kosto kapitale	2,441,564,000
Total kosto	20,136,430,002




Kostoja financiare e SMIK (në lek)

Qëllimi i politikës	Tipologjia e kostove	Kostoja totale	Kosto e planifikuar në	Kosto për t'u planifikuar në	Hendeku financiar
		2021–2027	PBA 2021–2023	PBA 2022–2024	2021–2027
			Buxheti dhe donatorët	Buxheti dhe donatorët	
QP1: MBROJTJA E SIGURISË SË BRENDSHME DHE MENAXHIMI I FLUKSEVE MIGRATORE, ME QËLLIM PARANDALIMIN E MIGRACIONIT TË PARREGULLT, SI DHE PARANDALIMIN DHE GODITJEN E KRIMIT NDËRKUFITAR	Korente	15,894,166,002	7,332,254,001	8,550,712,002	20,200,000
	Kapitale	1,292,406,000	1,140,312,500	143,093,500	
QP2: LEHTËSIMI I QARKULLIMIT LEGAL TË SHITETASVE DHE MALLRAVE	Korente	1,793,500,000	8,500,000	1,428,000,000	357,000,000
	Kapitale	1,149,158,000	1,149,158,000	0	
QP3: RESPEKTIMI I PLOTË I TË DREJTAVE THEMELORE, PËRFSHIRË TRAJTIMIN E ÇDO INDIVIDIT ME RESPEKT TË PLOTË PËR DINJITETIN DHE MUNDËSIMIN E QASJES NË MBROJTJEN NDËRKOMBËTARE TË ATYRE QË KANË NEVOJË	Korente	7,200,000	7,200,000	600,000	-600,000
	Kapitale	0	0	0	
TOTALI [lek]		20,136,430,002	9,637,424,501	10,122,405,502	376,600,000
TOTALI [euro] <i>1 euro = 125 lekë</i>		161,091,440	77,099,396	80,979,244	3,012,800





Kosto e PV - NDARJA E SHPENZIMEVE



■ PBA 2021-2023 ■ Financim i huaj ■ Buxheti 2024-2027 ■ Hendek financiar 2021-2027

NATYRA EKONOMIKE E KOSTOVE TË Planit Të Veprimit



**VENDIM**

Nr. 1144, datë 24.12.2020

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË OBJEKTIT “*ATRIUM CENTER THUMANA*”, NJËSIA ADMINISTRATIVE THUMANË, BASHKIA KRUIJË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË KRUIJË SI NJËSI ZBATUESE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” dhe “iii”, 16, dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit të objektit “*Atrium Center Thumana*”, Njësia Administrative Thumanë, Bashkia Krujë, në vlerën 220 210 898 (dyqind e njëzet milionë e dyqind e dhjetë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

2. Përdorimi i fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2020, për financimin e rindërtimit të objektit “*Atrium Center Thumana*”, Njësia Administrative Thumanë, Bashkia Krujë, të jetë në vlerën 44 042 180 (dyzet e katër milionë e dyzet e dy mijë e njëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH dhe të përballohet nga shpenzimet e fondit të rindërtimit.

3. Caktimin e Bashkisë Krujë si njësi zbatuese për rindërtimin e objektit “*Atrium Center Thumana*”, njësia administrative Thumanë, Bashkia Krujë.

4. Fondi për financimin e rindërtimit të objektit arsimor “*Atrium Center Thumana*” i transferohet në formën e transfertës së pakushtëzuar njësisë zbatuese, Bashkisë Krujë.



5. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Krujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 1145, datë 24.12.2020

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E
RINDËRTIMIT TË OBJEKTIT ARSIMOR
SHKOLLA 9-VJEÇARE “HAJDAR ZOGU”,
FSHATI TAPIZË, NJËSIA
ADMINISTRATIVE NIKËL, BASHKIA
KRUIË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË
KRUIË SI NJËSI ZBATUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” dhe “iii”, 16 dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të objektit arsimor shkolla 9-vjeçare “Hajdar Zogu”, fshati Tapizë, Njësia Administrative Nikël, Bashkia Krujë, në vlerën 103 147 686 (njëqind e tre milionë e njëqind e dyzet e shtatë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

2. Përdorimi i fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2020, për financimin e rindërtimit të objektit arsimor shkolla 9-vjeçare “Hajdar Zogu”, fshati Tapizë, Njësia Administrative Nikël, Bashkia Krujë, të jetë në vlerën 20 629 537 (njëzet milionë e gjashtëqind e njëzet e nëntë mijë e pesëqind e tridhjetë e shtatë) lekë pa TVSH dhe të përballohet nga shpenzimet e fondit rindërtimit.

3. Caktimin e Bashkisë Krujë si njësi zbatuese për rindërtimin e objektit arsimor shkolla 9-vjeçare “Hajdar Zogu”, fshati Tapizë, Njësia Administrative Nikël, Bashkia Krujë.

4. Fondi për financimin e rindërtimit të objektit arsimor shkolla 9-vjeçare “Hajdar Zogu” i transferohet në formën e transfertës së pakushtëzuar njësisë zbatuese, Bashkisë Krujë.

5. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Krujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 1150, datë 24.12.2020

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË
GRANTIT DHE PROJEKTIT
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE KfW FRANKFURT
AM MAIN (KfW), PËR PROGRAMIN E
RINDËRTIMIT TË NDËRTESAVE
PUBLIKE (FAZA I)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së grantit dhe projektit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për programin e rindërtimit të ndërtesave publike (faza I), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe



MARRËVESHJE GRANTI DHE PROJEKTI

DATE _____
 NDËRMJET KFW FRANKFURT AM
 MAIN (KfW) DHE
 KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
 REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
 PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
 RINDËRTIMIT (MARRËSI) DHE FONDIT
 SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT (FSHZH)
 (AGJENCIA ZBATUESE E PROJEKTTIT) PËR
 11,000,000.00 EURO
 - PROGRAM PËR RINDËRTIMIN E
 NDËRTEHAVE PUBLIKE (FAZA I)
 – BMZ - NR. 2019 69 542

PËRMBAJTJA

Neni

1. Shuma dhe qëllimi i Grantit
2. Kanalizimi i Grantit tek Agjencia Zbatuese e Projektit
3. Disbursimi
4. Pezullimi i disbursimit dhe kthimi i pagesave
5. Kostot dhe detyrimet
6. Deklarata kontraktuale dhe prokura e përfaqësimit
7. Projekti
8. Publikimi dhe transferimi i informacionit në lidhje me Projektin
9. Dispozita të ndryshme
 Marrëveshje Përbushjeje nga Marrësi
 Marrëveshje Përbushjeje nga Agjencia Zbatuese e Projektit

Bazuar në notën verbale të datës 19 dhjetor 2019 dhe 17 mars 2020 të Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë Drejtuar Qeverisë së Shqipërisë, Marrësi, Agjencia Zbatuese e Projektit dhe KfW-ja lidhin Marrëveshjen e mëposhtme të Grantit dhe të Projektit (Marrëveshja):

1. Shuma dhe qëllimi i Grantit

1.1 KfW-ja i ofron Marrësit një grant që nuk kalon shumë 11,000,000.00 euro (me fjalë: njëmbëdhjetë milion) (Granti).

Granti nuk do të jetë i kthyeshëm nëse nuk përcaktohet ndryshe në nenin 0.

1.2 Marrësi e kanalizon Grantin plotësisht tek Agjencia Zbatuese e Projektit në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 0. Agjencia Zbatuese e Projektit e përdor Grantin vetëm për rindërtimin me kursim energjie të ndërtesave të shkollave shtetërore, të cilat u shkatërruan nga tërmeti (Projekti) dhe kryesisht për të paguar koston e shkëmbimit valutë. Agjencia Zbatuese e Projektit dhe KfW-ja përcaktojnë detajet e Projektit dhe mallrat dhe shërbimet që do të financohen nga Granti me anë të një marrëveshje të veçantë “Marrëveshja e veçantë”) e cila do të kundërfirmoset nga Marrësi, i përfaqësuar nga Ministria e Rindërtimit.

1.3 Taksat dhe detyrimet e tjera publike në ngarkim të Marrësit ose Agjencisë Zbatuese të Projektit dhe detyrimet e importit nuk do të financohen nga Granti.

2. Kanalizimi i Grantit tek Agjencia Zbatuese e Projektit

2.1 Marrësi e kanalizon Grantin tek Agjencia Zbatuese e Projektit si një grant jo i kthyeshëm sipas një marrëveshjeje të veçantë granti.

2.2 Përpara disbursimit të parë nga Granti, Marrësi i jep KfW-së një kopje dhe një kopje të noterizuar të përkthimit në gjuhën angleze ose gjermane të marrëveshjes së veçantë të grantit të përmendur në nenin 0.

2.3 Kanalizimi i grantit nuk përbën përgjegjësi të Agjencisë Zbatuese të Projektit ndaj KfW-së për detyrime pagimi sipas kësaj Marrëveshjeje.

3. Disbursimi

3.1 KfW-ja disburson Grantin sipas ecurisë së Projektit dhe me kërkesë të Agjencisë Zbatuese të Projektit. Me një Marrëveshje të Veçantë, Marrësi, Agjencia Zbatuese e Projektit dhe KfW-së përcaktojnë procedurën e disbursimit, sidomos të dhënat që tregojnë se fondet e disbursuara janë përdorur për qëllimin e përcaktuar.

3.2 KfW-ja ka të drejtë të refuzojë të bëjë disbursime pas datës 30 qershor 2025.

4. Pezullimi i disbursimit dhe kthimi i pagesave

4.1 KfW-ja nuk mund të pezullojë disbursimet vetëm, nëse

a) Marrësi nuk ka përbushur detyrimet e tij ndaj KfW-së për të bërë pagesat në kohë;

b) janë shkëlur detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje ose marrëveshjeve të veçanta në lidhje me këtë Marrëveshje;



c) Agjencia Zbatuese e Projektit nuk mund të provojë që Granti është përdorur për qëllimin e përcaktuar;

d) përmeshja e detyrimeve të KfW-së, sipas kësaj Marrëveshjeje cenon ligjin e zbatueshëm; ose

e) krijohen rrethana të jashtëzakonshme që pengojnë ose rrezikojnë rëndë zbatimin, funksionimin ose qëllimin e Projektit.

4.2 Nëse ka ndodhur ndonjë nga parashikimet e specifikuar në nenin 4.1(0, (0 ose (0 ka ndodhur dhe nuk është eliminuar gjatë një periudhe të përcaktuar nga KfW-ja, që sidoqoftë duhet të jetë të paktën 30 ditë, KfW-ja:

a) në rastin e specifikuar në nenin 4.1(0 ose (0, mund të kërkojë kthimin e menjëhershëm të të gjithë shumave të disbursuara;

b) në rastin e specifikuar në nenin 4.1(0 mund të kërkojë kthimin e menjëhershëm të këtyre shumave sepse Agjencia Zbatuese e Projektit nuk është në gjendje të tregojë se janë përdorur për qëllimin e përcaktuar.

5. Kostot dhe detyrimet

Marrësi merr përsipër të gjitha taksat dhe detyrime të tjera që lindin jashtë Republikës Federale të Gjermanisë, në lidhje me përfundimin dhe ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje, si edhe të gjitha kostot e transferimit dhe konvertimit që lindin në lidhje me disbursimin e Grantit.

6. Deklarata kontraktuale dhe prokura e përfaqësimit

6.1 Ministri për Rindërtimin dhe çdo person i caktuar prej tij ose saj në KfW dhe i autorizuar me specimenin e nënshkrimit të njohur prej tij ose saj përfaqëson Marrësin në ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje. Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Zbatuese të Projektit dhe çdo person i caktuar prej tij ose saj në KfW dhe i autorizuar me specimenin e nënshkrimit të njohur prej tij ose saj përfaqëson Agjencinë Zbatuese të Projektit në ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje. Afati i prokurës së përfaqësimit mbaron kur KfW-ja merr revokimin e shprehur të tyre nga përfaqësuesi i autorizuar në atë kohë.

6.2 Ndryshimet ose shtesat në këtë Marrëveshje dhe çdo njoftim dhe deklaratë e marrë nga palët kontraktuese sipas kësaj Marrëveshjeje bëhen me shkrim. Çdo njoftim apo deklaratë e tillë konsiderohet e marrë, pasi ka mbërritur në adresën e mëposhtme të palës kontraktuese përkatëse ose

në adresë tjetër të palës kontraktuese përkatëse që i është njoftuar palës tjetër kontraktuese:

Për KfW-në:

KfW
Postfach 11 11 41
60046 Frankfurt am Main
Federal Republic of Germany
Faks: +49 69 7431-2944

Për Marrësin:

Këshilli i Ministrave i Republikës së

përfaqësuar nga Ministria e Shtetit

Kryeministria
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”
Tiranë
Shqipëri

Për Agjencinë Zbatuese të

Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Rr. “Sami Frashëri”, 10
Tirana, Albania
Telefon: +355 4234 885
Faks: +355 4234 885

6.3 Ministri i Rindërtimit është autorizuar për të nënshkruar çdo ndryshim që duhet të miratohet nga Këshilli i Ministrave. Ndryshimet në këtë Marrëveshje ,që prekin vetëm periudhën e disbursimit (neni 3.2) nuk kërkojnë miratimin paraprak nga Këshilli i Ministrave dhe nuk kërkojnë miratim të mëtejshëm nga qeveria apo tjetër.

6.4 Ndryshimet e kësaj Marrëveshjeje që prekin vetëm marrëdhëniet juridike ndërmjet KfW-së dhe Marrësit nuk kërkojnë pëlqimin e Agjencisë Zbatuese të Projektit.

7. Projekti

7.1 Agjencia Zbatuese e Projektit:

a) përgatit, zbaton, vë në punë dhe mirëmban Projektin në përputhje me praktikën e shëndosha financiare dhe inxhinierike, sipas standardeve mjedisore dhe sociale dhe sidomos në përputhje me konceptimin e Projektit të miratuar ndërmjet Agjencisë Zbatuese të Projektit dhe KfW-së;

b) ngarkon një subjekt me përgatitjen e projektimit dhe mbikëqyrjen e ndërtimit të Projektit, siç përcaktohet në pikën 7.1 të kësaj Marrëveshjeje dhe siç shtjellohet më tej në pikën 2.3 të Marrëveshjes së Veçantë ndërmjet KfW-së dhe FSHZH-së, në përputhje me pikën 1.2 të kësaj Marrëveshjeje;

c) zbaton në çdo kohë dispozitat e prokurimit të përcaktuara në Marrëveshjen e Veçantë si edhe planin përkatës të prokurimit;

d) mirëmban ose siguron mirëmbajtjen e librave dhe regjistrave që qartësisht tregojnë të gjitha kostot e mallrave dhe shërbimeve të nevojshme për



Projektin dhe që identifikojnë qartë mallrat dhe shërbimet e financuara nga ky Grant;

e) bën të mundur që përfaqësuesit e KfW-së në çdo kohë të inspektojnë librat dhe regjistrat në fjalë dhe të gjithë dokumentacionin tjetër që ka lidhje me realizimin e Projektit dhe të vizitojnë Projektin dhe të gjitha strukturat që lidhen me të; dhe

f) i jep KfW-së të gjithë informacionin dhe të dhënat për Projektin dhe ecurinë e tij të mëtejshme sipas kërkesës së KfW-së.

7.2 Agjencia Zbatuese e Projektit dhe KfW-ja përcaktojnë detajet në lidhje me nenin 7.1 dhe me anë të Marrëveshjes së Veçantë.

7.3 Marrësi dhe Agjencia Zbatuese e Projektit:

a) sigurojnë financimin e plotë të Projektit dhe, me kërkesë, i japin KfW-së të dhëna që tregojnë mbulimin e kostove që nuk paguhen nga ky Grant; dhe

b) me dëshirën e tyre dhe menjëherë informojnë KfW-në për çdo dhe të gjitha rrethanat që pengojnë ose cenojnë rëndë realizimin, funksionimin ose qëllimin e Projektit.

7.4 Marrësi do të ndihmojë Agjencinë Zbatuese të Projektit, në përputhje me praktikën e shëndosha financiare dhe inxhinierike për zbatimin e Projektit dhe për përmbushjen e detyrimeve të Agjencisë Zbatuese të Projektit, sipas kësaj Marrëveshjeje dhe sidomos, do t'i japë Agjencisë Zbatuese të Projektit të gjitha lejet e nevojshme për zbatimin e Projektit.

8. Publikimi dhe transferimi i informacionit në lidhje me Projektin

8.1 Për të zbatuar parimet e pranuar ndërkombëtarisht për transparencë dhe efikasitet maksimal në bashkëpunimin për zhvillim, KfW-ja publikon informacion të përzgjedhur (përfshirë rezultatet e kategorizimit mjedisor dhe social dhe vlerësim si edhe raporte vlerësimi *ex post*) për Projektin dhe financimin e tij gjatë negociatave parakontraktuale, ndërkohë që zbatohet/zbatohen marrëveshja/marrëveshjet dhe në fazën postkontraktuale (këtu e më poshtë e quajtur si "Periudha e Plotë").

Informacioni publikohet rregullisht në faqen e internetit të KfW-së për fushën e veprimtarisë "Banka për Zhvillim KfW" (<http://transparenz.kfw-entwicklungsbank.de/>).

Publikimi i informacionit (ose nga KfW-ja ose nga palët e treta në përputhje me nenin 0 më poshtë) për Projektin dhe financimin e tij nuk

përfshin dokumentacion kontraktual ose informacion sensitiv të detajuar financiar apo pune për palët e përfshira në Projekt ose financimin e tij, siç është për shembull:

a) informacioni për të dhënat e brendshme financiare;

b) strategjitë e punës;

c) udhëzime dhe raporte të brendshme të korporatës;

d) të dhëna personale të personave juridikë;

e) vlerësimi i brendshëm i KfW-së për gjendjen financiare të palëve.

8.2 KfW-ja ndan informacionin e përzgjedhur për Projektin dhe financimin e tij gjatë Periudhës së Plotë me subjektet e përmendura më poshtë, sidomos për të siguruar transparencë dhe efikasitet:

a) filialet e KfW-së;

b) Republikën Federale të Gjermanisë dhe organet kompetente të saj, autoritetet, institucionet, agjencitë ose subjektet;

c) organizata të tjera zbatuese të përfshira në bashkëpunimin dypalësh gjerman për zhvillim sidomos Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH;

d) organizata ndërkombëtare të përfshira në mbledhjen e të dhënave statistikore dhe anëtarët e tyre, sidomos Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) dhe anëtarët e saj.

8.3 Gjithashtu, Republika Federale e Gjermanisë i ka kërkuar KfW-së të ndajë informacionin e përzgjedhur për Projektin dhe financimin e tij gjatë Periudhës së Plotë me subjektet e mëposhtme, që publikojnë seksionet që lidhen me qëllimin:

a) Republika Federale e Gjermanisë për qëllime të Nismës për Transparencë të Ndihmës Ndërkombëtare

(http://www.bmz.de/de/was_wir_machen/wege/transparenz-fuer-mehr-wirksamkeit/index.html);

b) Germany Trade & Invest (GTAI) për qëllime të informacionit për tregun (<https://www.gtai.de/gtai-de/trade>);

c) OECD për qëllim të raportimit të flukseve financiare në kuadër të bashkëpunimit për zhvillim (<http://stats.oecd.org/>);

d) Instituti Gjerman për Vlerësimin e Zhvillimit (DEVal), për qëllim të vlerësimit të bashkëpunimit gjerman për zhvillim për të siguruar transparencë dhe efikasitet (<http://www.deval.org/de/>).



8.4 KfW-ja më tej rezervon të drejtën të përcjellë informacionin (përfshirë atë për qëllime të publikimit) mbi projektin dhe financimin e tij gjatë periudhës së plotë të palët e tjera të treta për të ruajtur interesat legjitimë.

KfW-ja nuk përcjell informacion te palët e tjera të treta nëse interesat legjitimë të Marrësit dhe/ose Agjencisë Zbatuese të Projektit në informacionin që nuk përcillet janë më të mëdha se interesat e KfW-së për përcjelljen e tij. Interesat legjitimë të Marrësit dhe/ose Agjencisë Zbatuese të Projektit përfshijnë sidomos fshehtësinë e informacionit sensitiv të përmendur në nenin 0, i cili përjashtohet nga publikimi.

Gjithashtu, KfW-ja ka të drejtë t'i përcjellë informacion palëve të treta, nëse kjo është e nevojshme, për shkak të kërkesave ligjore ose rregullatore ose të kërkojë apo të mbrojë pretendimet apo të drejta të tjera të ligjshme në gjykatë apo procese administrative.

9. Dispozita të ndryshme

9.1 Marrësi merr përsipër që të përmbushë në çdo kohë detyrimet e përcaktuara në aneksin 1a (Marrëveshje Përmbushjeje nga Marrësi). Agjencia Zbatuese e Projektit merr përsipër të përmbushë në çdo kohë detyrimet e përcaktuara në aneksin 1b (Marrëveshje Përmbushjeje nga Agjencia Zbatuese e Projektit).

9.2 Nëse ndonjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera mbeten të paprekura. Çdo boshllëk që rezulton nga kjo plotësohet nga një dispozitë në përputhje me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje.

9.3 As Marrësi as Agjencia Zbatuese e Projektit nuk mund të caktojë apo transferojë, të premtojë apo të japë si garanci ndonjë pretendim nga kjo Marrëveshjeje.

9.4 Kjo Marrëveshje rregullohet nga legjislacioni i Republikës Federale të Gjermanisë. Vendi i zbatimit është Frankfurt am Main.

9.5 Marrëdhëniet juridike të krijuara nga kjo Marrëveshje ndërmjet KfW-së, Marrësit dhe Agjencisë Zbatuese të Projektit përfundojnë me mbarimin e ciklit të dobishëm të Projektit, por jo më vonë se pesëmbëdhjetë vjet pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

9.6 Kjo Marrëveshje Financimi dhe Projekti hyn në fuqi pas nënshkrimit nga pala e fundit.

Bërë në 3 (tri) kopje origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt am Main _____

KfW

Sot, në ditën e _____, të _____ 2020

Emri
Titulli

Sot, në ditën e _____, të _____ 2020

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Rindërtimit

Emri
Titulli

Fondi Shqiptar i Zhvillimit

Emri
Titulli

Aneks

Aneks 1a Marrëveshje Përmbushjeje nga Marrësi

Aneks 1b Marrëveshje Përmbushjeje nga Agjencia Zbatuese e Projektit

ANEKS 1a

MARRËVESHJE PËRMBUSHJEJE NGA MARRËSI

1. PËRKUFIZIME

“Praktikë shtrënguese”, pengimi ose dëmtimi apo kërcënim për të penguar ose dëmtuar, direkt ose indirekt, një person ose pronën e personit, me qëllim për të ndikuar në mënyrë të gabuar në veprimet e një personi.

“Praktikë e fshehtë”, marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë personave për të arritur një qëllim të gabuar, si edhe për të ndikuar në mënyrë të gabuar në veprimet e një personi tjetër.

“Praktikë korruptive”, premtimi, ofrimi, dhënia, bërja, insistimi, marrja, pranimi apo kërkimi, direkt apo indirekt, i një pagese të paligjshme apo avantazhi të padrejtë të çdo natyre, për ose nga çdo person, me synim ndikimin në veprimet e çdo personi apo frenimin e çdo veprimi nga ai person.

“Praktikë mashtruese”, çdo veprim apo mosveprim, si edhe keqpërfaqësim i cili me dijeni apo pakujdesi, keqdrejton apo përpiqet të keqdrejtojë një person për përfitim financiar apo për shmangie detyrimi.

“Praktikë penguese”: i. shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi apo fshehja me dashje e të dhënave të



rëndësishme për hetimin ose bërja e deklaratave të rreme para hetuesve për të penguar në thelb një hetim ndaj akuzave për praktikë korruptive, praktikë mashtruese, praktikë shtrënguese apo praktikë të fshehtë, ose kërcërimi, ngacmimi apo frikësimi i një personi që të mos tregojë njohuritë e tij për çështjet që lidhen me hetimin apo ndjekjen e hetimit; ose ii. çdo veprim që synon të pengojë në thelb ushtrimin e së drejtës të KfW-së për t'u njohur me informacionin e kërkuar kontraktual, në lidhje me një hetim zyrtar për akuzën e një praktike korruptive, praktike mashtruese, praktike shtrënguese ose praktikë të fshehtë.

“Person”, çdo person fizik, subjekt juridik, ortakëri ose shoqatë *de facto*.

“Praktikë e dënueshme”, çdo praktikë shtrënguese, praktikë e fshehtë, praktikë mashtruese apo praktikë penguese (siç janë përkufizuar këto terma më sipër), e cila: i. është e paligjshme sipas legjislacionit gjerman apo legjislacioni tjetër të zbatueshëm; dhe ii. që ka, ose mund të ketë, ndikim thelbësor ligjor ose reputacioni në këtë Marrëveshje ndërmjet Marrësit dhe KfW-së ose zbatimin e saj.

“Sanksione”, sanksione ekonomike, financiare ose tregtare të përcaktuara në ligje, rregullore, masa embargoje ose kufizuese të administruara, të miratuara ose të vendosura nga Organi Sanksionues.

“Organi sanksionues” njëri nga Këshilli i Sigurisë i Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe Republika Federale e Gjermanisë.

“Lista e sanksioneve”, listë e personave, grupeve apo subjekteve të përcaktuara që u nënshtrohen sanksioneve, e nxjerrë nga një organ sanksionues.

2. DHËNIA E INFORMACIONIT

Marrësi:

a) i vë menjëherë në dispozicion KfW-së me kërkesë të gjithë informacionin përkatës “njih klientin tënd” ose të ngjashëm për Marrësin sipas kërkesës së KfW-së;

b) i jep menjëherë KfW-së me kërkesë të gjithë informacionin në lidhje me Projektin dhe dokumentet e Marrësit dhe palët e tij (nën)kontraktuese dhe palët e tjera që i duhet KfW-së për të përmbushur detyrimet e saj për të parandaluar çdo Praktikë të Dënueshme, pastrimin e parave dhe/ose financimin e terrorizmit si edhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënies

së punës me Marrësin i cili është i nevojshëm për këtë qëllim;

c) informon KfW-në, menjëherë dhe me vullnetin e tij, sapo vihet në dijeni ose dyshon për një praktikë të dënueshme, pastrim të parave dhe/ose financim të terrorizmit në lidhje me projektin;

d) i jep KfW-së të gjithë informacionin dhe raportet për Projektin dhe ecurinë e tij të mëtejshme, sipas kërkesës së KfW-së për qëllimet e këtij aneksi; dhe

e) bën të mundur që KfW-ja dhe agjentët e saj në çdo kohë të inspektojnë të gjithë dokumentacionin e Marrësit dhe palëve të tij (nën)kontraktuese dhe palët e tjera që kanë lidhje me Projektin dhe të vizitojnë Projektin dhe strukturat e tij që lidhen me qëllimet e këtij aneksi.

3. PËRFAQËSIMI DHE GARANCIA

3.1 Në lidhje me legjislacionin gjerman ose legjislacionin e vendit të Marrësit, Marrësi tregon që asnjë nga personat që vepron, në lidhje me projektin në emër të Marrësit nuk është angazhuar ose përfshirë në ndonjë praktikë të dënueshme, pastrim të parave ose financim të terrorizmit.

3.2 Përfaqësimi dhe garancia e përcaktuar në këtë nen bëhet për herë të parë me ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje. Do të konsiderohet e përsëritur pas çdo tërheqjeje të Grantit, duke iu referuar rrethanave që kanë epërsi në atë datë.

4. SIPËRMARRJE POZITIVE

Marrësi merr përsipër, sapo Marrësi ose KfW-ja vihet në dijeni ose dyshon për një praktikë të dënueshme, pastrim të parave ose financim të terrorizmit, që të bashkëpunojë plotësisht me KfW-në dhe agjentët e saj, për të përcaktuar nëse ka ndodhur një ngjarje e tillë. Në veçanti, Marrësi përgjigjet menjëherë dhe me detaje të arsyeshme për çdo njoftim nga KfW-ja dhe jep mbështetje dokumentare për këtë përgjigje me kërkesë të KfW-së.

5. SIPËRMARRJE NEGATIVE

Marrësi nuk hyn në transaksione ose nuk përfshihet në aktivitete të tjera në lidhje me Projektin që do të përbënin shkelje të sanksioneve.



ANEKS 1b

MARRËVESHJE PËRMBUSHJEJE NGA AGJENCIA ZBATUESE E PROJEKTTIT

1. PËRKUFIZIME

“Praktikë shtrënguese”, pengimi ose dëmtimi apo kërcënimi për të penguar ose për të dëmtuar, direkt ose indirekt, një person ose pronën e personit me qëllim për të ndikuar në mënyrë të gabuar në veprimet e një personi.

“Praktikë e fshehtë”, marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë personave për të arritur një qëllim të gabuar, si edhe për të ndikuar në mënyrë të gabuar në veprimet e një personi tjetër.

“Praktikë korruptive”, premtimi, ofrimi, dhënia, bërja, insistimi, marrja, pranimi apo kërkimi, direkt apo indirekt, i një pagese të paligjshme apo avantazhi të padrejtë të çdo natyre, për ose nga çdo person, me synim ndikimin në veprimet e çdo personi apo frenimin e çdo veprimi nga ai person.

“Kategori të përcaktuara të veprave penale”, kategoritë e mëposhtme të veprave penale të përkufizuara nga rekomandimet e FATF-së dhe shënimi përkatës interpretues: pjesëmarrje në grup të organizuar kriminal dhe përfitim i paligjshëm; terrorizëm përfshirë financimin e terrorizmit; trafikim i qenieve njerëzore dhe kontrabandim i migrantëve; shfrytëzim seksual i fëmijëve; trafikim i paligjshëm i lëndëve narkotike dhe substancave psikotropike; trafikim i paligjshëm i armëve; trafikim i paligjshëm i mallrave të vjedhura dhe të tjera; korrupsion dhe mitmarrje; mashtrim; falsifikim i kartëmonedhave; falsifikim dhe pirateri e produkteve; krim mjedisor; vrasje, plagosje e rëndë; rrëmbim, kufizim i paligjshëm ose marrje peng; vjedhje me dhunë ose vjedhje; kontrabandim (si edhe në lidhje me doganat dhe detyrimet dhe taksat e akcizës); krime tatimore (në lidhje me taksat direkt dhe indirekte); zhvatje; falsifikim; pirateri; abuzim me informacion të privilegjuar (*insider trading*) dhe manipulim tregu.

“Rekomandimet FATF”, rekomandime të përcaktuara herë pas here nga Task-Forca e Veprimit Financiar (FATF). FATF-ja është organ ndërqeveritar, që ka për qëllim zhvillimin dhe promovimin e politikave kombëtare dhe ndërkombëtare për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

“Praktikë mashtruese”, çdo veprim apo mosveprim, si edhe keqpërfaqësim, i cili me dëjani apo pakujdesi, keqdrejton apo përpiqet të keqdrejtojë një person për përfitim financiar apo për shmangie detyrimi.

“Origjinë e paligjshme”, origjina e fondeve të siguruarra përmes:

- a) çdo veprë penale të renditur në Kategorinë e Përcaktuar të Veprave Penale;
- b) çdo Praktike Korruptive;
- c) çdo Praktike Mashtruese; ose
- d) pastrimit të parave.

“Praktikë penguese”: i. shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi apo fshehja me dashje e të dhënave të rëndësishme për hetimin ose bërja e deklaratave të rreme para hetuesve për të penguar në thelb një hetim ndaj akuzave për praktikë korruptive, praktikë mashtruese, praktikë shtrënguese apo praktikë të fshehtë ose kërcënimi, ngacmimi apo frikësimi i një personi që të mos tregojë njohuritë e tij për çështjet që lidhen me hetimin apo ndjekjen e hetimit; ose ii. çdo veprim që synon të pengojë në thelb ushtrimin e së drejtës të KfW-së për t’u njohur me informacionin e kërkuar kontraktual, në lidhje me një hetim zyrtar për akuzën e një praktike korruptive, praktike mashtruese, praktike shtrënguese ose praktikë të fshehtë.

“Person”, çdo person fizik, subjekt juridik, ortakëri ose shoqatë *de facto*.

“Praktikë e dënueshme”, çdo praktikë shtrënguese, praktikë e fshehtë, praktikë mashtruese apo praktikë penguese (siç janë përkufizuar këto terma më sipër), e cila: i. është e paligjshme sipas legjislacionit gjerman apo legjislacioni tjetër të zbatueshëm; dhe ii. që ka ose mund të ketë, ndikim thelbësor ligjor ose reputacioni në këtë Marrëveshje ndërmjet Agjencisë Zbatuese të Projektit dhe KfW-së ose zbatimin e saj.

“Sanksione”, sanksione ekonomike, financiare ose tregtare të përcaktuara në ligje, rregullore, masa embargoje ose kufizuese të administruara, të miratuara ose të vendosura nga organi sanksionues.

“Organi sanksionues”, njëri nga Këshilli i Sigurisë i Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe Republika Federale e Gjermanisë.

“Lista e sanksioneve”, listë e personave, grupeve apo subjekteve të përcaktuara që u nënshtrohen sanksioneve, e nxjerrë nga një organ sanksionues.



2. DHËNIA E INFORMACIONIT

Agjencia Zbatuese e Projektit:

a) vë menjëherë në dispozicion të KfW-së, me kërkesë të gjithë informacionin e duhur “njih klientin tënd” ose të ngjashëm për Agjencinë Zbatuese të Projektit dhe çdo aksionar të drejtpërdrejtë dhe/ose jo të drejtpërdrejtë, filial dhe ose ndonjë degë tjetër (nëse ka), sipas kërkesës së KfW-së;

b) i jep menjëherë KfW-së, me kërkesë të gjithë informacionin në lidhje me Projektin dhe dokumentet e Agjencisë Zbatuese të Projektit dhe palët e saj (nën)kontraktuese dhe palët e tjera që i duhet KfW-së për të përmbushur detyrimet e saj për të parandaluar çdo praktikë të dënueshme, pastrimin e parave dhe/ose financimin e terrorizmit, si edhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënies së punës me Agjencinë Zbatuese të Projektit, i cili është i nevojshëm për këtë qëllim;

c) informon KfW-në, menjëherë dhe me vullnetin e saj, sapo vihet në dijeni ose dyshon për ndonjë praktikë të dënueshme, pastrim të parave dhe/ose financim të terrorizmit nga Agjencia Zbatuese e Projektit, ndonjë anëtar i organeve të saj drejtuese ose organ tjetër drejtues apo ndonjë aksionar i saj;

d) i jep KfW-së të gjithë informacionin dhe raportet për Projektin dhe ecurinë e tij të mëtejshme, sipas kërkesës së KfW-së për qëllimet e këtij aneksi;

e) bën të mundur që KfW-ja dhe agjentët e saj në çdo kohë të inspektojnë të gjithë dokumentacionin e Agjencisë Zbatuese të Projektit dhe palëve të saj (nën)kontraktuese dhe palët e tjera që kanë lidhje me Projektin dhe të vizitojë Projektin dhe strukturat e tij që lidhen me qëllimet e këtij aneksi.

f) informon KfW-në menjëherë dhe, me vullnetin e saj, për çdo ngjarje që rezulton në Agjencinë Zbatuese të Projektit, ndonjë anëtar të organeve të saj drejtuese apo organ tjetër drejtues apo ndonjë aksionar të saj, që është ose do të bëhet një shtetas i emëruar në veçanti, person apo subjekt i bllokuar i mbajtur në një listë sanksionesh.

3. PËRFAQËSIMI DHE GARANCIA

3.1 Në lidhje me legjislacionin gjerman ose legjislacionin e vendit të krijimit të Agjencisë Zbatuese të Projektit, Agjencia Zbatuese e Projektit

përfaqëson dhe garanton që sa më poshtë është e vërtetë dhe e saktë:

a) Në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Agjencia Zbatuese e Projektit vepron në emër të saj dhe për llogari të saj.

b) Në dijeninë e saj më të mirë dhe vetëm në lidhje me aksionarët që njeh Agjencia Zbatuese e Projektit, sipas rregulloreve të zbatueshme të tregut të aksioneve, as ekuiteti i Agjencisë Zbatuese të Projektit as fondet e investuara në Projekt nuk janë me origjinë të paligjshme.

c) Asnjë nga Agjencitë Zbatuese të Projektit, degët, filialet e saj ose person tjetër që vepron për llogari të tij ose të tyre nuk është angazhuar ose përfshirë në ndonjë Praktikë të Dënueshme, pastrim të parave ose financim të terrorizmit.

d) Agjencia Zbatuese e Projektit nuk: i. ka hyrë në marrëdhënie biznesi me shtetas të emëruar në veçanti, persona ose subjekte të bllokuara të mbajtura në ndonjë listë sanksionesh; ose ii. është përfshirë në ndonjë veprimtari tjetër që do të përbënte shkelje të sanksioneve.

3.2 Përfaqësimet dhe garancitë e paraqitura në këtë nen bëhen për herë të parë me ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje. Ato do të konsiderohen të përsëritura pas çdo tërheqjeje të Grantit, duke iu referuar rrethanave që kanë epërsi në atë datë.

4. SIPËRMARRJE POZITIVE

Agjencia Zbatuese e Projektit merr përsipër:

a) të respektojë plotësisht standardet kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në përputhje me rekomandimet e FATF-së dhe të zbatojë, mbajë dhe, nëse është e nevojshme, të përmirësojë standardet dhe udhëzimet e brendshme (përfshirë pa kufizim në lidhje me kujdesin e duhur ndaj klientit) të përshtatshme për të shmangur çdo praktikë të dënueshme, pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit; dhe

b) sapo Agjencia Zbatuese e Projektit ose KfW-ja vihet në dijeni ose dyshon për një praktikë të dënueshme, pastrim të parave ose financim të terrorizmit, që të bashkëpunojë plotësisht me KfW-në dhe agjentët e saj, për të përcaktuar, nëse ka ndodhur një ngjarje e tillë. Në veçanti, Agjencia Zbatuese e Projektit përgjigjet menjëherë dhe me detaje të arsyeshme për çdo njoftim nga KfW-ja dhe jep mbështetje dokumentare për këtë përgjigje me kërkesë të KfW-së.



5. SIPËRMARRJE NEGATIVE

Agjencia Zbatuese e Projektit merr përsipër:

- a) të sigurohet që ekuiteti dhe fondet e tjera që investon nuk do të jenë me origjinë të paligjshme;
- b) të sigurohet që puna nuk do të çojë në ndonjë praktikë të dënueshme, pastrim të parave ose financim të terrorizmit; dhe
- c) të mos hyjë apo të vazhdojë marrëdhënie pune me shtetas të emëruar në veçanti, persona ose subjekte të bllokuara të mbajtura në listën e sanksioneve dhe të mos përfshihet në veprimtari tjetër që do të përbënte shkelje të sanksioneve.

VENDIM

Nr. 238, datë 21.12.2020

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “WENERG” SHA, PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT TË ERE-s, PËR BARRËSIMIN E 100% TË AKSIONEVE TË SHOQËRISË NË FAVOR TË BANKËS OTP ALBANIA SHA (ISH-SOCIETE GENERALE ALBANIA SHA)

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të pikës 6.2, të “Licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”; të pikës 5.2, të “Licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr.135/7 prot., datë 15.12.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Wenerg’ sh.a., për marrjen e autorizimit të ERE-s, për barrësimin e 100% të aksioneve të shoqërisë në favor të Bankës OTP Albania sh.a. (ish-Societe Generale Albania sh.a.)”, konstatoi se:

- Shoqëria “Wenerg” sh.a. është mbajtëse e licencës për prodhimin e energjisë elektrike nr. 104, seria PV10K, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 51, datë 5.7.2010, si dhe e licencës për tregtimin e energjisë elektrike nr. 184, seria T12P, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 137, datë 8.10.2012.

- Me shkresën nr. HD1-29/20 prot., datë 28.9.2020, shoqëria ka paraqitur kërkesën për të marrë autorizimin e ERE-s, për barrësimin e 100 % të aksioneve të shoqërisë, për të garantuar kredinë nga kredidhënësi, Banka OTP Albania sh.a. (ish-Societe Generale Albania sh.a.) që përfaqëson një ristrukturim të kredisë me qëllim financimin e ndërtimit të Hec-it Dardha 1.

- Në zbatim të pikës 2.1, të marrëveshjes siguroese, Banka (barrëmarrësi), në rast mospërbushjeje, ka të drejtën për të ekzekutuar menjëherë të gjitha detyrimet e siguruar sipas kësaj marrëveshjeje e kësajsoj transferimin e aksioneve të shoqërisë.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 158, datë 20.10.2020, është vendosur shtyrja me 30 ditë të vendimmarrjes së ERE-s për dhënien e autorizimit, për barrësimin e 100% të aksioneve të shoqërisë “Wenerg” sh.a., në favor të Bankës OTP ALBANIA sh.a., për arsye se shoqëria nuk kishte depozituar në ERE prokurën përkatëse të përfaqësuesit të saj, si dhe miratimin paraprak të autoritetit kontraktues, në zbatim të nenit 17, pika 1, “iii”, të kontratës përkatëse të koncesionit, ku përcaktohet se çdo transferim tjetër nga koncesionari, ose filiali i tij, për një palë të tretë, të të paktën 51% të aksioneve në shoqërinë e re do t’i nënshtrohet miratimit paraprak të autoritetit kontraktues.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 190, datë 19.11.2020, është vendosur zgjatja me 30 ditë e afatit të shqyrtimit të kërkesës së shoqërisë “Wenerg” sh.a. për dhënien e autorizimit për barrësimin e 100% të aksioneve në favor të bankës OTP Albania sh.a., me kërkesë të aplikuesit.

- Me anë të shkresave të saj, shoqëria ka njoftuar MIE-n për sa i përket nënshkrimit të marrëveshjeve me bankën, por nuk ka kërkuar miratimin paraprak të saj.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 383/15 prot., datë 14.12.2020, shoqëria ka depozituar të noterizuar prokurën e përgjithshme për përfaqësuesin ligjor të saj.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 383/15 prot., datë 14.12.2020, shoqëria ka ritheksuar pretendimin e saj se nuk ka hyrë në ndonjë marrëveshje për të cilën kërkohet miratimi paraprak i AK-së, në zbatim të nenit 17, pika 1, “iii”, të kontratës përkatëse të koncesionit, pasi një transferim i tillë nuk ka ndodhur dhe as nuk ka



ndonjë synim për të kryer një transaksion të tillë. Vendosja e barrës siguruese mbi kapitalin aksionar të Wenerg sh.a., si kolateral për kredinë e marrë nga kjo e fundit, nuk do të thotë automatikisht transferim të aksioneve, pasi kjo do të ndodhte vetëm në rast të mosshlyerjes së detyrimeve që rrjedhin nga kredia dhe kalimit në ekzekutim nga banka (kreditori).

- Autorizimi i dhënë nga ana e ERE-s për barrësimin e 100 % të aksioneve të shoqërisë “Wenerg” sh.a., nuk e çliron atë nga detyrimi për të marrë dhe miratimet e institucioneve të tjera përkatëse.

- Shoqëria “Wenerg” sh.a. duhet të njoftojë ERE-n pas shlyerjes së plotë të kredisë dhe heqjen e barrës siguruese mbi aksionet e saj.

- Shoqëria ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj ERE-s për sa i përket pagesave rregullatore.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit nga ana e ERE-s për barrësimin e 100% të aksioneve të shoqërisë “Wenerg” sh.a., në favor të Bankës OTP Albania sh.a. (ish-Societe Generale Albania sh.a.).

2. Dhënia e autorizimit nga ana e ERE-s, sipas pikës 1 të këtij vendimi, nuk e zhvesh shoqërinë “Wenerg” sh.a. nga detyrimi për të marrë miratimin nga Ministria e Infrastrukturës dhe nëse kërkohet nga ministria.

3. Shoqëria të njoftojë ERE-n pas shlyerjes së plotë të kredisë dhe heqjen e barrës siguruese mbi aksionet e saj.

4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë MIE-n dhe aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 239, datë 21.12.2020

MBI SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “WENERG” SHA PËR BARRËSIM TË ASETVEVE (MAKINERI DHE PAJISJE) NË FAVOR TË “OTP ALBANIA” SHA, PËR EFEKT TË RISTRUKTURIMIT TË KREDISË, PËR FONDET E PËRDORURA, ME QËLLIM FINANCIJMIN E NDËRTIMIT TË HEC “DARDHA 1”

Në mbështetje të nenit 16; të nenit 20, germa “a”, të nenit 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; në zbatim të nenit 11, të “Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016; pikës 1.3 dhe 1.6, të “Licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 135/17 prot., datë 17.12.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Wenerg” sh.a. për lënien barrë të aseteve (makineri dhe pajisje) në favor të bankës “OTP Albania” sh.a.,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr.159, datë 20.10.2020, vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “WENERG” sh.a. për barrësim të aseteve (makineri dhe pajisje) në favor të bankës “OTP Albania” sh.a., për efekt të ristrukturimit të kredisë, për fondet e përdorura, me qëllim financimin e ndërtimit të HEC “Dardha 1”.

- Në vijim të sa më sipër, ERE, me shkresën nr. 383/12 prot., datë 2.11.2020, iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës, dhe i kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.

- Sa më sipër, shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 383/12 prot., datë 11.12.2020, ka përcjellë dokumentacionin e munguar.



- Aplikimi i shoqërisë “Wenerg” sh.a. është tërësisht i plotësuar, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “p”, “g”, “h”, “i”, “j”. Plotësuar.

- Neni 7, pikat 3, 4, 6. Plotësuar.

- Nga rakordimi me Drejtorinë e Financave rezulton se shoqëria “Wenerg” sh.a. i ka kryer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “Wenerg” sh.a., për barrësim të aseteve (bashkëlidhur lista e aseteve si makineri, pajisje etj.) në favor të “OTP Albania” sh.a., për efekt të ristrukturimit të kredisë,

për fondet e përdorura, me qëllim financimin e ndërtimit të HEC “Dardha 1”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë MIE-n dhe aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

Asset Nomination	Balance as at 31.12.2018	Balance as at 31.12.2019
Machineries and equipments		
Uzina	5,709,479	5,276,315
Ngrites 23 ton seria 13824 (1 cope)	-	-
Ngrites 6 ton seria 13822 (1 cope)	-	-
Paisje teknologjike per sistemin e ftohjes se gjeneratoreve	-	-
Nenstacioni + Linja 110 KVA	16,142,644	14,917,942
F V Shtylla metalike ankerore me bullona(zinguara)	-	-
F V Shtylla metalike ndermjetese me bullona(zinguara)	-	-
Grupi elektromekanik	68,429,797	63,238,198
Turbina 1	-	-
Paisjet e Komandimit	11,796,438	10,901,472
Pajje automatizimi per automatizimin e centralit	-	-
Paisje te tjera	503,453	402,762
Borepastrues (Simoni SRL) (2132)	-	-
Sharre elektrike (LPC Diamant) (2132)	-	-
Multimeter dixhital	-	-
Estraktor	-	-
Paisje elektrike	-	-
Vepra e Marrjes Nr.1	146,528	130,026
Transformatore 10 KVA (Rhone Alpes Electricite France) (2132)	-	-
Vepra e Marrjes Nr.2	146,528	130,026
Transformatore 10 KVA (Rhone Alpes Electricite France) (2132)	-	-
Vepra e Marrjes Nr.3	146,528	130,026
Transformatore 10 KVA (Rhone Alpes Electricite France) (2132)	-	-
Kanale derivimi	1,606,335	1,425,426
Transformator 10 KVA (HPL Engineering) (2132)	-	-
Uzina	140,857	124,994
Transformatore 40 KVA (Rhone Alpes Electricite France) (2132)	-	-
Nenstacioni + Linja 110 KVA	37,877,788	33,611,894
Zbara	-	-
V Transformator fuqie 10MVA,6 3/110 kV	-	-
V Celes ngarkese me vaj 110kV,250A,31 5 kA	-	-
V Transformatore rryme 110kV(per matje dhe mbrojtje)	-	-
V Transformatore tensioni 110kV(per matje dhe mbrojtje)	-	-
V Ndares 3P me dy thika toke 110 kV, 1250A	-	-
V Ndares 3P me nje thike toke 110 kV, 1250A	-	-
V Ndares 1P me nje thike toke 110 kV, 1250A	-	-
V Shkarkues 110 kV(123kV), F V Transformator nevoja vetjake 100kVA,6 3/0.4 kV,	-	-
V Celat komutuese 7 2 kV,1250A,20kA(komandim&kontroll&matje)	-	-
V Radnizator 220V AC&DC	-	-
sunlight batery 12V 90 Ah	-	155,203
Grupi elektromekanik	31,178,888	28,715,555
eneratori kryesor 1	-	-
enerator diesel (emergjence)	-	-
htese gjate 2013 (Mates te Rrjedhjes + aksesoret, Gjenerator nafte)	174,257	161,037
sunlight batery 12V 90 Ah	-	108,593
anel elektrik per mbrojtjen e transformatorit te veprave (ft nr 22, seri 69586972)	-	142,875
TOTAL OF MACHINERIES AND EQUIPMENTS	173,999,522	159,572,342



VENDIM
Nr. 242, datë 21.12.2020

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “HEC ZALL XHUXHË” SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGIJË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e” dhe nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 15, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 21.12.2020, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “HEC Zall Xhuxhë” sh.p.k., si dhe relacionin nr. 135/13 prot., datë 17.12.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “HEC Zall Xhuxhë” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 186, datë 16.11.2020, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “HEC Zall Xhuxhë” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje, me “Njoftimin për licencim” nr. 62/36 prot., datë 17.11.2020, u krye njoftimi në median e shkruar dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palë të treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “HEC Zall Xhuxhë” sh.p.k.

- Me shkresën nr. 1165/1 prot., datë 26.11.2020, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.

- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria “HEC Zall Xhuxhë” sh.p.k. me shkresën e protokolluar

në ERE me nr. 1165/2, datë 3.12.2020, ka përcjellë dokumentacionin e munguar.

- Dokumentacioni i këtij aplikimi është kryesisht i plotësuar, dhe më poshtë veçohet dokumentacioni që mbetet i pa plotësuar:

- neni 9, pika 3, germa “a” (vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore). Shoqëria nuk ka depozituar vërtetimet përkatëse, por në vijim vlerësohet të vendoset si kusht depozitimi i tij në ERE;

- neni 9, pika 3, germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financim dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera, etj.). Shoqëria nuk ka dokumentuar aftësinë ose mbështetjen financiare në lidhje me veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, si e tille vlerësohet që kjo kërkesë të vendoset si kusht në këtë vendim;

- neni 9, pika 4.8, germa “a” (sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t’u tregtuar në GWh/sipas viteve); shoqëria nuk ka paraqitur sa kërkohet nga kjo pikë e rregullores dhe vlerësohet të vendoset si kusht në këtë vendim;

- neni 9, pika 4.8, germa “b” (kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e këtij aktiviteti); shoqëria nuk ka paraqitur dokumente në lidhje me këtë kërkesë të rregullores dhe vlerësohet të vendoset si kusht depozitimi i dokumentacionit në ERE.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, sipas “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “HEC Zall Xhuxhë” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, me kushtin që shoqëria të depozitojë brenda 3 muajve nga marrja e këtij vendimi:

i. vërtetimin për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore;



ii. dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera, etj.);

iii. sasinë e energjisë elektrike të parashikuar për t'u tregtuar në GWh/për pesë vitet e licencës së tregtimit të energjisë elektrike;

iv. kapitalin financiar të parashikuar për ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.

2. Mos plotësimi i kushteve të këtij vendimi përbën shkak për rishikimin e tij.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 243, datë 21.12.2020

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “ES 2019”
SHPK NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, nenit 8, pika 3, neni 9, pikat 1,2,3, pika 4,8, nenit 10, pika 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 21.12.2020, mbasi shqyrtoi

relacionin nr. 135/13 prot., datë 17.12.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, lidhur me “Fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘ES 2019’ sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “ES 2019” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1239 prot., datë 2.12.2020, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit në fazën e fillimit të procedurave të licencimit, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për shoqërinë “ES 2019” sh.p.k., rezulton se subjekti plotëson kryesisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formatit dhe dokumentacioni për aplikim:

Neni 9, pika 1, germat: “a”, “b” dhe “c”, plotësuar;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal:

Neni 9, pika 3, germat: “a”, “d”, plotësuar;

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor

Neni 9, pika 2:

- germat “a”/“b” (akti i themelimit/statuti (nëse është hartuar si dokument i ndryshëm/i veçantë nga akti i themelimit)), plotësuar pjesërisht.

Shoqëria duhet të depozitojë në ERE aktin e themelimit të nënshkruar nga themeluesi (original ose fotokopje e noterizuar), si dhe statutin në formatin origjinal ose fotokopje e noterizuar;

- germa “c” (vërtetim për regjistrimin dhe ekstrakt historik nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), plotësuar pjesërisht.

Shoqëria duhet të depozitojë në ERE certifikatën e regjistrimit;

- germa “d” (vërtetim që shoqëria dhe drejtuesit kryesorë të saj në rastin e personave juridikë, nuk janë të përfshirë në një proces penal të filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata), plotësuar pjesërisht;

- germa “e” (struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse), pa plotësuar.

- Shoqëria nuk ka depozituar asnjë dokument në lidhje me këtë kërkesë të rregullores;



- Dokumentacioni financiar dhe fiskal:

Neni 9, pika 3

- germa “b” (paraqitje bilanci financiar të tre viteve të fundit/ose të kohës së ekzistencës së shoqërisë (për shoqëritë me ortakë shoqëri të tjera, paraqitja e bilanci të këtyre të fundit), pa plotësuar;

- Shoqëria nuk ka depozituar asnjë dokumentacion në lidhje me këtë kërkesë të rregullores;

- germa “c” (Dokumente që vërtetojnë aftësinë dhe/ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera, etj.) Pa plotësuar.

- Shoqëria nuk ka depozituar në ERE dokumentacionin që kërkohet nga kjo pikë e rregullores;

- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë tregtimit të energjisë elektrike:

Neni 9, pika 4.8

- germa “a” (sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t’u tregtuar në GWh sipas viteve). Plotësuar pjesërisht.

Në lidhje me këtë kërkesë të rregullores, shoqëria ka deklaruar volumin e tregtimit të energjisë për një vit, ndaj duhet të saktësojë sasinë e energjisë që parashikon edhe për 4 vitet e tjera;

- germa “b” (Kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj.) Pa plotësuar.

- Shoqëria nuk ka paraqitur dokumentacion në lidhje me këtë kërkesë të rregullores;

- germa “c” (Lista e kontratave të mëparshme të realizuara (nëse ka pasur)). Pa plotësuar.

- Shoqëria nuk ka depozituar informacion qoftë edhe në mënyrë deklarative në lidhje me këtë kërkesë të rregullores.

- Në bazë të nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, do të njoftohet subjekti t’i paraqesë ato në ERE brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “ES 2019” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 245, datë 21.12.2020

**MBI ZGJATJEN E AFATIT TË
VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-
S, NË LIDHJE ME KËRKESËN E
SHOQËRISË “GREENTECH ENERGY
SYSTEMS” SHPK, PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Nisur nga sa më sipër, në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 53, pika 3, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 135/15 prot., datë 17.12.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, lidhur me “Zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s në lidhje me kërkesën e shoqërisë ‘Greentech Energy Systems’ sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Greentech Energy Systems” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1155



prot., datë 2.11.2020, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 183, datë 13.11.2020, vendosi: “Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Greentech Energy Systems” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar”.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje u krye njoftimi në median e shkruar me shkresën me nr. 62/35 prot., datë 16.11.2020, për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Me shkresën nr. 1155/1 prot., datë 24.11.2020, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar: fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar nga aplikimi i saj

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1155/2 prot., datë 17.12.2020, shoqëria ka paraqitur kërkesën për “Shtyrje të afatit për plotësimin e dokumentacionit, për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19”.

- Në nenin 14, pika 2, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, përcaktohet se për centralet e lidhura drejtpërdrejtë me rrjetin e shpërndarjes, dhe për të gjitha licencat e tjera Bordi merr vendim jo më vonë se 30 ditë pune nga data e publikimit të parë të njoftimit në shtyp, për aplikimin në shtyp, ndaj për kërkesën e shoqërisë “Greentech Energy Systems” sh.p.k., Bordi duhet të marrë vendimin përfundimtar brenda datës 31.12.2020.

- Në nenin 53, pika 3, të “Kodit të Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” përcaktohet se:

- afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.

- Kërkesa e shoqërisë, për zgjatje të afatit të depozitimit të dokumentacionit përkatës, është bërë përpara mbarimit të afatit për vendimmarrjen përfundimtare të Bordit të ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë me 30 ditë punë afatin e vendimmarrjes në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Greentech Energy Systems” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 246, datë 21.12.2020

**MBI ZGJATJEN E AFATIT TË
VENDIMARRJES SË BORDIT TË ERE-
s, NË LIDHJE ME KËRKESËN E
SHOQËRISË “GREENTECH ENERGY
SYSTEMS” SHPK, PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Nisur nga sa më sipër, në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 53, pika 3, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 135/15 prot., datë 17.12.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s në lidhje me kërkesën e shoqërisë ‘Greentech Energy Systems’ sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Greentech Energy Systems” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1156



prot., datë 2.11.2020, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC Pishat, me vendndodhje në përroin e Holtës, Bashkia Gramsh, qarku Elbasan.

- Po ashtu, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 184, date 13.11.2020, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Greentech Energy Systems” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Pishat” me kapacitet të instaluar 1991 kw, për një afat 30-vjeçar.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje, u krye njoftimi në median e shkruar me shkresën me nr. 62/37 prot., datë 16.11.2020, për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Me shkresën nr. 1155/1 prot., datë 24.11.2020, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar nga aplikimi i saj.

Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1155/2 prot., datë 17.12.2020, shoqëria ka paraqitur kërkesën për shtyrje të afatit për plotësimin e dokumentacionit, për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19.

- Në nenin 14, pika 2, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, përcaktohet se për centralet e lidhura drejtpërdrejtë me rrjetin e shpërndarjes, dhe për të gjitha licencat e tjera Bordi merr vendim jo më vonë se 30 ditë pune nga data e publikimit të parë të njoftimit në shtyp, për aplikimin në shtyp, ndaj për kërkesën e shoqërisë “Greentech Energy Systems” sh.p.k., Bordi duhet të marrë vendimin përfundimtar brenda datës 31.12.2020.

- Në nenin 53, pika 3, të “Kodit të Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” përcaktohet se:

“3. Afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.”.

- Kërkesa e shoqërisë për zgjatje të afatit të depozitimit të dokumentacionit përkatës është bërë përpara mbarimit të afatit për vendimmarrjen përfundimtare të Bordit të ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë me 30 ditë punë afatin e vendimmarrjes në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Greentech Energy Systems” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 247, datë 21.12.2020

MBI ZGJATJEN E AFATIT TË
VENDIMMARRJES SË BORDIT
TË ERE-s, NË LIDHJE ME KËRKESËN
E SHOQËRISË “ENERGY SUPPLY - AL”
SHPK, PËR RINOVIMIN E LICENCËS
NR. 310, SERIA F11/FK15, NË
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa “ç” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 92, pika 1 dhe 2, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 135/14 prot., datë 17.12.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s në lidhje me kërkesën e shoqërisë ‘Energy Supply – AL’ sh.p.k, për rinovimin e licencës nr. 310, seria F11/Fk15, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”, konstatoi se:



- Shoqëria “Energy Supply - AL” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1185, datë 10.11.2020, ka aplikuar për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, nr. 310, seria F11/FK15, miratuar me vendimin e Bordit nr. 5, datë 2.2.2011 dhe rinovuar me vendimin nr. 123, datë 14.10.2015.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 194, datë 26.11.2020, ka vendosur të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “Energy Supply - AL” sh.p.k., me nr. 310, seria F11/FK15, miratuar me vendimin e Bordit nr. 5, datë 2.2.2011 dhe rinovuar me vendimin e Bordit nr. 123, datë 14.10.2015, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 4.2.2021.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje u krye njoftimi në median e shkruar me shkresën me nr. 62/40 prot., datë 28.11.2020, për fillimin e procedurës për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Me shkresën nr. 1185/2 prot., datë 2.12.2020, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar nga aplikimi i saj, por kjo shkresë është kthyer mbrapsht nga posta dhe është ridërguar sërish në datën 16.12.2020.

- Në nenin 16, pika 6, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, përcaktohet se Bordi do të marrë vendimin për rinovim ose jo të licencës jo më vonë se 20 ditë pune nga fillimi i procedurave për shqyrtimin e një aplikimi, konform kësaj rregulloreje, ndaj për kërkesën e shoqërisë “Energy Supply – AL”, Bordi duhet të marrë vendimin përfundimtar brenda datës 28.12.2020.

- Në nenin 92, pika 1 dhe 2, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se:

“1. Përveç kur ndalohet shprehimisht nga ligji, në raste të justifikuara, për shkak të kompleksitetit të çështjes, organi publik mund të zgjasë vetëm një herë afatin e përcaktuar ,sipas nenit 91, të këtij Kodi.

2. Zgjatja e afatit bëhet për aq sa është e nevojshme për përfundimin e procedurës, në proporcion me vështirësinë e çështjes konkrete, por jo më shumë se kohëzgjatja e afatit fillestar.”.

- Duke qenë se shoqëria nuk është njoftuar ende për vendimmarrjen e Bordit në lidhje me kërkesën e saj dhe për dokumentacionin e konstatuar të munguar, po ashtu duke marrë parasysh kufizimet e vendosura për shkak të COVID-19, që mund të kenë ndikuar në mosmarrjen e shkresës nga ana e shoqërisë, vlerësohet zgjatja e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s me 20 ditë pune.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë me 20 ditë pune afatin e vendimmarrjes në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Energy Supply - AL” sh.p.k., për rinovimin e licencës nr. 310, seria F11/FK15, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 248, datë 21.12.2020

**MBI ZGJATJEN E AFATIT TË
VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-
s, NË LIDHJE ME KËRKESËN E
SHOQËRISË “ENERGY SUPPLY - AL”
SHPK, PËR RINOVIMIN E LICENCËS
NR. 309, SERIA T11/T15, NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 92, pika 1 dhe 2, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe



procedurat e ERE-s”, të ndryshuar, të miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 135/14 prot., datë 17.12.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Energy Supply – AL” sh.p.k., për rinovimin e licencës nr. 309, seria T11/T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Energy Supply - AL” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1185, datë 10.11.2020, ka aplikuar për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, nr. 309, seria T11/T15, miratuar me vendimin e Bordit nr. 6, data 2.2.2011, dhe rinovuar me vendimin nr. 122, datë 14.10.2015.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 195, datë, 26.11.2020, ka vendosur të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 309, seria T11/T15, të shoqërisë “Energy Supply - AL” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit nr. 6, datë 2.2.2011, dhe rinovuar me vendimin e Bordit nr. 122, datë 14.10.2015, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 4.2.2021.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje u krye njoftimi në median e shkruar me shkresën me nr. 62/41 prot., datë 28.11.2020, për fillimin e procedurës për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Me shkresën nr. 1185/2 prot., datë 2.12.2020, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar nga aplikimi i saj, por kjo shkresë është kthyer mbrapsht nga posta dhe është ridërguar sërish në datën 16.12.2020.

- Në nenin 16, pika 6, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, përcaktohet se Bordi do të marrë vendimin për rinovim ose jo të licencës jo më vonë se 20 ditë pune nga fillimi i procedurave për shqyrtimin e një aplikimi, konform kësaj rregulloreje, ndaj për kërkesën e shoqërisë “Energy Supply – AL”, Bordi duhet të marrë vendimin përfundimtar brenda datës 28.12.2020.

- Në nenin 92, pika 1 dhe 2, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se:

“1. Përveç kur ndalohet shprehimisht nga ligji, në raste të justifikuara, për shkak të kompleksitetit të çështjes, organi publik mund të zgjasë vetëm një herë afatin e përcaktuar, sipas nenit 91 të këtij Kodi.

2. Zgjatja e afatit bëhet për aq sa është e nevojshme për përfundimin e procedurës, në proporcion me vështirësinë e çështjes konkrete, por jo më shumë se kohëzgjatja e afatit fillestar.”.

- Duke qenë se shoqëria nuk është njoftuar ende për vendimmarrjen e Bordit në lidhje me kërkesën e saj dhe për dokumentacionin e konstatuar të munguar, po ashtu duke marrë parasysh kufizimet e vendosura për shkak të COVID-19, që mund të kenë ndikuar në mosmarrjen e shkresës nga ana e shoqërisë, vlerësohet zgjatja e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s me 20 ditë pune.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë me 20 ditë punë afatin e vendimmarrjes në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Energy Supply - AL” sh.p.k., për rinovimin e licencës nr. 309, seria T11/T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM
Nr. 250, datë 21.12.2020

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË
“ALBANIAN GREEN ENERGY” SHPK,
PËR SHTYRJEN E AFATEVE TË
VENDIMIT NR. 89, DATË 6.8.2008,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16 dhe 42, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 5 dhe 6, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”; pikës 1.2, 1.6 dhe 1.7, të kushteve licencës nr. 63, seria NPM08P, “Për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga (bllok motorë–gjeneratorë të ushqyer me biomasë të lëngshme, Shëngjin, Lezhë”, të dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s me nr. 89, datë 6.8.2008, të ndryshuar; nenit 67, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 21.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 135/1 prot., datë 14.12.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, lidhur me kërkesën e shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 89, datë 6.8.2008, të ndryshuar,

konstatoi se:

- Shoqëria “Albanian Green Energy” sh.p.k. është licencuar nga ERE me vendimin nr. 89, datë 6.8.2008, në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centralet eolike (bllok motorë–gjeneratorë të ushqyer me biomasë të lëngshme), me kusht zbatimin e sa parashikuar në licencën tip të miratuar nga Bordi i Komisionerëve për aktivitetin e ndërtimit dhe prodhimit të energjisë elektrike nga centrale eolike.

- Në vijim të këtij licencimi, ERE ka miratuar shtyrjen e afateve të ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve eolike, si dhe prodhimin e energjisë elektrike prej tyre me:

- vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 19, datë 8.3.2010;

- vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 92, datë 6.9.2011;

- vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 138, datë 15.11.2013.

- Në vlerësim të sa më sipër, ERE, me vendimin nr. 88, datë 9.6.2016, ka vendosur:

1. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k., për zgjatjen e afatit të licencës nr. 63, seria NPM08P, për ndërtim, instalim, shfrytëzimin të centrale elektrike dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale eolike (bllok motorë–gjeneratorë të ushqyer me biomasë të lëngshme), Shëngjin Lezhe, dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s me nr. 89, datë 6.8.2008.

2. Fillimin e procedurave për heqjen e licencës së shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k. nr. 63, seria NPM08P, dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s me nr. 89, datë 6.8.2008”.

Në vijim të shtyrjeve ndër vite, për shkak të kompleksit të problematikës që i licencuari ka hasur për kryerjen e plotë të studimit të fizibilitetit; të etapave administrative nëpër të cilat kalon projekti i parqeve eolike, si një teknologji e re për vendin; argumentet shpjeguese të dhëna dhe depozituara në ERE nga shoqëria, si dhe duke mbajtur në konsideratë qëndrimin e MIE-s me shkresën nr. 102/4 prot., datë 27.4.2015, i cili ka ardhur si përgjigje e shkresës së ERE-s nr. 14 prot., datë 7.1.2015, ku iu kërkua të prononcohet, lidhur me kompetencën institucionale të trajtimit të këtyre subjekteve në mbështetje të legjislacionit në fuqi, MIE bën me dije se VKM-ja nr. 1701, datë 17.12.2008, “Për miratimin e rregullores për procedurat e dhënies së autorizimeve për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese që nuk janë objekt koncesioni”, nuk ka efekt prapaveprues. Vlerësimi i kërkesave lidhur me licencat e miratuara nga ERE duhet të bëhet konform dispozitave ligjore, të cilat kanë qenë në fuqi në kohën e miratimit të këtyre licencave. Gjithashtu për këtë projekt, gjatë kësaj kohe nuk ka pasur shprehje interesi nga palë të treta.

- Me urdhrin e kryetarit të ERE-s nr. 145, datë 4.12.2019, u ngrit grupi i punës për monitorimin e kushteve të vendimeve nr. 89, datë 6.8.2008, “Për licencimin e shoqërisë ‘Albanian Green Energy’ sh.p.k.”.

- MIE, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 714/1, datë 13.2020, ka bërë me dije qëndrimin



e saj: “Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nuk është dakord me shtyrjen e afatit të licencave të lëshuara nga ERE për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese nga energjia elektrike eolike, pasi është në fuqi baza ligjore për të aplikuar për ndërtimin e impianteve eolike sipas përcaktimeve të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” dhe të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

- Nisur nga vështirësitë e krijuara për shkak të COVID-19 dhe masave të marra nga Qeveria Shqiptare për distancimin social me qëllim parandalimin e përhapjes së COVID-19, u bë i vështirë dhe finalizimi i monitorimit në kohë, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 63, datë 13.6.2020, të Bordit të ERE-s.

- Referuar përfundimeve të monitorimit, dokumentacionit dhe informacionit të përcjellë nga shoqëria në kuadër të këtij monitorimi, është e nevojshme të rishikohet i gjithë ky dokumentacion, për të vlerësuar statusin e plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit nga ana e shoqërisë.

- Në zbatim të parashikimeve të përcaktuara në nenin 67 të Kodit të Procedurave Administrative, u pa e arsyeshme që për arsye të verifikimit të plotë të dosjes së dokumentacionit të depozituar në ERE dhe gjetjeve të monitorimit, të shtyhet me 30 ditë vendimarrja.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shtyrjen me 30 ditë të vendimarrjes mbi “Kërkesën e shoqërisë ‘Albanian Green Energy’ sh.p.k, për zgjatjen me 36 muaj të afatit të plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit nr. 89, datë 6.8.2008, të ndryshuar”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë dhe MIE-n për këtë vendimarrje.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 251, datë 21.12.2020

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “BIOPOWER GREEN ENERGY” SHPK, PËR SHTYRJEN E AFATEVE TË VENDIMIT NR. 90, DATË 6.8.2008, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 67, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 135/2 prot., datë 14.12.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes lidhur me kërkesën e shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k. për shtyrjen e afateve të vendimit të ERE-s nr. 90, datë 6.8.2008, të ndryshuar,

konstatoi se:

- Shoqëria “Biopower Green Energy” sh.p.k. është licencuar nga ERE me vendimin nr. 90, datë 6.8.2008, në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centralet eolike “BPGE 1” dhe “BPGE 2”, Lezhë, Shëngjin, me kusht zbatimin e sa parashikuar në licencën tip të miratuar nga Bordi i Komisionerëve për aktivitetin e ndërtimit dhe prodhimin të energjisë elektrike nga centrale eolike, si dhe kushteve respektive të këtij vendimi.

- Në vijim të këtij licencimi, ERE ka miratuar shtyrjen e afateve të ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë “BPGE 1” dhe “BPGE 2” në Shëngjin, Lezhë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike prej tyre, me:

- Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 20, datë 8.3.2010;

- Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 93, datë 6.9.2011;

- Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 137, datë 15.11.2013.

- Në vlerësim të sa më sipër, ERE, me vendimin nr. 84, datë 9.6.2016, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Biopower Green Energy’ sh.p.k., për shtyrjen e afateve të licencës nr. 64, seria NPM08P, të dhënë



me vendimin e Bordit të Komisionerëve ERE-s me nr. 90, datë 6.8.2008, të ndryshuar”, ka vendosur:

1. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k., për zgjatjen e afatit të licencës nr. 64, seria NPM08P, dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 90, datë 6.8.2008, “Për ndërtimin, instalimin, shfrytëzimin e centraleve elektrike dhe prodhimin e energjisë elektrike nga parku eolik “BPGE 1” dhe “BPGE 2” në Shëngjin, Lezhë.

2. Fillimin e procedurave për heqjen e licencës së shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k., nr. 64, seria NPM08P, dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 90, datë 6.8.2008.

Në vijim të shtyrjeve ndër vite, për shkak të kompleksit të problematikës që i licencuari ka hasur për kryerjen e plotë të studimit të fizibilitetit; të etapave administrative nëpër të cilat kalon projekti i parqeve eolike si një teknologji e re për vendin; argumentet shpjeguese të dhëna dhe depozituara në ERE nga shoqëria, si dhe duke mbajtur në konsideratë qëndrimin e MIE-s me shkresën nr. 102/4 prot., datë 27.4.2015, i cili ka ardhur si përgjigje e shkresës së ERE-s nr. 14 prot., datë 7.1.2015, ku iu kërkua të prononcohet lidhur me kompetencën institucionale të trajtimit të këtyre subjekteve në mbështetje të legjislacionit në fuqi, MIE bën me dije se VKM-ja nr. 1701, datë 17.12.2008, “Për miratimin e rregullores për procedurat e dhënies së autorizimeve për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese që nuk janë objekt koncesioni”, nuk ka efekt prapaveprues. Vlerësimi i kërkesave lidhur me licencat e miratuara nga ERE duhet të bëhet konform dispozitave ligjore, të cilat kanë qenë në fuqi në kohën e miratimit të këtyre licencave. Gjithashtu për këtë projekt, gjatë kësaj kohe nuk ka pasur shprehje interesi nga palë të treta.

- Me urdhrin e kryetarit të ERE-s nr. 144, datë 4.12.2019, u ngrit grupi i punës për monitorimin e plotësimit të kushteve të vendimit nr. 90, datë 6.8.2008, “Për licencimin e shoqërisë ‘Biopower Green Energy’ sh.p.k.

- MIE, në përgjigje, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 714/1, datë 13.7.2020, ka bërë me dije qëndrimin e saj: “Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nuk është dakord me shtyrjen e afatit të licencave të lëshuara nga ERE, për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese nga energjia elektrike eolike, pasi është në fuqi baza ligjore për të aplikuar

për ndërtimin e impianteve eolike sipas përcaktimeve të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” dhe të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

- Nisur nga vështirësitë e krijuara për shkak të COVID-19 dhe masave të marra nga Qeveria Shqiptare për distancimin social me qëllim parandalimin e përhapjes së COVID-19, u bë i vështirë dhe finalizimi i këtij monitorimi në kohë sipas përcaktimeve të vendimit nr. 63, datë 13.6.2020, të Bordit të ERE-s.

- Referuar përfundimeve të monitorimit, dokumentacionit dhe informacionit të përcjellë nga shoqëria në kuadër të këtij monitorimi, është e nevojshme të rishikohet i gjithë ky dokumentacion, për të vlerësuar statusin e plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit nga ana e shoqërisë.

- Në zbatim të parashikimeve të përcaktuara në nenin 67, të Kodit të Procedurave Administrative, u pa e arsyeshme që për arsye të verifikimit të plotë të dosjes të dokumentacionit të depozituar në ERE dhe gjetjeve të monitorimit, të shtyhet me 30 ditë vendimmarrja.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shtyrjen me 30 ditë të vendimmarrjes mbi “Kërkesën e shoqërisë ‘Biopower Green Energy’ sh.p.k., për zgjatjen me 36 muaj të afatit të plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit nr. 90, datë 6.8.2008, të ndryshuar”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për këtë vendimmarrje.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM
Nr. 253, datë 21.12.2020

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “E-VENTO SRL ALBANIA” SHPK, PËR SHTYRJEN E AFATEVE TË VENDIMIT NR. 84, DATË 17.7.2008, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 67, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 21.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 135/5 prot., datë 14.12.2020, dhe info shtesë me nr. 36-5-1 prot., datë 14.12.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes lidhur me “Kërkesën e shoqërisë “E-Vento SRL Albania” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 84, datë 17.7.2008, të ndryshuar”,

konstatoi se:

- Shoqëria “E-Vento SRL Albania” sh.p.k., është licencuar nga ERE me vendimin nr. 84, datë 17.7.2008, në aktivitetin e “Ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrik me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike” prej tyre, me kusht zbatimin e sa parashikuar në licencën tip, të miratuar nga Bordi i Komisionerëve për aktivitetin e “Ndërtimit dhe prodhimin të energjisë elektrike nga centrale eolike” (parku eolik Sarandë), me kushtet e tij respektive.

- ERE ka miratuar shtyrjen e afateve të ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë për parkun eolik Sarandë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike prej tyre me:

- vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 63, datë 22.9.2009;

- vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 55, datë 25.8.2010;

- vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 134, datë 15.11.2013.

- Në vlerësim të sa më sipër, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 87, datë 9.6.2016, “Mbi kërkesën e shoqërisë “E-Vento SRL Albania” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të licencës nr. 60, seria NPM08, “Për ndërtimin, instalimin, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale eolike”,

të dhënë me vendimin nr. 84, datë 17.7.2008, të ndryshuar, ka vendosur:

1. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë “E-Vento SRL Albania” sh.p.k., për zgjatjen e afatit të licencës nr. 60, seria NPM08, dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 84, datë 17.7.2008, “Për ndërtimin, instalimin, shfrytëzimin e centraleve elektrike dhe prodhimin e energjisë elektrike.

2. Fillimin e procedurave për heqjen e licencës së shoqërisë “E-Vento SRL Albania” sh.p.k., nr. 60, seria NPM08, dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 84, datë 17.7.2008.

- Në vijim të shtyrjeve ndër vite, për shkak të kompleksit të problematikës që i licencuari ka hasur për kryerjen e plotë të studimit të fizibilitetit; të etapave administrative nëpër të cilat kalon projekti i parqeve eolike, si një teknologji e re për vendin; argumentet shpjeguese të dhëna dhe të depozituara në ERE nga shoqëria, si dhe duke mbajtur në konsideratë qëndrimin e MIE-s me shkresën nr. 102/4 prot., datë 27.4.2015, i cili ka ardhur si përgjigje e shkresës së ERE-s nr. 14 prot., datë 7.01.2015, ku iu kërkua të prononcohet, lidhur me kompetencën institucionale të trajtimit të këtyre subjekteve në mbështetje të legjislacionit në fuqi, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) bën me dije se: VKM-ja nr. 1701, datë 17.12.2008, “Për miratimin e rregullores për procedurat e dhënies së autorizimeve për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese që nuk janë objekt koncesioni”, nuk ka efekt prapaveprues. Vlerësimi i kërkesave lidhur me licencat e miratuara nga ERE duhet të bëhet konform dispozitave ligjore, të cilat kanë qenë në fuqi në kohën e miratimit të këtyre licencave. Gjithashtu për këtë projekt, gjatë kësaj kohe nuk ka pasur shprehje interesi nga palë të treta.

- Me urdhrin e kryetarit të ERE-s nr. 133, datë 14.11.2019, u ngrit grupi i punës për monitorimin e kushteve të vendimit nr. 84, datë 17.7.2008, “Për licencimin e shoqërisë “E-Vento SRL Albania” sh.p.k.”, të ndryshuar”.

- MIE, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 714/1 prot., datë 13.7.2020, ka bërë me dije qëndrimin e saj: “Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) nuk është dakord me shtyrjen e afatit të licencave të lëshuara nga ERE për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese nga energjia elektrike eolike, pasi është në fuqi baza



ligjore për të aplikuar për ndërtimin e impianteve eolike sipas përcaktimeve të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” dhe të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

- Nisur nga vështirësitë e krijuara për shkak të COVID-19 dhe masave të marra nga Qeveria Shqiptare për distancimin social, me qëllim parandalimin e përhapjes së COVID-19, monitorimi dhe finalizimi i praktikës ka pasur vështirësitë e veta për rakordimin sipas përcaktimeve të vendimit nr. 83, datë 4.5.2020, të Bordit të ERE-s.

- Referuar përfundimeve të monitorimit, dokumentacionit dhe informacionit të përcjellë nga shoqëria në kuadër të këtij monitorimi, është e nevojshme të rishikohet i gjithë ky dokumentacion, për të vlerësuar statusin e plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit nga ana e shoqërisë.

- Në zbatim të parashikimeve të përcaktuara në nenin 67, të “Kodit të Procedurave Administrative”, u pa e arsyeshme që për arsye të verifikimit të plotë të dosjes të dokumentacionit të depozituar në ERE dhe gjetjeve të monitorimit, shtyrja me 30 ditë e vendimmarrjes.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shtyrjen me 30 ditë të vendimmarrjes mbi “Kërkesën e shoqërisë ‘E-Vento SRL Albania’ sh.p.k., për zgjatjen e afatit të plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit nr. 84, datë 17.7.2008, të ndryshuar”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për këtë vendimmarrje.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Petrit Ahmeti**

VENDIM Nr. 254, datë 21.12.2020

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “HERA” SHPK, PËR SHTYRJEN E AFATEVE TË VENDIMIT NR. 61, DATË 2.11.2007, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 67, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 135/4 prot., datë 14.11.2020 dhe info shtesë me nr. 47-2-1 prot., datë 14.12.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, lidhur me kërkesën e shoqërisë “HERA” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 61, datë 2.11.2007, të ndryshuar,

konstatoi se:

- Shoqëria “Hera” sh.p.k. është licencuar nga ERE me vendimin nr. 61, datë 2.11.2007, në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike (parku eolik Pogradec dhe Korçë), me fuqi 150 mw, me kusht zbatimin e sa parashikuar në licencën tip të miratuar nga Bordi i Komisionerëve për aktivitetin e ndërtimit dhe prodhimin të energjisë elektrike.

- Në vijim të këtij licencimi, e pas kërkesës së subjektit, ERE ka miratuar shtyrjen e afateve të ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë për parkun eolik Pogradec dhe Korçë (projekti KAPPET), si dhe prodhimin e energjisë elektrike prej tyre me:

- vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 56, datë 25.8.2010;

- vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 136, datë 15.11.2013.

- Në vlerësim të sa më sipër, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 86, datë 9.6.2016, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘HERA’ sh.p.k. për shtyrjen e afateve të licencës nr. 49, seria NPM07, “Për ndërtimin, instalimin, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale elektrike, (projekti KAPPET)”, të dhënë me vendimin e Bordit të



ERE-s me nr. 61, datë 2.11.2007, të ndryshuar, ka vendosur:

1. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë “Hera” sh.p.k. për zgjatjen e afatit për 36 muaj, të licencës nr. 49, seria NPM07, dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 61, datë 25.11.2007, për ndërtimin, instalimin, shfrytëzimin e centraleve elektrike dhe prodhimin e energjisë elektrike nga Parku Eolik Pogradec–Korçë.

2. Fillimin e procedurave për heqjen e licencës së shoqërisë “Hera” sh.p.k., nr. 49, seria NPM07, dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 61, datë 25.11.2007.

- Në vijim të shtyrjeve ndër vite, për shkak të kompleksit të problematikës që i licencuari ka hasur për kryerjen e plotë të studimit të fizibilitetit; të etapave administrative nëpër të cilat kalon projekti i parqeve eolike, si një teknologji e re për vendin; argumentet shpjeguese të dhëna dhe depozituara në ERE nga shoqëria, si dhe duke mbajtur në konsideratë qëndrimin e Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me shkresën nr. 102/4 prot., datë 27.4.2015, i cili ka ardhur si përgjigje e shkresës së ERE-s nr. 14 prot., datë 7.1.2015, ku iu kërkuar të prononcohet, lidhur me kompetencën institucionale të trajtimit të këtyre subjekteve në mbështetje të legjislacionit në fuqi, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, MIE, bën me dije se VKM-ja, nr. 1701, datë 17.12.2008, “Për miratimin e rregullores për procedurat e dhënies së autorizimeve për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese që nuk janë objekt koncesioni”, nuk ka efekt prapaveprues. Vlerësimi i kërkesave lidhur me licencat e miratuara nga ERE duhet të bëhet konform dispozitave ligjore, të cilat kanë qenë në fuqi në kohën e miratimit të këtyre licencave. Gjithashtu për këtë projekt, gjatë kësaj kohe nuk ka pasur shprehje interesi nga palë të treta.

- Me urdhrin e kryetarit të ERE-s nr. 146, datë 4.12.2020, u ngrit grupi i punës për monitorimin e kushteve të vendimit nr. 61, datë 2.11.2007, “Për licencimin e shoqërisë ‘HERA’ sh.p.k. në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike (parku eolik Pogradec dhe Korçë), i ndryshuar.

- MIE, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 714/1, datë 13.7.2020, ka bërë me dije qëndrimin e saj: “Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) nuk është dakord me shtyrjen e

afatit të licencave të lëshuara nga ERE për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese nga energjia elektrike eolike, pasi është në fuqi baza ligjore për të aplikuar për ndërtimin e impianteve eolike, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” dhe të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

- Nisur nga vështirësitë e krijuara për shkak të COVID-19 dhe masave të marra nga Qeveria Shqiptare për distancimin social me qëllim parandalimin e përhapjes së COVID-19, u bë i vështirë dhe finalizimi i këtij monitorimi në kohë, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 83, datë 4.5.2020, të Bordit të ERE-s.

- Referuar përfundimeve të monitorimit, dokumentacionit dhe informacionit të përcjellë nga shoqëria në kuadër të këtij monitorimi, është e nevojshme të rishikohet i gjithë ky dokumentacion, për të vlerësuar statusin e plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit.

- Në zbatim të parashikimeve të përcaktuara në nenin 67, të “Kodit të Procedurave Administrative”, u pa e arsyeshme që për arsye të verifikimit të plotë të dosjes së dokumentacionit të depozituar në ERE dhe gjetjeve të monitorimit, shtyrja me 30 ditë e vendimmarrjes.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shtyrjen me 30 ditë të vendimmarrjes mbi “Kërkesën e shoqërisë ‘HERA’ sh.p.k. për zgjatjen e afatit të plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit nr. 61, datë 2.11.2007, të ndryshuar”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për këtë vendimmarrje.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 255, datë 21.12.2020****MBI PROPOZIMIN E OST SHA PËR
TREGUESIT E KRITEREVE
STANDARDE TË CILËSISË SË
SHËRBBIMIT TË TRANSMETIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE, PËR VITIN 2021**

Në mbështetje të nenit 7, pika 1, 16 dhe 20, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 15, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, të miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; “Rregulloren për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e ERE-s nr. 207, datë 18.12.2017; të nenit 104, pika 4, germa “a”; të nenit 113, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), pasi shqyrtoi relacionin nr. 135/9 prot., datë 15.12.2020, të Drejtorisë së Monitorimit të Tregut dhe Inspektiveve, lidhur me “Shqyrtimin e propozimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) për treguesit e kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2021”,

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 207, datë 18.12.2017, Bordi i ERE-s miratoi “Rregulloren për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe të performancës së sigurisë së rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike”.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, me kërkesë të shoqërisë OST sh.a., si rezultat i pamundësisë për të përmbushur kërkesat e kësaj rregulloreje brenda afateve që ajo përcakton, për shkak të nevojës së kryerjes së investimeve të domosdoshme, Bordi i ERE-s, me vendime të herëpashershme, ka vendosur shtyrjen e hyrjes në fuqi të saj.

- Vendimi më i fundit i Bordit të ERE-s nr. 124, datë 30.7.2020, “Mbi kërkesën e shoqërisë OST sh.a. për disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 207, datë 18.12.2017, ‘Për miratimin e rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike’” vendosi: 1. Të pranojë pjesërisht kërkesën e OST

sh.a. për shtyrjen deri në datën 31.12.2021, të afatit të parashikuar në pikën 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 209, datë 16.12.2019, “Për një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 207, datë 18.12.2019, ‘Për miratimin e rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike’”, si të paargumentuar e të pambështetur plotësisht në prova.

- Të ndryshojë pikën 2, germa “a”, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 209, datë 16.12.2019, “Për një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 207, datë 18.12.2019, ‘Për miratimin e rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike’, si më poshtë:

- Pika 7.3, e “Rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike”, ndryshon dhe bëhet: “OST sh.a. do të propozojë në ERE për miratim nivelin e lejuar të kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit, brenda datës 30.11.2020”.

- Në zbatim të vendimit të ERE-s, të sipërcituar, OST sh.a., me shkresën nr. 7200 prot., datë 1.12.2020, ka parashtruar propozimin e tij sa i përket “Treguesit të kriterëve standarde të performancës për operatorin e sistemit të transmetimit”, për vitin 2021, si dhe ka parashtruar një sërë argumentesh me qëllim shtyrjen e afatit të parashikuar në pikën 2, të vendimit nr. 124, datë 30.7.2020, “Mbi kërkesën e shoqërisë OST sh.a., për disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 207, datë 18.12.2017, ‘Për miratimin e rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike’”, në bazë të nenit 10, të “Rregullores për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”, deri më 31 dhjetor 2021.

- Në të njëjtën kohë OST sh.a., me shkresën nr. 3577 prot., datë 16.6.2020, nëpërmjet të cilës parashtron një sërë argumentesh, ka kërkuar gjithashtu që afati i parashikuar në pikën 2, të vendimit nr. 209, datë 16.12.2019, “Mbi kërkesën e shoqërisë OST sh.a. për disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 207, datë 18.12.2017, ‘Për miratimin e rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike’”, të shtyhet.

- Nga analizimi i dokumentacioneve të përcjella nga OST sh.a. në ERE, u evidentua se argumentet e përcjellë përmes shkresës nr. 7200 prot., datë



1.12.2020, janë po ato të përcjella me shkresën nr. 3577 prot., datë 16.6.2020, në të cilën është kërkuar ndryshimi i vendimit të Bordit të ERE-s nr. 209, datë 16.12.2019, “Për një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 207, datë 18.12.2019, ‘Për miratimin e rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike’”. Për sa parashtruar, Bordi i ERE-s është shprehur me vendimin nr. 124, datë 30.7.2020.

- OST sh.a., me shkresën nr. 893/2 prot., datë 27.10.2020, përcjell në ERE, ndër të tjera parashtron: “Mbi përmbushjen e detyrimeve të nenit 73, pika 2, të “Kodit të transmetimit”. Informacioni i përcjell ofron një pasqyrë të cilësisë së punës së sistemit të transmetimit të ilustruar nga “Treguesit e kriterëve standarde të performancës për Operatorin e Sistemit të Transmetimit, për vitin 2019”.

- Nga analizimi i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga OST sh.a., parashtrojmë si më poshtë vijon:

Koha Mesatare e Ndërprerjes së Furnizimit me Energji Elektrike (AIT) nënkupton matjen e kohës së ndërprerjes së furnizimit me energji elektrike në sistem (orë në vit). Ky tregues për vitin 2021, të jetë 35 minuta.

Energjia e pa Furnizuar (ENS) nënkupton sasinë totale të energjisë (në mwh) që duhet t’i ishte furnizuar konsumatorëve, të cilëve iu është ndërprerë energjia elektrike, nëse nuk do të kishte pasur ndërprerje. Ajo llogaritet si shumë e energjisë së pa furnizuar për çdo rast ndërprerjeje. Ky tregues për vitin 2021, të jetë në vlerën 467.8 mwh.

Cilësia e Frekuencës (FQ) nënkupton matjen e devijimit të frekuencës së sistemit mbi ose nën vlerën nominale prej 50 hz, duke pasur në konsideratë se frekuenca nominale në sistemin elektroenergjitik të vendit i cili operon në mënyrë sinkrone me rrjetin evropian të transmetimit ENTSO-E është 50 hz. Ky tregues për vitin 2021, të jetë brenda diapazonit ± 200 mhz.

Periodha e njoftimit të ndërprerjeve të planifikuara në sistemin e transmetimit nënkupton numrin e orëve dhe ditëve në avancë të dhënies së njoftimit për konsumatorët e lidhur direkt në sistemin e transmetimit dhe Operatorët e Sistemit të Shpërndarjes (OSHEE), lidhur me ndërprerjet e planifikuara. Ky tregues për vitin 2021, të jetë 72 orë.

Koha e nevojshme për t’ju përgjigjur kërkesave për lidhje të reja, nënkupton kohën që i nevojitet OST sh.a. për të dhënë një përgjigje me shkrim, për kërkesën për lidhje të re. Kjo kohë mund të llogaritet në mënyrë të veçantë sipas niveleve të ndryshme të tensionit të pikës së lidhjes. Llogaritja e kohës do të marrë në konsideratë afatet përkatëse për trajtimin e kërkesave për lidhje bazuar në “Rregulloren e procedurave për lidhjet e reja dhe modifikimin e lidhjeve ekzistuese me rrjetin e transmetimit”. Ky tregues për vitin 2021, do të jetë sipas përcaktimeve në piken 2.2.3, të rregullores së miratuar me vendimin nr. 87/2018, brenda 60 ditëve.

Indeksi i Kohëzgjatjes Mesatare të Ndërprerjeve (SAIDI) i referohet kohëzgjatjes mesatare të ndërprerjeve për klientët, të cilët kanë ndërprerje gjatë një periudhe kohore (tremujor, gjashtëmujor, vjetor). Ky tregues për vitin 2021, të jetë 104 minuta.

Cilësia e Tensionit (VQ) nënkupton vlerësimin e devijimit të tensionit mbi ose nën vlerën nominale të pritshme për tensionin e rrjetit, sipas përcaktimeve të “Kodit të rrjetit të transmetimit”. Ky tregues, për vitin 2021, të jetë brenda diapazonit të përcaktuar në nenin 38, të “Kodit të transmetimit”.

Përqindja e ankesave për cilësinë e tensionit nënkupton përqindjen e ankesave për devijimet e tensionit jashtë kufijve të specifikuar në “Kodin e rrjetit të transmetimit”, që janë zgjidhur brenda afatit kohor të përcaktuar në “Rregulloren për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”. Ky tregues për vitin 2021, të jetë 0%.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratoj “Treguesit e matjes për cilësinë e furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të transmetimit, për vitin 2021”.

a. Koha Mesatare e Ndërprerjes së Furnizimit me Energji Elektrike (AIT), 35 minuta;

b. Energjia e pa Furnizuar (ENS), 467 mwh;

c. Periodha e njoftimit të ndërprerjeve të planifikuara në sistemin e transmetimit, 72 orë;



d. Koha e nevojshme për t'ju përgjigjur kërkesave për lidhje të reja, brenda 60 ditëve;

e. Indeksi i Kohëzgjatjes Mesatare të Ndërprerjeve (SAIDI), 104 minuta;

f. Cilësia e Tensionit (VQ), sipas përcaktimeve të nenit 38, të “Kodit të transmetimit”;

g. Përqindja e ankesave për cilësinë e tensionit 0%.

2. OST sh.a. të raportojë në ERE çdo 3 (tre) muaj mbi ecurinë e zbatimit të “Treguesve të matjes së cilësisë së furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të transmetimit, për vitin 2021”.

3. Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Inspektiveve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 256, datë 21.12.2020

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
MIRATIMIN E “RREGULLORES PËR
INTEGRITETIN DHE
TRANSPARENCËN E TREGUT ME
SHUMICË TË ENERGJISË (REMIT)”**

Në mbështetje të nenit 16, 19, 20, germat: “ç” dhe “d”; të nenit 22, 51, pika 2, germa “dh” dhe 97 pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 16, pika 4, germat: “a”, “b”, “c”, “ç”, dhe pikat 5 dhe 6, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; nenit 28, pika 1, të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, si dhe nenit 15 dhe 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 135/11 prot., datë 16.12.2020, të Drejtorive Teknike,

konstatoi se:

- ERE, bazuar në përcaktimet e ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, ka përgjegjësinë për monitorimin e tregut të energjisë elektrike dhe gazit natyror në Shqipëri.

- Bordi i Rregullatorëve të Komunitetit të Energjisë, në bashkëpunim me palët kontraktuese, me vendimin e datës 7 gusht 2020, bazuar në përcaktimet e rregullores nr. 1227/2011, “Mbi integritetin dhe transparencën e tregut me shumicë të energjisë” vendosi: Duke marrë në konsideratë vendimin nr. 2018/01/MC - EnC të Këshillit Ministerial të Komunitetit të Energjisë, “Mbi adoptimin nga palët kontraktuese të rregullores nr. 1227/2011 Për integritetin dhe transparencën e tregut me shumicë të energjisë (REMIT)”.

- Rregullorja për integritetin dhe transparencën e tregut të energjisë me shumicë (REMIT) përcakton kriteret që ndalojnë praktikën abuzive që mund të ndodhin dhe të ndikojnë në tregjet me shumicë të energjisë. Në të njëjtën kohë, REMIT-i ndihmon në funksionimin e duhur të këtyre tregjeve, duke marrë parasysh karakteristikat e tyre specifike.

- Drafti i përgatitur i rregullores (REMIT), është i ndërtuar në 6 (gjashtë) krerë:

1. Dispozita të përgjithshme: Në këtë kre të rregullores përcaktohen fusha e veprimit të saj, termat e përdorur, si edhe elemente të tjera të përgjithshme.

2. Ndalimi i tregtimit dhe detyrimi për publikim të të dhënave: Në këtë kre, ndër të tjera përcaktohen, ndalimet e vendosura ndaj personave që kanë informacion të brendshëm në lidhje me një produkt të energjisë në tregun me shumicë, detyrimi për publikimin e të dhënave nga ana e pjesëmarrësve të tregut, si dhe ndalimin e çdo angazhimi apo përpjekjeje për t'u përfshirë në manipulimin e tregut të energjisë me shumicë.

3. monitorimi dhe regjistrimi i pjesëmarrësve në treg: Në këtë kre përcaktohet se ERE do të monitorojë aktivitetin tregtar të produkteve të energjisë me shumicë për të zbuluar dhe parandaluar tregtinë bazuar në informacionin e brendshëm dhe manipulimin e tregut në vend, si dhe detyrimin e pjesëmarrësve të tregut për t'u regjistruar pranë ERE-s, në bazë të afateve të përcaktuara.



4. Informacionet konfidenciale: Në këtë kre parashikohet mbrojtja e të dhënave dhe konfidencialiteti i tyre sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

5. Monitorimi, hetimi administrativ dhe masat administrative: Ky kre përcakton se ERE, në përputhje me kompetencat e dhëna nga ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe ligji nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, do të ndërmarrë masa për monitorimin dhe hetimin administrativ në lidhje me ndalimet dhe kërkesat e kësaj rregulloreje, të cilat do të ushtrohen në mënyrë direkte ose në bashkëpunim me institucione të tjera.

6. Dispozitat përfundimtare: Në këtë kre të fundit përcaktohet e drejta e ERE për të ndryshuar dispozitat e kësaj rregulloreje, interpretimi i saj dhe hyrja në fuqi.

- REMIT-i do të përcaktojë në mënyrë të detajuar mënyrën dhe procedurat që do të ndiqen nga ERE për monitorimin e funksionimit të tregut me shumicë të energjisë, si dhe veprimtari të caktuara të pjesëmarrësve në këtë treg, në funksion të eliminimit të abuzimit nëpërmjet zhvillimit të tij, nxitjes së konkurrencës dhe aplikimit të standardeve të transparencës.

- Rregullorja në shtojcën A, do të përcaktojë formate të sakta për informacionin që do të dorëzojnë dhe paraqesin në ERE, si dhe në Bordin e Rregullatorëve të Komunitetit të Energjisë, pjesëmarrësit në tregun me shumicë të energjisë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e drafit të “Rregullores për integritetin dhe transparencën e tregut me shumicë të energjisë” (REMIT).

2. Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Inspektiveve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Petrit Ahmeti**

VENDIM Nr. 257, datë 21.12.2020

MBI MIRATIMIN E PROGRAMIT TË PAJTUESHMËRISË SË OSSH SHA

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 72, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 135/8 prot., datë 15.12.2020, të drejtorive teknike, mbi miratimin e Programit të Pajtuëshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a.),

konstatoi se:

- Shoqëria OSSH sh.a., me shkresën nr. 8669 prot., datë 12.11.2020, i është drejtuar ERE-s me kërkesën për miratimin e Programit të Pajtuëshmërisë së OSSH sh.a., sipas detyrimeve që rrjedhin prej nenit 72, pika 3, germa “b”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, sipas së cilit OSSH sh.a. ngarkohet të hartojë një program pajtuëshmërie që përcakton masat që do të merren për të siguruar ndalimin e veprimeve diskriminuese, si dhe të sigurojë që respektimi i programit të monitorohet në mënyrë të duhur.

- Programi i Pajtuëshmërisë është miratuar me vendimin nr. 18/2020 të Këshillit të Administrimit të OSSH sh.a.

- Me vendimin nr. 196, datë 26.11.2020, Bordi i ERE-s, filloi procedurën për miratimin e Programit të Pajtuëshmërisë.

- Përmes komunikimit elektronik të datës 11 dhjetor 2020, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë përcolli në ERE komentet dhe sugjerimet e tij, në lidhje me Programin e Pajtuëshmërisë, të cilat, siç u bëmë me dije nga ana e OSSH sh.a, janë pasqyruar në pjesën më të madhe të tyre.

- Në mënyrë të përmbledhur, komentet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, të cilat janë reflektuar në Programin e Pajtuëshmërisë, konsistojnë në:

- referimin më qartë të qëllimit të Programit për të shmangur sjelljen diskriminuese në favor të kompanive bija të OSSH sh.a.;



- vendosjen e një detyrë eksplicite ndaj Zyrtarit të Pajtueshmërisë, sa i përket identifikimit të rasteve kur stafi është duke punuar njëkohësisht në më shumë se një kompani apo është në konflikt (interesi);

- të drejtën e aksesit të zyrtarit në të gjithë të dhënat e rëndësishme të shoqërisë, të përfshihet në mënyrë të qartë në program;

- nxjerrjen e rekomandimeve dhe udhëzimeve të brendshme nga ana e zyrtarit;

- punonjësit (e OSSH sh.a.), jo vetëm të deklarojnë gatishmërinë për të implementuar Programin e Pajtueshmërisë, por ky i fundit duhet të jetë detyrues për ta;

- në të drejtat e punonjësve duhet të përfshihet e drejta për të adresuar te zyrtari çdo informacion lidhur me diskriminimin potencial, në mënyrë anonime;

- përmbajtja e programit vjetor të përkufizohet më në detaje;

- aksesit në informacion dhe përjashtimi nga çdo privilegj (lidhur me informacionin) i kompanive bija në biznesin konkurrues duhet të adresohet në më shumë detaje;

- OSSH sh.a., si një kompani me të drejtë ekskluzive duhet të prokurojë të gjithë mallrat dhe shërbimet përmes një procedurë konkurruese. Në rastet e ndonjë të mirë apo shërbimi të prokuruar brenda kompanisë, pa një procedurë publike prokurimi, këto të mira apo shërbime do të vlerësohen me çmim tregu ose në kosto, cilado (prej tyre) është më e ulët;

- sa u përket sanksioneve disiplinore në nivelet menaxheriale dhe për të gjithë punonjësit e OSSH sh.a., Programi i Pajtueshmërisë duhet të përfshijë pasoja shtesë/më të detajuara.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë Programin e Pajtueshmërisë së OSSH sh.a. dërguar elektronikisht në ERE përmes *email*-it të datës 14.12.2020 (bashkëlidhur).

2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë OSSH sh.a. dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda

30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

PROGRAMI I PAJTUESHMËRISË I OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE (OSSH SHA)

1. HYRJJE

1.1 Dispozita të përgjithshme

Programi i Pajtueshmërisë (Programi) së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSSH sh.a.) përcakton kushtet për ndarjen dhe pavarësinë e OSSH sh.a., në zbatim të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

1.2 Qëllimi

Programi synon shmangien e sjelljeve diskriminuese të OSSH sh.a. ndaj pjesëmarrësve të tjerë në tregun e energjisë elektrike, posaçërisht në favor të shoqërive bija, si dhe ofron mekanizmat për zbatimin, monitorimin dhe raportimin e tij. Programi përcakton detyrimet specifike të punonjësve për përmbushjen e këtij objektivit dhe transponon në mënyrë të plotë kërkesat e direktivës 2009/72/EC, në pajtim me nenin 72, të ligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike. Gjithashtu, Programi i Pajtueshmërisë përcakton të drejtat dhe detyrimet e Zyrtarit të Pajtueshmërisë për të raportuar çdo shkelje të dispozitave të lartpërmendura ligjore.

Në kuadër të Programit të Pajtueshmërisë, OSSH sh.a përcakton:

- Zyrtarin e Pajtueshmërisë, i cili ngarkohet me monitorimin e përhershëm dhe të vazhdueshëm dhe raportimin pranë ERE-s, mbi zbatimin e Programit, sidomos në nivelin e zbatueshmërisë dhe efektshmërisë së tij;

- Të drejtat dhe detyrimet e punonjësve të OSSH sh.a për të përmbushur objektivat e Programit;


- Masat për shmangien e sjelljeve diskriminuese në raport me pjesëmarrësit e tjerë në tregun e energjisë elektrike.



1.3 Struktura organizative

Referuar ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet të jetë i ndarë dhe i pavarur nga aktivitetet e tjera, të cilat nuk kanë të bëjnë me shpërndarjen e energjisë elektrike, si dhe të ketë të drejta të plota vendimmarrëse, të pavarura nga shoqëria e integruar.

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes aktualisht funksion me strukturat e saja mbështesë sipas organigramës së mëposhtme:





2. Zyrtari i pajtueshmërisë

Me vendim të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë caktohet Zyrtari i Pajtueshmërisë, i cili është përgjegjës për të siguruar pajtueshmërinë, si dhe paraqitjen e Raportit të Pajtueshmërisë pranë ERE-s. Zyrtari i Pajtueshmërisë është përgjegjës për monitorimin lidhur me respektimin e detyrimeve ligjore të Programit të Pajtueshmërisë, si dhe për ndryshimet apo rishikimet e nevojshme të këtij programi me miratimin e ERE-s. Zyrtari i Pajtueshmërisë nuk do të mbajë, në mënyrë direkte apo indirekte, asnjë pozitë apo interes profesional në kompaninë vertikalisht të integruar. Zyrtari i Pajtueshmërisë do të raportojë raste ku stafi i OSSH-së identifikohet të jetë punësuar në më shumë se një kompani në të njëjtën kohë, apo nëse stafi ka ndonjë konflikt tjetër interesi.

Zyrtari i Pajtueshmërisë ka të drejtë të jetë i pranishëm në mbledhjet e Këshillit të Administrimit apo të menaxhimit të OSSH sh.a., kurdo që Zyrtari i Pajtueshmërisë, në diskrecionin e tij të plotë, vlerëson se pjesëmarrja e tij në mbledhje kontribuon në ekzekutimin e detyrave të tij, dhe mund të ndërlihdhen me çështje, të tilla si: kushtet e aksesit në sistemin e shpërndarjes, si dhe të përdorimit të këtij rrjeti, alokimin e kapaciteteve të shpërndarjes, transparenca, projektet në zbatim lidhur me operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes, blerjen dhe shitjen e energjisë për nevoja të mbulimit të humbjeve në rrjetin e shpërndarjes etj. Zyrtari i Pajtueshmërisë do të ketë qasje në të gjitha informatat që ai, në diskrecionin e tij, vendos se janë të nevojshme për kryerjen e detyrave të tij, duke përfshirë të dhënat e OSSH-së dhe shoqërive bija.

Zyrtari i Pajtueshmërisë raporton pranë Këshillit të Administrimit dhe stafit menaxherial të OSSH sh.a, lidhur me mosmarrëveshjet e mundshme në kuadër të implementimit të Programit, si dhe përgatit me shkrim masat dhe propozimet për të rregulluar problematika të tilla, duke përfshirë këtu edhe rekomandime për udhëzime të brendshme. Në rast se këto problematika nuk janë rregulluar brenda një afati të arsyeshëm, Zyrtari i Pajtueshmërisë i raporton pranë ERE-s. Për shmangie të dyshimit, asgjë në këtë provizion nuk do të nënkuptojë që Zyrtari i Pajtueshmërisë është vartës ndaj Këshillit të Administrimit apo stafit menaxherial të OSSH sh.a.

Zyrtari i Pajtueshmërisë ka të drejtë, në diskrecionin e tij të plotë, të raportojë në mënyrë direkte pranë autoritetit rregullator për çdo shkellje të Programit të Përputhshmërisë përderisa për këtë proces e mbanë të informuar stafin menaxherial.

3. Të drejtat dhe detyrimet e punonjësve të OSSH sh.a., në kuadër të Programit të Pajtueshmërisë

Punonjësit duhet të njihen me Programin e Pajtueshmërisë janë të detyruar për zbatimin e tij. Punonjësit duhet të mbështesin në mënyrë aktive Zyrtarin e Pajtueshmërisë gjatë përmbushjes së detyrimeve të tij. OSSH sh.a. ofron rregullisht trajnime për punonjësit e saj, lidhur me programin dhe siguron kushtet për një ambient mbështetës për zbatimin e këtij programi. Punonjësit duhet të kenë të drejtë t'i drejtohen Zyrtarit të Pajtueshmërisë në mënyrë anonime për çdo informacion që ka të bëjë me diskriminimin apo mospërputhjen me programin.

4. Pavarësia e organeve drejtuese të OSSH sh.a.

Në referim të ligjit nr. 43/ 2015, të ndryshuar, kur Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është pjesë e një shoqërie vertikalisht të integruar, me qëllim që të jetë i pavarur në aspektin organizativ dhe të vendimmarrjes nga aktivitetet e tjera që nuk lidhen me shpërndarjen e energjisë elektrike, ndër të tjera, duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

a) të ketë të drejta të plota vendimmarrëse, të pavarura nga shoqëria e integruar për të siguruar funksionimin, mirëmbajtjen apo zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes;

b) të hartojë dhe të depozitojë në ERE një program vjetor, i cili përcakton masat që do të merren për të siguruar ndalimin e veprimeve diskriminuese, si dhe realizimin e objektivave kryesorë të shoqërisë, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në aktivitetin ekonomik e financiar të saj, përfshirë edhe mekanizmat për mbikëqyrjen e zbatimit të tyre. Programi Vjetor duhet të përfshijë së paku kapitujt në vijim: i. ndarjen e llogarive; ii. ndarjen e menaxhmentit; iii. ndarjen e identitetit dhe logos; iv. mbajtjen e informative; dhe v. pavarësinë e OSSH-së në vendimmarrje;

c) personat përgjegjës për menaxhimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes:

i. nuk do të marrin pjesë në strukturat përgjegjëse të shoqërisë së integruar, në mënyrë



direkte ose indirekte, lidhur me veprimtarinë e përditshme operationale të prodhimit, transmetimit dhe furnizimit me energji elektrike;

ii. nuk do të marrin kompensim financiar apo përfitim tjetër material apo financiar nga kompanitë tjera dhe,

iii. nuk do të kenë paga të ndërlidhura me nivelin e performancës së kompanive të tjera brenda shoqërisë së integruar;

d) Personat përgjegjës për menaxhimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes do të nënshkruajnë deklaratë të pavarësisë e cila do të reflektojë pikat “i” deri “iii” më lart.

5. Ndarja e aktiviteteve

Për të siguruar transparencën objektivitetin dhe parandalimin e diskriminimit, OSSH sh.a. po i nënshtrohet një procesi të rëndësishëm që lidhet me ndarjen ligjore, funksionale, financiare lidhur me aktivitetin që ka të bëjë me shpërndarjen e energjisë elektrike.

5.1 Ndarja ligjore

Në kuadër të përmbushjes së detyrimit të ndarjes ligjore, aktualisht OSSH sh.a. është si pjesë e një shoqërie vertikalisht të integruar. OSHEE sh.a., në cilësinë e aksionarit themelues, shoqërisë mëmë, ka themeluar shoqëritë e reja aksionare të kontrolluara, me një nivel administrimi (me Këshill Administrimi), ndër të cilat Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. (OSSH), me objekt aktiviteti shpërndarjen e energjisë elektrike, ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për sigurimin e energjisë elektrike klientëve, lidhjen e klientëve dhe përdoruesve të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, instalimin dhe shërbimet e matjes së energjisë elektrike etj., si dhe çdo aktivitet tjetër fitimprurës me interes për shoqërinë.

5.2 Ndarja funksionale

Për të siguruar objektivitetin, për të përmbushur shërbimin e shpërndarjes së energjisë elektrike për të gjithë pjesëmarrësit në tregun e energjisë elektrike, si dhe për të parandaluar sjelljen diskriminuese, OSSH sh.a. do të sigurojë shpërndarjen e energjisë elektrike në mënyrë të pavarur nga aktivitetet e tjera të ndërmarrja brenda shoqërisë vertikalisht të integruar. Në këtë kuadër, vetëm personat e ngarkuar me menaxhimin e OSSH sh.a. do të përgjigjen për ushtrimin e funksioneve të Operatorit të Shpërndarjes. Asnjë ndërhyrje nga persona të tjerë lidhur me aktivitetet

e përditshme të Operatorit të Shpërndarjes, nuk do të konsiderohet e tolerueshme.

Të gjitha vendimmarrjet lidhur me menaxhimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes janë funksione të drejtpërdrejta të personave të ngarkuar me menaxhimin e OSSH sh.a., në mënyrë jodiskriminuese dhe pa ushtruar asnjë ndikim te pjesëmarrësit e tjerë të tregut, si dhe aktivitetet e tjera brenda shoqërisë vertikalisht të integruar.

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes harton planin e investimit për zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes dhe e paraqet për miratim në ERE. OSSH sh.a. do të sigurojë raport të veçantë financiar, në lidhje me aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike. OSSH sh.a. paraqet në ERE pasqyrat e plota financiare për çdo vit ushtrimor.

6. Përfshirja e sjelljes diskriminuese

Operatori i sistemit të shpërndarjes duhet të sigurojë qasje transparente dhe jodiskriminuese me rrjetin e shpërndarjes në pajtim me rregullat e miratuara nga ERE, lidhur me miratimin e kostove që do t'i ngarkohen përdoruesit për kyçje në sistem të shpërndarjes dhe përdorim të tij.

7. Konkurrenca dhe marrëdhëniet komerciale

Aktivitetet e OSSH sh.a. nuk duhet të kufizojnë apo ndikojnë në konkurrencën e drejtë, në tregun e energjisë elektrike dhe do të sigurojnë qasje jodiskriminuese në të gjitha fushat e mundshme të ndikimit që mund të përfshijnë, por nuk janë të kufizuara, me: i. kërkesat teknike për kyçje; ii. procedurat dhe afatet kohore të kërkesave për kyçje; iii. standardizimin e kushteve kontraktuale dhe komerciale; iv. kostot e kyçjes; dhe v. cilësinë e shërbimit në lidhje me mirëmbajtjen dhe rregullimin e problemeve në rrjet;

8. Zbatimi i parimeve të objektivitetit, transparencës dhe paanshmërisë

Për të siguruar objektivitetin, transparencën dhe paanshmërinë në veprimtarinë operationale të shoqërisë, OSSH sh.a. do të sigurohet për zbatimin e Programit të Pajtuëshmërisë dhe të procedurave të brendshme të saj. Njësitë përgjegjëse brenda shoqërisë do të trajtojnë me ndershmëri dhe kujdes çdo ankesë të adresuar për punën e shoqërisë duke siguruar anonimitet të plotë dhe duke mbajtur, gjithashtu, një bazë të dhënash për trajtimin dhe kthimin e përgjigjeve.



Nivelet menaxheriale dhe të gjithë punonjësit e OSSH sh.a. do të ndalojnë çdo formë kufizimi, apo pengimi të të drejtave të përdoruesve të rrjetit, në të kundërt do të jenë subjekt i sanksioneve disiplinore, sipas legjislacionit në fuqi, si dhe parashikimeve të referuara në kontratën kolektive të punës, lidhur me masat disiplinore.

9. E drejta e informimit

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes garanton që mbledhja dhe procesimi i të dhënave prej tij, është në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, duke ruajtur konfidencialitetin e informacionit të marrë. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ruan konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar, përveç rasteve kur kërkohet nga autoritetet kompetente, në përputhje me funksionet e tyre, të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të sigurojë akses jodiskriminues për çdo informacion të karakterit publik, duke respektuar parimin e barazisë sa u takon të njëjtave kushte, procedura, kosto dhe cilësisë për të gjithë pjesëmarrësit në tregun e energjisë.

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të vendosë procedura të brendshme që sigurojnë që informacionet komercialisht të ndjeshme nuk mund të aksesohen nga persona që kanë çdo ndërlidhje me shoqërinë e integruar apo kompanive bija të saj apo të ndonjë kompanie tjetër. Specifikisht, OSSH sh.a. do të:

i. vendosë mekanizma të brendshëm dhe rregulla për t'i mbrojtur informacionet komercialisht të ndjeshme dhe për t'u siguruar që kompanitë motra të OSSH-së nuk gëzojnë përparësi diskriminuese në qasjen e këtyre informative;

ii. trajtojë në mënyrë konfidenciale çdo informatë të ndarë nga pjesëmarrësit në treg, përveç nëse ajo informatë është markuar si informatë jokonfidenciale;

iii. trajtojë në mënyrë konfidenciale çdo informatë financiare që i afekton operimet e pjesëmarrësve në treg apo informata që kanë të bëjnë me koston e furnizimit të energjisë; dhe

iv. ofrojnë qasje jodiskriminuese për çdo informatë relevante publike dhe të respektojnë procedurat e aplikueshme në mënyrë konsistente.

10. Ofrimi i shërbimeve të përbashkëta

Shërbimet e përbashkëta që mund të ofrohen nga shoqëria e integruar e që janë të natyrës administrative dhe nuk ndërlidhen direkt me ofrimin e shërbimit të shpërndarjes të energjisë elektrike, do të ofrohen në bazë të koston reale të ofrimit të këtyre shërbimeve. Natyra e këtyre shërbimeve është e lidhur me ofrimin e shërbimeve: ligjore, burimeve njerëzore, ekonomike, të teknologjisë së informacionit etj.

Shërbimet e përbashkëta do të ofrohen në bazë të një marrëveshjeje të qartë të ofrimit të shërbimeve e cila do të specifikojë, në mes tjerash:

i. përshkrimin e shërbimit të ofruar;

ii. arsyetimin se pse ky shërbim duhet të ofrohet nga kompania vertikalisht e integruar;

iii. koston totale të ofrimit të këtij shërbimi; dhe

iv. metodologjinë e alokimit të koston së ofrimit të shërbimit. Marrëveshjet për shërbimet e përbashkëta do të përmbajnë detyrime të qarta lidhur me marrëdhëniet që rregullohen në to, afatet kohore në përmbushjen e detyrimeve, detyrimet përkatëse financiare etj.

Në përcaktimin e metodologjisë së sipërpërmendur, së alokimit të koston së shërbimit, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të sigurojë, posaçërisht, që koston e alokuara ndaj Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes përcaktohen në bazë të alokatorëve qartësisht të identifikuar dhe që alokimi i kostove nuk përfshinë ndërsubvencionim të kostove të cilat do të duhej t'u alokoheshin kompanive të tjera të shoqërisë së integruar. Parimet e alokimit të kostove do të shqyrtohen nga Zyrtari i Pajtuësmerisë.

Shërbimet e marra nga OSSH do të jenë subjekt i një procesi konkurrues prokurimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Nëse shërbimet prokurohen përbrenda kompanisë, këto shërbime duhet të bëhen me çmime të tregut apo të reflektojnë koston e brendshme të ofrimit të shërbimit, nëse është më e ulët.

11 Zbatimi dhe detyrimi për zbatim i Programit

Dispozitat e këtij Programi janë të detyrueshme për të gjithë drejtuesit dhe punonjësit e OSSH-së. Programi është detyrues për përfaqësuesit e autorizuar të OSSH-së, për audituesit, këshilltarët, kontraktuesit, pjesëmarrësit dhe përdoruesit e rrjetit, si dhe palët e tjera të treta.



Të gjithë drejtuesit dhe punonjësit e OSSH-së, përfaqësuesit e autorizuar, audituesit, duhet të konfirmojnë me shkrim që janë të informuar dhe do ta zbatojnë Programin. Ata do të informohen nga Zyrtari i Pajtueshmërisë, sa më shpejt të jetë e mundur në rast ndryshimesh apo amendimesh. OSSH-ja do të sigurojë që stafi do të marrë trajnimin adekuat për të përkrahur implementimin e Programit të Pajtueshmërisë, duke siguruar po ashtu që punonjësit e rinj të trajnohen brenda 8 javëve nga data e punësimit. OSSH do të sigurojë që njohuritë në lidhje me Programin e Pajtueshmërisë janë koherente dhe çdo ndryshim komunikohet përmes trajnimeve shtesë.

Gjithashtu, Zyrtari i Pajtueshmërisë jep udhëzime të vazhdueshme për zbatimin e Programit për punonjësit ekzistues dhe të sapopunësuarit. Për çdo shkelje të dispozitave të Programit, drejtuesit ose punonjësit e OSSH-së informojnë menjëherë Zyrtarin e Pajtueshmërisë. Në rast të konstatimit, shkelja e ndonjë dispozite të Programit mund t'i japë OSSH-së të drejtën për të aplikuar procedurën disiplinore në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Për të siguruar zbatimin e plotë të këtij Programi, Zyrtari i Pajtueshmërisë është i obliguar për:

- raportin mbi implementimin dhe monitorimin e Programit, përputhshmërinë e akteve dhe proceseve të brendshme të shoqërisë me Programin e Pajtueshmërisë;
- propozimin e masave për përmirësimin e Programit;
- përditësimin e Programimit;
- hartimin e raportit vjetor lidhur me zbatimin e Programit.

Me miratimin e këtij Programi nga Enti Rregullator i Energjisë, OSSH sh.a. do të informojë të gjithë punonjësit për t'iu përmbajtur parimeve të përcaktuara në Program.

Zyrtari i Pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes paraqet çdo vit në ERE një raport vjetor, i cili përcakton masat e marra në kuadër të programit të pajtueshmërisë. Zyrtari i Pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes është plotësisht i pavarur dhe ka akses në të gjitha informacionet e nevojshme të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe çdo shoqërie të lidhur, për të përmbushur detyrën e tij.

12. Hyrja në fuqi

Programi do të hyjë në fuqi me miratimin e Entit Rregullator të Energjisë. OSSH sh.a. do të marrë masat për publikimin e këtij programi në faqen e tij zyrtare.

VENDIM

Nr. 258, datë 21.12.2020

MBI KORRIGJIMIN E PAGESAVE RREGULLATORE, PËR VITIN 2020, PËR DISA NGA TË LICENCUARIT E SEKTORIT TË ENERGIJISË

Në mbështetje të nenit 17, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 14, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; të neneve 5, pika 5.4 dhe 6, pika 6, pika 6.1.1, 6.4, dhe nenit 7, i “Rregullores për përcaktimin e miratimit e pagesave rregullatore”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 190, datë 23.11.2017, të ndryshuar me vendimin nr. 129, datë 10.8.2020; të nenit 15, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.12.2020, pasi shqyrtoi relacionin nr. 135/19 prot., datë 18.12.2020, të Drejtorisë së Tarifave dhe Çmimeve, mbi korrigjimin e pagesave rregullatore, për vitin 2020, për disa nga të licencuarit e sektorit të energjisë,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr.171, datë 4.11.2020, vendosi: “Mbi llogaritjen e pagesave rregullatore për vitin 2020”;

- Me anë të shkresës nr. 237, datë 16.12.2020, shoqëria “Hydro Seta” sh.p.k. ka kërkuar rishikimin e pagesës rregullatore të vitit 2020, të miratuar me vendimin nr. 171/2020, të Bordit të ERE-s, duke përcjellë pasqyrat financiare të shoqërisë për vitin 2019, në të cilat evidentohen të ardhurat e realizuara të shoqërisë;

- Në vijim të kësaj kërkesë, u krye një rikontroll, prej të cilit rezultoi një pasaktësi lidhur me të ardhurat e marra në konsideratë gjatë llogaritjes së pagesës rregullatore për subjektin “Hydro Seta” sh.p.k.

- Mbas saktësimit të të ardhurave, rezultoi se pagesa rregullatore 2020 për këtë subjekt është



llogaritur në një vlerë më të lartë, e si rrjedhojë aplikimi i saj nuk do të ishte i drejtë në aspektin ligjor dhe rregullator, si dhe në frymën e bashkëpunimit reciprok me një të licencuar, në kohën kur pika 3, e vendimit nr. 171/2020, detyron kryerjen e pagesës rregullatore ndaj ERE-s, jo më vonë se 30 ditë nga botimi në Fletoren Zyrtare, të vendimit sipërcituar.

- ERE vlerësoi të nevojshme të vijonte me kontrollin e të ardhurave, të marra në konsideratë për përcaktimin e pagesave rregullatorë, dhe për shoqëritë e tjera të licencuara nga ERE nga ku rezultuan dhe pasaktësi të tjera.

- Gjatë këtij kontrolli, u evidentua se është llogaritur pagesë rregullatore dhe për shoqëri të cilave i ka përfunduar licenca gjatë vitit 2020, si dhe një shoqëri e cila nuk ishte përfshirë në llogaritjen e pagesave rregullatore për vitin 2020.

- Pasaktësitë e konstatuara gjatë kontrollit mbi regjistrimin e të ardhurave që kanë shërbyer për llogaritjen e pagesës rregullatore, lidhen me faktin se një pjesë e këtyre subjekteve nuk kanë raportuar llogaritë e ndara nga aktivitetet e tjera që ata ushtrojnë, detyrim ky i përcaktuar në pikën 1, të nenit 35, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, e si rrjedhojë të ardhurat e marra në konsideratë nuk kanë qenë nga ushtrimi i aktivitetit të licencuar.

- Për një pjesë të të licencuarve, të cilëve i janë konstatuar pasaktësi në llogaritje, ERE ka përlllogaritur këtë pagesë mbi bazën e vlerësimeve nga të dhëna të marra nga publikime zyrtare, në zbatim të pikës 6.4, të “Rregullores për përcaktimin e miratimin e pagesave rregullatorë”, për arsye të mos dërgimit të pasqyrave financiare të plota/audituar, si një detyrim i përcaktuar në pikën 1, të nenit 46, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Për një pjesë të të licencuarve u evidentuan disa lapsuse në regjistrimin e të ardhurave, të cilat kanë ardhur për shkak të kushteve të vështira të punës *online*, të shkaktuara prej pandemisë COVID-19.

- Mbas saktësimin të të ardhurave, rezultojnë një rishpërndarje e re e pagesës rregullatore 2020, jo vetëm për subjektet, subjekt i këtij vendimi, por dhe për të gjithë të licencuarit e tjerë që operojnë në tregun e energjisë elektrike dhe gazit natyror.

- Efektet e korigjimit të pagesës rregullatore për të licencuarit e tjerë, të cilët të ardhurat e konsideruara sipas përcaktimeve të pikës 6.1.1, janë regjistruar saktë, do të korigjohen në llogaritjen e pagesës rregullatore të periudhës pasardhëse.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Korigjimin e pagesës rregullatore për vitin 2020 vetëm për shoqëritë e licencuara të përcaktuara në pikën 1, të vendimit nr. 171, datë 4.11.2020, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Diferencat që rezultojnë nga korigjimi i pagesës rregullatore të vitit 2020, për shoqëritë e licencuara sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi, për efekt të buxhetit të ERE-s, të miratuar me vendimin nr. 22, datë 30.1.2020, të Bordit të ERE-s, do të alokohen në llogaritjen e pagesës rregullatore të periudhës pasardhëse të të gjithë të licencuarve të sektorit të energjisë që nuk janë subjekt i këtij vendimi.

3. Të licencuarit, subjekt i këtij vendimi (sipas tabelës bashkëlidhur), duhet të kryejnë pagesat rregullatore ndaj ERE-s, jo më vonë se 30 ditë nga botimi në Fletoren Zyrtare i këtij vendimi, në të kundërt, ERE, mbështetur në nenin 107, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit, si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2 % të xhiros ditore për çdo ditë vonesë në pagesën e saj

4. Drejtoria e Financës dhe IT-së të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike, ose brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare për të licencuarit në sektorin e gazit natyror.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



I	Liçensë për prodhim	Pagesa Rregullatore 2020 e saktësuar	Pagesa rregullatore 2020 (Vendimi 171/2020)
1	“ELEKTRO LUBONJA” sh.p.k	7,707	11,790
2	“Sarolli” sh.p.k	37,083	83,098
3	“Hidropowerplant Construction” sh.p.k.	168,693	371,137
4	"C & S ENERGY" sh.p.k	672,660	690,281
5	DAAB Energy Group sh.p.k	121,030	125,530
6	”EUROBIZNES” sh.p.k	4,523	102,595
7	“Hydro Seta” sh.p.k	413,203	1,969,594
8	“DERBI – E” sh.p.k.	20,776	109,125
	Total	1,445,675	3,463,152
V	Liçensë për furnizim të energjisë elektrike /gazit natyror	Pagesa Rregullatore 2020 e saktësuar	Pagesa rregullatore 2020 (Vendimi 171/2020)
1	"Electral" sh.p.k	-	100,000
	Total	-	100,000
VI	Liçensë për tregtim të energjisë elektrike /gazit natyror	Pagesa Rregullatore 2020 e saktësuar	Pagesa rregullatore 2020 (Vendimi 171/2020)
1	”Hidropower Elektrik” sh.p.k	100,000	-
	Total	100,000	-
VI	Liçensë për tregtim të energjisë elektrike /gazit natyror	Pagesa Rregullatore 2020 e saktësuar	Pagesa rregullatore 2020 (Vendimi 171/2020)
1	"Gaea-Energjia alternative e gjelber" sh.p.k	-	100,000
2	"Electral" sh.p.k	-	100,000
3	"Anio Oil&Gas"sh.p.k	-	258,329
	Total	-	458,329
Emertimi		Pagesa Rregullatore 2020 e saktësuar	Pagesa rregullatore 2020 (Vendimi 171/2020)
Total		1,545,675	4,021,480



KORRIGJIM GABIMI MATERIAL

Strategjia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike, që duhej t'i ishte bashkëlidhur vendimit nr. 1084, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike dhe planit të veprimit, 2020–2025", botuar në Fletoren Zyrtare nr. 233, datë 30.12.2020.

PËRMBAJTJA

PJESA I: KONTEKSTI STRATEGJIK

1. HYRJE

2. VLERËSIMI I SITUATËS AKTUALE NË SHQIPËRI

2.1 Situata e Sigurisë Kibernetike

2.2 Kuadri ligjor i sigurisë kibernetike

2.3 Internet i sigurt për fëmijët

2.4 Edukimi, hulumtimi dhe trajnimi në fushën e sigurisë kibernetike

3. VIZIONI I STRATEGJISË

3.1 VIZIONI

3.2 Treguesit e impaktit dhe treguesit e rezultatit

PJESA II: QËLLIMI I POLITIKAVE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË TË STRATEGJISË

4. Qëllimi i politikës 1: Garantimi i sigurisë kibernetike në nivel kombëtar, nëpërmjet mbrojtjes së infrastrukturave të informacionit, duke fuqizuar mjetet teknologjike dhe juridike

Objektivi specifik 1: Përmirësimi i kuadrit ligjor që normon dhe rregullon fushën e sigurisë kibernetike në vend, si dhe harmonizimi i i tij me direktivat dhe rregulloret e Bashkimit Evropian

Objektivi specifik 2: Ngritja dhe funksionimi i CSIRT-eve në të gjithë sektorët e industrisë në nivel kombëtar

Objektivi specifik 3: Fuqizimi dhe implementimi i masave të sigurisë në infrastrukturat kritike dhe të rëndësishme të informacionit

Objektivi specifik 4: Përmirësimi i infrastrukturave të informacionit për të luftuar krimin kibernetik, radikalizimin dhe ekstremizmin e dhunshëm

5. Qëllimi i politikës 2: Ndërtimi i një mjedisi të sigurt kibernetik, duke edukuar dhe ndërgjegjësuar shoqërinë në ngritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e sigurisë së informacionit

5.1 Objektivi specifik 1: Rritja e kapaciteteve profesionale në fushën e sigurisë së informacionit nëpërmjet rishikimit të kurrikulave arsimore

5.2 Objektivi specifik 2: Rritja e ndërgjegjësimit dhe e aftësive profesionale të institucioneve publike dhe private për sigurinë kibernetike

5.3 Objektivi specifik 3: Rritje e ndërgjegjësimit të shoqërisë, për sigurinë kibernetike dhe kërcënimet kibernetike

6. Qëllimi i politikës 3. Krijimi i mekanizmave të nevojshëm për sigurinë e fëmijëve në hapësirën kibernetike, duke përgatitur njëkohësisht brezin e ri të aftë për të përfituar nga përparësitë e teknologjisë së informacionit dhe për të përballuar sfidat e zhvillimit

6.1 Objektivi specifik 1: Forcimi i kuadrit ligjor për rritjen e sigurisë së fëmijëve në internet

6.2. Objektivi specifik 2: Parandalimi i abuzimit seksual të fëmijëve në internet nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit dhe krijimit të hapësirave të sigurta për lundrimin në internet

6.5 Objektivi specifik 5: Forcimi i bashkëpunimit ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijëve në internet

7. Qëllimi i politikës 4: Rritja e bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e sigurisë kibernetike me partnerët strategjikë

7.1 Objektivi specifik 1: Forcimi i bashkëpunimit institucional në nivel kombëtar

7.2 Objektivi specifik 2: Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes kibernetike dhe luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit

PJESA IV: ZBATIMI, PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, LLOGARIDHËNIA

PJESA V PLANI I VEPRIMIT DHE BURIMET FINANCIARE PËR ZBATIM

Metodologjia e kostimit të aktiviteteve

Buxheti dhe burimet financiare për zbatimin e planit të veprimit

PJESA I: KONTEKSTI STRATEGJIK

1. HYRJE

Në dekadat e fundit, zhvillimi i internetit, si dhe ndryshimet inovative në teknologji, kanë sjellë ndryshime rrënjësore dhe sfida në çdo shoqëri në mbarë botën. Jetët tona të përditshme, të drejtat e njeriut, ekonomitë dhe ndërveprimet shoqërore, ndikohen thellësisht nga teknologjitë e informacionit dhe komunikimit. Një hapësirë e



përbashkët dhe e lirë kibernetike, promovon përfshirjen sociale dhe politike, thyen barrierat e komunikimit midis vendeve, komuniteteve dhe qytetarëve, siguron transparencë, duke lejuar ndërveprimin dhe shkëmbimin e informacionit dhe ideve në kohë reale në të gjithë globin. Të gjitha zhvillimet dhe rritja e përdorimit të teknologjive së informacionit dhe komunikimit, vijnë me përfitime të mëdha dhe në të njëjtën kohë sjellin kërcënime, prandaj mbrojtja kibernetike dhe siguria janë vendimtare.

Në hapësirën kibernetike, ekzistojnë përpjekje të vazhdueshme nga individë dhe grupe të ndryshme me interesa keqdashës, të cilat ndikojnë në mbarëvajtjen dhe funksionimin e shteteve. Ndërhyrjet e privatësisë, vjedhjet e identitetit, janë gjithashtu një problem në rritje dhe shumë shqetësues për të gjithë shoqërinë.

Nga njëra anë, qeveria po investon gjithnjë e më shumë në infrastrukturën digjitale, për të ofruar shërbime digjitale për qytetarët. Nga ana tjetër, qytetarët po e përdorin internetin gjithnjë e më shumë për shkak të avantazheve që ofron.

Shqipëria, si një vend në zhvillim, mbështetet, gjithashtu, në teknologjinë e informacionit, duke synuar rritjen e nivelit të jetesës dhe përmirësimin e shërbimeve publike. Krahas përfitimeve nga përdorimi i teknologjive të reja digjitale, përdorimi i internetit sjell problematikat e veta në lidhje me sigurinë kibernetike. Kërcënimet kibernetike, duke përfituar nga dobësitë teknologjike ose mungesa e njohurive në përdorimin e mirë të këtyre mjeteve, janë gjithnjë e më shumë në rritje, duke cenuar sigurinë e sistemeve të informacionit.

Një prej sfidave aktuale dhe të vazhdueshme për të gjitha vendet është ndërtimi i një shoqërie të zhvilluar digjitale dhe të mbrojtur kibernetikisht, të pajisur me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme, për të maksimizuar përfitimet dhe për të menaxhuar rreziqet.

Në “Strategjinë e Sigurisë Kombëtare, 2014–2020” dhe në “Dokumentin e Politikave për Sigurinë Kibernetike, 2014–2017”, Shqipëria ka ndërmarë hapa të rëndësishëm, për të përmirësuar situatën e sigurisë kibernetike. Krahas zhvillimeve, në fushën e teknologjisë së informacionit dhe revolucionit mbi digitalizimin e shërbimeve publike, është plotësuar dhe përmirësuar kuadri ligjor për sigurinë kibernetike.

Falë këtij progresi, Shqipëria është përmirësuar në Indeksin Global të Sigurisë Kibernetike krahasuar me vitin 2017, nga 89, në 62, në mbarë botën dhe 36 në nivel evropian.

Gjithsesi, ky progres, ende nuk ka arritur në shkallën dhe ritmin e ndryshimit të nevojshëm për të qëndruar, përpara lëvizjes dhe evolucionit të shpejtë, që vjen nga kërcënimet e ndryshme kibernetike. Pa dyshim, sulmet kibernetike janë ndër kërcënimet më të rëndësishme të sigurisë për botën moderne dhe për këtë arsye siguria kibernetike, është bërë një pjesë e rëndësishme e sigurisë kombëtare. Për këtë arsye, hartimi i Strategjisë Kombëtare e Sigurisë Kibernetike 2020–2025”, është një domosdoshmëri, për ngritjen e mekanizmeve të duhur institucionalë, me qëllim rritjen e nivelit të sigurisë kibernetike në vend.

Në përmbushje të angazhimeve qeveritare, si dhe në koherencë të plotë me zhvillimet strategjike të vendeve të zhvilluara, për një mjedis kibernetik sa më të sigurt, kjo Strategji do të mbështetet në parimet themelore të mëposhtme:

- zbatimi i vlerave të njëjta themelore në botën fizike dhe digjitale;
- mbrojtja e të drejtave themelore, liria e shprehjes, të dhënat personale dhe privatësia;
- qasja për të gjithë;
- qeverisje demokratike dhe efikase;
- përgjegjësi e përbashkët në garantimin e sigurisë kibernetike.

2. VLERËSIMI I SITUATËS AKTUALE NË SHQIPËRI

Vlerësimi i situatës aktuale për sigurinë kibernetike në Shqipëri është kryer në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse dhe është mbështetur në 4 shtylla si më poshtë:

1. Situata e sigurisë kibernetike;
2. Korniza ligjore e sigurisë kibernetike;
3. Internet i sigurt për fëmijët;
4. Edukimi, hulumtimi dhe trajnimi në sigurinë kibernetike

2.1. Situata e sigurisë kibernetike

2.1.1 Infrastrukturat kritike të informacionit

“Strategjia e Sigurisë Kombëtare”, e miratuar në vitin 2014, ka përcaktuar kornizën dhe shtyllat në nivel kombëtar për rritjen e sigurisë në vend. Si një vend në zhvillim pa infrastrukturën e nevojshme ligjore për sigurinë kibernetike, kjo fushë është zhvilluar vetëm dy vitet e fundit, gjatë së cilëve janë identifikuar infrastrukturat kritike dhe të



rëndësishme të informacionit në sektorin publik dhe atë privat. Gjithashtu, janë hartuar masat minimale të sigurisë që duhet të aplikohen, për rritjen e nivelit të sigurisë kibernetike në këto infrastruktura dhe është ndërtuar mekanizmi metodologjik, për ngritjen dhe funksionimin e CSIRT-eve sektoriale në nivel kombëtar.

Kuadri ligjor i lidhur me sigurinë e komunikimeve elektronike, plotësohet me rregullimet ligjore për sigurinë dhe integritetin e rrjeteve të komunikimeve elektronike, rrjetet e telekomunikacionit, të cilat janë pjesë e ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, i cili ka transpozuar direktivat e BE-së për komunikimet elektronike.

Korniza ligjore për sigurinë kibernetike ka përcaktuar, gjithashtu, Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK), si autoritet përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit.

Përkatesisht, situata aktuale lidhur me sigurinë në infrastrukturat kritike të informacionit, në **sektorin bankar**, me implementimin e ligjit për sigurinë, është përmirësuar krahasuar me dy vite më parë. Në këto infrastruktura, janë aplikuar masa sigurie të konsiderueshme, të cilat janë aprovuar nga AKCESK, si dhe janë ngritur CSIRT-et sektoriale, duke krijuar kështu një mjedis të sigurt kibernetik.

Siguria kibernetike, në **sektorin financiar**, e ndarë në dy shtylla, përkatesisht në atë publike dhe private, paraqitet si më poshtë:

Në infrastrukturat qeveritare kritike të informacionit që përdoren nga institucionet publike, përkatesisht të alokuara pranë qendrës së të dhënave qeveritare, dhe që menaxhohen nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, aplikohen të gjitha masat e sigurisë konform legjislacionit në fuqi dhe standardit ISO 27001. AKSHI është CSIRT sektorial qeveritar dhe është certifikuar me këtë standard në vitin 2018 dhe mbi çdo infrastrukturë qeveritare nën administrim të AKSHI-t, aplikohen politikat e standardit ISO 27001.

Për sa u përket infrastrukturave kritike, që administrohen nga operatorë privat, janë në proces identifikimi dhe në disa raste edhe investimi për t'u ngritur.

Në sektorin e shëndetësisë, të ndarë në dy shtylla, në atë publik dhe atë privat, situata kibernetike paraqitet si më poshtë:

Infrastrukturat kritike të administruara nga operatorët/institucionet publike, kanë implementuar masat e miratuara, në zbatim të ligjit për sigurinë, të cilat kanë ndikuar në rritjen e nivelit të sigurisë kibernetike. Gjithashtu janë ngritur grupet përgjegjëse, për menaxhimin dhe trajtimin e incidenteve, të cilat në mungesë të kornizës ligjore, kanë qenë inekzistente.

Për sa u përket infrastrukturave të informacionit, që administrohen nga operatorë privatë, të cilat konsiderohen si infrastruktura kritike, në kuptim të kornizës ligjore të miratuar nga Komisioni Evropian, për rrjetet dhe infrastrukturat e informacionit, janë të paidentifikuara dhe sipas studimit të situatës, nga autoriteti përgjegjës, nuk përmbushin, gjithashtu, elementet e sigurisë, që duhet të garantojë një infrastrukturë kritike.

Sektori energjetik. Aktualisht, të gjithë operatorët e sistemit energjetik si në prodhim, në transmetim dhe në shpërndarje janë, duke implementuar teknologji inovative të mbështetura mbi sisteme kompjuterike dhe rrjete transmetimi të të dhënave, për menaxhimin dhe optimizimin e proceseve teknologjike. Në të tria elementet e sistemit energjetik është implementuar ose planifikohet të implementohet sistemi SCADA, si dhe kanë qendrat e tyre të operimit dhe të ruajtjes së sistemeve kompjuterike dhe, po ashtu, rrjetet e transmetimit të të dhënave. Gjithashtu, bashkë me leximin dhe analizimin e të dhënave të sistemeve energjetike në distancë, parashikohet që shumë shpejt të implementohen edhe modulet e operimit, të cilat automatizojnë procese të cilat aktualisht kryhen manualisht nga operatori. Kalimi në sisteme të pavarura, të cilat operojnë automatikisht padyshim do të kërkojë implementimin e masave dhe politikave të sigurisë, pasi impakti në rast të incidenteve kibernetike do të jetë shumë i madh. Kjo padyshim kërkon që fillimisht vetë operatorët në fushën e energjetikës në momentin e planifikimit të projekteve TIK dhe të automatizimit t'i kushtojnë një vëmendje të veçantë pjesës së sigurisë së sistemeve, si dhe të krijojnë procedura dhe kapacitete njerëzore të brendshme në funksion të sigurisë kibernetike.



Në sektorin e transportit, i cili përbëhet nga disa shtylla, gjendja paraqitet si më poshtë:

Infrastrukturat kritike të informacionit mbi *transportin ajror*, përmbushin detyrimet e rregullave minimale të sigurisë, si dhe kanë ngritur në strukturën përkatëse CSIRT-in sektorial.

Infrastrukturat kritike të informacionit mbi *transportin rrugor*, nuk përmbushin asnjë detyrim të rregullave minimale të sigurisë, përfshi këtu edhe ngritjen e CSIRT-it sektorial përkatës.

Për sa u përket infrastrukturave të informacionit mbi *transportin detar*, të cilat konsiderohen si infrastruktura kritike në kuptim të kornizës ligjore të miratuar nga Komisioni Evropian, për rrjetet dhe infrastrukturat, janë ende të paidentifikuara.

Gjithashtu, **në sektorin e ujësjellësit**, të cilët administrohen nga pushteti lokal dhe cilësohen si infrastruktura kritike të informacionit, ende nuk janë identifikuar si të tilla në kuptim të legjislacionit në fuqi për sigurinë kibernetike dhe në to nuk aplikohen masa sigurie.

Për sa i përket infrastrukturës digjitale dhe rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike, duke marrë parasysh që pjesa më e madhe e kërcënimeve dhe sulmeve kibernetike vijnë përmes rrjeteve të komunikimeve elektronike, çështjet e sigurisë kibernetike në këtë sektor ndiqen dhe janë nën përgjegjësinë e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP). AKEP-i, bazuar në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, më specifikisht, neni 122 dhe në rregulloren nr. 37, datë 29.10.2015, “Mbi masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe/ose integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”, kërkon marrjen e masave të duhura teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose të shërbimeve të komunikimeve elektronike nga ana e sipërmarrësve të komunikimeve elektronike që veprojnë nën Regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm për të gjitha shërbimet, përfshirë këtu edhe shërbimin DNS që ata ofrojnë për pajtimtarët e tyre. AKEP-i ka kryer dhe kryen në vazhdimësi inspektime dhe audite pranë sipërmarrësve për të verifikuar implementimin dhe zbatimin e masave të duhura teknike dhe organizative të sigurisë dhe në bashkëpunim me AKCESK-në ndjek incidentet e sigurisë që raportohen nga sipërmarrësit e

komunikimeve elektronike. AKEP-i është administrator i domainit “.al” dhe ka autorizuar 8 subjekte si regjistrarë të akredituar për ofrimin e shërbimit të regjistrimit të *domain name* nën zonën .al (*TLD name registries*). Me përfshirjen e këtij shërbimi në listën e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit, subjekt i zbatimit të përcaktimeve të rregullores nr. 37, datë 29.10.2015, “Mbi masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe/ose integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike” do të jenë dhe regjistrarët e akredituar nga AKEP-i për ofrimin e shërbimit të regjistrimit të *domain name* nën zonën .al.

Penetrimi i internetit në Shqipëri është ende në zhvillim dhe paraqitet në një nivel mesatar përdorimi. Rreth 67% e popullsisë si dhe rreth 40% e familjeve kanë pasur qasje në internet në vitin 2019.

2.1.2 Krimi kibernetik

Shqipëria, ashtu dhe si shtetet e tjera, është në shumë raste viktimë e veprimtarisë keqdashëse kibernetike, të kryer nga aktorë kriminalë, duke përfshirë aktorët shtetërorë dhe joshetërorë, që mund të përdorin infrastrukturën e rrjetit në Shqipëri dhe jashtë saj. Së bashku me përmirësimin e internetit, Shqipëria ka parë, gjithashtu, shfaqjen e formave të ndryshme të krimit kibernetik. Format e zakonshme të krimit kibernetik që mbizotërojnë në Shqipëri, përfshijnë mashtrimet që lidhen me *Internet banking*, të tilla si: *phishing* dhe *spam*. Edhe kur individët përgjegjës, për veprimtaritë kriminale kibernetike kundër Republikës së Shqipërisë identifikohen, shpesh është e vështirë për agjencitë e zbatimit të ligjit në Republikën e Shqipërisë dhe organizatat ndërkombëtare, që t'i ndjekin ato kur ato janë në juridiksione të kufizuara.

Aktualisht vihet re se mungojnë mjetet e nevojshme për të marrë dhe krijuar inteligjencë kibernetike, duke përdorur burime njerëzore dhe logjistike të nevojshme për të ushtruar veprimtarinë ligjzbatuese.

Rritja e kapaciteteve për t'u përballur me sfidat kibernetike është thelbësore dhe si pasojë duhet të ndryshohen strukturat, qasja, kapacitetet teknike dhe logjistike etj.

Një hap i rëndësishëm përpara në zhvillimin e legjislacionit dhe marrjen e masave kundër krimit kibernetik, do të jetë edhe strategjia e parë kombëtare për krimin kibernetik, e cila do të



përgatitet nga autoritetet respektive dhe do të vihet në jetë në një kohë relativisht të shkurtër. Ky dokument do të mund të përcaktojë rrugën për të luftuar veprimtaritë kriminale në fushën kibernetike, si dhe mundësimin e më shumë mjeteve të përshtatshme në shërbim të kësaj lufte.

2.2 Kuadri ligjor i sigurisë kibernetike

Një qasje gjithëpërfshirëse kombëtare e sigurisë kibernetike, nuk mund të bëhet duke përdorur vetëm teknologjitë dhe shërbimet, por duhet të shoqërohet me një kornizë ligjore të mirë dhe aktuale, me fokus në natyrën dinamike të mjedisit të TIK-ut dhe natyrën evoluese të kërcënimeve kibernetike.

Struktura të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, realizojnë fushata ndërgjegjësimi për grupe të ndryshme interesi me qëllim mbrojtjen nga kërcënimet që vijnë nga krimi kibernetik dhe sulme të tjera të sigurisë në internet.

Një kuadër ligjor dhe rregullator që mbron format e ndryshme të abuzimit dhe krimit elektronik, është thelbësor për krijimin e një ambienti të besueshëm, për komunikimet dhe transaksionet elektronike.

Ligjet kryesore që lidhen me sigurinë dhe krimin kibernetik janë:

- ligji nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- ligji nr. 2/2017, “Për sigurinë kibernetike”;
- ligji nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- ligji nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;
- ligji nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar”, i ndryshuar;
- ligji nr. 9880, datë 25.2.2008, “Për nënshkrimin elektronik”, i ndryshuar;
- ligji nr. 107, datë 15.10.2015, “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, i ndryshuar.

Lidhur me sa më sipër, është i nevojshëm harmonizimi i legjislacionit në fushën e sigurisë kibernetike, me atë të BE-së, duke krijuar mekanizmin e plotë dhe të qartë të kodifikuar, për të adresuar saktë problematikat dhe për t'i zgjidhur ato.

Gjithashtu është e nevojshme të realizohet, aty ku është e mundur, qasja, nënshkrimi, ratifikimi dhe zbatimi i instrumenteve ndërkombëtare të

sigurisë në internet, duke përfshirë shpërndarjen e burimeve të mjaftueshme, sipas prioriteteve kombëtare, duke marrë në konsideratë zhvillimet teknologjike dhe duke zbatuar parimin e teknologjisë neutrale.

2.3 Internet i sigurt për fëmijët

Përdorimi gjithnjë e në rritje i internetit nga fëmijët, është problematika më e madhe për sa i përket sigurisë së tyre në mjedis *online*, jo vetëm në Shqipëri. Siguria e fëmijëve në internet është një ndër prioritetet e Shqipërisë dhe e të gjitha institucioneve që e kanë në fokus të veprimtarisë së tyre.

Në vitin 2018–2019 u realizua nga *Unicef Albania*, si partneri strategjik dhe kryesor i qeverisë në mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijëve, një studim mbi “**Eksperiencat e fëmijëve në përdorimin e Internetit në Shqipëri**”⁷⁹, i cili anketoi 1000 fëmijë të moshave 9–18 vjeç dhe prindërit e tyre, rezultatet paraprake të të cilit janë si më poshtë:

Mosha mesatare kur fëmijët e anketuar, kanë aksesuar internetin për herë të parë është 9 vjeç, nga ku 37% pohojnë se kanë përdorur internetin nga mosha 8-vjeçare ose/dhe më herët. Ndërsa 51% e fëmijëve të anketuar kanë gjithnjë akses *online* (sa herë që ata dëshirojnë).

Në përgjithësi, fëmijët e anketuar përdorin më shumë internetin dhe kanë më shumë aftësi teknologjike *online* se prindërit e tyre. Kjo përbën një pengesë që prindërit të shoqërojnë në mënyrë efektive eksperiencën e fëmijëve në internet, jo vetëm duke kontrolluar aksesin, por duke i ndihmuar fëmijët të zhvillojnë gjykim kritik mbi eksperiencat dhe përmbajtjet në internet.

Nga studimi rezultoi se gjatë kohës së lundrimit të tyre në internet fëmijët, janë hasur me situata të padëshiruara. Më konkretisht, 14% e fëmijëve të anketuar kanë përjetuar *online* diçka që i ka mërzhitur, veçanërisht mosha 15–17 vjeç. 1 në 10 fëmijë (9%), ka pasur një përvojë seksuale të padëshiruara në internet.

Statistikat nga ky hulumtim tregojnë se fëmijët janë të ekspozuar nga përmbajtje të dëmshme *online* si imazhet e dhunës apo abuzimit (1 në 5 fëmijë),

⁷⁹ Studimi “Eksperiencat e fëmijëve në përdorimin e internetit në Shqipëri” do të publikohet në 2019 nga *Unicef Albania*. Gjetjet paraprake u prezantuan gjatë Samitit “VIRAL” të organizuar nga *Unicef Albania* në nëntor 2018: <https://www.unicef.org/albania/viral-summit-better-Internet-children-and-adolescents-albania>



përmbajtje që flasin për dhunë fizike (17% e fëmijëve) apo përmbajtje që flasin për vetëvrasje (1 në 10 fëmijë). 1 në 5 fëmijë kanë qenë subjekt i mesazheve denigruese dhe të urrejtjes drejt tyre, që është, gjithashtu, një indikator i situatave të mundshme të bullizmit *online*.

Ndërkohë, studimi tregon se fëmijët e kanë të vështirë të ndajnë situatat e vështira që përjetojnë dhe të kërkojnë ndihmë: 1 në 5 fëmijë nuk ia ka treguar askujt ndodhinë që e ka mërztur ndërsa 75% e fëmijëve të anketuar e kërkojnë ndihmën dhe mbështetjen nga bashkëmoshatarët e tyre dhe jo nga të rriturit.

Më shumë se 20% e fëmijëve të anketuar, pranojnë të gjitha kërkesat për shoqëri në rrjetet sociale, ndërsa 25% e fëmijëve pranojnë se kanë bashkëvepruar *online* me dikë, që nuk e njohin në jetën reale dhe 16% e tyre, kanë takuar personalisht dikë, që e kanë njohur vetëm nëpërmjet internetit. Prindërit janë të informuar vetëm për 9% të rasteve të mësipërme.

Fëmijët e anketuar pohojnë se nuk kanë asnjë kontroll ose supervizim nga prindërit, kur shohin video *online* (78%), vizitojnë rrjetet sociale (58%), përdorin aplikacionet e mesazheve (57%) apo përdorin kamerën e kompjuterit ose telefonit (56%).

Siç vihet re nga studimi, përdorimi i internetit nga fëmijët në mënyrë të pakontrolluar është në tregues shumë të lartë. Kjo problematikë shoqërohet shpesh herë edhe me pasoja të rënda. Mungesa e informacionit të prindërit lidhur me rreziqet që paraqet interneti i pasigurt, është në nivele të larta gjithashtu.

Lidhur me kontrollin prindëror, edhe pse ofrohet si mundësi teknike nga disa operatorë të ofrimit të shërbimit të internetit, nuk aplikohet. Gjithashtu, nga studimi i situatës në 7 rajone të vendit, i konstatuar nëpërmjet fushatave ndërgjegjësuese, në të cilën u përfshinë rreth 12.000 fëmijë të shkollave 9-vjeçare, në masë të madhe fëmijët konfirmojnë se prindërit e tyre, nuk kanë informacion të qartë mbi rreziqet e përdorimit të internetit të pasigurt nga fëmijët.

Një studim tjetër i realizuar në 2019 po nga zyra e UNICEF Albania “Faktori Web”⁸⁰ ka evidentuar

një sërë mangësish ligjore dhe institucionale, të cilat pengojnë garantimin me efikasitet të sigurisë së fëmijëve në internet.

Studimi ka gjetur se megjithëse legjislacioni shqiptar në tërësi përputhet me standardet ndërkombëtare përkatëse mbi abuzimin seksual të fëmijëve, ai është shpesh i fragmentuar dhe i mungojnë përkufizime shumë të rëndësishme lidhur me abuzimin seksual të fëmijëve, angazhimin dhe detyrimin e tyre në aktivitete seksuale dhe në aktivitete të tjera të pahijshme. Parimi i mbrojtjes nga materialet e dëmshme dhe të paligjshme në internet pengohet nga dy faktorë: 1. Përkufizimi i materialit të dëmshëm është shumë i përgjithshëm dhe lë shumë hapësirë për gjykim individual; dhe 2. Mungesa e përkufizimeve të qarta të shfrytëzimit të fëmijëve në aktivitete seksuale e bën të vështirë identifikimin e akteve të paligjshme.

Një tjetër gjetje e rëndësishme lidhet me legjislacionin shqiptar që rregullon funksionimin e ofruesve të shërbimit të internetit, i cili është i paqartë, për sa u përket ngarkimit të autoriteteve administrative me kompetencat e bllokimit ose fshirjes së materialeve të caktuara. Kjo i pengon këto autoritete që t’i kuptojnë qartë rolet dhe funksionet e tyre, dhe që të kenë mekanizmat për ushtrimin e tyre. Në këtë fushë nevojitet legjislacion i qartë lidhur me kompetencat dhe procedurat ekzakte të autoriteteve administrative.

Lidhur me hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të abuzimit seksual me fëmijët në internet, studimi pohon se as policia dhe as prokuroria nuk janë plotësisht të pajisura me infrastrukturën e duhur për hetimin efikas të rasteve të abuzimit të fëmijëve në internet. Njësisia për hetimin e krimit kibernetik pranë Policisë së Shtetit ka mungesë mundësish për kryerjen e mbikëqyrjes aktive *online*, duke cenuar aftësinë e tyre për të filluar hetimet *ex officio* dhe proaktive. Mungesa e reagimit të shpejtë nga ofruesit e shërbimit të internetit ndaj kërkesave të prokurorisë, si dhe vështirësitë në identifikimin e adresave IP të kundërvajtësve të pretenduar, ndikojnë në mënyrë shqetësuese në cilësinë dhe efikasitetin e përgjithshëm të hetimit, dhe

kibernetike në Shqipëri:
<https://www.unicef.org/albania/sq/deklarata-shtyp/faktoriweb-vler%C3%ABsimi-i-kuadrit-ligjor-dhe-gatishm%C3%ABris%C3%AB-institucionale-p%C3%ABr>

⁸⁰ UNICEF Albania, 2019, Faktori Web: Vlerësimi i kuadrit ligjor dhe gatishmërisë institucionale për trajtimin e abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve në hapësirën
 Faqe | 1490



rrjedhimisht edhe në mundësinë për t'i vënë autorët para përgjegjesisë.

Studimi tregon se Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijës, por dhe profesionistë të tjerë që merren me mbrojtjen e fëmijëve në internet kanë nevojë për ngritje kapacitetesh dhe mbështetje për adresimin e rasteve të abuzimit të fëmijëve në Internet. Gjithashtu, nuk ka të dhëna specifike të mbledhura dhe të publikuara për abuzimin e fëmijëve në internet.

2.4. Edukimi, hulumtimi dhe trajnimi në fushën e sigurisë kibernetike

Burimet njerëzore me aftësi dhe kualifikime të nevojshme në sigurinë kibernetike, kanë provuar të jenë një nga sfidat më të vështira për vendet në zhvillim, në drejtim të zbatimit të një CSIRT-i kombëtar dhe përmirësimit të gjendjes së përgjithshme kombëtare të sigurisë kibernetike. Është thelbësore që të sigurohet një nivel i mjaftueshëm edukimi, hulumtimi dhe trajnimi për sigurinë në internet, si dhe për të mbështetur nevojat e brendshme për profesionistët e sigurisë kibernetike.

Ekzistojnë disa programe studimi që ofrohen nga institucione të arsimit të lartë, në fushën e sigurisë kibernetike, të cilat janë në fillimet e tyre, por që kërkohet një përpjekje më e madhe për të arritur nivelin e nevojshëm, si dhe, gjithashtu, nuk ka iniciativa kërkimore, për sigurinë kibernetike në Shqipëri. Njohuritë që studentët marrin në universitete, janë të pamjaftueshme për të përballuar kërkesat e tregut për punësim në këtë fushë. Përveç të tjerave edhe stafi akademik paraqet problematikat e veta, në kuptim të mbulimit të spektrit të plotë të kësaj fushe.

Si rrjedhojë hartimi i kurrikulave të mirëfillta për sigurinë kibernetike dhe thellimi i njohurive të stafit akademik është një nevojë imediate për të përballuar kërkesat e tregut.

Nga ana tjetër, rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore nëpërmjet trajnimeve të dedikuara për fushën e sigurisë kibernetike, në administratën publike dhe të gjithë sektorët publikë, është një nevojë tjetër e cila duhet të konsiderohet nga institucionet publike.

Gjithashtu, ekziston nevoja për një qasje të përbashkët, në edukimin e stafit qeveritar dhe publikut në lidhje me praktikën më të sigurtë mbi ndërgjegjësimin për sigurinë kibernetike.

3. VIZIONI I STRATEGJISË

3.1 Vizioni

Garantimi i sigurisë kibernetike në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet ngritjes dhe funksionimit të mekanizmave bashkëveprues institucionale: instrumenteve ligjore dhe teknike, si element kritik i mbrojtjes në hapësirën kibernetike, për infrastrukturën digjitale, transaksionet dhe komunikimet elektronike; nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve profesionale, rritjes së vetëdijes mbarëkombëtare si dhe forcimit të bashkëpunimeve kombëtare dhe ndërkombëtare për një mjedis digjital të sigurt.

3.2 Treguesit e impaktit dhe treguesit e rezultatit

Strategjia Kombëtare e Sigurisë Kibernetike do të monitorohet nëpërmjet matjes së indikatorëve bazë të përcaktuar në aneksin Pasaporta e indikatorëve. Me qëllim ndjekjen e realizimit të objektivave specifike, të përkthyer në plan veprimi të detajuar, janë hartuar indikatorët bazë, të cilët do të shërbejnë si udhëzues për të monitoruar realizimin e Strategjisë.

Indikatorët janë konceptuar të tillë që të jenë të kuptueshëm, të matshëm dhe lehtësisht të krahasueshëm, sipas periudhave të monitorimit. Për çdo objektiv specifik janë planifikuar, 2 indikatorë bazë, të cilët mund të jenë të thjeshtë apo të përbërë, në varësi të nënobjektivave që do të matin.

PJESA II

QËLLIMI I POLITIKAVE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKE TË STRATEGJISË

Me qëllim rritjen e nivelit të sigurisë kibernetike në vend, Qeveria e Republikës së Shqipërisë duhet të përmbushë këto qëllime:

Garantimi i sigurisë kibernetike në nivel kombëtar, nëpërmjet mbrojtjes së infrastrukturave të informacionit, duke fuqizuar mjetet teknologjike dhe juridike.

Ndërtimi i një mjedisi të sigurt kibernetik, duke ndërgjegjësuar shoqërinë dhe duke ngritur kapacitetet profesionale.

Krijimi i mekanizmave të nevojshëm për sigurinë e fëmijëve në hapësirën kibernetike, duke përgatitur njëkohësisht brezin të ri të aftë për të përfutur nga përparësitë e teknologjisë së informacionit dhe për të përballuar sfidat e zhvillimit.



Rritja e bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e sigurisë kibernetike me partnerët strategjikë.

4. Qëllimi i politikës 1. Garantimi i sigurisë kibernetike në nivel kombëtar, nëpërmjet mbrojtjes së infrastrukturave të informacionit, duke fuqizuar mjetet teknologjike dhe juridike

Zhvillimet e vrullshme në të gjithë sektorët e ekonomisë të mbështetur fuqishëm dhe nga inovacionet teknologjike, e bëjnë shumë të vështirë për vendimmarrësit të kuptojnë dhe të minimizojnë rreziqet, që rrjedhin nga përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Këto rreziqe janë përgjegjësi e përbashkët globale dhe përfshijnë perspektiva kombëtare dhe ndërkombëtare. Përgjegjësia e përbashkët brenda vendit, përfshin si industrinë, ashtu edhe administratën dhe qytetarët.

Hartimi dhe aplikimi i politikave dhe i mjeteve për krijimin e një mjedisi të sigurt komunikimi, është komponenti më i vlefshëm për menaxhimin e incidenteve të sigurisë kibernetike, si dhe kryerjen e transaksioneve elektronike të sigurta në tregun e brendshëm, me qëllim garantimin e bashkëveprimit të sigurt elektronik midis autoriteteve publike dhe qytetarëve, bizneseve, duke rritur efektivitetin e shërbimeve *online* publike dhe private, të biznesit dhe tregtisë elektronike.

Mjedisi digjital është i ndjeshëm: sistemet dhe rrjetet e informacionit, mund të ndikohen nga incidentet e sigurisë, siç janë gabimet njerëzore, ngjarjet natyrore, dështimet teknike ose sulmet. Këto situata po rriten dhe po bëhen gjithnjë e më komplekse dhe mund të çojnë në humbje të mëdha financiare dhe të ndikojnë në mirëqenien e shoqërisë në përgjithësi.

Ndërtimi i besimit në mjedisin *online* është çelësi për zhvillimin ekonomik dhe social. Mungesa e besimit, në veçanti për shkak të mungesës së perceptuar të sigurisë kibernetike i bën konsumatorët të hezitojnë në përdorimin e transaksioneve elektronike.

4.1 Objektivi specifik 1: Përmirësimi i kuadrit ligjor që normon dhe rregullon fushën e sigurisë kibernetike në vend, si dhe harmonizimi i i tij me direktivat dhe rregulloret e Bashkimit Evropian.

Aktualisht, autoritetet e sigurisë në vend, kanë krijuar bazën ligjore mbi të cilën të ushtrojnë veprimtarinë e tyre. Pavarësisht hartimit të ligjeve e akteve nënligjore, rregulloreve dhe standardeve,

nga analiza e kryer, si dhe nga vlerësimi i nivelit të maturimit të sigurisë kibernetike në vend, është evidentuar nevoja për rishikim të të gjithë kuadrit ligjor e rregullator, me qëllim harmonizimin e plotë me direktivat e Bashkimit Evropian, si dhe me qëllim koordinimin e brendshëm institucional.

Realizimi i këtij objektivi specifik synon të kryejë harmonizimin e legjislacionit shqiptar mbi sigurinë kibernetike me atë të BE-së. Gjithashtu, do të hartohet një procedurë kombëtare për veprim në rastet e gjendjeve të jashtëzakonshme të krijuara nga krizat kibernetike.

Nënobjektivat:

4.1.1 Përmirësimi i kuadrit rregullator për sigurinë kibernetike i harmonizuar me ligjet sektoriale, për të adresuar saktë çështjet dhe zgjidhur ato, duke përfshirë, por pa u kufizuar: IoT, teknologjinë 5G, inteligjencën artificiale.

4.1.2 Përshatja e vazhdueshme e standardeve dhe rregullave, sipas zhvillimeve të fushës, së sigurisë kibernetike.

4.1.3 Përmbushja e angazhimeve të marra si vend i Aleancës së Atlantikut të Veriut, për hapësirën kibernetike.

4.1.4 Përcaktimi i një procedure kombëtare për rastet e gjendjeve të jashtëzakonshme të krijuar nga krizat kibernetike, me qëllim marrjen e masave konkrete për zgjidhjen e situatës në kohe reale.

4.2 Objektivi specifik 2: Ngritja dhe funksionimi i CSIRT-eve në të gjithë sektorët e industrisë në nivel kombëtar

Bazuar në ligjin “Për sigurinë kibernetike” dhe detyrimeve që rrjedhin prej tij, me qëllim garantimin e sigurisë së sistemeve të informacionit dhe komunikimit, është detyrim identifikimi dinamik i infrastrukturave kritike e të rëndësishme të informacionit, si dhe më tej ngritja e ekipeve të përgjigjeve ndaj incidenteve (CSIRT). Aktualisht kanë filluar të merren masat e para për ngritjen e tyre në disa prej infrastrukturave tashmë të përcaktuara me vendim, por ky është një proces në vijueshmëri, i cili monitorohet nga AKCESK-i.

Realizimi i këtij objektivi të politikës 1 do të matet me numrin e CSIRT-eve. Të gjithë operatorët e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit duhet të kenë CSIRT-et përkatëse, të cilat duhet të zbatojnë të gjitha kërkesat minimale të miratuara dhe audituara nga AKCESK-u.

**Nënobjektivat:**

4.2.1 Krijimi i kushteve optimale të punës për funksionimin e CSIRT-eve, në përmbushje të detyrave të veta, për të garantuar sigurinë kibernetike në infrastrukturat kritike e të rëndësishme të informacionit.

4.2.2 Ngritja e kapaciteteve të CSIRT-eve nëpërmjet trajnimeve dhe stërvitjeve kibernetike.

4.3 Objektivi specifik 3: Fuqizimi dhe implementimi i masave të sigurisë në infrastrukturat kritike dhe të rëndësishme të informacionit

Bazuar në vlerësimet e bëra gjatë viteve 2018–2019 nga autoriteti përgjegjës i fushës së sigurisë kibernetike, tek infrastrukturat kritike e të rëndësishme të informacionit, mbetet si një detyrë parësore, shtimi dhe fuqizimi i implementimit të masave të sigurisë. Institucionet publike e private duhet të përmirësojnë procedurat e tyre, hartimin e planeve strategjike për mbrojtjen kibernetike nga sulmet apo krimi kibernetik, si dhe planet për menaxhimin e riskut në rastet kur ndodhin këto sulme. Objektivi i kësaj Strategjie është nxitja dhe detyrimi që të gjitha infrastrukturat kritike e të rëndësishme të informacionit të hartojnë planet strategjike në rastet e sulmeve kibernetike, si dhe të marrin masa për të përballuar këto sulme dhe për të rikuperuar dëmin apo për të eliminuar atë tërësisht.

Realizimi i këtij objektivi specifik do të kërkojë që të gjithë operatorët e infrastrukturave kritike e të rëndësishme të informacionit, të cilët kanë CSIRT-et e tyre, të implementojnë sisteme të specializuara në identifikimin e sulmeve kibernetike, parandalimin e tyre, analizimin e rikuperimit e dëmeve nga këto sulme, si dhe nxjerrjen e mësimave për të ardhmen. Gjithashtu, operatorët duhet të kryejnë analizat e menaxhimit të riskut, si dhe vetëvlerësimet në lidhje me nivelin e maturimit të sigurisë kibernetike në infrastrukturat që administrojnë.

Nënobjektivat:

4.3.1 Përdorimi i zgjidhjeve *hardware* dhe *software* të avancuara për identifikimin, parandalimin dhe menaxhimin e incidenteve kibernetike.

4.3.2 Analizimi i infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit për vlerësimin e menaxhimin e riskut në to.

4.3.3 Hartimi i planeve strategjike për mbrojtjen e hapësirës kibernetike nga incidente të mundshme.

4.3.4 Realizimi i vetëvlerësimeve në infrastrukturat kritike dhe të rëndësishme të informacionit për matjen e nivelit të maturimit të sigurisë kibernetike.

4.4 Objektivi specifik 4: Përmirësimi i infrastrukturave të informacionit për të luftuar krimin kibernetik, radikalizimin dhe ekstremizmin e dhunshëm.

Interneti është një mjet që nga njëra anë ndikon në zhvillimin e shoqërisë, në lehtësimin e procedurave dhe akses të shpejtë në të dhëna, por nga tjetër është një mjet për individë/grupe keqbërëse që kryejnë krime kibernetike apo që përpiqen të radikalizojnë individë nga shtresa vulnerabël apo të marxhinalizuara me qëllime ekstremiste e për të kryer akte të dënueshme nga shoqëria. Lidhur me këtë fenomen është e nevojshme që të merren një sërë masash nga institucionet publike dhe private për t'i luftuar ato dhe për t'i mbajtur nën kontroll deri në minimizim të tyre.

Për të realizuar sa më lart, do të synohet ngritja e mekanizmave për të rregulluar e ofruar internet të sigurt në ambientet publike. Gjithashtu do të synohen bashkëpunime me organizatat e shoqërisë civile dhe bizneset me qëllim mbajtjen nën kontroll dhe evidentimin e elementeve kontaminues që qarkullojnë në internet e që cenojnë sigurinë kibernetike në vend. Pra do të ngrihen dy mekanizma për të monitoruar fenomenet e mësipërme.

Nënobjektivat:

4.4.1 Monitorimi dhe parandalimi i fenomeneve, që nxisin ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin në shtresat vulnerabël në hapësirën kibernetike.

4.4.2 Evidentimi në vazhdimësi i elementeve kontaminues, që qarkullojnë në internet, që cenojnë sigurinë kibernetike në vend.

4.4.3 Ngritja e mekanizmave për rregullimin e internetit të sigurt në ambientet publike, të certifikuar nga autoriteti rregullues i fushës së sigurisë kibernetike.

4.4.4 Ngritja e kapaciteteve të autoriteteve përgjegjëse kundër krimit kibernetik.

4.4.5 Rritja e bashkëpunimit rajonal në luftën kundër krimit kibernetik.

5. Qëllimi i politikës 2: Ndërtimi i një mjedisi të sigurt kibernetik, duke edukuar dhe ndërgjegjësuar shoqërinë në ngritjen e



kapaciteteve profesionale në fushën e sigurisë së informacionit

Ekzistenca e aftësive dhe kapaciteteve profesionale për t'u përgjigjur dhe për të menaxhuar incidente të sigurisë kibernetike nuk është më opion në ditët e sotme.

Rritja e kapaciteteve në fushën e sigurisë kibernetike ka për qëllim përgjigjen në mënyrë efektive ndaj krimit kibernetik. Ky është një komponent integral i bashkëpunimit ndërkombëtar që mund të rrisë harmonizimin me vizionin e BE-së për një hapësirë kibernetike globale, të hapur, të lirë e të sigurt për të gjithë, duke siguruar respektimin e të drejtave të njeriut.

Metodat e përdorura për rritjen e kapaciteteve dhe ndërgjegjësimin e shoqërisë janë thelbësore për të përcaktuar efektivitetin e ndërtimit të një mjedisi të sigurt.

5.1 Objektivi specifik 1: Rritja e kapaciteteve profesionale në fushën e sigurisë së informacionit nëpërmjet rishikimit të kurrikulave arsimore.

Nënobjektivat:

5.1.1 Hartimin e programeve të studimit në arsimin e lartë në fushën e sigurisë kibernetike, me qëllim krijimin e gjeneratës së re të ekspertëve të sigurisë kibernetike.

5.1.2 Hartimi i rekomandimeve për integrimin në kurrikula universitare të informacioneve në lidhje me internetin e sigurt.

5.1.3 Rritja e kapaciteteve kërkimore dhe inovative në fushën e sigurisë kibernetike

5.2 Objektivi specifik 2: Rritja e ndërgjegjësimin dhe e aftësive profesionale të institucioneve publike dhe private për sigurinë kibernetike.

Nënobjektivat:

5.2.1 Trajnime periodike për thellimin e njohurive në sigurinë kibernetike, sipas dinamikës së fushës, për stafin administrativ në nivel qendror dhe në nivel lokal.

5.2.2 Rritja dhe mbështetja e kapaciteteve kërkimore dhe risive të biznesit nëpërmjet nxitjes së ngritjes së qendrave kërkimore shkencore në fushën e sigurisë kibernetike.

5.2.3 Rritja e kapaciteteve të CSIRT-eve në nivel kombëtar dhe nivelit ekzekutiv të administratës publike nëpërmjet trajnimeve dhe stërvitjeve kibernetike.

5.3 Objektivi specifik 3: Rritje e ndërgjegjësimin të shoqërisë, për sigurinë kibernetike dhe për kërcënimet kibernetike.

Nënobjektivat:

5.3.1 Organizimi i fushatave ndërgjegjësuere nga autoriteti përgjegjës, për sigurinë kibernetike, me grupe interesi të ndryshme, duke përdorur hapësirat e duhura për realizimin e tyre, përfshirë edhe mediat audiovizive apo edhe ato sociale.

5.3.2 Krijimin e një platforme edukative *online*, për sigurinë kibernetike, për të rritur ndërgjegjësimin në grup-mosha të ndryshme të shoqërisë, për përdorimin e internetit të sigurt dhe të infrastrukturës digjitale.

6. Qëllimi i politikës 3: Krijimi i mekanizmave të nevojshëm për sigurinë e fëmijëve në hapësirën kibernetike, duke përgatitur njëkohësisht brezin e ri të aftë për të përfituar nga përparësitë e teknologjisë së informacionit dhe për të përballuar sfidat e zhvillimit

Ofrimi i internetit të sigurt për fëmijët dhe të rinjtë në Shqipëri mbetet një nga objektivat strategjikë të qeverisë shqiptare, siç është shprehur dhe në Agjendën Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017–2020. Për një numër të konsiderueshëm të fëmijëve, sot interneti, telefonat celularë, dhe teknologjitë e tjera të informacionit janë bërë pjesë e jetës së përditshme. Familja (prindërit), bashkëmoshatarët dhe shkolla janë tri mjediset e socializimit të fëmijëve, ndërsa mjedisi digjital është bërë i katërti. Për ta, dallimi midis *online* dhe *offline*, gjithnjë e më shumë bëhet i pakuptimtë, dhe ata lëvizin pa ndërprerje ndërmjet të dy mjediseve. Mbrojtja e fëmijëve në internet kërkon veprime specifike dhe të artikuluar në mënyrë të qartë. Njëkohësisht mbrojtja e fëmijëve duhet të jetë proporcionale me rreziqet që fëmijët hasin, dhe nuk duhet të pengojë përdorimin e teknologjive të informacionit për rritjen, edukimin dhe zhvillimin e fëmijëve. Politikat e qeverisë duhet të krijojnë një mjedis digjital, i cili i përgjigjet nevojave të fëmijëve, duke garantuar njëkohësisht mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të tyre. Për këtë arsye, ndërmarrja e hapave të menjëhershëm për të krijuar mjedise digjitale të sigurta është e rëndësishme, duke garantuar njëkohësisht



respektimin e të drejtave dhe arritjen e potencialit maksimal të zhvillimit të fëmijëve.

6.1 Objektivi specifik 1: Forcimi i kuadrit ligjor për rritjen e sigurisë së fëmijëve në internet

Nënobjektivat:

6.1.1 Hartimi i një baze ligjore të posaçme për mbledhjen e të dhënave të incidenteve të raportuara të dhunës, bullizimit dhe abuzimit *online* të fëmijëve në shkolla.

6.1.2 Përmirësimi i Kodit Penal, për ta sjellë në linjë me legjislacionin ndërkombëtar për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi seksual në internet.

6.1.3 Ndryshimi i dispozitave procedurale penale në Kodin e Procedurës Penale dhe miratimi i akteve rregullatore lidhur me parashkrimin e veprave penale lidhur me abuzimin seksual të fëmijëve, si dhe procedurat dhe afatet e nevojshme për të rritur efikasitetin e hetimit, prioritizimin e rasteve dhe analizën e provave lidhur me rastet e abuzimit seksual të fëmijëve nëpërmjet internetit dhe teknologjive të komunikacionit.

6.1.4 Plotësimi dhe çartësimi i legjislacionit në lidhje me njoftimin dhe heqjen dhe bllokimit të materialeve të paligjshme *online*.

6.2. Objektivi specifik 2: Parandalimi i abuzimit seksual të fëmijëve në internet nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit dhe krijimit të hapësirave të sigurta për lundrimin në internet

Nënobjektivat:

6.2.1 Përmirësimi dhe krijimi i programeve për ndërgjegjësimin mbi sigurinë në internet në sistemin edukativ.

6.2.2 Krijimi dhe mbështetja e rrjetit *online* të mësuesve të TIK-ut për të promovuar çështjen e mbrojtjes së fëmijëve në internet.

6.2.3 Krijimi ose përmirësimi i hapësirave publike me internet të sigurt për fëmijët dhe familjet nëpërmjet nismave për të ofruar aksesim falas të internetit por njëkohësisht informacion të filtruar me qëllim mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve nga përmbajtjet abuzuese *online*.

6.2.4 Aplikimi i filtrave në shkollat publike dhe private për të parandaluar aksesin e fëmijëve në faqe të papërshtatshme dhe të paligjshme, si dhe informimi në vijueshmëri i mësuesve të TIK për raportimin e incidenteve.

6.2.5 Identifikimi, mbështetja dhe promovimi i talenteve për të krijuar zgjidhje teknike që ndihmojnë në mbrojtjen dhe sigurinë *online*.

6.3 Objektivi specifik 3: Hetimi efektiv dhe sjellja para drejtësisë e autorëve të krimeve kibernetike ndaj fëmijëve, me fokus abuzimin dhe shfrytëzimin seksual

Nënobjektivat:

6.3.1 Sigurimi i sigurimit të mjeteve teknike që ndihmojnë policinë dhe organet përkatëse në analizimin dhe zbulimin e rasteve të dhunës *online*, veçanërisht lidhur me imazhet e abuzimit seksual me fëmijët

6.3.2 Krijimi i programeve të trajnimit për personelin e gjyqësorit, prokurorisë dhe policisë, në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve në internet dhe sigurinë kibernetike, duke përfshirë evidenca të përdorimit digjital dhe ndihmën e ndërsjellë juridike.

6.3.3 Ngritja e një sistemi kursesh pranë Shkollës së Magjistraturës dhe Akademisë së Sigurisë, në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me krimet ndaj fëmijëve *online* dhe mënyrat e mbrojtjes së tyre në internet.

6.3.4 Krijimi i mekanizmeve për standardizimin e punës së analizimit të provave digjitale nga struktura e krimit kibernetik në Policinë e Shtetit.

6.3.5 Krijimi i një grupi pune së bashku me strukturat e krimit kibernetik në Policinë e Shtetit dhe industrinë për të zgjidhur problemet e hetimit dhe identifikimit të personave të dyshuar për abuzim me fëmijët *online*, me fokus të veçantë identifikimin e përdoruesve fundorë nëpërmjet adresave IP.

6.4 Objektivi specifik 4: Rritja e ndërgjegjësimit dhe edukimi tek të gjitha segmentet e shoqërisë për përdorimin e sigurt të internetit nga fëmijët

Nënobjektivat:

6.4.1 Fushata ndërgjegjësimi me prindërit dhe edukatorët në lidhje me rreziqet dhe problemet me të cilat përballen fëmijët në internet.

6.4.2 Zhvillimi i programeve të trajnimit me mësuesit e TIK-ut, në lidhje me çështjet e internetit të sigurt.

6.4.3 Zhvillimi i programeve të trajnimit për Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijës lidhur me trajtimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje ku rreziku i dhunës, abuzimit, shfrytëzimit



apo i neglizhimit lidhet me internetin dhe teknologjitë e informacionit.

6.5 Objektivi specifik 5: Forcimi i bashkëpunimit ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijëve në internet

Nënobjektivat:

6.5.1 Promovimi nëpërmjet bashkëpunimit me të gjitha ISP-të i mekanizmave ekzistues të aplikuar në platformat e tyre për sigurinë e fëmijëve në internet.

6.5.2 Integrimi nga të gjitha ISP-të në platformat e tyre të listës IWF (*Internet Watch Foundation Hash List*), që ndalon çdo individ të hedhë, shkarkojë apo shikojë imazhe apo video të abuzimit seksual të fëmijëve, si dhe krijimin e aksesit të strukturave të hetimit të krimit kibernetik në Policinë e Shtetit në këtë listë.

6.5.3 Ngritja e një Komiteti Teknik Këshillues për Sigurinë e Fëmijëve në internet, pranë Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve.

7. Qëllimi i politikës 4: Rritja e bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e sigurisë kibernetike me partnerët strategjikë

Koordinimi dhe bashkëpunimi i të gjithë aktorëve është elementi bazë për garantimin e suksesit. Për shkak të dinamikës dhe shpejtësisë me të cilën zhvillohet Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) bashkëpunimi me sektorin privat duhet të forcohet. Vetëm nëpërmjet një bashkëpunimi të ngushtë mund të rritet siguria dhe zhvillimi i TIK-ut në administratën shtetërore në koherencë me zhvillimet dhe trendin e teknologjisë.

Rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet institucioneve shtetërore do të forcohet për të garantuar ndërveprimin dhe koordinimin në forcimin e sigurisë dhe minimizimin e dëmeve nga sulmet kibernetike.

Shqipëria mbështet dhe do të jetë pjesë e iniciativave ndërkombëtare, të cilat synojnë rritjen dhe forcimin e sigurisë. Në mënyrë të veçantë do të forcohet bashkëpunimi me NATO-n dhe BE-në, duke u bërë pjesë aktive e iniciativave të përbashkëta për sigurinë kibernetike. Anëtarësimi i Shqipërisë në organizmat dhe forumet e sigurisë kibernetike të njohura ndërkombëtare dhe rritja e bashkëpunimit është prioritet.

Në cilësinë e vendit anëtar të NATO-s, Shqipëria njeh hapësirën kibernetike si domainin e pestë të luftës, së bashku me tokën, detin, ajrin dhe

hapësirën. Hapësira kibernetike paraqet sfida dhe siguria në këtë hapësirë arrihet vetëm, duke menduar në nivel global dhe duke punuar ngushtë në nivel ndërkombëtar.

7.1 Objektivi specifik 1: Forcimi i bashkëpunimit institucional në nivel kombëtar

Nënobjektivat:

7.1.1 Rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet institucioneve shtetërore për të garantuar sigurinë në nivel kombëtar në hapësirën kibernetike.

7.1.2 Krijimi i një instrumenti për shkëmbimin e informacionit përmes pikave të kontaktit të dedikuara nga institucionet përkatëse, në raste të kërcënimeve kibernetike.

7.1.3 Ngritja e një strukture fleksibël me ekspertët më të mirë të sigurisë kibernetike në vend, me qëllim mbështetje në raste krizash kibernetike, testimi dhe vlerësimi të nivelit të sigurisë kibernetike në nivel kombëtar.

7.2 Objektivi specifik 2: Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes kibernetike dhe luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit

Nënobjektivat:

7.2.1 Zhvillimi i mekanizmave dhe i procedurave efikase, për bashkëpunim ndërkombëtar, në rast të incidenteve kibernetike, sulmeve dhe krizave, sipas parimeve të vendosura ndërkombëtarisht.

7.2.3 Forcimi i bashkëpunimit dhe shkëmbimi i informacionit me NATO-n/OSBE-në dhe organizata/forume të tjera ndërkombëtare.

PJESA IV ZBATIMI, PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, LLOGARIDHËNIA

Hartimi i Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Kibernetike, 2020–2025, mbështetet në Strategjinë e Sigurisë Kibernetike të Bashkimit Evropian dhe është në vijim të Dokumentit të Politikave për Sigurinë Kibernetike, 2015–2017.

- Metodologjia u përcaktua të jetë me pjesëmarrje të të gjitha institucioneve publike kontribuese në sigurinë kibernetike të vendit, si dhe gjithëpërfshirëse, duke i ofruar një numri të madh aktorësh mundësinë për të kontribuar.



- Strategjia u mbështet në angazhimet dhe standardet e BE-së dhe organizmave të tjerë ndërkombëtarë, si dhe mbi dy vlerësimet e kryera nga ITU dhe *Oxford University*, me mbështetjen e Bankës Botërore.

- Angazhimi i institucioneve publike dhe private i jep kësaj Strategjie mundësinë për të qenë objektive dhe e realizueshme. Grupi ndërinstitucional i punës, si dhe të gjithë aktorët e përfshirë në konsultime dhanë komente të vlefshme, duke e rishikuar disa herë draftin e përgatitur me qëllim miratimin e një strategjie gjithëpërfshirëse, ku secili të gjejë veten e të japë kontributin e tij në garantimin e sigurisë kibernetike të vendit.

- Kjo Strategji nuk është një strategji vetëm për institucionet, por është një strategji që nxit dhe mbështet mbrojtjen kibernetike edhe të individit, qytetarëve dhe, veçanërisht, fëmijëve si e ardhmja e këtij vendi. Në të evidentohen edhe masa për të luftuar jo vetëm krimin kibernetik, por edhe nxitjen e terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm nëpërmjet hapësirës kibernetike.

Plani i veprimit që shoqëron Strategjinë Kombëtare të Sigurisë Kibernetike, 2020–2025 u përgatit, bazuar në:

a) gjetjet e rekomandimet e raportit të vlerësimit të zbatimit të Dokumentit të Politikave për Sigurinë Kibernetike 2015–2017;

b) gjetjet e rekomandimet e dhëna në raportet e vlerësimit nga ITU⁸¹ dhe *Oxford University*⁸²;

c) në planet buxhetore të institucioneve publike për periudhën 2020–2022.

Sikurse paraqitet edhe në objektivat specifike dhe aktivitetet kryesore të propozuara në këtë Strategji dhe Planin e Veprimit, rolin koordinues duhet ta kryejë Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.

Gjithashtu, në këtë dokument janë marrë parasysh detyrimet që lindin nga procesi i integritimit evropian dhe rekomandimet e lëna, nga *NIS Direktive* dhe përshtatja që po bëhet në BE për

81

https://cesk.gov.al/Publikime/2019/Albania_Assessment_ReportITU.pdf

82

<https://cesk.gov.al/Publikime/2019/AlbaniaCMMReport.pdf>

ENISA si EU CERT, si dhe angazhimet si vend anëtar i NATO.

Të gjitha masat/aktivitetet e propozuara, pasi u vlerësuan dhe plotësuan edhe nga grupi ndërinstitucional i punës, përgjegjës për hartimin e Strategjisë, u detajuan më tej gjatë vlerësimit të efekteve financiare për zbatimin e kësaj Strategjie Kombëtare dhe Planit të saj të Veprimit 2020–2025, me nevojën për rishikim çdo dy vjet, bazuar në dinamikën e zhvillimit të sektorit.

Secili institucion përgjegjës për aktivitetet duhet të planifikojë realizimin e tyre duke garantuar buxhetet e planifikuara, burimet njerëzore dhe kapacitetet teknike me qëllim realizimin e tyre.

Çdo vit do të bëhet vlerësimi i zbatimit të aktiviteteve dhe arritjes së objektivave të identifikuar nëpërmjet realizimit të indikatorëve. Institucionet përgjegjëse për realizimin e aktiviteteve dhe arritjes së rezultateve kanë detyrimin e raportimit sipas standardeve raportuese. Koordinator i Strategjisë duhet të përgatitë raportin vjetor dhe ta publikojë.

PJESA V

PLANI I VEPRIMIT DHE BURIMET FINANCIARE PËR ZBATIM

Metodologjia e kostimit të aktiviteteve

Shpenzimet e nevojshme për zbatimin e PKV-së janë nxjerrë duke kostuar secilin nga aktivitetet e këtij plani veprimi. Metodologjia e zbatuar për llogaritjen e kostove paraqet një kombinim të metodave që mund të përdoren në rastet e strategjive me shumë aktorë.

Metodologjia kryesore e përdorur është kostimi i bazuar në aktivitetet (*Activity Based Costing-ABC*), ku për çdo aktivitet evidentohet institucioni përgjegjës si dhe burimi i mbulimit të kostove dhe alokon burimet për të gjitha produktet dhe shërbimet në bazë të konsumit aktual për secilin aktivitet.

Buxheti u hartua mbështetur në koston e secilit aktivitet të pasqyruar në planin e veprimit, kohështrirjen dhe frekuencën e zbatimit të tij, si dhe numrin e përfituesve për aktivitetet e caktuara.

Për llogaritjen e shpenzimeve për aktivitetet kryesore është vepruar si më poshtë:

- Llogaritja e shpenzimeve për burime njerëzore bazohet në kohën e parashikuar për realizimin e veprimtarisë dhe një page mesatare ditore të një kategorie të caktuar të nëpunësve civilë,



- Llogaritja e shpenzimeve për shërbime.

Për këto aktivitete janë mbajtur parasysh kostot e shërbimeve të institucioneve përkatëse, bazuar në standardet e miratuara.

- Llogaritja e shpenzimeve për aktiviteteve që lidhen me hartimin dhe rishikimin e legjislacionit, monitorimin dhe funksionimin e strukturave të përhershme etj.

Për këto aktivitete gjatë llogaritjeve janë mbajtur parasysh shpenzimet e vazhdueshme që do të ndodhin, për shembull për pagat, kontributet e sigurimeve shoqërore, ekspertizë të huaj (kur është parashikuar në plan) dhe mjete konsumi.

- Llogaritja e shpenzimeve për aktiviteteve që lidhen me studime, fushata ndërgjegjësuere programe trajnimi ekspertiza thuaja etj., llogaritja e kostove është bërë sipas iniciativave specifike të ngjashme, si dhe sipas natyrës së aktiviteteve dhe kostove që ofron tregu për shërbime të tilla.

- Në llogaritjen e shpenzimeve për trajnime është mbajtur në konsideratë kosto e trajnimit për një person. Si kosto për njësi janë përdorur kostot e ASPA-s dhe/ose kostot e aplikuarra për trajnime të ngjashme në të shkuarën.

- Për atë pjesë të aktiviteteve ku informacioni nuk ishte i plotë (si në rastin e projekteve apo studimeve) është ndjekur metoda e vlerësimit për analogji ose me fjalë të tjera janë marrë në konsideratë shpenzimet e bëra për aktivitete të ngjashme që kanë qenë përfshirë në planet buxhetore të mëparshme.

Buxheti dhe burimet financiare për zbatimin e planit të veprimit

Strategjia Kombëtare e Sigurisë Kibernetike do të zbatohet në periudhën 2020-2025. Për të mundësuar zbatimin e saj janë llogaritur shpenzimet e nevojshme për zbatimin e secilit aktivitet, objektiv specifik dhe qëllimit të politikave.

Buxheti i përgjithshëm për zbatimin e Strategjisë është reflektuar në disa forma:

- Buxheti i përgjithshëm sipas viteve për secilin aktivitet, objektiv specifik, qëllim strategjik dhe burimeve të financimit

- Buxheti i detajuar sipas aktiviteteve, burimeve të financimit dhe institucioneve përgjegjëse

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 760 lekë